



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të
Posta Shqiptare SHA

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI PËRPUTHSHMËRINË
NË
POSTA SHQIPTARE SHA

DHJETOR 2023

Përmbajtja	faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	22
II. HYRJA	24
1. Objekti i auditimit	24
2. Qëllimi i auditimit	24
3. Identifikimi i çështjes:	25
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:	25
5. Përgjegjësitë e Audituesve:	25
6. Kriteret e vlerësimit.....	25
7. Standardet e auditimit.....	27
8. Metodot e auditimit	27
9. Dokumentimi i auditimit	27
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	29
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM.....	29
2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	30
2.1 Mbi funksionimin e strukturave të auditimit të brendshëm dhe sistemit të kontrollit të brendshëm financiar.	30
2.2 Hartimi dhe realizimi i programit ekonomik-financiar si dhe miratimi i tyre në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet eprore.	34
2.3 Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.	51
2.4 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.....	119
2.5 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.....	120
2.6 Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta, sponsorizime, etj)....	124
2.7 Mbajtja e evidencës kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë dhe hartimi i pasqyrave financiare.	134
2.8 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.....	137
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	138

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

KLSH në periudhën nga data 23.01.2023 deri më datë 12.05.2023 kreu auditimin mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA për periudhën nga data 01.06.2019 deri në 31.12.2022, duke u përqendruar në auditimin e funksionimit të strukturave të auditimit të brendshëm dhe sistemit të kontrollit të brendshëm financiar, hartimin dhe realizimin e programeve ekonomiko – financiare si dhe miratimin e tyre në organet kompetente, ligjshmërinë e procedurave të prokurimit publik si dhe ato të zbatimit të kontratave të lidhura për shërbime, mallra dhe punime, ligjshmërinë e emërimeve, strukturën organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve, blerjet e vogla si dhe organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Grupi i Auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të Auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA për periudhën 01.06.2019 – 31.12.2022, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë **opinion të kualifikuar mbi përputhshmërinë** e veprimtarisë ekonomike dhe financiare.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 32 akte, nga të cilat 29 akt konstatime dhe 3 akt verifikime, të dorëzuara në protokollin e subjektit të audituar brenda afateve. Pas shqyrtimit me objektivitet dhe paanshëmri të observacioneve të dërguara, përmes shkresës së datës 08.11.2023 është përcjellë në subjekt Projektraporti i Auditimit, për të cilin janë dorëzuar komente sipas shkresës së administruar në KLSH me nr. 406/10 prot., datë 19.12.2023 nga ana e institucionit të audituar jashtë afatit 1 muhor. Përmes e-mailit të datës 13.12.2023 është njoftuar subjekti në lidhje me vijimin e procedurave për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi i evidencës dokumentare të administruar nga grupi i auditimit të KLSH, rezultojnë se: a. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar plane afat mesme apo afat gjatë të zhvillimit strategjik të saj. b. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar dhe miratuar plan biznesin afatmesëm të shoqërisë. Si rezultat i mungesës së dokumenteve dhe planeve strategjike shoqëria Posta Shqiptare nuk ka përcaktuar objektiva të qarta të zhvillimit, të cilat do të shërbenin si objektiva të matshme për	34 – 50	E lartë	Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të filloj hartimin dhe miratimin e planit të biznesit dhe dokumentet e tjerë strategjik të zhvillimit ekonomik afat mesëm dhe afat gjatë të shoqërisë.

	<p>valerësimin e performancës së drejtimit të shoqërisë dhe në përmirësimin e performancës së shoqërisë. Mungesa e hartimit dhe miratimit të këtyre dokumenteve strategjik, ngarkon me përgjegjësi organet drejtuese të shoqërisë si këshillin mbikëqyrës dhe administratorët respektiv brenda periudhës së auditimit.</p>			
2	<p>Disa zyra postare të marra me qira në Tiranë rezultojnë të kenë distanca të afërta me njëra tjetrën. Kjo distancë e afërt ka sjellë tejkalim të nevojave të qytetarëve në këto zona për të përdorur shërbimet e postës. Edhe pse në relacionet përkatëse hartuar nga Drejtori i Filialit Tiranë kërkohen ambiente të reja për nevojat operacionale të postës me arsyetimin se ka një ngarkesë të madhe, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga filiali i postës për qytetin e Tiranës për rezultatin ekonomik të zyrave postare u konstatua se këto zyra kryejnë një aktivitet të ulët për ofrimin e shërbimeve që kryen Posta Shqiptare duke rezultuar në të ardhura të pakta në krahasim me shpenzimet dhe si rezultat kjo përben shpenzime pa efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet. Këto zyra postare që janë marrë me qira nga Posta Shqiptare rezultojnë të kenë një bilanc negativ ku disa nga këto zyra postare rezultojnë me humbje prej vitesh.</p>	34 – 50	E lartë	<p>Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kryerjen e një analize të saktë në lidhje me nevojat për marrjen me qira të ambienteve postare për të shmangur përdorimin e fondeve pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.</p>
3	<p>Në asnjë rast nuk është përlogaritur sipërfaqja e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të zyrave postare, duke pasur në konsideratë numrin e punonjësve të zyrave.</p>	34 – 50	E lartë	<p>Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kryerjen e një analize të saktë në lidhje me sipërfaqen e ambienteve postare të marra me qira për të shmangur përdorimin e fondeve pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.</p>
	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara rezultojnë se në 3 raste janë vendosur kritere të paargumentuara teknikisht dhe ligjshëm për sa i takon numrit të punonjësve të kërkuar, numrit dhe kualifikimeve të stafit kryesor teknik dhe atij mbështetës si dhe numrit dhe kapacitetit të mjeteve në disa raste. Konkretisht:</p> <p>1. Procedura me objekt: “Rikonstruktion i zyrave postare të filialeve Tiranë, Durrës, Qendra Tranzite, Ndryshime ndarjesh për shkak të ndryshimit të strukturës dhe Ndryshimi i ndriçimit nga floureshent në led (322 copë) në Godinën e Drejtorisë së Përgjithshme”, viti 2019 janë kërkuar:</p> <p><i>Kriteri 2.3.5: “Një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën Prill 2019 - Shtator 2019 të vërtetuar me ...”</i></p> <p>Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultojnë se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër prej 100 të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p><i>Kriteri: 2.3.8: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:</i></p> <p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbalit të argumentimit të kritereve të datës 04.10.2019 rezultojnë se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p>2. Procedura me objekt: “Rikonstruktion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan” dhe “Rikonstruktion i zyrave postare të filialeve</p>	51 – 118	E lartë	<p>Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve të argumentuara teknikisht dhe ligjshëm si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.</p>

<p>Vlorë Sarandë, Gjirokastrë” janë vendosur kritere si më poshtë:</p> <p><i>Kriteri 2.3.5: “Një punësim mesatar i të paktën 80 (tetëdhjetë) personave, për periudhën janar 2019 - tetor 2019 të vërtetuar me ...”</i></p> <p>Në fakt, sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion, rezulton se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër prej 80 të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p><i>Kriteri: 2.3.8: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: ...</i></p> <p>Sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbalit të argumentimit të kriterëve rezulton se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura pavarësisht faktit nëse ky numër dhe lloj mjetesh mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p>3. Procedura me objekt: “Rikonstrukcion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”, viti 2019 janë vendosur kritere si më poshtë:</p> <p><i>Kriteri 2.3.6: “Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 54 punonjës të punësuar për periudhën Janar 2019 – Qershor 2019...”</i></p> <p>Në fakt, sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion, rezulton se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër prej 54 të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p>Gjithashtu i panevojshëm dhe jashtë kontekstit të investimit në fjalë është edhe kërkesa e bërë për arkitektin si dhe ajo për të punësuarin i cili duhet të disponojë certifikatën “Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” ku është kërkuar që të jetë domosdoshmërisht edhe drejtues teknik.</p> <p><i>Kriteri: 2.3.9: Operatori ekonomik duhet të paraqesë Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë: ...</i></p> <p>Sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion, rezulton se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura pavarësisht faktit nëse ky numër dhe lloj mjetesh mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p>Në lidhje me kriteret rezulton se janë bërë ankesa të cilat kanë marrë përgjigje nga ana e AK si dhe janë bërë sugjerime nga ana e APP përmes postës elektronike në datë 14.08.2019.</p>			
<p>Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton se në 1 rast, konkretisht në procedurat me objekt Rikonstrukcion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë BOE nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimit e stafit mesatar për periudhën janar – nëntor 2019 sipër përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit me nr. 92 rep., 23 kol., datë 17.01.2020. Konkretisht sipas kësaj marrëveshjeje punimet janë ndarë në raportin 69.38 % OE A... dhe 30.62 % OE B.... Nisur nga fakti që numri total i punonjësve të kërkuar është 90, atëherë nga ana e këtyre dy OE duhet të ishin sjellë respektivisht dëshmi për disponimin e respektivisht 63 dhe 27 të punësuar. Në fakt nga ana e OE A... janë paraqitur listë pagesat mujore</p>	51 – 118	E lartë	Nga ana e shoqërisë aksionare Posta Shqiptare të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiency dhe economicitet të fondeve.

	<p>janar 2019 – nëntor 2019 me një numër mesatar prej 61 të punësuarish. Gjithashtu, nga ana e OE B... edhe pse janë marrë përsipër 30.62 %, nuk janë sjellë dëshmi për disponimin e një inxhinieri elektrik si dhe një arkitekti si pjesë e licencës së shoqërisë. Përveç sa më sipër rezultojnë se nga ana e BOE nuk janë dorëzuar analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar.</p>			
	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt <i>“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”</i> viti 2019 rezultojnë se specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur sipas shkresës nr. 381 prot., datë 08.02.2019 me përbërje të grupit z. G. P., z. B. Sh. dhe znj. E. S. janë të paargumentuara teknikisht dhe ligjërishit. Konkretisht rezultojnë të tilla kërkesat e komisionit për mjetet si:</p> <p>Autoveturë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsumi i kombinuar Max: 4.0 l/100 km; - Gjatësia Min-Max 4,350-4,400 mm - Lartësia Min-Max 1,400-1,450 mm - Gjerësia (pa pasqyra) Min-Max 1,850-1,880 mm - Distanca Aksiale Min-Max 2,640-2,660 mm - Sensorë parkimi prapa (përse jo edhe Sensorë përpara) - Etj. <p>Furgonçina</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsumi i kombinuar: Max: 4.5 l/100 km; - Gjatësia: Min 4,150 mm - Lartësia: Min 1,770 mm - Gjerësia (pa pasqyra): Min 1,760 mm - Distanca Aksiale: Min 2,480 mm - Lartësia nga toka: Min 175 mm - Etj. <p>Motoçikleta</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmasat: (gjatësia/gjerësi/lartësi): Max. 1,950/720/1,060 mm - Lartësia nga toka: Min. 130 mm - Peshë: Min-Max 90-110 kg - Sistemi i frenimit: Para sistem hidraulik me disk, prapa me tambure - Rrota e përparme: Tubolare deri në 16”, goma 90/80-16 deri në 100/100-16 - Rrota e pasme: Tubolare deri në 14”, goma 110/80-14 deri në 120/80-14 - Valixhe në pjesën mbrapa: Kapaciteti deri në 75 litra, me hapje nga sipër (kuti plastike) - Koshi në pjesën e përparme: Kapaciteti deri në 35 litra (kuti plastike) <p>Në lidhje me këto specifikime, përveç sa më sipër, nuk argumentohet domosdoshmëria e përdorimit të sistemit GPS i cili, sipas citimit të Grupit të Punës është parashikuar të përdoret vetëm për Motoçikletat dhe Furgoncinat dhe jo për Autoveturën. Konkretisht është cituar: <i>... Menaxhimin e flotës me anë të inkuorporimit të sistemit të GPS ... duke sqaruar në vijim se ky menaxhim do të kryhet nga ana e kompanisë operationale, pra shoqëria private fituese e procedurës së prokurimit.</i></p>	51 – 118	E lartë	<p>Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve të argumentuara teknikisht dhe ligjërishit si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficientësi dhe ekonomicitet.</p>
	<p>Nga ana e Grupit të Auditimit u analizua Relacioni i hartuar nga ana e Grupit të Punës i ngritur me Urdhër nr. 53, datë 12.03.2019, me nr. 740 prot., datë 12.03.2019 për analizën e kostos dhe efikasitetin procedural për</p>	51 – 118	E lartë	<p>Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për një vlerësim të saktë të leverdishmërisë së investimeve të kryera për punë/mallra shërbime me qëllim</p>

	<p>procedurën e prokurimit si më sipër, kjo me qëllim identifikimin e avantazheve dhe disavantazheve të përdorimit të Leasing operacional dhe imazhin e institucionit.</p> <p><u>Nga kjo analizë rezultojnë si më poshtë shpjegohet:</u></p> <p>Sipas këtij relacioni, pika 2 është cituar ndër të tjera se vlera e automjetit pëson një rënie të konsiderueshme gjatë viteve të përdorimit, vlerë kjo e parikuperueshme në fund të jetës së automjetit. Në fakt, nga një analizë e dokumenteve të vëna në dispozicion rezultojnë se nga grupi përkatës nuk është marrë në konsideratë shuma e mbetur e investimit e cila në fund të 4 viteve rezultojnë të jetë në total në masën 24,332,448 lekë, e përlogaritur kjo për mjete si më poshtë:</p> <p>Motoçikleta – 3,756,840 lekë; Autovetura – 3,686,400 lekë; Furgonçina – 16,889,208 lekë;</p> <p>Pra, në total rezultojnë se AK në përfundim të afatit të kontratës së qirasë do të kishte në dispozicion të tij asetet me vlerë kontabël 24,332,448 lekë. Përveç kësaj, rezultojnë se pa u mbështetur në një historik konkret, Grupi i Punës ka përlogaritur për variantin e blerjes, shpenzime për kryerjen e shërbimeve periodike. Konkretisht rezultojnë se në përlogaritje janë përfshirë pajisje kamera dhe sistemi GIS, të dyja këto në shumën prej 67,000 lekë/makine për 4 vite, ose shuma prej 1,407,000 lekë pa TVSH. Njëkohësisht nga ana e këtij Grupi Pune është përlogaritur shuma prej 114,720 lekë pa TVSH/vit x mjet, ose në total për 21 furgonçina shuma prej 9,636,480 lekë pa TVSH, parashikim ky jo plotësisht i argumentuar, kjo pasi vetë blerja e sistemit së bashku me kamerat është parashikuar në shumën prej 67,000 lekë/mjet. Nga verifikimi i kilometrave të përshkruara nga mjetet e marra me qira nga fillimi i kontratës e deri aktualisht rezultojnë se autoveturat, furgonçinat dhe motoçikletat në pjesën më të madhe të tyre kanë përshkruar më pak kilometra nga sa janë parashikuar¹.</p>			<p>shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve siç është i rastit të kontratës me objekt “Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite” me vlerë 96,009,900 lekë pa TVSH.</p>
	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt <i>“Rikonstrukcion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstrukcion i Filialit Qendra Tranzite”</i>, viti 2018 rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE H. O K. N & T tepër në vlerë si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej 458,663 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.3.0.1.</p>	51 – 118	E lartë	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej 458,663 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE H.O K. N & T me të cilët është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 2902/16 prot., datë 05.12.2018 me objekt <i>“Rikonstrukcion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstrukcion i Filialit Qendra Tranzite”</i>, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.</p>
	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt <i>“Rikonstrukcion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, Loti II Rikonstrukcion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”</i>, viti 2020 rezultoi</p>	51 – 118	E lartë	<p>1. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për</p>

¹ Aneksi 2.3.7

	<p>se në përgjithësi punimet janë kryer me një cilësi të dobët duke bërë që investimi të paraqesë shenja shumë të hershme amortizimi, kjo më shumë në rifiniturat për shkak kryesisht të mos marrjes së masave kundër shkaktarëve të lagështisë. Dyert nuk janë vendosur të cilësisë së parë dhe druri duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të punimeve të mos respektohen kërkesat e projektit për një shumë totale prej 740,432 lekë pa TVSH për 84.14 m² dyer të realizuara. Gjithashtu, për sa i takon dritareve dhe dyerve rezultoi se nuk janë realizuar me material plastik por me alumin të thjeshtë duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të punimeve të mos respektohen kërkesat e projektit dhe preventivit për një shumë totale prej 1,248,296 lekë pa TVSH për dritaret dhe dyert e realizuara. Për rrjedhojë rezultoi se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet fondet në shumën prej 1,988,728 lekë pa TVSH. Gjithashtu nga inspektimi rezultuan ambiente me lagështi dhe punime rifiniturash të amortizuara në prej lagështisë dhe mungesës së izolimeve në disa raste. Nga krahasimi i volumeve të situacionuara e likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE A. & B.S në shumën totale prej 58,414 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.3.0.2.</p>			<p>arkëtimin e vlerës totale prej 58,414 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE A. & B. S me të cilët është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/47 prot., datë 30.03.2020 me objekt <u>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë”</u>, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.</p> <p>2. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të kontratave të punimeve për të siguruar përmeshjen e detyrimeve kontraktuale e duke shmangur kështu përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve siç është ai në rastin e kontratës me objekt <u>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë”</u> me BOE A.& B.S ku rezultoi se nuk janë respektuar specifikimet teknike për dy zëra punimesh në shumën prej 1,988,414 lekë pa TVSH.</p>
	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt <u>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan”</u>, viti 2020 nga krahasimi i zërave të situacionuar e të pasqyruara në librezën e masave si dhe verifikimit në terren të kryer në prezencë të përfaqësuesve të Postës Shqiptare SHA rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve OE L.N K.N si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej 202,501 lekë pa TVSH, e argumentuar kjo sipas Aneksit nr. 2.3.0.3.</p>	51 – 118	E lartë	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej 202,501 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit të punimeve OE L.N K.N me të cilin është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/56 prot., datë 15.05.2020 me objekt <u>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan”</u>, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.</p>
	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt <u>“Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”</u>, viti 2020 nga krahasimi i zërave të situacionuar e të pasqyruara në librezën e masave rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve OE K.N C.N si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej 265,301 lekë pa TVSH, e argumentuar kjo sipas Aneksit nr. 2.3.0.4.</p>	51 – 118	E lartë	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej 265,301 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit të punimeve OE K.N C.N me të cilin është lidhur</p>

				kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/56 prot., datë 15.05.2020 me objekt "Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës", për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.
	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e zbatimit të kontratave me objekte si më poshtë rezulton se:</p> <p>1. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastrë, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, <u>Loti I: Rikonstruksion i Zyrave Postare të Filialeve Gjirokastrë, Sarandë:</u> Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;</p> <p>Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria R. N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;</p> <p>Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I. Y. me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. I. S. Në fakt, referuar dokumentacionit të kontratës së dhurimit të kuotave me nr. 1828 rep. 754 kol., datë 25.09.2020 ndodhur në QKB, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R.N. Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.</p> <p>2. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastrë, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, <u>Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite:</u> Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;</p> <p>Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria R.N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;</p> <p>Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I. Y. me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. I. S.. Në fakt, referuar dokumentacionit të kontratës së dhurimit të kuotave me nr. 1828 rep. 754 kol., datë 25.09.2020 ndodhur në QKB, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R.N. Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.</p> <p>3. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, <u>Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan:</u> Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R. N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;</p> <p>Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria A.N me përfaqësues ligjor znj. A. N.;</p> <p>Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I.Y ... me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. A. N.. Në fakt, sipas dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe</p>	51 – 118	E lartë	<p>Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA të merren masat e nevojshme për identifikimin dhe shmangien e rasteve të konfliktit të interesit me qëllim sigurimin e shërbimeve efektive nga ana e Kontraktorëve.</p>

<p>ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R....N</p> <p>Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.</p> <p>4. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, <u>Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë:</u></p> <p>Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R....N ... me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;</p> <p>Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria D....S me përfaqësues ligjor z. V. T.;</p> <p>Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria L...Y ... me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. R. N.. Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga e një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara të njëjtin person i cili njëkohësisht ka qenë edhe përfaqësues ligjor i shoqërisë hartuese të projektit R....N konkretisht znj. R. N.. Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.</p>			
<p>Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt <i>“Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë“</i>, gjatë implementimit dhe zbatimit të kontratës nga grupi i auditimit u konstatua që një pjesë e konsiderueshme e automjeteve nuk ishin të pajisura me sistemin GPS si dhe automjetet që ishin të pajisura me sistemin GPS, nuk u arrit të merreshin të dhëna për vitet periudhë nën auditim 2019-2022, pasi në sistemin qendror nuk u gjenden rekorde për gjurmimin e automjeteve.</p>	51 – 118	E lartë	<p>Posta Shqiptare SHA, komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrin në konsideratë të gjitha kushtet e kontratës dhe të garantojë zbatimin e tyre me përpikmëri nga të dyja palët.</p>
<p>Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt <i>“Blerje palmar profesional, barkod reader me Wireless, lexues barkodesh”</i>, rezulton se në hartimin e kriterëve të veçanta është përfshirë në pikën nr. 2.5 kërkesa sipas të cilës produktet e ofruara duhet të jenë Brand i njohur Ndërkombëtar, veprim ky diskriminues pasi kriteri i plotësimit të kërkesave të cilësisë dhe originalitetit të mallrave nuk qëndron, kjo sepse janë certifikatat ato që i japin këto attribute dhe jo emri. Gjatë analizimit të kësaj procedure, rezulton se komisioni i vlerësimit të ofertave ka s’kualifikuar ofertën me vlerë më të ulët mbështetur në këtë kriter, atë të OE S.....A me vlerë 29,800,000 lekë pa TVSH dhe duke kualifikuar OE S.....A me ofertë ekonomike 32,821,000 lekë pa TVSH, me diferencë 3,021,000 lekë.</p>	51 – 118	E lartë	<p>1. Organet Drejtuese të Posta Shqiptare SHA, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes së pajisjeve hardware, të krijojë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikime të prodhuesve pengojnë zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë.</p> <p>2. Organet Drejtuese të Posta Shqiptare SHA, të tregojë kujdes gjatë vlerësimit të ofertave dhe të marrë në konsideratë të gjithë kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nëse janë ose jo në përputhje me dokumentacionin e sjellë nga O.E. pjesëmarrës.</p>
<p>Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt <i>“Mirëmbajtja e Data Center”</i>, nuk është marrë në konsideratë menaxhimi i duhur i burimeve të shoqërisë, ku grupi i auditimit gjykon që pjesët hardware dhe sistemet e mësipërme mund të menaxhohen dhe mirëmbahen nga vetë specialistët e institucionit si dhe gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në përlogaritjen e fondit limit nuk janë marrë në konsideratë çmimet e pajisjeve që do të mbulohen me mirëmbajtje, duke kaluar çmimin e tyre të blerjes. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit,</p>	51 – 118	E lartë	<p>Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, gjatë alokimit të burimeve të shoqërisë, të marrin në konsideratë përdorimin e 3E, duke përdorur burimet e shoqërisë për kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave të shoqërisë.</p>

	efiçencës dhe ekonomicitetit vlera prej 11,898,000 lekë .			
	Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt <i>“Blerje Eterna BI + DataWarehouse + Reporting Services, log management, manaxhim te dokumenteve, statistikë si dhe Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit”</i> , më datë 22.07.2019, objektivi ka qenë ndërtimi i një magazine të dhënash (Data Warehouse), inteligjencë biznesi (Business Intelligence) dhe administrim logesh (Log Management) që do të shërbejnë si një burim kryesor raportimi dhe analize për punonjësit e Postës Shqiptare SHA si dhe mirëmbajtja e tyre për 4 vite, ku njëkohësisht është zhvilluar dhe procedura me objekt <i>“Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite”</i> , më datë 05.05.2020 ku kanë objekt të ngjashëm dhe flitet për të njëjtat zëra mirëmbajtje si më poshtë: ‘Application server’, ‘Database Server’ dhe ‘DataWarehouse Server’.	51 – 118	E lartë	Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, të kryejnë një analizë të hollësishme të sistemeve të implementuar, duke kryer një kategorizim të serverëve dhe të mirëmbajtjes së tyre, pasi në procedurat e prokurimit të zhvilluara për mirëmbajtjet, objekti dhe specifikimet janë të njëjta.
	Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt <i>“Mirëmbajtja e Moduleve të Eternës (Finance-kontabilitet, Burimet njerëzore, Magazina, Help Desk) për 4 vite”</i> , datë 31.05.2019, nga auditimi rezulton se zhvillimi i mirëmbajtjes për modulet në fjalë nuk është i nevojshëm dhe mund të mbulohet nga specialistët e IT së institucionit, duke marrë në konsideratë dhe modulet ose aplikacionet e tjera që zhvillohen pranë institucioneve të tjera të cilët mirëmbahen nga vetë specialistët e institucioneve pas zhvillimit të trajnimeve. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, efiçencës dhe ekonomicitetit vlera prej 9,450,000 lekë .	51 – 118	E lartë	Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, gjatë alokimit të burimeve të shoqërisë, të marrin në konsideratë përdorimin me efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve, duke përdorur burimet e shoqërisë për kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave të shoqërisë.
	Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt <i>“Blerje Biznes Hub”</i> , më datë 14.05.2021, në përbërje të objektit dhe specifikimeve të cilësuar në dokumentet standardë të procedurës së prokurimit, cilësohen modifikime të moduleve ekzistuese të Eternës, për të cilët është zhvilluar procedurë për mirëmbajtjen dhe modifikimin e moduleve ekzistuese. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, efiçencës dhe ekonomicitetit vlera prej 25,000,000 lekë .	51 – 118	E lartë	Organet drejtuese të shoqërisë, të kryejnë një analizë të hollësishme lidhur me shtimin dhe modifikimin e moduleve, të cilat janë objekt i procedurave të mëparshme të prokurimeve dhe detyrë e O.E. fitues i procedurave të mëparshme të Eternës, si dhe të kryejë një analizë kosto përfitim në lidhje me shtimin e moduleve të tilla, pasi mirëmbajtja e tyre rrit kostot e shoqërisë.
	Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt <i>“Blerje bojëra teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail”</i> , më datë 30.09.2022, për një vlerë prej 12,580,000 lekë pa TVSH, nga i njëjti operator ekonomik, vlerë e cila nuk e mbulon fitimin e përdorimit të sistemit gjatë kësaj periudhe, pasi sistemi “Hibrid Mail” pothuajse nuk ka funksionuar. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, efiçencës dhe ekonomicitetit vlera prej 12,580,000 lekë .	51 – 118	E lartë	Organet drejtuese të shoqërisë, gjatë menaxhimit të burimeve të shoqërisë si dhe zhvillimit të sistemeve të reja të kryejë një analizë kosto përfitim të detajuar duke shmangur përdorimin e fondeve pa efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet.
	Mbi bazën e ofertave të paraqitura nga subjektet e sipërcituar, grupi i punës ka përllogaritur fondin limit në shumën 40,577,848 lekë, pa TVSH. Përllogaritja e FL nga grupi i punës është pasqyruar në relacionin nr. 2407/7 prot., datë 15.11.2022., miratuar nga Titullari i AK z. A. D. me Vendimin nr. 24, datë 16.11.2022. Në zbatim të LPP dhe akteve nënligjore të tij, grupi i auditimit të KLSH përllogariti fondin limit të kësaj procedure duke përfshirë dhe çmimet për njësi të 29 artikujve korrespondentë të kontratës së mëparshme. Fondi Limit i përllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH është në shumën 20,173,165 lekë pa TVSH. <i>Përllogaritja e Fondin Limit duke përfshirë edhe</i>	51 – 118	E lartë	Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përllogaritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit.

<p>29 artikujt e kontratës nr. 939/33 prot., datë 17.11.2021 me objekt “Blerje kancelari dhe zarfa” paraqitet në tabelën nr. 1., aneksi 2.3.1.</p> <p><u>Nga auditimi rezulton se:</u></p> <p>a. Autoriteti Kontraktor Posta Shqiptare ka zhvilluar tender për blerjen kancelari dhe zarfa me objekt dhe specifikime teknike të njëjta në vitin 2021 me procedurën e vitit 2022.</p> <p>b. Në kontratën e vitit 2021 me nr. 939/33 pot. datë 17.11.2021 “Blerje kancelari dhe zarfa”, 29 artikuj të saj, kanë specifikime teknike të njëjta me artikujt e procedurës së prokurimit të zhvilluar në vitin 2022.</p> <p>c. Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit, nuk ka përfshirë çmimet për njësi të këtyre 29 artikujve të kontratës së vitit 2021 në prokurimin e vitit 2022.</p> <p>c. Fondit limit i përllogaritur nga AK është miratuar në shumën 40,577,848 lekë pa TVSH, kundrejt atij të përllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH në shumën 20,173,165 lekë pa TVSH, pra AK Posta Shqiptare ka rritur artificialisht FL me 201 %, ose vlerën prej 20,404,683 lekë pa TVSH.</p>			
<p>Në referim të shkresës së datës 01.02.2023 të paraqitur në <u>Faksimilen nr. 1, aneksi 2.3.1.</u>, OE L.....GJ.....K..... sqaron se oferta e paraqitur prej tij është e përballeshme pasi ka një xhiro të lartë vjetore dhe se për të artikuj të njëjtë me ato të AK Posta Shqiptare ka realizuar kontrata të suksesshme me subjektet publike si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Autoriteti Portual Durrës 2. Bashkia Kavaje 3. Dega e doganës Shkodër 4. Drejtoria e përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës 5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 6. Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar 7. Ujësjellës Kanalizime Durrës 8. Universiteti i Korçës 9. Spitali rajonal memorial fier 10. Drejtoria Rajonale e shërbimit kombëtar te punës 11. Universiteti i Tiranës 12. Agjencia kombëtare e zonave të mbrojtura 13. Drejtoria e përgjithshme Detare 14. Instituti i sigurimeve shoqërore 15. Ujësjellës kanalizime Kamëz <p>Bashkëlidhur, shkresës në lidhje me zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, OE L.....GJ.....K..... ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015, si dhe vërtetim nga AK të sipërcituar mbi realizimin me sukses të kontratave me objekt të njëjtë me prokurimin e zhvilluar nga AK Posta Shqiptare. Kontrata këto të ngarkuara në SPE.</p> <p>Për sa më lart, OE L.....GJ.....K..... plotëson kërkesat e e pikës 2 germa a, b, c, ç, d, të nenit 93 në të 5 komponentët e kërkuar.</p> <p><u>Nga auditimi i procedurave të mëparshme të Postës Shqiptare, rezulton se:</u></p> <p>Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera, bojëra printeri” të vitit 2022, KVO ka konstatuar se:</p> <p>OE M.....G & D.....N dhe L...T O.....E kanë rezultuar oferta anomalisht të ulta.</p> <p>Pas kërkesës së KVO të asaj procedure, drejtuar dy OE mbi dhënien e sqarimeve për mbështetjen e ofertës anomalisht të ulët, rezulton se këta OE kanë paraqitur pothuajse të njëjtat argumente me ato të paraqitura nga OE OE L.....GJ.....K.....</p>	<p>51 – 118</p>	<p>E lartë</p>	<p>Administratori i Shoqërisë Posta Shqiptare të përdorë procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës 11,990,389 lekë të ndarë në mënyrë propocionale për secilin anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit “Blerje kancelari dhe zarfa”.</p>

<p>duke i pranuar dhe kualifikuar dhe në përfundim është shpallur fitues OE M.....G & D.....N, pavarësisht se rezultonte Ofertë anomalisht e ulët.</p> <p>Ndërkohë për rastin e OE L....GJ....K....., Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i kane konsideruar jo bindëse argumentet e këtij OE duke e s'kualifikuar në kundërshtim me nenin 82 pika 4 e VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” KVO e ka s'kualifikuar OE OE L....GJ....K..... në mënyrë të pa drejtë, dhe pas shpjegimeve të dhëna nga OE L....GJ....K....., duke vërtetuar me dokumentacion që kishte kapacitete financiare për ta realizuar kontratën me një marzh të vogël fitimi, dhe për më tepër që nga auditimi i kësaj procedure rezultoi që vlera e FL e përlogaritur nga AK posta Shqiptare ishte jo reale dhe e rritur artificialisht me 201%</p> <p><i>Për sa më lart, shuma 11,990,389 lekë</i> e cila përfaqëson diferencën midis ofertës së shpallur fituese padrejtësisht në vendin e parë në shumën 39,187,981 lekë të OE L....T O.....E dhe ofertës së paraqitur nga OE L....GJ....K..... në shumën 27,197,592.50 lekë e s'kualifikuar si ofertë anomalisht e ulët, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Postës Shqiptare.</p>			
<p>Në referim të relacionit të hartuar nga grupi i punës mbi përlogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje letër fotokopje A4, letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër. A4 Traktor (3 kopje)” nr. 1209/8 prot., datë 07.06.2022, ftesa për ofertë i është dërguar OE M.....G & D.....N, L....T O.....E, L.....C dhe A.....O të cilët kanë paraqitur ofertat për çmim për njësi i më poshtë, të paraqitur në tabelën nr. 1., aneksi 2.3.2. Mbi bazën e ofertave të subjekteve të sipërcituar, grupi i punës ka përlogaritur fondin limit në shumën 62,891,062 lekë, pa TVSH. Përlogaritja e FL nga grupi i punës është pasqyruar në relacionin nr. 1209/8 prot., datë 07.06.2022, i cili është miratuar nga Titullari i AK znj. A. K. me Vendimin nr. 6, datë 07.06.2022.</p> <p><u>Nga auditimi rezulton se:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Autoriteti Kontraktor Posta Shqiptare ka zhvilluar tender me të njëjtin objekt prokurimi edhe në vitin 2021, duke lidhur kontratën nr. 2575/40 prot., datë 17.06.2021 me objekt “Blerje letër fotokopje A4”, dhe kontratën nr. 2575/41 prot., “Blerje letër traktor (3 kopje) A5, A4” datë 17.06.2021. - Grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit nuk ka përfshirë çmimet për njësi të artikujve letër fotokopje A4 dhe atyre të letrës traktor (3 kopje) A5, A4 të kontratës së lidhur në vitin 2021, të cilat kanë patur specifikime teknike të njëjta me specifikimet e kërkuara nga AK në procedurën e prokurimit të vitit 2022. - Në zbatim të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi, grupi i auditimit të KLSH bëri përlogaritjen e fondit limit duke përfshirë dhe çmimet për njësi të artikujve letër fotokopje A4 dhe letër traktor (3 kopje) A5 dhe A4. <p>Si rezultat FL i përlogaritur nga grupi i auditimit të KLSH është në shumën 42,064,659 lekë pa TVSH. Ndërkohë që AK Posta Shqiptare Fondin limit e ka përlogaritur dhe miratuar në shumën 62,891,062 lekë, pa TVSH pra me një diferencë prej 20,826,403 lekë pa TVSH.</p> <p>Për sa më lart, AK ka rritur artificialisht me 150 % Fondin Limit për procedurën me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3</p>	<p>51 – 118</p>	<p>E lartë</p>	<p>Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përlogaritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit.</p>

<p><i>kopje</i>)". Grupi i auditimit të KLSH, në përlogaritja e Fondin Limit të kësaj procedure ka përfshirë përveç çmimeve të studimit të tregut edhe çmimet e artikujve të kontratës nr. 2575/40 prot., kontratës nr. 2575/41 prot., datë 17.06.2021 me objekt "Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)" të paraqitur në tabelën nr. 2., aneksi 2.3.2.</p>			
<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kontraktuesi ka dorëzuar pranë magazinës së AK Posta Shqiptare mallin pjesë të Kontratës nr. 1637/82 datë 22.02.2023, letër Fotokopje A3 80 gr/m² më datë 18.08.2023, pra me 118 ditë me vonesë të këtij artikulli duke mos respektuar nenin 10 pika 10.2 të Kontratës Loti I "Blerje letër fotokopje A4, letër fotokopje A3". Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka mbajtur proces verbal në lidhje me dorëzimin me vonesë të këtij artikulli, duke mos informuar AK për mos përmbushjen e afateve nga kontraktuesi siç janë të përcaktuara në kontratën e sipërcituar për mallin "Leter A3 80 gr/m²" ku është përcaktuar se: "Malli objekt kontrate do të lëvrohet me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, për gjatë periudhës 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Sasia prej 25 % e mallit objekt kontrate, duhet të lëvrohet jo më vonë se 2 (dy) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës...". Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se OE I...T O.....E nuk e ka respektuar këtë detyrim për mallin letër A3 pjesë e objektit të kontratës nr. 1637/82 datë 22.02.2023. Vlera e penaltetit sipas nenit 21 duhet të llogaritet mbi 25 % të vlerës totale të këtij artikulli duke e penalizuar me 4/1000 për ditë.</p>	51 – 118	E lartë	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.
<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kontraktuesi nuk ka zbatuar kushtet e kontratës për afatin e dorëzimit të letrës traktor A5 me 3 kopje në masën 25 % të sasisë, të cilën duhej ta dorëzonte pranë AK Posta Shqiptare brenda datës 23.05.2023, kjo pasi është dorëzuar gjithë sasia e mallit letër A5 traktor me 3 kopje më datë 15.08.2023, pra 84 ditë me vonesë nga afati i përcaktuar në kontratën nr. 1637/92 prot., datë 23.03.2023. Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka mbajtur proces verbal për dorëzimin me vonesë të letrës traktor A5 si pjesë e mallit të kontratës dhe nga ana e Drejtorisë Ekonomike të Postës Shqiptare nuk është llogaritur penaltitet për këtë mall, duke e paguar tërësisht faturën tatimore nr. 156/2023 datë 15.08.2023 të kontraktuesit A.....O. Bazuar në kushtet e kontratës, Letra A5 "Traktor" (3 kopje) si pjesë e mallit objekt kontrate duhet që sasia prej 25 % të dorëzohej brenda datës 23.05.2023. Në referim të nenit 21 të kontratës "Penalitet", parashikohet se: "Penalitetet për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarife ditore 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i kontratës, por jo me pak se 25 % e vlerës së kontratës.</p> <p>Për sa më lart, Kontraktuesi A.....O ka dorëzuar mallin letër A5 traktor (3 kopje) me 84 dite vonesë nga përcaktimi në DTS dhe kontratën e lidhur midis palëve.</p> <p>Meqenëse ky zë i Kontratës për artikullin me emërtimin letër A5 traktor (3 kopje) është lëvruar në sasinë totale më datë 15.08.2023, për të llogaritur penaltitetin është marrë vlera minimale e këtij zëri në shumën 25% të saj. Vlera e letrës A5 Traktor (3 kopje) është në</p>	51 – 118	E lartë	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

	shumën 7,841,160 lekë. Vlera e përlloritur e penalitetit është në shumën (1,960,290*0.004)*84=658,657 lekë, vlerë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet eficientë dhe ekonomicitet të fondeve.			
	<p>Nga auditimi rezulton se:</p> <p>AK ka lidhur kontratën nr. 635/46 prot., datë 15.02.2021 me objekt "Blerje tonera dhe bojëra printeri", nga ku 10 artikuj nga 14 artikuj të kërkuar në procedurën e prokurimit mbi bazën e Urdhri i Prokurimit nr. 17. prot., datë 26.10.2022 kanë specifikime teknike dhe Part/Number të njëjtë. Grupi i KLSH mbi bazën e çmimeve të ofertave të OE dhe çmimeve koresponduese të artikujve të kontratës së mëparshme bëri përlloraritjen e fondit limit, shuma kjo e cila rezultoi 11,376,988 lekë.</p> <p>Për sa më lart, AK ka përlloritur fondin limit në shumën 14,717,900 lekë duke e rritur artificialisht me 29 % më shumë se vlera e fondit limit, e përlloritur nga grupi i auditimit të KLSH. Pra 3,340,912 lekë pa TVSH më tepër.</p>	51 – 118	E lartë	Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përlloraritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit.
	<p>Nga auditimi rezulton se grupi i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike nuk ka përcaktuar asnjë tregues teknik për mallrat e kërkuara, por thjesht ka pasqyruar listën e materialeve të kërkuar nga Drejtori i filialit qendra Tranzite z. A. Gj. bashkëlidhur relacionit me nr. 190 prot., datë 17.03.2022. Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike nuk ka parashikuar që:</p> <p>1.Operatori Ekonomik të paraqiste katalogun original të prodhuesit ose kopje të noterizuar të përkthyer në gjuhën shqipe me të dhënat teknike ku të jenë specifikuar të gjitha specifikimet e pjesëve të këmbimit;</p> <p>2.Në ditën e hapjes së ofertave Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesë para komisionit mostra për të gjithë artikujt Pjesë Këmbimi;</p> <p>3. Kërkesat e paraqitura tek shtojca nr. 5 nuk janë materializuar në kritere të veçanta si kërkesa të detyrueshme për OE pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi.</p> <p>Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike për të garantuar cilësinë e mallrave të kërkuara duhej të përfshinte kërkesën që gjatë dorëzimit të mallit, ato të shoqëroheshin me certifikata të sigurimit të cilësisë.</p>	51 – 118	E lartë	Administratori i shoqërisë të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të hartimit të specifikimeve teknike, pasi në disa raste hartimi i tyre konstatohet jo korrekt.
	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt "Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë" rezulton se specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke mos përshkruar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së për të vlerësuar mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara e për rrjedhojë janë hartuar të tilla që nuk kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve si rrjedhojë e arsyeve të sipërpërmendura. Referuar LPP është saktësuar fakti se specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik dhe ato duhet ti referohen standardeve kombëtare, ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato duhet t'u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose</p>	51 – 118	E lartë	<p>1. Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të specifikimeve teknike në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet.</p> <p>2. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive për mosvënien në përdorim të këtij investimi me vlerë 47,500,000 lekë pa TVSH si dhe për shfrytëzimin e këtij aseti për qëllimin për të cilin është blerë.</p>

<p>specifikimeve teknike kombëtare. Kërkesat e bëra nuk janë bërë plotësisht në terma funksionalë pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Grupi i auditimit ka kryer një analizë të kriterëve të vendosura në raport me ato të përmbushura në ana e OE fitues të cilat, në gjykim të grupit krijohet një dyshim i arsyeshëm e i mbështetur në argumente konkrete mbi paracaktimin e OE fitues përmes vendosjes së specifikimeve teknike fikse të paargumentuara dhe që nuk lidhen me ndonjë domosdoshmëri konkrete me nevojat e AK. Konkretisht këto analizohen si më poshtë rast pas rasti për një pjesë prej tyre me qëllim identifikimin e fenomenit:</p> <p>1. Kriteri</p> <p>Kamera të integruar me rezolucion jo më pak se 350 k Pixel dhe me kënd vrojtimi jo më pak se 92 gradë, për të monitoruar përdorimin dhe operacionet me zgjidhjen e MAK. Kamera duhet të jetë version miniature i përshtatshëm për tu montuar në MAK. Kërkohej që kamerat të kenë përmasa jo më të mëdha se 30 mm x 30 mm për arsyen e mësipërme. Kamera duhet të jetë e pajisur me një sensor për dedektim të imazhit, me shpejtësi kapje jo më të vogël se 30 fps at 640x480. Kamera duhet të vijë me një portë USB nga e cila gjithashtu të marrë ushqim (energji elektrike). Nga sa më sipër, duke krahasuar kërkesat dhe të dhënat e produkteve sipas katalogut konstatohet se edhe për sa i takon të kërkesave edhe për sa i takon vlerave korresponduese, këto specifikime rezultojnë se janë marrë në mënyrë identike nga prodhuesi (Foto nr. 1 Aneksi nr. 2.3.4).</p> <p>2. Kriteri</p> <p>PC i brendshëm i integruar në format panelor i inkorporuar në ekranin 12"-13" (inch). Me të paktën 5 porta për lidhje USB, nga të cilat të paktën 1 portë duhet të jetë USB 3.0 për të garantuar shpejtësi më të madhe transmetimi. Të paktën 1 portë RJ45 dhe 1 portë DB15 (për lidhje VGA).</p> <p>Nga sa më sipër, duke krahasuar kërkesat dhe të dhënat e produkteve sipas katalogut konstatohet se edhe për sa i takon kërkesave edhe për sa i takon vlerave korresponduese, këto specifikime, rezultojnë se janë marrë në mënyrë identike nga prodhuesi (Foto nr. 2 Aneksi nr. 2.3.4).</p> <p>Në lidhje me zbatimin e kontratës pas një inspektimi në terren të disa pajisjeve MAK në qendrat e caktuara në procesverbal për qytetin e Tiranës, rezultoi se asnjë nga 4 pajisjet nuk janë funksionale me shpjegimin nga grupi i ndjekjes kontratës se i ka mbaruar afati sistemit Cloud. Sistem ky i domosdoshëm për funksionim e pajisjeve MAK.</p>			
<p>Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit në terren të mallit objekt kontrate, pas një inspektimi në terren duke zgjedhur disa nga pikat ku janë montuar kutit postare sipas proces-verbalit bashkangjitur dosjes së prokurimit, rezultoi se shumë kuti postare në hyrjet e pallateve nuk ishin funksionale pasi nuk përmbanin as emrin dhe as nr. e apartamentit të banorëve. Pas një komunikimi dhe me administratorët e pallateve ata e mohuan që të kishin një kopje të çelësave për aksesimin e kutive postare. Kjo gjë është e ilustruar dhe nga fotot me nr. 3, 4, 5 dhe 6 në Aneksin nr. 2.3.4. Kutitë restante nuk janë montuar por janë në gjendje në magazinën qendrore të postës.</p>	51 – 118	E lartë	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat të analizojë situatën, të nxjerrë shkaqet dhe përgjegjësitë me qëllim vënien në funksion të Kontratës nr. 225/19 pot., datë 21.05.2021.
<p>Nga auditimi u konstatua se Rregullorja e Brendshme, "Për organizimin, funksionimin e</p>	51 – 118	E lartë	Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, të hartojnë,

	<p><i>administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA</i> miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare nuk është përshtatur (amenduar) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Posta Shqiptare. Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në rregulloren e brendshme të Posta Shqiptare SHA detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara përgjithësisht në nivel makro; - në disa raste konstatohet se mungojnë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi për disa funksione që janë në strukturën organizative por nuk gjenden të reflektuara në rregulloren e brendshme të funksionit të administratës qendrore. 			<p>amendojnë dhe miratojnë, rregulloren e brendshme, “<i>Për organizimin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA</i>” duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite në shoqëri. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale.</p>
	<p>Gjatë auditimit të procedurave në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj, në asnjë rast nuk u evidentua ndonjë gjurmë që sektorëve/departamenteve përkatëse ju ka lindur nevoja për rekrutimin e punonjësve të rinj.</p>	120 – 123	E lartë	<p>Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, gjatë hartimit të strukturës organizative të aparatit qendror Posta Shqiptare SHA dhe njësisë të vartësisë, dhe në momentin e plotësimit të strukturës me punonjës të rinj, të marrë në konsideratë nevojat e sektorëve/departamenteve dhe njësisë të vartësisë që të arrijnë efikasitetin e plotë me qasjen me burimet njerëzore të duhura sipas nevojave.</p>
	<p>Gjatë auditimit të mënyrës së rekrutimit të punonjësve të rinj, nuk u dokumentua një procedurë e mirëfilltë e rekrutimit të tyre. Deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura; nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.</p>	120 – 123	E lartë	<p>Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj, të kryejnë procedurat sipas metodave më të mira dhe me të drejta, për zhvillimin e tyre me transparencë të plotë dhe konkurrencë të plotë, duke përzgjedhur kandidatin e duhur sipas nevojave të institucionit.</p>
	<p>Nga analiza e llogarisë 638 “Penalitete dhe dëmshpërblime”, për vitin 2021, shpenzimet për dëmshpërblime, kryesisht për largimet nga puna, që shoqëria ka kryer për shkak të vendimeve të formës së prerë të gjykatave, janë vlerësuar në vlerën gjithsej prej 10,302,400 lekë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me Vendimin nr. 36, datë 11.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. A. K., si dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi i paditësit është kryer me numër dokumenti 442, datë 11.03.2021 në vlerën prej 1,568,134 lekë. - Me Urdhrin e Sekuestros nr. 14483, datë 25.06.2021 është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. A. K. dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi është kryer me numër dokumenti 1122, datë 29.06.2021 në vlerën prej 854,700 lekë. - Me Vendimin nr. 163, datë 08.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. R. M., si edhe dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi është kryer me numër dokumenti 4278, datë 05.10.2021 në vlerën prej 1,663,801.60 lekë. - Me Vendimin nr. 23, datë 01.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin Sindikatën e Pavarur të Industrisë, Energjetikës të Shqipërisë, si edhe dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi i paditësit është kryer me numër dokumenti 769, datë 17.06.2021 në vlerën prej 6,215,765 lekë. <p>Nga vendimet e gjykatave, sa më sipër,</p>	120 – 123	E lartë	<p>Nga ana e Drejtorisë Posta Shqiptare SHA të analizohen shpenzimet e dëmshpërblimeve për shkak të ndërprerjeve të njëanshme të marrëdhënieve të punës dhe të përcaktohen personat shkaktarë përgjegjës. Administratori i shoqërisë të marrë masat e nevojshme për mundësinë e kompensimit të këtyre fondeve në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara ligjore.</p>

<p>ndërprerjet e marrëdhënieve të punës të ish-punonjësve kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi Punës i Republikës të Shqipërisë, i ndryshuar, për shkak të ndryshimeve të njëanshme të kushteve të përgjithshme të kontratës individuale të punës, nga ana shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Për sa më sipër, në kundërshtim me pikën 4, neni 5 të Vendimit nr. 11, datë 15.01.2018 të Asamblesë të Aksionarit “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e shoqërisë Posta Shqiptare SHA”, Administratori i Shoqërisë nuk ka propozuar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës mbi largimin e drejtuesve me nivel kombëtar përgjegjësie, siç është rasti i largimit të Drejtorit të Shërbimeve Bankare dhe Financiare në Drejtorinë e Përgjithshme, me Urdhrin nr. 28, datë 31.01.2018. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës në Vendimin nr. 13, datë 29.05.2020 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH” ka analizuar rastet e largimeve nga puna dhe ka ngarkuar administratorin dhe drejtoritë përkatëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. Sa më sipër, shoqëria nuk ka hartuar një plan veprimi për reagimin dhe raportimin sipas vendimit të sipërcituar, si edhe nuk ka nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për shpenzimet e kryera, të cilat rezultojnë si shpenzime me efekt financiar negativ. Sa më sipër, bie në kundërshtim me pikën 14.6, neni 14 i statutit të shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Parregullsitë sa më sipër, kanë shkaktuar shpenzime me efekt negativ financiar gjithsej në vlerën prej 10,302,400 lekë, në formën shpenzimeve të përsëritura për të njëjtin vend pune, në dëm të shoqërisë Posta Shqiptare SHA.</p>			
<p>Parku i filialit Tiranë është i përbërë nga 14 automjete naftë (gazoil) në gjendje pune, nga ku 7 prej tyre, të tipit Ford Courier janë pjesë të kontratës me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 “Qiraja financiare (Leasing)”, ndërmjet M....N M....S SHPK dhe Posta Shqiptare SHA. Me anë të kontratës të shërbimit të sigurisë nr. 1322/24 prot., datë 19.10.2020 është përfshirë shërbimi i sistemeve të gjurmimit GPS/GPRS, ku është parashikuar të kryhet monitorimi i mjeteve me targa AA288NY, AA289NY dhe AA798BX të këtij parku (qendra e monitorimit ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA, me shërbim 24 h/7). Për sa më sipër, rezulton se për periudhën 2021-2022 ky shërbim nuk ka funksionuar. Shërbimi gjurmimit GPS/GPRS nuk përfshin mjetet nga kontrata e qerasë financiare (leasing), monitorimi i të cilave kontraktohet nga shoqëria qiradhënëse M....N M....S SHPK. Procesi i administrimit të konsumit të karburantit (gazoil) është raportuar sipas formatit “Treguesit teknik të mjeteve”, i cili nuk përmban çmimin për njësi, orën, datën dhe vendin e furnizimit, megjithëse programi “I.....S” i furnitorit K.....I SHPK është në gjendje të gjenerojë një situacion të saktë shpenzimi, për çdo automjet, me datën, vendin, dhe orën e furnizimit, çmimin/njësi, sasinë përkatëse të lëndës djegëse, si edhe numrin e kuponit të tërhequr. Nga ana tjetër, në procesin e administrimit të karburantit mungojnë fletudhëtimet e lëvizjes së automjeteve apo autorizimet përkatëse dhe nga muaji Mars 2022 nuk janë dhënë kilometrat e përshkuara në formatin “Treguesit teknik të mjeteve”. Nga auditimi rezulton se në formatin e sipërcituar është vendosur norma e konsumit të karburantit</p>	<p>124 – 133</p>	<p>E lartë</p>	<p>1. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për nxjerrjen e përgjegjësive dhe më pas arkëtimin e shumë përkatëse ndaj personave përgjegjës, e cila aktualisht është në vlerën totale prej 1,160,531 lekë pa TVSH dhe aktualisht² është konsideruar si përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve për shërbime të ofruara jo në përputhje me termat e kontratës, të lidhur sipas aktit me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 “Qiraja financiare (Leasing)”. 2. Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren të gjitha masat e nevojshme për llogaritjen e vlerës së plotë të shumës së shkaktuar për shkak të dorëzimit të mjeteve jo në përputhje me kushtet e kontratës. Kjo përllogaritje të kryhet në bazë të kostos shtesë që i është shkaktuar buxhetit të AK Posta Shqiptare për sasinë e konsumuar të karburantit me norma mbi ato të paraqitura në katalogët përkatës të ofruara. Në përfundim të kësaj, vlera e përllogaritur të kërkohet</p>

² Deri në nxjerrjen e përgjegjësive.

<p>(gazoil) 10 litra (mesatarisht)/100 km, pa studim dhe procedurë të miratuar, për 7 mjetet nga kontrata leasing me targa AA 051YV, AA487YY, AA057YY, AA491YY, AA058YV, AA798YU, AA794YU. Por, në procesverbalin e datës 01.10.2019 për marrjen në dorëzim “<i>Mbi pranimin e 21 furgonçinave Ford Courier sipas kontratës “leasing” nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019</i>”, është konfirmuar se mjetet e reja të sipërcituara kanë një konsum të kombinuar 4.5 litra/100 km. Vendosija e normës së harxhimit të karburantit (gazoil)10 litra/100 km, duke u nisur nga kilometrat të plotësuar në formatin “<i>Treguesit teknik të mjeteve</i>”, tregon se administrimi i karburantit nuk është në pajtueshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator, për aq kohë sa kilometrat nuk janë të konfirmuara, kur lëvizjet e automjeteve nuk janë autorizuar, dhe kur nuk ka një studim të miratuar, që argumenton ndryshimin dhe rritjen e normës së dhënë të kombinuar për harxhimin e karburantit. Sa më sipër bie në kundërshtim me pikën 1.11.4 “<i>Rregullat mbi përdorimin e automjeteve</i>”, si edhe me pikat 3 dhe 7, neni 28 në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, miratuar me ndryshimet e saj me Urdhrin nr. 556, datë 13.12.2018 të Administratorit të shoqërisë. Veprimet dhe mosveprimet e njësisë shpenzuese Filiali Tiranë, kanë sjellë rritjen e paargumentuar të normës së konsumit të karburantit (gazoil), dhe kanë shkaktuar si pasojë konsumin prej 7,793 litra naftë më tepër {[konsumi në litra/muaj – konsumi i llogaritur (km të përshkruara * 4.5 litra/100 km)] /1 muaj}. Nga të dhënat e siguruar, rezulton se është kryer pagesa në vlerën prej 1,160,531 lekë më shumë, nga përdorimi i automjeteve “<i>leasing</i>” për periudhën Maj 2021 - Shkurt 2022 {Vlera në lekë e paguar/muaj – vlera e llogaritur [(km *4.5 litra/100 km) /1muaj * çmimi mujor]}. Parregullsitë, sa më sipër, kanë sjellë si pasojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA një përdorim pa efektivitet, eficientë dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën prej 1,160,531 lekë</p>			<p>në rrugë ligjore për tu arkëtuar ndaj personave të gjetur me përgjegjësi përmes ndjekjes së të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe të gjitha shkallëve të gjyqimit.</p>
<p>Drejtoria e Përgjithshme Posta Shqiptare SHA në momentin e hartimit të regjistrave të parashikimit, nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratës, të cilat kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Në 10 raste, gjatë hartimit të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve në vlerë të vogël, është evidentuar shmangie nga procedurat përkatëse të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo të kontratave si më poshtë: <u>Drejtoria e Përgjithshme</u> -Procedura e prokurimit me objekt “<i>Blerje materiale anti-covid 2019</i>” me numrin e referencës REF-87799-02-22-2021 dhe fond limit në vlerën prej 788,000 lekë pa TVSH, nga ku fitues është shpallur M. V. me vlerën prej 778,900 lekë pa TVSH. -Procedura e prokurimit me objekt “<i>Blerje produkte higjeno-sanitare</i>” me numrin e referencës REF-87793-02-22-2021 dhe fond limit në vlerën prej 792,666 lekë pa TVSH, nga ku fitues është shpallur M. V. me vlerën prej 779,900 lekë pa TVSH. Procedurat e prokurimit të sipërcituara rezultojnë në të njëjtën llogari shpenzimesh dhe me të njëjtin funksion kryesor parandalimin e përhapjes të infeksioneve nga bakteret dhe viruset.</p>	<p>124 – 133</p>	<p>E lartë</p>	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masat e nevojshme, që në hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve në vlerë të vogël, të krijohen linja të qarta bashkëpunimi, raportimi dhe përgjegjësi dhe vendimmarrje të përcaktuara për parandalimin e copëzimit të fondeve publike, kjo njëkohësisht me qëllim edhe shmangien e kufizimit të procedurave konkurruese të prokurimit.</p>

<p>Sa më sipër, vlera totale e tyre është 1,558,800 lekë, nga ku kanë tejkaluar pragun procedurës së prokurimit në vlerën prej 758,800 lekë.</p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Sigurimi i fondit të përdoruesve për shërbimin e pagesave</i>”, me fondin limit 543,000 pa TVSH, e realizuar në datën 13.10.2022 dhe operatori fitues A.A me vlerën prej 520,000 lekë pa TVSH.</p> <p>-Blerje nën vlerën 100,000 lekë “<i>Siguracioni TPL për mjetet motorike</i>”, me fondin limit 100,000 pa TVSH, e realizuar me vlerën prej 19,700 lekë pa TVSH me shoqërinë L.....A.</p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Sigurim kontrate për magazinë doganore</i>”, fondi limit 1,000,000 pa TVSH, e realizuar në datën 23.02.2022 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 970,000 lekë pa TVSH. Sa më sipër, përbëjnë grupe mallrash të ngjashëm në të njëjtën llogari shpenzimesh dhe si produkte sigurimi me të njëjtin funksion dhe qëllim kryesor blerjen e përgjegjësive tek shoqëritë e sigurimeve. Procedurat e sipërcituara së bashku, rezultojnë në vlerën totale prej 1,539,700 lekë, nga ku tejkalohet pragu në vlerën 539,700 lekë.</p> <p><u>Filiali Tiranë</u></p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Siguracioni i aktiveve të qëndrueshme (ndërtesës)</i>”, fondi limit 800,000 pa TVSH, e realizuar në datën 09.04.2021 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 796,400 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Siguracioni TPL për mjetet motorike</i>”, fondi limit 300,000 pa TVSH, e realizuar në datën 26.04.2021 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 298,500 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura nën vlerën 100,000 lekë me objekt “<i>Siguracioni TPL për mjetet motorike</i>”, fondi limit 100,000 pa TVSH, e realizuar në datën 09.07.2021 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 99,996 lekë pa TVSH.</p> <p>Sa më sipër, të tre procedurat përbëjnë grupe mallrash të ngjashëm në të njëjtën llogari shpenzimesh si dhe produkte sigurimi me të njëjtin funksion dhe qëllim kryesor, pra blerjen e përgjegjësive tek shoqëritë e sigurimeve. Vlera totale e tyre është 1,194,896 lekë, pra tejkalojnë pragun e procedurës së prokurimit në vlerën me 394,896 lekë lekë.</p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Siguracioni i aktiveve të qëndrueshme (ndërtesës)</i>” me numrin e referencës REF-21657--03-10-2022 me fond limit në vlerën 800,000 lekë pa TVSH, dhe fitues A.....A me vlerën prej 796,950 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Siguracioni TPL për mjetet motorike</i>” me numrin e referencës REF-26141-04-22-2022 me fond limit në vlerën prej 400,000 lekë pa TVSH dhe fitues A.....A me vlerën prej 398,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Dy procedurat e mësipërme së bashku rezultojnë në vlerën totale prej 1,194,950 lekë, nga ku tejkalojnë pragun e procedurës së prokurimit në vlerën prej 194,950 lekë.</p> <p>Sa më sipër trajtuam, bie në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit nr. 03, datë 08.01.2018 të APP, me pikën 3 të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021 të APP, gjithashtu në kundërshtim me nenin 56, pika 2 dhe 11, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “<i>Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik</i>”.</p> <p>Parregullsitë, sa më sipër, kanë sjellë për pasojë shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve</p>			
--	--	--	--

	apo kontratave.			
	Referuar urdhrorit nr. 194 datë 17.07.2019 për udhëtimet e disa punonjësve të Posta Shqiptare SHA jashtë shtetit, nga zyra e financës klasifikimi i shpenzimeve të paradhënies është kryer njëjloj për çdo pozicion pune. Ky urdhër nuk është argumentuar sipas VKM nr. 870, datë 14.12.2011 <i>“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”</i> referuar dokumentacionit të sjellë me observacionin nr. 909/59 prot., datë 06.10.2023, sepse klasifikimi i kryer për çdo person udhëtues është i njëjti për çdo pozicion pune, duke nisur nga pozicioni i administratorit, drejtori drejtorisë, kryetar dege dhe këshilltar. Si rrjedhojë në VKM nr. 870, datë 14.12.2011 <i>“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”</i> , nuk përcaktohet që paradhënia për klasifikimet e pozicioneve të mësipërme të jetë e njëjtë. Për këtë arsye nuk justifikohen shpenzimet e udhëtimit referuar urdhrave të paradhënies.	124 – 133	E lartë	Nga administratori i Posta Shqiptare SHA dhe zyra e financës të analizohet vlera e efektit financiar negativ prej 6,434 euro dhe të merren masa për korrigjimin e praktikave të shpenzimeve të udhëtimit jashtë shtetit, pa dokumentacion justifikues.
	Referuar urdhrorit nr. 199 datë 07.08.2019 për udhëtimet e disa punonjësve të Posta Shqiptare SHA jashtë shtetit, nga zyra e financës klasifikimi i shpenzimeve të paradhënies është kryer njëjloj për çdo pozicion pune. Ky urdhër nuk është argumentuar sipas VKM nr. 870, datë 14.12.2011 <i>“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”</i> referuar dokumentacionit të sjellë me observacionin nr. 909/59 prot., datë 06.10.2023, sepse klasifikimi i kryer për çdo person udhëtues është i njëjti për çdo pozicion pune, duke nisur nga pozicioni i administratorit, drejtori drejtorisë, kryetar dege dhe këshilltar. Si rrjedhojë në VKM. nr. 870, datë 14.12.2011 <i>“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”</i> , nuk përcaktohet që paradhënia për klasifikimet e pozicioneve të mësipërme të jetë e njëjtë. Për këtë arsye nuk justifikohen shpenzimet e udhëtimit referuar urdhrave të paradhënies.	124 – 133	E lartë	Nga administratori dhe zyra e financës të shoqërisë Posta Shqiptare SHA të analizohet vlera e efektit financiar negativ prej 3,145 euro dhe të merren masa për korrigjimin e praktikave të shpenzimeve të udhëtimit jashtë shtetit, pa dokumentacion justifikues.
	Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re një rritje në riskun mbi likuiditetit që përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare si dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Posta Shqiptare është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer llogaritë e pagueshme.	124 – 133	E lartë	Posta Shqiptare SHA të marrë të gjitha masat mbi arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, në rast të vonesave mbi arkëtimin e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave duke iu përmbajtur kushteve të kontratave si dhe në mos realizimin e arkëtimit të tyre të kalojë në borxh të keq. Gjithashtu Posta Shqiptare SHA të bëjë të mundur shlyerjen e llogarive të pagueshme duke shmangur penalitetet e mundshme në të ardhmen.

3. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA për periudhën 01.06.2019 deri më 31.12.2022 nuk është në përputhje me të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator. Grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

*Në përfundim të auditimit, pas marrjes së dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, rezultuan devijime materiale por jo të përhapura nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, situatë e cila justifikon dhënien e një **opinionit të kualifikuar mbi përputhshmërinë.***

Baza për opinionin e kualifikuar të përputhshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale. Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Posta Shqiptare SHA, e cila konsiderohet nga ana jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme. Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI 1500 (ISA 500)³ dhe ISSAI 1530 (ISA 530)⁴; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie. Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionit të gabuar rreth objektivit të auditimit. Si bazë për dhënien e opinionit të kualifikuar mbi përputhshmërinë kanë shërbyer gjetjet si më poshtë:

- **Dëm ekonomik në shumën prej 12,975,268 lekë pa TVSH nga të cilat:**

* 11,990,389 lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të vlerësimit të ofertave;

* 984,879 lekë pa TVSH prej punimeve të pakryera në fakt;

- **Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve në shumën prej 262,504,939 lekë pa TVSH nga të cilat:**

* 154,937,900 lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të leverdishmërisë për investime;

* Shuma prej 47,500,000 lekë pa TVSH prej mos vënies në përdorim të investimit;

* Shuma prej 44,571,998 lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të përcaktimit të vlerës së fondit limit;

* 1,988,414 lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të zbatimit të kontratave për punime civile;

* 10,302,400 lekë prej punimeve largimeve të padrejta nga puna;

* 846,321lekë prej penalteteve të paaplikuara për dorëzimet me vonese të produkteve objekt

³ Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.

⁴ Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

kontrate;

** 9,579 euro (ose 1,197,375 lekë) prej shpenzimeve të kryera pa dokumentacion justifikues;*

** 1,160,531 lekë pa TVSH prej mangësive në drejtim të administrimit të karburantit;*

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të Postës Shqiptare:

Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike, funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme⁵, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer të mundësojë identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH, gjithashtu aplikojnë edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme.

⁵ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të tij/saj.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 406/1 prot., datë 05.06.2023 miratuar nga Kryetari i KLSH, i ndryshuar, nga data 07.06.2023 deri me datë 29.09.2023, në subjektin “Posta Shqiptare SHA”, për periudhën 01.06.2019 deri më 31.12.2022, u krye “Auditim mbi Përputhshmërinë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

J. H., Përgjegjës Grupi,

A. L., Auditues,

E. K., Audituese,

B. S., Auditues,

J. B., Auditues,

K. G., Auditues,

E. S., Auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti i auditimit

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi nga data 01.06.2019 deri më datë 31.12.2022 përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit ligjor dhe rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse. Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të kësaj veprimtarie audituese janë:

1. Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
2. Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të drejtimit;
3. Dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse;
 - Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
 - Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
 - Asetet janë ruajtur dhe mirë administruar;
 - Veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA është në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim;
 - Kërkesat nga organet ligjvënëse, agjencitë financuese ose organizatat donatore janë respektuar sipas kushteve të marrëveshjeve të financimit.
4. Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të kuadrit rregullator përkatëse të prokurimit, si dhe zbatimi i detyrimeve kontraktore;
6. Dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së subjektit të audituar.

2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;

- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

3. Identifikimi i çështjes:

Raporti i Auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA për periudhën nga 01.06.2019 - 31.12.2022 ka identifikuar sipas kriterëve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Funksionimin e strukturave të auditimit të brendshëm dhe sistemit të kontrollit të brendshëm financiar;
- Hartimin dhe realizimin e programeve ekonomiko – financiare si dhe miratimin e tyre në organet kompetente;
- Ligjshmërinë e procedurave të prokurimit publik si dhe ato të zbatimit të kontratave të lidhura për shërbime, mallra dhe punime;
- Ligjshmërinë e emërimeve, strukturën organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve;
- Blerjet e vogla;
- Organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësisë të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

5. Përgjegjësitë e Audituesve:

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti ekonomik dhe financiar përputhet, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje financimi, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen dhe zbatohen etj.;

- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);
- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

6. Kriteret e vlerësimit

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”
- ✓ Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit

- shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Legjislacioni mbi prokurimin publik;
- ✓ Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, i ndryshuar;
 - ✓ Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 *“Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”*;
 - ✓ Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, i ndryshuar;
 - ✓ Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar;
 - ✓ Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 *“Për arkivat”*;
 - ✓ Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, ndryshuar;
 - ✓ Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”*, i ndryshuar;
 - ✓ Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, *“Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”*;
 - ✓ Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 *“Për sponsorizimet”*, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar;
 - ✓ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar;
 - ✓ Ligji nr. 7703, dt. 11.5.1993 *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar,
 - ✓ Ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 *“Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”*;
 - ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1039, datë 16.12.2015 *“Për përcaktimin e procedurave për emetimin, prodhimin, përdorimin dhe tregtimin e Pullës Postare Shqiptare”*
 - ✓ VKM nr. 241, datë 31.03.2011 *“Për kryerjen nga Posta Shqiptare SHA., të Shërbimeve Postare, Financiare dhe Shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për Institucionet e Qeverisjes Qendrore e Vendore, Institucionet e tjera Publike si dhe Shoqëritë Tregtare me kapital shtetëror”*, i ndryshuar,
 - ✓ VKM nr. 595, datë 31.08.2006 *“Për miratimin e tarifave të Postës Direkte”*
 - ✓ VKM nr. 539, datë 01.08.2003 *“Për miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë”*
 - ✓ VKM nr. 83, datë 03.02.2016, *“Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”*, i ndryshuar,
 - ✓ VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar;
 - ✓ VKM nr. 918 datë 29.12.2014 *“Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”*
 - ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 446, datë 26.09.2002 *“Mbi miratimin e tarifave postare bazë”*
 - ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 20.01.2001 *“Për vendosjen e kutive postare në ndërtesat e banimit dhe institucione”*
 - ✓ Udhëzimi i APP-së nr. 2, datë 27.01.2015 *“Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”*, etj.
 - ✓ Udhëzimi nr. 1, datë 22.01.2016 i Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike *“Për përcaktimin e rregullave për funksionimin e Komisionit*

Shtetëror të Pullës Postare Shqiptare”;

- ✓ Udhëzimi nr. 2, datë 22.01.2016 i Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike “Për përcaktimin e sasisë së Pullave Postare në ruajtje”8. Standardet e auditimit

7. Standardet e auditimit

Raporti i Auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si dhe mbështetur në:

- Kërkesat e Kushtetutës së Shqipërisë (Pjesa XIV, nenet 162 – 165);
- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ISSAI 100 - Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400 - Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 - Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500) - Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530) - Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”;

8. Metodat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të Audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- Verifikimi i transaksioneve* – mbi bazën e informacionit në dokumentet e bankave me të cilët subjekti kryen transaksione;
- Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- Raportet dhe informacionet* - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
- Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të Audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

9. Dokumentimi i auditimit

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjyqimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën,

kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera, arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe më pas shqyrtimin e observacioneve të subjektit, takimeve ballafaqese në subjekt, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI SUBJEKTIN NËN AUDITIM

Posta Shqiptare SHA është shoqëria më e madhe tregtare që operon në tregun e shërbimeve postare dhe financiare. Ndër vite, Posta Shqiptare nuk ka pasur në fokus vetëm aktivitetin tregtar, por ka shërbyer si një ndërmjetëse vitale midis biznesit, qytetarëve dhe institucioneve. Shoqëria ka si qëllim sigurimin e një shërbimi të qëndrueshëm, të sigurt, të shpejtë dhe me kosto konkurruese, rritjen në cilësi dhe në lloje të shërbimeve si dhe monitorimin e shërbimeve për shmangien e risqeve dhe abuzimeve gjatë shërbimeve. Veprimtaria e institucionit orientohet dhe organizohet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi, Vendimit të Këshillit të Ministrave si dhe programit të qeverisë në fushën e shërbimeve postare. Posta shqiptare ka një shtrirje të gjerë përgjatë gjithë territorit të Republikës me rreth 533 zyra postare dhe me rreth 2500 punonjës. Misioni i shoqërisë është të zgjerojë e përmirësojë shërbimet tradicionale të Postës, të sjell shërbime të reja postare, financiare e bankare në përputhje dhe në zbatim të politikës e strategjisë dhe zhvillimit të Postës Shqiptare, të automatizojë, kompjuterizojë e standardizojë shërbimet postare, financiare dhe bankare si dhe të sigurojë dhe të mbështesë rezultatin ekonomik në rritje të Postës Shqiptare Sh.a, nëpërmjet planeve ekonomike financiare, operative dhe strategjike. Objektivi kryesor është konsolidimi i pozicionit dhe rritja e reputacionit të kompanisë në tregun e shërbimeve, duke synuar arritjen e standardeve në të njëjtin nivel me shoqëritë homologe të rajonit e më gjerë.

Veprimtaria e subjektit të audituar mbështetet në bazën ligjore si më poshtë:

- Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 2/2017, “Për Sigurinë Kibernetike”.
- Ligji nr. 1029, datë 8.7.2010 për “Menaxhimin financiar dhe Kontrollin”;
- Ligji nr. 114/2015 për “Auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Aktet e brendshme rregullative të shoqërisë.

2. PËRSHKRIMI I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

2.1 Mbi funksionimin e strukturave të auditimit të brendshëm dhe sistemit të kontrollit të brendshëm financiar.

2.1.2 Mbi vlerësimin e veprimtarisë së kontrollit të brendshëm dhe Auditit të Brendshëm

Drejtoria e auditimit të brendshëm në Posta Shqiptare SHA është ngritur dhe ka funksionuar në bazë të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Drejtimit kryesore të auditimeve të kryera kanë qenë të bazuara në zbatim të ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Nga auditimi rezulton se Auditimi i Brendshëm është në nivel Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme dhe përbëhet nga 8 punonjës: Drejtori i Drejtorisë, 6 auditues financiarë dhe 1 auditues IT. Për vitin 2019, me shkresën nr. 2728/1 prot., datë 12.10.2018 është dërguar në Ministrinë e Financave pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm plani strategjik 2019-2021. Është bërë vlerësimi i riskut për 18 subjekte për vitin 2019, është planifikuar auditimi i 15 subjekteve të cilat janë 3 auditime në Drejtorinë e Përgjithshme edhe pjesa tjetër kryesisht janë Filiale dhe degë të tyre në rrethe. Gjithashtu janë planifikuar nevojat për trajnim të stafit për 5 tematika të ndryshme, me 40 persona pjesëmarrës dhe me kohëzgjatje 5 ditë. U konstatua se 3 auditime janë të pjesshme dhe 12 auditime të plota. Për vitin 2019 janë realizuar 8 auditime nga 15 të planifikuara, Në auditimet e kryera për këtë periudhë nuk ka pasur asnjë gjetje me dëm ekonomik dhe për 8 auditime janë dhënë 129 rekomandime. Për vitin 2020, me shkresën nr. 2520/1 prot., datë 30.09.2019 është në Ministrinë e Financave pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm dërguar plani strategjik për vitet 2020-2022. Është bërë vlerësimi i riskut për 9 subjekte, për vitin 2020 dhe janë planifikuar auditimi i 9 subjekteve të cilat janë 2 auditime në Drejtorinë e Përgjithshme edhe pjesa tjetër kryesisht janë Filiale dhe degë të tyre në rrethe. Gjithashtu janë planifikuar nevojat për trajnim të stafit për 5 tematika të ndryshme, me 40 persona pjesëmarrës dhe me kohëzgjatje 5 ditë. U konstatua se 1 auditim është 1 pjesshëm dhe 8 auditime të plota. Për vitin 2020 janë realizuar 6 auditime nga 9 të planifikuara. Në auditimet e kryera për këtë periudhë ka patur gjetje me dëm ekonomik dhe konkretisht në Filialin e Postës Korçë në vlerën 1,463,877 lekë, në Filialin e Postës Gjirokastrë 960,477 lek, dhe Filialin e Postës Mat në vlerën 15,380 lekë. Në lidhje me këto konstatime janë çuar për ndjekje penale 4 persona në Korçë dhe 1 në Gjirokastrë duke kërkuar edhe zhdëmtimin e shkaktuar për të gjitha rastet. Gjithashtu për 6 auditimet e kryera janë dhënë 113 rekomandime. Për vitin 2021, me shkresën nr. 2160 prot., datë 20.10.2020 është në Ministrinë e Financave pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm dërguar plani strategjik për vitet 2021-2023. Është bërë vlerësimi i riskut për 11 subjekte, për vitin 2021 janë planifikuar auditimi i 11 subjekteve të cilat janë 1 auditim në Drejtorinë e Përgjithshme edhe pjesa tjetër kryesisht janë Filiale dhe degë të tyre në rrethe. Gjithashtu janë planifikuar nevojat për trajnim të stafit për 5 tematika të ndryshme, me 40 persona pjesëmarrës dhe me kohëzgjatje 5 ditë. U konstatua se 3 auditime janë të pjesshme dhe 8 auditime të plota. Për vitin 2021 janë realizuar 6 auditime nga 11 të planifikuara, Në auditimet e kryera për këtë periudhë ka patur gjetje me dëm ekonomik dhe konkretisht në Filialin e Postës Lezhe Dega Laç në vlerën 4,943,611 lekë. Në lidhje me këtë konstatim është çuar për ndjekje penale 1 person duke kërkuar edhe zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar. Gjithashtu për 6 auditimet e kryera janë dhënë 33 rekomandime. Për vitin 2022, me shkresën nr. 1860 prot., datë 20.10.2021 në Ministrinë e Financave pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm është dërguar plani strategjik për vitet 2022-2024. Është bërë vlerësimi i riskut për 20 subjekte për vitin 2022, janë planifikuar auditimi i 8 subjekteve të cilat janë 1 auditim në Drejtorinë e Përgjithshme edhe pjesa tjetër kryesisht janë Filiale dhe degë të tyre në rrethe. Gjithashtu janë planifikuar nevojat për trajnim të stafit për 5 tematika të ndryshme, me 40 persona pjesëmarrës dhe me kohëzgjatje 5 ditë. U konstatua se 2 auditime janë të pjesshme dhe 6 auditime të plota. Për vitin 2022 janë realizuar 7 auditime nga 8 të planifikuara, Në

auditimet e kryera për këtë periudhë ka patur gjetje me dëm ekonomik dhe konkretisht në Filialin e Postës Kukës Dega Tropojë në vlerën 19,751,946 lekë dhe 429,66 euro si dhe në Filialin Hibrid Mail në vlerën 136,384 lekë. Në lidhje me këto konstatime janë çuar për ndjekje penale 4 persona në Tropojë duke kërkuar edhe zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar për të gjitha rastet. Gjithashtu për 7 auditimet e kryera janë dhënë 131 rekomandime.

1. Titulli i gjetjes:	Mos realizim i plotë i planit të auditimit të brendshëm.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Auditin e Brendshëm rezulton se për periudhën objekt auditimi, konkretisht në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nuk janë realizuar plotësisht auditimet e parashikuara në planet vjetore të miratuara nga ana e Titullarëve.
Kriteri:	Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6, pika a.
Ndikimi:	Mungesë e një mbështetje të plotë për Titullarin në arritjen e objektivave.
Shkaku:	Mos respektimit të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
Rëndësia:	E mesme.
1.1 Rekomandimi:	Drejtorja e Auditit të Brendshëm, të marrë masa për të përmbushur planet e auditimeve në subjektet e parashikuara.

2.1.2 Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme.
2. Pyetësi i vlerësimit të performancës së Postës Shqiptare
3. Deklarata e misionit të Postës Shqiptare
4. Struktura organizative dhe analitike e Postës Shqiptare
5. Struktura e Njesisë së Auditit të Brendshëm
6. Raportet e auditimit të brendshëm

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA, grupi auditues kreu verifikimet mbi implementimin dhe plotësimin e kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura për komponentët e mëposhtëm:

1. Mjedisin e kontrollit
2. Menaxhimin e riskut
3. Aktivitetet e kontrollit
4. Informimin dhe komunikimin
5. Monitorimin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar riskun e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive, efëiente dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

1. Mjedisi i Kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i rëndësishëm i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, etikën personale dhe profesionale, dhe mënyrën e organizimit të strukturës organizative të Posta Shqiptare SHA. Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se Posta shqiptare SHA ka rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e administratës qendrore të

shoqërisë Posta Shqiptare SHA” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës. Në rregulloren e brendshme të shoqërisë bazuar në detyrimin që ka autoriteti përgjegjës për parandalimin e kontrollin e konfliktit të interesit ka përfshirë dhe konfliktin e interesit. Me vendimin nr. 30, datë 30.07.2015 është miratuar Kodi i Etikës i punonjësve të shoqërisë Posta Shqiptare SHA dhe në këtë rregullore ka të përfshirë një nen të veçantë për konfliktin e interesit. U konstatua se në rastet e shkeljes së etikës nga punonjësit drejtori i drejtorisë ose përgjegjësi i sektorit raporton në drejtorinë e burimeve njerëzore dhe drejtori i departamentit referuar informacionit të marrë nga drejtorja e burimeve njerëzore relacionon dhe propozon pranë Titullarit të institucionit llojin e masës disiplinore. U konstatua se me anë të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm raportohet çdo dobësi në lidhje me funksionimin e kontrollit të brendshëm në bazë të përfundimeve nga zbatimi i programit të auditimeve dhe për auditime tematike me kërkesë të Titullarit. Titullari i institucionit merr opinione mbi performancën e institucionit bazuar në raportet e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe nga raportet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Misioni, objektivat dhe veprimtaria e Posta Shqiptare SHA janë të përfshira në rregulloren e brendshme të shoqërisë si dhe janë të publikuara në faqen e web-site. Stafi i Postës Shqiptare është i informuar për misionin e shoqërisë nëpërmjet rregullores së brendshme Për organizimin dhe funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Postës Shqiptare e miratuar me vendim nr. 6, datë 20.02.2018. Gjithashtu, stafi menaxhues është në ndjekje të procedurave për realizimin e objektivave që ka Posta Shqiptare. Rekrutimi i punonjësve bëhet duke përzgjedhur ndërmjet 3 kandidaturave bazuar në tre komponent, arsimi, eksperiencia në punë dhe trajnimet e marra.

2. Titulli i gjetjes:	Mungesa e planit për zhvillimin e strategjisë.
Situata:	Posta Shqiptare SHA nuk ka të miratuar planin për zhvillimin e strategjisë të cilën Titullari i njësisë publike miraton dhe monitoron.
Kriteri:	Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 mbi <i>“Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”</i> neni 8 <i>“Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”</i> dhe neni 21 <i>“Menaxhimi i riskut”</i> .
Ndikimi:	Mos miratimin e planit për zhvillimin e strategjisë.
Shkaku:	Veprimet dhe mosveprimet e Titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA.
Rëndësia:	E mesme.
2.1 Rekomandimi:	Nga ana e Administratorit të Shoqërisë të merren masa për të ngritur një plan për zhvillimin e strategjisë, duke zbatuar kërkesat e parashikuara nga ligji si dhe duke kryer procedurat hap pas hapi konform kuadrit përkatës ligjor e rregullator.

2. Menaxhimi i riskut

Njësia e Menaxhimit të Riskut është miratuar me vendimin 21, datë 13.07.2020 dhe është në varësinë e Administratorit ndërkohë që Kryetar i Njësisë së Menaxhimit të Riskut është znj J. S.. Të gjitha risqet e mara në konsideratë pasqyrohen tek regjistri i Riskut. Njësia e Menaxhimit të Riskut kryen raportime periodike 3-mujore për treguesit kyç dhe raportim vjetor për humbjet financiare të materializuara një herë në vit pranë BOA. Është miratuar strategjia e risqeve sipas nenit 21 të Ligjit 10296 të MFK me urdhër nr. 163/b, datë 20.06.2023.

3. Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat e vendosura për të adresuar riskun dhe për të arritur objektivat e institucionit. Ato përfshijnë një gamë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues. Në lidhje me aktivitetet e kontrollit, është e rëndësishme një ndarje e përshtatshme e detyrave, në mënyrë që i njëjti person/strukturë të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy ose më shumë detyrave që lidhen me: miratimin, zbatimin dhe

regjistrimin e operacioneve, vendosja e rregullave të brendshme mbi kontrollin para faktit ose paraprak të ligjshmërisë, veprime të përshtatshme kontrolli, etj.

Nga auditimi u konstatua se janë ngritur urdhra dhe udhëzime drejtuar të gjitha filialeve për mirë organizimin e punës, janë ngritur grupe të ndryshme pune sipas drejtorive respektive për monitorimin dhe kontrollin e brendshëm në filiale dhe degë. Gjithashtu Audit i Brendshëm sipas një programi vjetor dhe rastësisht kontrollon filialet e postës. Kontrolli i tyre bazohet në aktet ligjore dhe nën ligjore si në rregulloren e shërbimit postar, financiar, pastrim parash, para elektronike etj.

4. Informimi dhe komunikimi

Informimi dhe komunikimi janë thelbësore për zbatimin e të gjithë objektivave të kontrollit të brendshëm. U konstatua se sistemi i Informacionit dhe Komunikimit ka funksionuar me një rregullore specifike për “Përdorimin e Postës Elektronike në Posta Shqiptare SHA” me nr. 1528 prot., datë 29.05.2019. Mbi këtë kuadër shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit funksionojnë duke kaluar urdhrat dhe udhëzimet me anë të protokollit secilës drejtori që është e përfshirë, gjithashtu edhe me anë të portalit share-point ku kanë akses të gjithë punonjësit dhe të informohen. Drejtoria e shërbimeve Financiare, me shkresa të brendshme dërgon periodikisht në Drejtorinë ekonomike, raportimet ditore, javore apo mujore në vartësi të volumeve të transaksioneve si dhe në vartësi të kontratave apo marrëveshjeve me institucionet, evidencat mbi detyrimet financiare që Posta Shqiptare ka për palët e treta.

5. Monitorimi

Sistemet e kontrollit të brendshëm duhen monitoruar për të vlerësuar cilësinë e sistemit të performancës në kohë. Monitorimi kryhet nëpërmjet një monitorimi në vazhdimësi, nëpërmjet vlerësimeve të shkëputura ose duke i kombinuar të dyja. Monitorimi i aktiviteteve të kontrollit të brendshëm duhet të dallohet qartë nga verifikimi dhe monitorimi i operacioneve të institucionit. U konstatua se nëpërmjet kryerjes së analizave vjetore, analizave 3 mujore për drejtoritë dhe Filialet analizohet puna e drejtorive përkatëse si dhe puna e filialeve. Nga qendra e monitorimit mbahet informacion ditor mbi monitorimin e proceseve operacionale të punës, transportit dhe shpërndarjes së dërgesave postare, problemet e ndryshme të evidentuara në filiale ose degë.

3. Titulli i gjetjes:	Në drejtim të informimit dhe komunikimit.
Situata:	Posta Shqiptare SHA nuk ka zhvilluar dhe rifreskuar në portalin e saj informacionin e rrjetit postar për vendndodhjen e zyrave postare.
Kriteri:	Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Neni 3 “E drejta e informimit”.
Ndikimi:	Mungesë e informimit të publikut në lidhje me pikat e ofrimit të shërbimeve.
Shkaku:	Mos respektimi i plotë i <u>Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Neni 3 “E drejta e informimit.</u>
Rëndësia:	E ulët.
3.1 Rekomandimi:	Drejtoritë përkatëse të marrin masa për azhurnimin e faqes web në lidhje me vendndodhjet e pikave postare të vendosura në zona të ndryshme.

2.2 Hartimi dhe realizimi i programit ekonomik-financiar si dhe miratimi i tyre në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet eprore.

Posta Shqiptare SHA, është i vetmi operator publik postar, në tregun shqiptar i cili drejton administron dhe zhvillon rrjetin postar kombëtar si dhe ka detyrimin për përmbushjen e shërbimeve bazë postare. Kompania siguron një gamë të gjerë shërbimesh postare dhe financiare, e cila ushtron veprimtari financiare si “subjekt financiar jo bankë”, duke ofruar shërbime financiare dhe bankare përmes partneritetit me institucione financiare në vend. Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me qëllim njësimin e procedurave të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të programeve të zhvillimit të shoqërisë publike, ministria përgjegjëse për ekonominë ka miratuar udhëzime dhe metodologji në lidhje me hartimin, raportimi e programeve vjetore ekonomik financiare. Referuar udhëzimit nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë, hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik bëhet për periudha 1 vjeçare, afat mesme dhe afat gjatë në përputhje me objektivat e caktuar nga organet drejtuese të tyre. Referuar pikës II.1. të udhëzimit të sipërcituar parashikohet se:

Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive me kapital shtetëror, miratohen përfundimisht nga Ministria Përgjegjëse për Ekonominë, me cilësinë e pronarit të pronës shtetërore.

Në piken III.2. parashikohet se :

Drejtoritë e shoqërive ku shteti ka mbi 50 % të aksioneve, hartojnë projekt programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacion shpjegues pranë këshillave mbikëqyrës, brenda datës 1 Dhjetor të çdo viti.

Në piken III.5. parashikohet se:

Ministria përgjegjëse për ekonominë miraton projekt programin e secilës shoqëri me pjesëmarrje mbi 50% kapital shtetëror, brenda muajit shkurt të çdo viti.

Referuar nenit 19 të statutit të shoqërisë “Plani ekonomik”, parashikohet se:

Administratori, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe udhëzimet e lëshuara nga Asambleja e Përgjithshme hartojnë programin e zhvillimit ekonomik financiar dhe e paraqesin për miratim në Këshillin Mbikëqyrës. Pas miratimit, programi dërgohet në asamblenë e përgjithshme.

1. Titulli i gjetjes:	Mungesa e dokumenteve strategjik të zhvillimit të shoqërisë.
Situata:	<p>Nga auditimi i evidencës dokumentare të administruar nga grupi i auditimit të KLSH, rezulton se:</p> <p>c. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar plane afat mesme apo afat gjatë të zhvillimit strategjik të saj.</p> <p>d. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar dhe miratuar plan biznesin afatmesëm të shoqërisë.</p> <p>Si rezultat i mungesës së dokumenteve dhe planeve strategjike shoqëria Posta Shqiptare nuk ka përcaktuar objektiva të qarta të zhvillimit, të cilat do të shërbenin si objektiva të matshme për vlerësimin e performancës së drejtimit të shoqërisë dhe në përmirësimin e performancës së shoqërisë. Mungesa e hartimit dhe miratimit të këtyre dokumenteve strategjik, ngarkon me përgjegjësi organet drejtuese të shoqërisë si këshillin mbikëqyrës dhe administratorët respektiv brenda periudhës së auditimit, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe udhëzimin nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” <u>ku përcaktohet se:</u> “...Hartimi i programeve të zhvillimit ekonomik bëhet për periudha 1 vjeçare, afat mesme dhe afat gjatë në përputhje me objektivat e caktuar</p>

	<i>nga organet drejtuese e tyre.”</i>
Kriteri:	-Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. -Udhëzimi nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë. -Statuti i Postës Shqiptare, i ndryshuar.
Ndikimi:	Në vlerësimin e performancës së drejtimit të shoqërisë me objektiva të matshme sasior dhe cilësore.
Shkaku:	Mungesa e hartimit dhe miratimit të dokumenteve bazë strategjike.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të filloj hartimin dhe miratimin e planit të biznesit dhe dokumentet e tjerë strategjik të zhvillimit ekonomik afat mesëm dhe afat gjatë të shoqërisë.

Me veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi ish Administratori L. D., ish Administratori z. E. B., ish Administratori znj. A. K. dhe z. A. D. në cilësinë e Administratorit aktual të Shoqërisë pasi nuk kanë hartuar planin e biznesit të shoqërisë dhe të dokumenteve të tjerë strategjik të zhvillimit të shoqërisë në afat mesëm dhe afat gjatë në përputhje me objektivat e përcaktuara në strategjinë kombëtare për zhvillim ekonomik dhe social.

Hartimi i programit ekonomik për vitin 2019:

Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare z. L. D. me Urdhrin nr. 429 datë 27.08.2018 ka ngritur grupin e punës për ndjekjen e procedurës mbi hartimin e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë Posta Shqiptare për vitin 2019. Në pikën 3 të urdhrin të sipërcituar, grupi i punës duhet të analizonte treguesit ekonomik-financiar dhe të hartonte relacionin përmbledhës të programit të zhvillimit ekonomik i cili duhej të paraqitej për miratim në parim nga administratori i përgjithshëm brenda datës 01.10.2018. Mbi bazën e relacionit të datës 19.11.2018 të hartuar nga grupi i punës, Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare ka miratuar në parim programin e zhvillimit ekonomik financiar për vitin 2019, nëpërmjet Urdhrin nr. 523 datë 19.11.2018., nr. 3298 prot., datë 19.11.2018.

Projekt programi i zhvillimit ekonomik financiar të vitit 2019, sipas grupit të punës është mbështetur në objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social, si dhe dinamikën dhe tendencat që kanë patur treguesit e shërbimeve gjatë vitit 2018 dhe respektimin e të gjitha parametrave cilësor për arritjen e standardeve të “PostEurop” dhe UPU⁶-së, si dhe në dokumentin mbi strategjinë e Postës Shqiptare për periudhën 2019-2021.

Në lidhje me treguesit kryesor ekonomik për vitin 2019, në programin ekonomik të miratuar në parim parashikohet:

Të ardhurat të jenë në shumën 2.775 milion lekë, duke rezultuar me rritje ndaj realizimit të pritshëm të vitit 2018, me 257.7 milion lekë, ose 10.2 % më shumë.

Shpenzimet të jenë në shumën 2,750.3 milion leke, me rritje ndaj realizimit të pritshëm të vitit 2018, për 239.2 milion lekë, ose 9.5 % më shumë.

Rezultati ekonomik të arrijë në 25 milion lekë fitim, nga 6.6 milion lekë që pritet të realizojë në vitin 2018, pra 18.4 milion lekë ose 3.7 herë më shumë.

Nga auditimi rezulton se:

1. Programi ekonomik i shoqërisë i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 27. datë 21.11.2018, është miratuar nga Aksionari i Shoqërisë përfaqësuar nga Ministri përgjegjës i Ekonomisë me shkresën hyrëse në Postën Shqiptare me nr. 3335/3 datë 09.01.2019, dhe nga Ministri i MIE me shkresën 3335/2 prot., datë 22.12.2018 me treguesit kryesor të mëposhtëm:

⁶ Universal Postal Union

- a. Të ardhura gjithsej: 2,775,273 mijë lekë
- b. Shpenzime gjithsej: 2,697,270 mijë lekë
- c. Numri i punonjësve: 2,468 numri mesatar
- d. Paga mesatare: 40,942 lekë
- e. Fondi i pagave: 1,212,648 mijë lekë
- f. Investime: 847,591 mijë lekë

2. Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 04., datë 01.03.2019 ka miratuar ndryshimin e shpenzimeve nga 2,750,270 mijë lekë duke e zvogëluar në 2,697,270 mijë lekë.

3. Për efekt të dhënies së fondit të solidaritetit për dëmtimet nga tërmeti i datës 26.11.2019 këshilli mbikëqyrës me vendimin nr. 43 datë 06.12.2019 ka bërë disa ndryshime në Programin e zhvillimit ekonomik të vitit 2019 kryesisht duke rritur shpenzimet me 53,000 mijë lekë nga programi fillestar duke i planifikuar në shumën 2,750,270 mijë lekë e cila korrespondon me vlerën e shpenzimeve në vendimin fillestar të miratuar nga këshilli mbikëqyrës nr. 27 datë 21.11.2018.

4. Ndryshimet e programit ekonomik me vendimin nr. 43 datë 06.12.2019 nuk kanë marrë miratimin nga MEF si aksionari i vetëm i shoqërisë.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish Administratori z. L. D. pasi ka vepruar në mospërputhje me nenin 14 pika 14.7 e Statutit dhe pikës II.1. udhëzimit nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” dhe pika 6 në të cilin përcaktohet se:

“Për raste të veçanta, ku propozohen ndryshime në programin e miratuar nga Ministria përgjegjëse për ekonominë ndiqet e njëjta procedurë për miratimin e ndryshimit në programin e zhvillimit, si në rastin e miratimit të programit fillestar të shoqërisë. Nëse ndryshimet në programin ekonomik të zhvillimit, konsistojnë brenda zërave të miratuara nga ministria përgjegjëse për ekonominë, miratimi i këtij ndryshim bëhet vetëm me vendimin e këshillit mbikëqyrës.”. Treguesit kryesor të zhvillimit ekonomik financiar të shoqërisë mbi planifikimin, realizimin për vitin 2018 dhe 2019 paraqiten në tabelën nr. 1. aneksi nr. 2.2.1

2. Titulli i gjetjes:	Mos realizim i treguesve kryesor të planit të zhvillimit të shoqërisë për vitin 2019.
Situata:	<p>Për të analizuar treguesit kryesor të vitit 2019, Grupi i auditimit të KLSH i është referuar dhe të dhënave faktike të vitit 2018, për të bërë krahasimin e treguesve ekonomik financiar të realizuara në vitet buxhetore, për të mundësuar një analizë mbi realizimin dhe jo vetëm mbi programin e vitit ushtrimor.</p> <p>Të ardhura viti 2019:</p> <p>Për vitin 2019 shoqëria Posta Shqiptare ka realizuar 102 % të ardhurat kundrejt planifikimit, krahasuar me vitin 2018 të ardhurat janë 110.7% . Pra viti 2019 rezulton me një rritje të të ardhurave kundrejt planifikimit dhe kundrejt realizimit në vitin 2018. Nëse analizojmë shërbimet që krijojnë të ardhurat të pasqyruara në tabelën nr. 2 vërehet që ka një rënie të të ardhurave në 67.17 % nga shërbimi “Ekspressi” kundrejt planifikimit, si dhe vërehet një rënie me gati 18% të të ardhurat e siguruara nga zëri “Nga biznesi” kundrejt planifikimit.</p> <p>Në mënyrë të përmbledhur të ardhurat për vitin 2019 janë paraqitur në tabelën nr. 2, aneksi 2.2.1.</p> <p>Për të patur një analizë më të plotë, po krahasojmë zërat e të ardhurave të realizuara në vitin 2019 me ato të vitit 2018 të paraqitura në tabelën nr. 3., aneksi 2.2.1</p> <p>Nga krahasimi i treguesve të të ardhurave, rezulton se të ardhurat e</p>

vitet 2019 janë më të larta se ato të vitit 2018.

Të ardhurat nga “eksporti i pullës” në vitin 2019 janë në masën 218 % kundrejt planifikimit .

Por nga analizimi i strukturës së të ardhurave konstatohet se nuk ka një detajin në grupin e të ardhurave “Të tjera”, për pasoj duke qenë e papërcaktuar dhe e ndarë në zëra të veçantë, parashikimi për këtë kategori nuk përputhet me vlerën e realizimit në vitin ushtrimor.

Shpenzimet 2019

Në vitin 2019 shoqëria ka kryer **3,027,113** mijë lekë shpenzime nga **2,697,269** mijë lekë të programuara, ose 112 % duke rritur me 12 % shpenzimet, kryesisht për tatim taksat, shpenzimet rrjedhëse, amortizimit dhe të tjera (materiale).

Si rezultat i vendimeve të organeve drejtuese të shoqërisë, në fund të vitit 2019 ka një disbalacë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi raporti i shpenzimeve kundrejt të ardhurave është 107 %, si rezultat shoqëria është ekspozuar drejt riskut të mungesës së fitimit, dhe me pasoja negative në qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe në aftësinë për të pasur likuiditete për mbulimin e detyrimeve dhe investimeve të planifikuara në të ardhmen. Gjithashtu në vitin 2019 shoqëria ka rritur me 5 % shpenzimet për fondin e pagave kundrejt vitit 2018.

Gjatë viti 2019 zëri shpenzime për “expertët” është në shumën 63,632 mijë lekë ose 321% krahasuar me planifikim e shpenzimeve për këtë zë.

Referuar relacionit nr. 3295 prot., datë 19.11.2018 “Mbi projekt programin e zhvillimit ekonomik financiar të vitit 2019” i miratuar me vendimin nr. 27., datë 21.11.2018 të Këshillit Mbikëqyrës, pagesa e eksperteve është parashikuar për rivlerësimin e Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM) të Shoqërisë Posta Shqiptare.

Në mënyrë të përmbledhur programi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2018 dhe 2019 janë pasqyruar në tabelën nr. 4., aneksi 2.2.1

Investimet 2019

Për vitin 2019, shoqëria ka parashikuar investime në shumën 847, 591 mijë lekë me financim nga burimet financiare të shoqërisë.

Grupet e investimeve të parashikuar janë:

Ndërtim-Montim – Rikonstruksion, për rikonstruksionin në 84 zyra postare në 15 filiale dhe degë, që parashikohen të realizohen deri në fund të vitit 2019, të cilat përbëjnë 22.2% të totalit të investimeve

Makineri dhe pajisje, të cilat përbëjnë 16.1% të totalit të investimeve. Në këtë zë janë përfshirë zëvendësimi i pajisjeve informatike të amortizuara, mobilime, pajisje sigurie të vlerave monetare dhe objekteve etj.

Investime IT, të cilat përbëjnë 12.9% të totalit të investimeve. Investime për MARKETINGun, i cili përbën 4.5% të totalit të investimeve

Automatizimi i proceseve operationale në Qendrën Tranzite, i cili përbën 5.9% të totalit të investimeve

Hibrid mail me një vlerë 175.2 milion lekë ose 20.7% të totalit të investimeve

Investim për infrastrukture telekomunikacion dhe internet, i cili

	<p>përbën 17.7% të totalit të investimeve. Grupi i investimet për vitin 2018 dhe 2019 janë pasqyruar në tabelën nr. 5., aneksi 2.2.1</p> <p><u>Konkluzion:</u></p> <p>Niveli i realizimit të investimeve të vitit 2019 është i ulët dhe kundrejt programit zë 36 % të tij, megjithëse investimet janë dyfishuar në vitin 2019 kundrejt vitit 2018, shkalla e realizimit të tyre ngelet e ulët pasi dhe në vitin 2018 shoqëria ka realizuar 45 % të vlerës së investimit të planifikuara. Për sa më lart, përtej parashikimeve optimiste të menaxhimit të lartë të shoqërisë, për të patur një fitim neto 6.6 milion lekë, si rezultat i rritjes së shpenzimeve, rënies të disa kategorive të të ardhurave dhe mungesa e një menaxhimi efektiv dhe planifikimi të mirë nga ana e drejtuesve të shoqërisë Posta Shqiptare, kanë sjellë që shoqëria në fund të vitit 2019 të rezultojë me humbje në vlerën 188,035,447.6 lekë.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. - Udhëzimi nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë. - Statuti i Postës Shqiptare, i ndryshuar.
Ndikimi:	Ulje e investimeve të nevojshme për modernizimin e shërbimeve të ofruara nga Posta Shqiptare.
Shkaku:	Ndryshimet e programeve ekonomike duke rritur shpenzimet dhe mos mbajtjen e ekuilibrit financiar për mbulimin e tyre nga rritja e të ardhurave.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Këshilli Mbikëqyrës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësi për realizimin e ulët të të ardhurave ndër vite dhe të bëjë kujdes në vijimësi në lidhje me miratimin e shpenzimeve, për të mundësuar një mbulim të shpenzimeve nga të ardhurat, që shoqëria në fund të vitit ushtrimor të rezultojë me fitim.

Për veprimet apo mos veprimet për mos realizimin e treguesve ekonomik financiar të vitit 2019 ngarkohet me përgjegjësi ish administratori i shoqërisë z. L. D..

Hartimi i programit ekonomik për vitin 2020

Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare z. L. D. me Urdhrin nr. 206 datë 27.08.2019 ka ngritur grupin e punës për ndjekjen e procedurës mbi hartimin e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë Posta Shqiptare për vitin 2020. Në piken 3 të urdhrin të sipërcituar, grupi i punës duhet të analizojë treguesit ekonomik-financiar dhe të hartojë relacionin përmbledhës të programit të zhvillimit ekonomik i cili duhet të paraqitet për miratim në parim nga Administratori i Përgjithshëm brenda datës 15.11.2019. Për zbatimin e Urdhrin nr. 206 datë 27.08.2019, ish Administratori i shoqërisë z. L. D. ka miratuar programin e punës nr. 2250/1 prot., datë 27.08.2019 “Mbi hartimin e projekt programit të zhvillimit ekonomik të Shoqërisë Posta Shqiptare për vitin 2020”. Mbi bazën e relacionit nr. 2250/3 prot., datë 12.12.2019 të hartuar nga grupi i punës, ish Administratori i Shoqërisë Posta Shqiptare ka miratuar në parim programin e zhvillimit ekonomik financiar për vitin 2020 nëpërmjet urdhrin nr. 356., datë 16.12.2019 me nr. 3284 prot., datë 16.12.2019. Në lidhje me treguesit kryesor ekonomik për vitin 2020, në programin ekonomik të miratuar në parim parashikohet:

Te ardhurat të jenë në shumën 3,076.1 milion lekë, me rritje ndaj realizimit të pritshëm të vitit 2019, për 272.2 milion lekë, ose 9.7 % më shumë.

Shpenzimet parashikohen në shumën 3,041.6 milion lekë, me rritje ndaj realizimit të pritshëm të vitit 2019, për 268.1 milion lekë, ose 9.7 % më shumë.

Rezultati ekonomik parashikohet të arrijë në 34.6 milion lekë fitim, nga 30.5 milion lekë që pritet të rezultojë në vitin 2019, pra 4.1 milion lekë ose 13.4 % më shumë.

Miratimi i programit nga Këshilli Mbikëqyrës

Programi i zhvillimit ekonomik financiar për vitin 2020 është miratuar nga këshilli mbikëqyrës me nr. 46, datë 27.12.2019, në vlerat si më poshtë:

Të ardhurat	3,076,135 mijë lekë
Shpenzimet	3,041,584 mijë lekë
Rezultati financiar bruto (fitimi)	34,551 mijë lekë
Fitimi Neto	14,176 mijë lekë
Fondi për investime	613,496,088 mijë lekë

... etj.

Miratimi i Projekt Programit nga MFE dhe MIE

-Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 283/1 prot., datë 31.01.2020, pas analizimit të treguesve ekonomik të planifikuar ka miratuar në pranim programin e shoqërisë Posta Shqiptare të miratuar me vendimin nr. 46, datë 27.12.2019 të Këshillit Mbikëqyrës.

-Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 324/2 prot., datë 14.02.2020 ka miratuar programin e zhvillimit ekonomik financiar të shoqërisë Posta Shqiptare.

Treguesit kryesor të programit të zhvillimit ekonomik, janë paraqitur në tabelën nr. 6., aneksi 2.2.2.

Të ardhurat 2020.

Të ardhura përgjatë vitit 2020 janë realizuar në masën 89.26 % kundrejt planifikimit të tyre dhe krahasuar me vitin 2019 rezultojnë me një rënie me 3 %.

Realizimin më të ulët me 49.26 % zë shërbimi “ekspres”, i cili krahasuar me vitin 2019 ka një rënie me 23 %.

Të ardhur nga shërbimi postar në vitin 2020 janë realizuar në masën 89.26 % dhe krahasuar me vitin 2019 ka pësuar një rënie me 8 %.

Kategoritë kryesore të krijimit të të ardhurave janë paraqitur në tabelën nr. 7., aneksi 2.2.2.

Shpenzimet 2020

Shoqëria Posta Shqiptare në vitin 2020 ka shpenzuar nga burimet e veta 2,814 milion lekë kundrejt 3.041 milion lekë të planifikuara ose 93 %, pothuajse në vlera të barabarta me vitin 2019 dhe 12 % më shumë me vitin 2018. Por dhe në këtë vit shpenzimet sikurse dhe në vitin 2019 kanë kaluar të ardhurat me 3 %, dhe për pasojë kanë vendosur në vështirësi shoqërinë për vazhdimin normal të aktivitetit dhe realizimin e investimeve.

Programi dhe realizimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2020 janë pasqyruar në tabelën nr. 8., aneksi 2.2.2.

Investimet 2020

Pjesa e investimeve të përealizuara në vitin 2019 zënë 46.9 % të totalit të investimeve për vitin 2020.

Zërat kryesor të investimeve janë:

Ndërtim montim rikonstruksione të cilat parashikohen të zënë rreth 15.7 % të totalit të investimeve, duke përfshirë rikonstruksionin për 40 zyra në 12 filiale dhe degë.

Makineri dhe pajisje me rreth 33.3 % të totalit të investimeve,

Investime IT me rreth 4.1 % të totalit të investimeve

Grupi i investimeve të programuar dhe realizimi i tyre paraqiten në tabelën nr. 9., aneksi 2.2.2.

Ndryshimi i programit të zhvillimit ekonomik financiar

1. Me vendimin nr. 05., datë 03.03.2020 Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar disa ndryshime në programin e zhvillimit ekonomik në pjesën e programit të investimeve për vitin 2020, si më poshtë:

Emërtimi (lekë)	Ishte	Bëhet	Ndryshimi
Investime gjithsej	613,496,088	657,096,088	+43,600,000

Referuar Udhëzimit nr. 15 datë 15.02.2018, pika 6 në të cilin përcaktohet se:

Për raste të veçanta, ku propozohen ndryshime në programin e miratuar nga ministria përgjegjëse për Ekonominë ndiqet e njëjta procedurë për miratimin e ndryshimit në programin e zhvillimit, si në rastin e miratimit të programit fillestar të shoqërisë. Nëse ndryshimet në programin ekonomik të zhvillimit, konsistojnë brenda zërave të miratuara nga ministria përgjegjëse për Ekonominë, miratimi i këtij ndryshim bëhet vetë me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ka miratuar ndryshimin në parim me shkresën nr. 2960/1 prot., datë 24.04.2020. Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka miratuar ndryshimet në programin e investimeve për vitin 2020 me shkresën nr. 5607/1 prot., datë 22.05.2020.

2. Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin Qarkullues nr. 19 datë 07.07.2020, ka miratuar ndryshimin në programin e zhvillimit ekonomik të vitit 2020, në pjesën e programit të shpenzimeve për covid-19, duke zvogëluar shpenzimet për karburant dhe duke i shtuar tek shpenzimet/blerje pajisje mbrojtëse ndaj Covid - 19

3. Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin Qarkullues nr. 24 datë 08.10.2020, ka miratuar ndryshimin në programin e zhvillimit ekonomik të vitit 2020 për dhënien e shpërblimit për një pjesë të punonjësve për performancë të lartë gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga Covid – 19, duke ndryshuar fondin e pagave nga 1,368,001 mijë lekë në 1,331,319 mijë lekë si dhe ndryshimin e zërit të shpenzimeve për shpërblimin të programuar nga 5,000 mijë lekë në 41,682 mijë lekë, duke miratuar fondin e shpërblimit në vlerën 36,682 mijë lekë dhe shpërndarjen tek 968 punonjës sipas pozicioneve për 33 shoferë, 205 përpunues dhe 730 shpërndarës. Ndryshimet e programit në zërat e sipërcituar janë miratuar me vendimin nr. 150 datë 17.11.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

Hartimi i programit ekonomik për vitin 2021

Administratori i Shoqërisë Posta Shqiptare z. L. D. me Urdhrin nr. 57 datë 27.08.2020 ka ngritur grupin e punës për ndjekjen e procedurës mbi hartimin e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë Posta Shqiptare për vitin 2021. Në pikën 3 të urdhrin të sipërcituar, grupi i punës duhet të analizonte treguesit ekonomik-financiar dhe të hartonte relacionin përmbledhës të programit të zhvillimit ekonomik i cili duhej të paraqitej për miratim në parim nga administratori i përgjithshëm brenda datës 16.11.2020. Administratori i shoqërisë z. L. D. ka miratuar programin e punës nr. 1687/1 prot., datë 27.08.2020 mbi hartimin e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë Posta Shqiptare për vitin 2021. Mbi bazën e relacionit nr. 2644/1 prot., datë 23.12.2020 të hartuar nga grupi i punës, administratori i shoqërisë Posta Shqiptare SHA ka miratuar në parim programin e zhvillimit ekonomik financiar për vitin 2021. Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar në parim projekt programin e zhvillimit ekonomik financiar të vitit 2021 me vendimin nr. 31., datë 30.12.2020. Në lidhje me treguesit kryesor ekonomik për vitin 2021, në programin ekonomik të miratuar në parim parashikohet që:

<i>Të ardhurat</i>	3,176,954	mijë lekë
<i>Shpenzime</i>	3,172,794	mijë lekë
<i>Rezultati financiar bruto (fitimi)</i>	4,160	mijë lekë
<i>Fondi i pagave</i>	1,403,495	mijë lekë
<i>Numri mesatar vjetor i punonjësve</i>	2569	punonjës
<i>Fondi për investime</i>	739,673,793	mijë lekë

Programi ekonomik i vitit 2021 është miratuar me shkresën nr. 99/1prot., datë 25.01.2021 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të vijuar me miratimin nga MEF. Programi ekonomik i vitit 2021 është miratuar me shkresën nr. 111/1 prot., datë 05.02.2021 nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve përfaqësuar nga Ministri përgjegjës për ekonominë. *Treguesit kryesor ekonomik financiar për vitin 2021 janë pasqyruar në tabelën Nr. 10., aneksi 2.2.3.*

Të ardhurat 2021

Të ardhura nga veprimtaria e shoqërisë për vitin 2021, janë realizuar në masën 91.3 % me një rritje 5 % kundrejt 2020 dhe 2 % kundrejt vitit 2019. Ndryshe nga vitet e mëparshme zëri “Biznes” ka një rritje me 108.05 % kundrejt planifikimit dhe një rritje me 46 % kundrejt vitit 2020. Të ardhurat e realizuara nga eksporti i pullave në vitin 2021, kanë pësuar një rënie me 51.4% krahasuar me 2020.

Të ardhurat sipas zërave kryesor për vitin 2021, janë pasqyruar në tabelën nr. 11., aneksi 2.2.3.

Shpenzimet 2021

Shpenzimet e planifikuara në vitin 2021, janë realizuar në masën 93 % ose 4 % më shumë se shpenzimet e realizuara në 2020. Shpenzimet në vitin 2021 rezultojnë 2 % më shumë se të ardhurat, duke ndikuar në treguesit e qëndrueshmërisë financiare dhe të realizimit të investimeve, për pasoj shoqëria ka rezultuar me humbje në shumën (46,753,302.49) lekë.

Programi dhe realizimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2021 janë pasqyruar në tabelën nr. 12., aneksi 2.2.3.

Investimet 2021

Për vitin 2021 investimet ishin parashikuar në vlerën 739,674 milion lekë, ku burimi i financimit janë burimet e veta të shoqërisë. Në shumë totale të investimeve të vitit 2021 46.4 % përbëjnë shumën e investime të transferuara nga viti 2020.

Zërat kryesor të investimeve janë:

Ndërtim montim rikonstruksione të cilat parashikohen të zënë rreth 10.8 % të totalit të investimeve, duke përfshirë rikonstruksionin për 2 zyra postare qendrore në filialin e Postës Tirane dhe Durrës dhe ish Filiali Qendra Tranzit.

Makineri dhe pajisje me rreth 34 % të totalit të investimeve,

Investime IT me rreth 29.3 % të totalit të investimeve

Në mënyrë të përmbledhur, grupi i investimeve për vitin 2021 janë pasqyruar në tabelën nr. 13., aneksi 2.2.3.

Hartimi i programit ekonomik 2022

Administratori i shoqërisë ka ngritur grupin e punës me urdhrin nr. 78 datë 30.08.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për ndjekjen e procedurës mbi hartimin e projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë Posta Shqiptare SHA për vitin 2022” i ndryshuar me urdhrin nr. 78/1 datë 20.12.2021. Grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 78/1 datë 20.12.2021 ka paraqitur relacionin mbi projekt programin e zhvillimit ekonomik financiar të vitit 2022 të miratuar nga Administratori i shoqërisë z. E. B. me shkresën nr. 1782/4 prot., datë 20.12.2021. Me vendimin nr. 15 datë 24.12.2021 është miratuar në parim nga Këshilli Mbikëqyrës Projekt Programi i Zhvillimit Ekonomiko Financiar të vitit 2022 në vlerat si më poshtë:

Të ardhurat	3,219,500	mijë lekë
Shpenzimet	3,215,213	mijë lekë
Rezultati financiar bruto (fitim humbje)	4,287	mijë lekë
Fondi i pagave	1,415,250	mijë lekë
Numri mesatar vjetor i punonjësve	2,569	punonjës
Fondi për investime	363,976.3	mijë lekë

Treguesit kryesor ekonomik financiar për vitin 2022, janë pasqyruar në tabelën nr. 14., aneksi 2.2.4.

Me shkresën nr. 2571/4 prot., datë 28.12.2021 Administratori i shoqërisë z. E. B. i është drejtuar MEF për miratimin e programit ekonomik të vitit 2022 të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 15 datë 24.12.2021.

MEF me shkresën hyrëse të shoqërisë publike Posta Shqiptare nr. 2571/5 prot., datë 10.01.2022, pas shqyrtimit të praktikës rekomandon se programi i paraqitur dhe i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 15 datë 24.12.2021 duhet të rishikohet pasi:

1. Mungon mendimi i MIE.

2. Programi ka mosrealizimin e treguesve ndër vite. Për shembull Shoqëria Posta Shqiptare kishte planifikuar për vitin 2019 një fitim prej 78 milion lekë.

Megjithatë, rezultati financiar sipas bilancit kontabël të vitit 2019 tregon një humbje me -188 milion lekësh. Po ashtu, për vitin 2020, programi planifikonte një fitim prej 34 milion lekësh, ndërsa rezultati financiar sipas bilancit kontabël të vitit 2020 është me humbje prej 72 milion lekësh.

3. Në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë, kërkohet që Këshilli mbikëqyrës të analizojë treguesit e planifikuar duke i krahasuar me treguesit faktik dhe të identifikojë përgjegjësit për treguesit ekonomik financiar të përealizuar.

-Administratori i Shoqërisë posta shqiptare, z. E. B. me shkresën nr. 2571/8 prot., datë 31.01.2022 ka përcjell pa bërë asnjë ndryshim të projekt programit të zhvillimit ekonomik të shoqërisë posta shqiptare për vitin 2022.

-MIE me shkresën nr. 569/2 prot., datë 28.01.2022 në zbatim të kreut II të udhëzimit të MFE nr. 15 datë 15.02.2018 “*Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror*” ka lejuar të vijohet me procedurat për miratimin përfundimtar pranë ministrisë përgjegjëse të ekonomisë.

-MFE në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë, ka miratuar programin ekonomik për vitin 2022 me shkresën hyrëse në protokollin e shoqërisë posta shqiptare nr. 2571/10 prot., datë 14.02.2022 megjithëse kishte kërkuar nga Këshilli Mbikëqyrës një analizë të hollësishme për situatën në këtë shoqëri e cila deri në atë moment rezultonte me një bilanc financiar negativ deri në atë moment.

Ndryshimet e programit të zhvillimit ekonomik të vitit 2022

Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr. 7 datë 09.08.2022 ka miratuar ndryshimin e programit ekonomik të vitit 2022 për blerjen e printerave termik për CN23 në printera multifunksional për kalimin e fondit prej 4,000 mijë lekë për blerjen e printerave termik për CN3 në shtimin e fondit për printera multifunksional në vlerën 9,800 mijë lekë (5,800 mijë lekë + 4,000 mijë lekë).

Të ardhurat 2022

Të ardhurat e realizuara në vitin 2022 janë masën 94 % dhe krahasuar me vitin 2021 janë rritur me 3 %. Të ardhurat nga eksporti i pullës janë në masën 54 % krahasuar me vitin 2021 janë rritur me 4 %.

Të ardhurat sipas zërave kryesor për vitet 2022 janë pasqyruar në tabelën nr. 15., aneksi 2.2.4.

Shpenzimet 2022

Shpenzimet në vitin 2022 janë realizuar në masën 91 % dhe krahasuar me vitin 2021, ato pothuajse janë në njëjtin nivel. Në 2022 të ardhurat janë më të larta se shpenzimet e realizuara, ky fakt ka ndikuar në rezultatin financiar duke kaluar shoqërinë Posta Shqiptare në fitim pas disa treguesve negativ të fitimit në vitet 2019, 2020 dhe 2021.

Programi dhe realizimi i shpenzimeve sipas zërave për vitin 2022 është pasqyruar në tabelën nr. 16., aneksi 2.2.4.

Investimet 2022

Për vitin 2022 nga shoqëria Posta Shqiptare janë parashikuar investime në vlerën 364 milion lekë me financimin nga burimet e veta, nga këto 185.5 milion lekë janë parashikuar për vitin 2022 të cilat zënë 51% të vlerës totale të investimeve dhe 178.5 milion lekë janë investime të transferuara nga viti 2021 të cilat zënë 49 % të vlerës totale të investimeve. Në vitin 2022 investimet janë realizuar në masën 24 %.

Grupi i investimeve për vitin 2022 është pasqyruar në tabelën nr. 17., aneksi 2.2.4. Administratori i shoqërisë znj. A. K. mbi bazën e relacionit nr. 2374/1 prot., datë 21.10.2022 mbi ndryshimin e programit të investimeve për rikonstruksione të vitit 2022 të trashëguara nga viti 2021 i cili nuk do të sjell ndryshime në vlerën totale të programuar e miratuar nga Ministria Financave dhe Ekonomisë për vitin 2022 me shkresën nr. 23408/3 prot., datë 11.02.2022. Sipas relacionit vlera e rikonstruksioneve të objekteve të dala nga projekti i dorëzuar (preventivat përfundimtar të zbatimit të punimeve të ndërtimit) të hartuara nga “4.....F” & “N..... G.....” është në total 11,582,000 lekë pa TVSH më shumë se parashikimi për rikonstruksionin këtyre objekteve në programin e zhvillimit të shoqërisë Posta Shqiptare për vitin 2022. Fondi prej 11,582,000 lekë pa TVSH që nevojitet për realizimin e rikonstruksionit të zyrave të merret nga fondi prej 35,000,000 lekë. Relacioni për ndryshimin të planit të investimeve për rikonstruksione të vitit 2022 të trashëguara nga vitit 2021 i është përcjell Këshillit Mbikëqyrës me shkresën nr. 2374/3 prot., datë 28.10.2022 nga administratori z. A. D..

Nga administrimi i vendimeve të vitit 2022, konstatohet se:

Këshilli Mbikëqyrës nuk ka dalë me vendim për miratim të ndryshimeve të programit të investimeve për rikonstruksione të vitit 2022 të trashëguara nga viti 2021, siç kërkohet në shkresën e Administratorit z. A. D. nr. 2374/3 prot., datë 28.10.2022.

Hartimi i programeve të zhvillimit për Filialet

Pas miratimit të programeve të zhvillimit ekonomik nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Programet e zhvillimit ekonomik përcillen të detajuara pranë filialeve të Postës Shqiptare.

Burimi kryesor i të ardhurave nga shërbimet postare janë:

- Rinovimi i marrëveshjes me Raiffesisen Bank, nga ndryshimi i tarifave të realizimit të shërbimit
- Negociatat me Policinë e Shtetit për shpërndarjen e gjobave të Policisë Rrugore.
- Zgjerimi i marrëveshjes me prefekturat në të gjithë vendin për legalizimin e dokumenteve.
- Zgjerimi i portofolit të shpërndarjes së faturave të OSHEE (me faturat e zonave rurale që aktualisht shpërndahen nga lexuesit e OSHEE-së).
- ... etj.

Pas marrjes së programeve nga Drejtoritë e Filialeve hartohet një program i veçantë pune për realizimin e tij.

Më poshtë po paraqesim programin e zhvillimit ekonomik të filialit të Postës Vlorë:

Të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi/humbja në total për vitin 2019

Të Ardhurat	118,440.4	mijë lekë
Shpenzimet	86,452.2	mijë lekë
Fitimi	31,988.2	mijë lekë

Të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi/humbja në total për vitin 2020

Të Ardhurat	139,396.0	mijë lekë
Shpenzimet	97,013.1	mijë lekë
Fitimi	42,382.9	mijë lekë

Të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi/humbja në total për vitin 2021

Të Ardhurat	139,665	mijë lekë
Shpenzimet	96,718	mijë lekë
Fitimi	42,947	mijë lekë

Të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi/humbja në total për vitin 2022

Të Ardhurat	143,681	mijë lekë
Shpenzimet	97,462.9	mijë lekë
Fitimi	46218.1	mijë lekë

NË LIDHJE ME KONTRATAT E QIRAVE

Posta Shqiptare SHA ka në administrim 504 objekte nga të cilat 52 janë jashtë funksioni. Këto objekte administrohen në mënyrë direkte nga 15 filiale. Kontratat e marrjes dhe dhënies me qira të ambienteve nga Posta Shqiptare janë si më poshtë:

Objektet e dhëna me qira	
Filialet	Numri i objekteve
Filiali Lushnje	2
Filiali Elbasan	1
Filiali Sarande	4
Filiali Durres	2
Filiali Lezhe	1
Filiali Gjirokaster	1
Total	12

Objektet e marra me qira	
Filialet	Numri i objekteve
Filiali Lushnje	1
Filiali Berat	1
Filiali Tirane	27
Filiali Elbasan	4
Filiali Sarande	1
Filiali Kukes	1
Filiali Fier	2
Filiali Korce	3
Filiali Shkoder	3
Filiali Gjirokaster	2
Filiali Durres	11
Filiali Tranzit	1
Drejtoria e Përgjithshme	1
Total	58

Posta Shqiptare SHA ka marrë me qira 58 objekte për nevojat e veta operationale. Shpenzimet për qira të Posta Shqiptare SHA për periudhën e auditimit 2019-2022, janë vlerësuar përkatësisht, për vitin 2019 në vlerën 32,910,318 lekë, për vitin 2020 në vlerën 60,433,342 lekë, për vitin 2021 në vlerën 81,587,669 lekë dhe për vitin 2022 në vlerën prej 77,247,231.60 lekë. Sa më sipër, Filiali Tiranë përbën pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve, përkatësisht 34,781,482 lekë ose 43 % në vitin 2021 dhe 34,157,684 lekë ose 44 % në vitin 2022. Për shkak të nevojave për ushtrimin e shërbimit universal postar, rezultojnë 58 objekte të marra me qira, nga ku 28 prej tyre, ose 48 % , i përkasin Filialit Tiranë. Posta Shqiptare SHA ka dhënë 12 objekte me qira të cilat konsiderohen si të ardhura. Të ardhurat nga qiraja për shoqërinë Posta Shqiptare SH.A, janë vlerësuar përkatësisht, për vitin 2022 në vlerën prej 1,865,280 lekë.

1- Kontratat e marrjes me qira

1- Kontratë qiraja lidhur midis Posta Shqiptare SHA Filiali Tiranë dhe znj. E. A. datë 15.11.2019 me nr. 1480/6 prot është lidhur me një afat 5 vjeçar me çmimin 105.000 lekë me sipërfaqe 80.85 m². Grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Brendshëm nga Posta Shqiptare SHA Filiali Tiranë me nr. 1264/3 prot datë 23.09.2019 i përbërë nga z. B. D., z. A. C. dhe z. A. V. ka shpallur fitues ofertën e znj. E. A. ku sipas procesverbalit të mbajtur nga ky grup pune kjo ofertë është analizuar si më e përshtatshme.

1. Titulli i gjetjes:	Mungesa e certifikatës së pronësisë dhe kontratave të furnizimit me energji dhe ujë të pijshëm.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave rezulton se për praktikën e qiramarrjes mes Posta Shqiptare Filiali Tiranë dhe znj. E. A., në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të Auditimit, nuk u konstatua certifikatë pronësie, kontratë e lidhur me UKT dhe as me OSHEE, kushte të cilat janë në

	kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 39/1 datë 23.09.2019 me nr. 1264/3 prot nga Drejtori i Posta Shqiptare SHA Filiali Tiranë z. G. L..
Kriteri:	Dokumentacion nuk garanton pronën e marrë me qira ku referuar përcaktimit ligjor të bërë në pikën 3 në nenin 802 të “Kodi Civil në RSH” qiradhënësi duhet të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë.
Ndikimi:	Qiradhënësi duhet të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë dhe nuk ka plotësuar të gjitha kushtet për të qenë ofertë fituese.
Shkaku	Moszbatimi i kushteve për ofertën fituese.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kualifikimin e ofertuesve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim gëzimin e qetë të periudhës së qirasë dhe shmangien e përdorimit të fondeve pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.
1.2 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kualifikimin e ofertuesve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim gëzimin e qetë të periudhës së qirasë dhe shmangien e përdorimit të fondeve pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. B. D., z. A. C. dhe z. A. V. në cilësinë e grupit të punës si dhe z. G. L. ish-Drejtori i Postës Shqiptare Filialit Tiranë.

2- Kontratë e qirasë lidhur midis Posta Shqiptare SHA, Filiali Sarandë dhe znj. S. M. dhe z. M. M. datë 15.05.2019 me nr. 463 prot është lidhur me një afat 1 vjeçar me çmimin 75,600 lekë me sipërfaqe 84 m². Grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Brendshëm nga Posta Shqiptare SHA Filiali Sarandë me nr. 185 prot datë 14.02.2019 i përbërë nga z. F. X., znj. A. M. dhe znj. J. K. ka shpallur fitues ofertën e znj. S. M. dhe z. M. M. ku sipas procesverbalit mbajtur nga ky grup pune kjo ofertë është analizuar si më e përshtatshme.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Posta Shqiptare SHA u konstatua se:

Ofertuesi znj. S. M. dhe z. M. M. nuk kanë paraqitur kontratë të lidhur me UKT dhe OSHEE kushte të cilat janë në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 185 prot datë 14.02.2019 nga Drejtori i Posta Shqiptare SHA Filiali Sarandë z. F. X.. Grupi i punës ka shpallur ofertë fituese objektin e znj. S. M. dhe z. M. M. edhe pse ky objekt nuk ka çmimin më të ulët nga ofertuesit e tjerë. Gjithashtu është vënë re se objektet kanë vendndodhje në rrugë të afërta me njëra tjetrën. Nga Drejtori i Filialit Sarandë z. F. X. nuk ka një analizë të saktë për sipërfaqen që kërkohet për marrjen me qira të zyrës postare. Mungesa e përllogaritjeve të sakta ndikon në sipërfaqen e kërkuar, e cila është e lidhur drejtpërdrejtë me çmimin e qirasë.

2. Titulli i gjetjes:	Mungesa e dhe kontratave të furnizimit me energji dhe ujë të pijshëm.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave rezulton se për praktikën e qiramarrjes mes Posta Shqiptare Filiali Sarandë dhe znj. S. M. dhe z. M. M., në përmbytje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të Auditimit, nuk u konstatua kontrata e lidhur me UK Sarandë dhe OSHEE, kushte të cilat janë në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 185 prot datë 14.02.2019 nga Drejtori i Posta Shqiptare SHA Filiali Sarandë z. F. X..
Kriteri:	Ofertuesi znj. S. M. dhe z. M. M. nuk kanë paraqitur kontratë të lidhur me UKT dhe OSHEE kushte të cilat janë në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 185 prot datë 14.02.2019 nga

	Drejtori i Posta Shqiptare SHA Filiali Sarandë z. F. X..
Ndikimi:	Ofertuesi nuk ka plotësuar të gjitha kushtet për të qenë ofertë fituese.
Shkaku	Moszbatimi i kushteve për ofertën fituese.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kualifikimin e ofertuesve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim gëzimin e qetë të periudhës së qirasë dhe shmangien e përdorimit të fondeve pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.
2.2 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për plotësimin e dosjes së ofertuesit znj. S. M. dhe z. M. M. me dokumentacionin e nevojshëm sipas parashikimeve të kuadrit ligjor e rregullator. Në rast të mosplotësimit, nga ana e Posta Shqiptare SHA të bëhet ndërprerja e kontratës së qirasë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. F. X., znj. A. M. dhe znj. J. K. në cilësinë e grupit të punës si dhe z. F. X. Drejtori i Postës Shqiptare Filialit Sarandë.

3- Kontratë qiraja lidhur midis Posta Shqiptare SHA, Filiali Durrës dhe z. V. M. datë 01.07.2021 është lidhur me një afat 1 vjeçar me çmimin 20,000 lekë me sipërfaqe 50 m². Grupi i punës i ngritur nga Posta Shqiptare SHA i përbërë nga znj. Sh. I., znj. V. D. dhe znj. L. M. ka shpallur fitues ofertën e z. V. M. ku sipas procesverbalit mbajtur nga ky grup pune kjo ofertë është analizuar si më e përshtatshme.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Posta Shqiptare SHA u konstatua se: Ofertuesi z. V. M. nuk ka paraqitur certifikatë pronësie kushte të cilat janë në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 7 datë 17.05.2021 nga Drejtori i Posta Shqiptare SHA Filiali Durrës znj. E. B.. Grupi i punës ka shpallur ofertë fituese objektin e z. V. M. edhe pse ky objekt nuk ka certifikatë pronësie por është objekt në proces legalizimi. Gjithashtu është konstatuar se Drejtoresha për Postën Shqiptare Filiali Durrës znj. E. B. ka pranuar kërkesën e z. V. M. për rritjen e pagesës së qirasë nga 20,000 lekë në 29,500 lekë me Urdhrin e datës 15.11.2022 nr. 488/1 prot pa kryer përsëri procedurën ligjore për marrjen e ambientit me qira. Neni 821 i Kodit Civil e përcakton saktë se *Përsëritja e kontratës së qirasë rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshme.*

3. Titulli i gjetjes:	Mungesa e certifikatës së pronësisë.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave rezulton se për praktikën e qiramarrjes mes Posta Shqiptare Filiali Durrës dhe z. V. M., në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, nuk u konstatua certifikata e pronësisë për ambientin e marrë me qira nga Posta Shqiptare SHA. Ofertuesi z. V. M. nuk ka paraqitur certifikatë pronësie kushte të cilat janë në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 7 datë 17.05.2021 nga Drejtori i Posta Shqiptare SHA Filiali Durrës znj. E. B.. Gjithashtu është konstatuar se Drejtoresha për Postën Shqiptare Filiali Durrës znj. E. B. ka pranuar kërkesën e z. V. M. për rritjen e pagesës së qirasë nga 20,000 lekë në 29,500 lekë pa kryer përsëri procedurën ligjore për marrjen e ambientit me qira. Neni 821 i Kodit Civil e përcakton saktë se <i>Përsëritja e kontratës së qirasë rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshme.</i>
Kriteri:	Dokumentacioni nuk garanton pronën e marrë me qira ku referuar përcaktimit ligjor të bërë në pikën 3 në nenin 802 të “Kodi Civil në RSH” qiradhënësi duhet të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë. Neni 821 i Kodit Civil “Përsëritja e kontratës së qirasë”.

Ndikimi:	Qiradhënësi duhet të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë dhe nuk ka plotësuar të gjitha kushtet për të qenë ofertë fituese.
Shkaku	Moszbatimi i kushteve për ofertën fituese dhe moskryerja e procedurës ligjore për marrjen e ambientit me qira.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kualifikimin e ofertuesve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim gëzimin e qetë të periudhës së qirasë dhe shmangien e përdorimit të fondeve pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.
3.2 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për plotësimin e dosjes së ofertuesit z. V. M. me dokumentacionin e nevojshëm sipas parashikimeve të kuadrit ligjor e rregullator. Në rast të mosplotësimit, nga ana e Posta Shqiptare SHA të bëhet ndërprerja e kontratës së qirasë.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi znj. Sh. I., znj. V. D. dhe znj. L. M. në cilësinë e grupit të punës si dhe znj. E. B. Drejtore e Postës Shqiptare Filiali Durrës.

Nga auditimi konstatohet se:

Disa zyra postare të marra me qira në Tiranë rezultojnë të kenë distanca të afërta me njëra tjetrën. Kjo distancë e afërt ka sjellë tejkalim të nevojave të qytetarëve në këto zona për të përdorur shërbimet e postës. Edhe pse në relacionet përkatëse hartuar nga Drejtori i Filialit Tiranë kërkohen ambiente të reja për nevojat operationale të postës me arsyetimin se ka një ngarkesë të madhe, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga filiali i postës për qytetin e Tiranës për rezultatin ekonomik të zyrave postare u konstatua se këto zyra kryejnë një aktivitet të ulët për ofrimin e shërbimeve që kryen Posta Shqiptare duke rezultuar në të ardhura të pakta në krahasim me shpenzimet dhe si rezultat kjo përben shpenzime pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet. Këto zyra postare që janë marrë me qira nga Posta Shqiptare rezultojnë të kenë një bilanc negativ me humbje prej vitesh.

Konkretisht zyrat postare që rezultojnë me humbje kur është konstatuar distancë e afërt janë:

- Zyra Postare nr. 12 rezulton me humbje që nga viti 2020 në vlerën 5,181,132 lekë.
- Zyra Postare nr. 32 rezulton me humbje që nga viti 2021 në vlerën 2,811,063 lekë.
- Zyra Postare nr. 20 rezulton me humbje në vitin 2021 në vlerën 920,028 lekë.
- Zyra Postare nr. 46 rezulton me humbje në vitin 2023 në vlerën 387,455 lekë.

Kjo situatë krijohet si rrjedhojë e mos marrjes së masave për kryerjen e një analize të saktë të aktivitetit të nevojshëm që këto zyra postare duhet të kryejnë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me pikat 23, 24 dhe 25 në nenin 3 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

4. Titulli i gjetjes:	Mungesa e analizës së saktë.
Situata:	Disa zyra postare të marra me qira në Tiranë rezultojnë të kenë distanca të afërta me njëra tjetrën. Kjo distancë e afërt ka sjellë tejkalim të nevojave të qytetarëve në këto zona për të përdorur shërbimet e postës. Edhe pse në relacionet përkatëse hartuar nga Drejtori i Filialit Tiranë kërkohen ambiente të reja për nevojat operationale të postës me arsyetimin se ka një ngarkesë të madhe, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga filiali i postës për qytetin e Tiranës për rezultatin ekonomik të zyrave postare u konstatua se këto zyra kryejnë një aktivitet të ulët për ofrimin e shërbimeve që kryen Posta Shqiptare duke rezultuar në të ardhura të pakta në krahasim me shpenzimet dhe si rezultat kjo përben shpenzime pa eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet. Këto zyra postare që janë marrë me qira nga Posta Shqiptare rezultojnë të kenë një bilanc negativ ku disa nga këto zyra

	postare rezultojnë me humbje prej vitesh.
Kriteri:	Neni 8, pika 1 dhe neni 12 pika 3, germa a, ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “...duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienzë.” “...garantimin para miratimit të shkresave/urdrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efizienzës dhe efektivitetit”.
Ndikimi:	Shpenzim i kryer në kundërshtim me parimet e efektivitetit, efizienzës dhe ekonomicitetit.
Shkaku	Kërkesa e marrjeve me qira të ambienteve postare pa kryer një analize të saktë.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kryerjen e një analize të saktë në lidhje me nevojat për marrjen me qira të ambienteve postare për të shmangur përdorimin e fondeve pa efektivitet, efizienzë dhe ekonomicitet.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. Sh. K. Drejtori i Filialit Tiranë dhe z. G. L. ish-drejtori i Filialit Tiranë.

Nga auditimi konstatohet se:

-Grupet e punës në filiale në shumë raste kanë analizuar si ofertën më të përshtatshme objekte të cilat nuk kanë dokumentacion të rregullt pronësie, dokumentacion i cili nuk garanton pronën e marrë me qira ku referuar përcaktimit ligjor të bërë në pikën 3 në nenin 802 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil në RSH” qiradhënësi duhet të garantojë gëzimin e qetë gjatë periudhës së qirasë.

- Nuk është përlogaritur sipërfaqja e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të zyrave postare, duke pasur në konsideratë numrin e punonjësve të zyrave, si dhe përcaktimit të bërë në shkronjën “a” të pikës 2 për mjedisin, Shtojca, të VKM nr. 521, datë 06.08.2014 “Për miratimin e rregullores Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës”. Mungesa e përlogaritjeve të sakta ndikon në sipërfaqen e kërkuar, e cila është e lidhur drejtpërdrejtë me çmimin e qirasë. Situata që krijohet si rrjedhojë e mos marrjes së masave për kryerjen e një analize të saktë të sipërfaqes së nevojshme për zyra përben shpenzime pa efizienzë, ekonomicitet dhe efektivitet.

5. Titulli i gjetjes:	Mungesa e analizës së saktë.
Situata:	Në asnjë rast nuk është përlogaritur sipërfaqja e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të zyrave postare, duke pasur në konsideratë numrin e punonjësve të zyrave.
Kriteri:	Neni 8, pika 1 dhe neni 12 pika 3, germa e ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “...duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienzë.” “...garantimin para miratimit të shkresave/urdrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efizienzës dhe efektivitetit”. Shkronja “a” e pikës 2 për mjedisin, Shtojca, të VKM nr. 521, datë 06.08.2014 “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës”.
Ndikimi:	Shpenzim i kryer në kundërshtim pa ekonomi, efektivitet dhe efizienzë.
Shkaku	Kërkesat e marrjeve me qira të ambienteve postare pa kryer një analize të saktë në lidhje me sipërfaqen.
Rëndësia:	E lartë.

5.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kryerjen e një analize të saktë në lidhje me sipërfaqen e ambienteve postare të marra me qira për të shmangur përdorimin e fondeve pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.
-------------------------	---

-Në përcaktimin e kriterëve fituese nuk është kërkuar asnjë i tillë që lidhet me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës, referuar përcaktimeve ligjore të bëra në VKM nr. 564, datë 3.7.2013 “Për miratimin e rregullores “për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, konkretisht për:

-Rrugët dhe daljet e emergjencës;

-Zbulimi dhe shuarja e zjarrit (pajisen me detektorë dhe sisteme alarmi për zjarret);

-Disponimi i certifikatës së sigurisë nga zjarri dhe projektit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, detyrime ligjore të përcaktuara në nenin 37 të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;

6. Titulli i gjetjes:	Kërkesat e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.
Situata:	Nga Posta Shqiptare SHA nuk janë kërkuar kriteret e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.
Kriteri:	VKM nr. 564, datë 3.7.2013 “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës” Nenin 37 të i ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
Ndikimi:	Sigurimi i kushteve të sigurisë për punonjësit e Postës Shqiptare.
Shkaku	Nga Posta Shqiptare SHA nuk janë kërkuar kriteret e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për plotësimin e kërkesave të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.

-Mjediset e punës, nëse është e nevojshme, përshtaten në mënyrë të tillë që të marrin parasysh nevojat e punëmarrësve me aftësi të kufizuara;

-Nga titullari i institucionit nuk është ngritur grup pune për marrjen në dorëzim të ambienteve, si dhe verifikimin e plotësimin të specifikimeve të vendosura;

- Nuk janë hartuar dhe miratuar deklaratat e ekzistencës/jo të konfliktit të interesave konkretisht ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

7. Titulli i gjetjes:	Nga Titullari i institucionit nuk është ngritur grup pune për marrjen në dorëzim të ambienteve. Nuk janë hartuar dhe miratuar deklaratat e ekzistencës/jo të konfliktit të interesave.
Situata:	Nga Posta Shqiptare SHA nuk është ngritur grup pune për marrjen në dorëzim të ambienteve për të siguruar kërkesat e Postës Shqiptare ndaj objekteve. Nuk janë hartuar dhe miratuar deklaratat e ekzistencës/jo të konfliktit të interesave.
Kriteri:	Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. VKM nr. 564, datë 3.7.2013 “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”.
Ndikimi:	Ngritja e grupit të punës për marrjen në dorëzim të ambienteve për të siguruar kushtet për aksesin e personave me aftësi të kufizuara i cili pasqyrohet dhe në kushtet e përcaktuara për një ofertë fituese.
Shkaku	Nga Posta Shqiptare SHA nuk janë kërkuar kriteret e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës dhe nuk ka marrë masat për të ngritur grup pune për

	marrjen në dorëzim të ambienteve.
Rëndësia:	E lartë.
7.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për të ngritur grup pune për marrjen në dorëzim të ambienteve.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. Sh. K. Drejtori i Filialit Tiranë si dhe z. G. L. ish-drejtori i Filialit Tiranë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Posta Shqiptare SHA u konstatua se:

- Në shumicën e kontratave të dhënies me qira të ambienteve të Postës Shqiptare nëpër Filiale nuk është përcaktuar baza ligjore sipas VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 *“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*. Sipas pikës 2 të kësaj VKM-je *përcaktohet saktë se:*

*Pasuritë shtetërore, që jepen me qira janë: ndërtesat, sipërfaqet funksionale (jo nën ndërtesë), trualli i lirë, makineritë e pajisjet e linjat e prodhimit të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare me kapital 100 për qind shtetëror (në vijim “shoqëri shtetërore”) dhe tokat e pafrytshme. Pasuritë shtetërore, që jepen me enfiteozë sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi, janë vetëm pasuritë e paluajtshme të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve dhe shoqërive shtetërore. Edhe pse asnjë objekt nuk është mbi 200 m² kjo VKM përcakton saktë që dhe objektet që jepen me qira pa konkurrim duhet të plotësojnë dokumentacionin që parashikon VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*.*

8. Titulli i gjetjes:	Posta Shqiptare nuk ka përdorur ligjin e posaçëm për dhënien me qira të objekteve.
Situata:	Posta Shqiptare nuk ka përdorur ligjin e posaçëm për dhënien me qira të objekteve.
Kriteri:	VKM nr. 54, datë 5.2.2014 <i>“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”</i> .
Ndikimi:	Dhënia me qira pa përdorur ligjin e posaçëm.
Shkaku	Titullari i institucionit nuk ka përdorur bazën ligjore.
Rëndësia:	E lartë.
8.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për të përdorur ligjin e posaçëm për dhënien me qira të objekteve të pasurisë shtetërore.

2.3 Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit, rezultuan mangësitë si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të vendosjes së kriterëve.
Situata:	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara rezultoi se në 3 raste janë vendosur kriterë të paargumentuara teknikisht dhe ligjërish për sa i takon numrit të punonjësve të kërkuar, numrit dhe kualifikimeve të stafit kryesor teknik dhe atij mbështetës si dhe numrit dhe kapacitetit të mjeteve në disa raste. Konkretisht:</p> <p>1. Procedura me objekt: <i>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Tiranë, Durrës, Qendra Tranzite, Ndryshime ndarjesh për shkak të ndryshimit të strukturës dhe Ndryshimi i ndriçimit nga floureshent në led (322 copë) në Godinën e Drejtorisë së Përgjithshme”</i>, viti 2019 janë kërkuar:</p> <p><i>Kriteri 2.3.5: “Një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën Prill 2019 - Shtator 2019 të vërtetuar me ...”</i></p> <p>Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër prej 100 të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p><i>Kriteri: 2.3.8: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:</i></p> <p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbalit të argumentimit të kriterëve të datës 04.10.2019 rezultoi se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p>2. Procedura me objekt: <i>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan”</i> dhe <i>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”</i> janë vendosur kriterë si më poshtë:</p> <p><i>Kriteri 2.3.5: “Një punësim mesatar i të paktën 80 (tetëdhjetë) personave, për periudhën janar 2019 - tetor 2019 të vërtetuar me ...”</i></p> <p>Në fakt, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër prej 80 të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p><i>Kriteri: 2.3.8: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:</i></p> <p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht procesverbalit të argumentimit të kriterëve rezultoi se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura pavarësisht faktit nëse ky numër dhe lloji mjeteve mund të jetë ose jo i mjaftueshëm.</p> <p>3. Procedura me objekt: <i>“Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër,</i></p>

	<p><i>Lezhë, Mat dhe Kukës</i>”, viti 2019 janë vendosur kritere si më poshtë: <i>Kriteri 2.3.6: “Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 54 punonjës të punësuar për periudhën Janar 2019 – Qershor 2019...”</i> Në fakt, sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion, rezulton se nuk ka ndonjë llogaritje analitike në raport me grafikun e punimeve, kapacitet e mjeteve si dhe normativat përkatëse se prej nga ka rezultuar një numër prej 54 të punësuarish në lidhje me këtë kontratë pavarësisht faktit nëse ky numër mund të jetë ose jo i mjaftueshëm. Gjithashtu i panevojshëm dhe jashtë kontekstit të investimit në fjalë është edhe kërkesa e bërë për arkitektin si dhe ajo për të punësuarin i cili duhet të disponojë certifikatën <i>“Për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”</i> ku është kërkuar që të jetë domosdoshmërisht edhe drejtues teknik. <i>Kriteri: 2.3.9: Operatori ekonomik duhet të paraqesë Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë:</i> Sipas dokumentacioni të vënë në dispozicion, rezulton se nuk ka një sqarim konkret për të argumentuar numrin llojin dhe kapacitetet e mjeteve të vendosura pavarësisht faktit nëse ky numër dhe lloj mjetesh mund të jetë ose jo i mjaftueshëm. Në lidhje me kriteret rezulton se janë bërë ankesa të cilat kanë marrë përgjigje nga ana e AK si dhe janë bërë sugjerime nga ana e APP përmes postës elektronike në datë 14.08.2019.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, <i>“Për prokurimin publik”</i>, i ndryshuar, Neni 1 <i>“Objekti dhe qëllimi”</i>, pika 2 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Qëllimi i këtij ligji është:</i> a) <i>të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;</i> b) <i>të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;</i> c) <i>të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;</i> ç) <i>të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;</i> d) <i>të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;</i> dh) <i>të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.</i> Neni 2 <i>“Parimet e përzgjedhjes”</i> <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:</i> a) <i>mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;</i> b) <i>transparencë në procedurat e prokurimit;</i> c) <i>barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.”</i> Neni 20 <i>“Mosdiskriminimi”</i> <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“I Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.”</i> - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 <i>‘Për miratimin e rregullave të</i></p>

	<p><i>prokurimit publik</i>, neni 26 “Kontratat për punë publike”, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“3) <i>Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës;</i></p> <p>5) <i>Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”</i></p> <p>61 “<i>Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit</i>” <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“3) <i>Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjrisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre..”</i></p> <p>- Rregullore e Brendshme e Punës</p>
Ndikimi:	Vendosja e kriterëve jo në përputhje me nevojat e shërbimit ndikon në konkurrencën e lirë e të ndershme si dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet të fondeve të shoqërisë aksionare Posta Shqiptare.
Shkaku	Interpretim i gabuar i kuadrit ligjor e rregullator të procedurave të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve të argumentuara teknikisht dhe ligjrisht si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJP z. N. Ll., z. K. B., znj. J. P., znj. D. K. dhe z. S. Z. si dhe anëtarët e KSHA z. E. T., znj. B. B. dhe znj. A. V..

2. Titulli i gjetjes:	Kualifikim dhe shpallje fitues e OE me mangësi në dokumentacion.
Situata:	<p>Sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton se në 1 rast, konkretisht në procedurat me objekt Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër BOE nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimit e stafit mesatar për periudhën janar – nëntor 2019 sipër përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit me nr. 92 rep., 23 kol., datë 17.01.2020. Konkretisht sipas kësaj marrëveshjeje punimet janë ndarë në raportin 69.38 % OE A... dhe 30.62 % OE B.... Nisur nga fakti që numri total i punonjësve të kërkuar është 90, atëherë nga ana e këtyre dy OE duhet të ishin sjellë respektivisht dëshmi për disponimin e respektivisht 63 dhe 27 të punësuar. Në fakt nga ana e OE A... janë paraqitur listë pagesat mujore janar 2019 – nëntor 2019 me një numër mesatar prej 61 të punësuarish. Gjithashtu, nga ana e OE B..., edhe pse janë marrë përsipër 30.62 %, nuk janë sjellë dëshmi për disponimin e një inxhinieri elektrik si dhe një arkitekti si pjesë e licencës së shoqërisë.</p>

	<p>Përveç sa më sipër rezulton se nga ana e BOE nuk janë dorëzuar analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar.</p>
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2 <u>ku përcaktohet se</u>: “Qëllimi i këtij ligji është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. <p>Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” <u>ku përcaktohet se</u>: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që Autoriteti Kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese:”</p> <p>Neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, <u>ku përcaktohet se</u>: Pika 3: Autoriteti Kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji;</p> Pika 5: Autoriteti Kontraktor nuk e pranon një ofertë: c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji;” <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 66 “Kualifikimi i ofertuesve” “2“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.” - VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave ‘Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit’. <p>Pika 10 <u>ku përcaktohet se</u>: “Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e</p>

	<p>ndërtimit e që marrin pjesë në tenderë publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave”.</p> <p>Pika 11 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve. Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar.”</p> <p>- Rregulloren e Përgjithshme të punës;</p>
Ndikimi:	Kualifikimi dhe shpallja fitues e Operatorëve Ekonomikë të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim nuk siguron përdorim me efektivitet, eficiencë dhe economicitet të fondeve të Posta Shqiptare SHA.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve të KVO.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Nga ana e shoqërisë aksionare Posta Shqiptare të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe economicitet të fondeve.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO znj. A. K., znj. R. Ll. dhe znj. M. Z.

Zhvillimi i Procedurës “Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”, me nr. REF-28142-06-24-2019)		
<p>1. Urdhër Prokurimi Urdhri nr. 26 me nr. 1767 prot., datë 24.06.2019</p>	<p>3. Përlogaritja e vlerës së Fondit Limit Urdhër nr. 42 me nr. 558 prot., datë 22.02.2019 z. R. A. znj. V. K. znj. Q. H.</p> <p>Specifikimet teknike Urdhri nr. 16 me nr. 381 prot., datë 08.02.2019 z. G. P., Inxhinier Pyjesh z. B. Sh., Ekonomist znj. E. S., Ekonomiste</p> <p>Hartimi i Kriereve të Veçanta të Kualifikimit z. G. P., – Përgjegjës për transportin</p> <p>Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 26 me nr. 1767 prot., datë 24.06.2019 znj. D. K. – Personi Përgjegjës për Prokurimin z. G. P., – Përgjegjës për transportin znj. B. B. – Specialiste Zhvillimi</p>	<p>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 26/1 me nr. 1767/1 prot., datë 24.06.2019 z. H. B. – Kryetar z. K. B. – Anëtar z. E. A. – Anëtare</p>
<p>2. Lloji i Procedurës “E hapur”, “Shërbime”, format elektronik</p>		
<p>5. Fondi Limit (pa TVSh) 100,000,000 lekë 5.1 Afati 48 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës</p>	<p>6. Oferta e kualifikuar e para M....N M....S ShPK Kontrata me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 me vlerë 115,221,880 lekë me TVSH</p>	<p>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 3,990,100 lekë 4 %</p>

8. Data e hapjes së tenderit 19.07.2019, ora 11:00	9. Burimi Financimit Të ardhurat e vet SHA	10. Operatorët Ekonomikë (oferta lekë pa TVSH)
11. Ankimime Po, në AK në lidhje me kriteret M..... M..... 1296/13, prot., datë 02.07.2019	12. Përgjigje Ankesës Po	Pjesëmarrës: <u>M....N M....S– 96,009,900</u>
Titullari i Autoritetit Kontraktor z. L. D.		

➤ Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se sipas një relacioni të datës 07.02.2019 të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve z. V. A. është cituar se për realizimin e shpërndarjes në adresë të paketave dhe kolipostave janë nevojitur rreth 21 furgonçina dhe rreth 30 motoçikleta të parashikuara për tu përdorur në 14 Filiale të Postave. Nga ana e Drejtorit të Burimeve Njerëzore znj. M. H. në datë 12.02.2019 është bërë kërkesë për automjete të reja për shkak të domosdoshmërisë për ndjekjen dhe kontrollin e shërbimeve postare. Sipas një shkrese pa datë të znj. A. K., drejtuar Administratorit të shoqërisë, i është kërkuar këtij të fundit procedimi me blerjen me Leasing operacional, kjo sipas shkresave me nr. 3103/1 prot., datë 08.11.2018 nga Departamenti i Shërbimeve dhe nr. 239/b, prot., datë 15.11.2018 të Drejtorisë Juridike. Sipas shkresës nr. 381 prot., datë 08.02.2019 është ngritur Grupi i Punës për përcaktimin e specifikimeve teknike me përbërje të grupit z. G. P., z. B. Sh. dhe znj. E. S. nga ana e të cilit janë përgatitur sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019. Në lidhje me përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, sipas shkresës nr. 558 prot., datë 22.02.2019 është ngritur Grupi i Punës me përbërje të grupit z. R. A., znj. V. K. dhe znj. Q. H., nga ana e të cilit është hartuar procesverbal administruar në Posta Shqiptare SHA me nr. 558/1 prot., datë 25.02.2019 sipas të cilit janë përzgjedhur subjektet për të paraqitur ofertë me qëllim parashikimin e vlerës së fondit limit. Subjektet e përzgjedhura kanë rezultuar:

H,...I. A....O A....A
A....N M....R C....Y
M....N M....S
A....O S....A

Në përgjigje të kërkesës për ofertë nga ana e këtyre shoqërive, në mënyrë të ngjashme nga të katërt ofertuesit, është kthyer përgjigje se Leasing Operacional nuk mund të ofrohet për një vit pasi vetëm vitin e parë mjetet kanë një kosto zhvlerësimi të madhe e për rrjedhojë periudha më e shkurtër është ajo 4 vjeçare. Përgjigja si më sipër i është bërë me dije ish Titullarit të AK sipas Relacionit me nr. 558/6 prot., datë 01.03.2019. Në vijim, është ngritur me Urdhër nr. 53, datë 12.03.2019 të ish Titullarit një grup pune sipas shkresës me nr. 740 prot., datë 12.03.2019 me përbërje të grupit znj. A. K. Kryetare dhe znj. L. H., znj. E. M. dhe z. H. M., anëtarë, për analizën e kostos dhe efikasitetin procedural për procedurën e prokurimit. Ky grup pune ka hartuar Relacionin përkatës sipas shkresës me nr. 99/b prot., datë 18.04.2019. Në vijim sipas shkresës me nr. 1110 prot., datë 19.04.2019, është ngritur me Urdhër nr. 74, datë 19.04.2019 Grupi i Punës për përlllogaritjen e fondit limit (pas dështimit të herës së parë për shkak të afatit 1 vjeçar) me përbërje të grupit z. R. A., znj. V. K. dhe znj. Q. H.. Në zbatim të Urdhrit Grupi i Punës ka hartuar procesverbalin nr. 1110/1 prot., datë 19.04.2019 sipas të cilit ka zgjedhur po të njëjtat subjekte ofertuese për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit.

H,...I. A....O A....A
A....N M....R C....Y
M....N M....S
A....O S....A

Kërkesat drejtuar subjekteve si më sipër janë bërë me shkresën me nr. 1110/2 prot., datë 19.04.2019 ku janë kërkuar:

- 3 autovetura
- 30 motorra
- 21 furgonçina

Nga këta rezultat se dokumentohet përgjigjet si më poshtë:

Sasia	Mjeti	Ofertuesi	Modeli	Shkresa	Kësti mujor
3	Autoveturë	M....N M....S	VOLVO V40	1110/5, datë 23.04.2019	145,500 lekë
30	Motorr	M....N M....S	Nuk specifikohet	1110/5, datë 23.04.2019	15,750 lekë
21	Furgonçinë	M....N M....S	Fiat Doblo	1110/5, datë 23.04.2019	73,500 lekë

Sasia	Mjeti	Ofertuesi	Modeli	Shkresa	Kësti mujor
3	Autoveturë	A....N M....R C....Y	Ford Focus	1110/4, datë 23.04.2019	141,000 lekë
30	Motorr	A....N M....R C....Y	Lifan	1110/4, datë 23.04.2019	16,500 lekë
21	Furgonçinë	A....N M....R C....Y	Ford Courier	1110/4, datë 23.04.2019	75,000 lekë

Sasia	Mjeti	Ofertuesi	Modeli	Shkresa	Kësti mujor
3	Autoveturë	A....O S....A	MERCEDES CLASS A 180 CDI	1110/3, datë 23.04.2019	144,000 lekë
30	Motorr	A....O S....A	Nuk specifikohet	1110/3, datë 23.04.2019	16,350 lekë
21	Furgonçinë	A....O S....A	MERCEDES CITAN 108 CDI	1110/3, datë 23.04.2019	74,250 lekë

3. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të përcaktimit të vlerës së fondit limit.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion ë lidhje me procedurën e prokurimit me objekt <i>“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”</i> viti 2019 rezulton se nga mjetet e ofertuara nga ana e OE M....N M....S, ai i modelit Furgonçinë është i markës FIAT modeli Fiat Doblo dhe të dhënat e këtij mjeti, çmimi njësi i të cilit ka shërbyer si referencë për përllogaritjen e vlerës së fondit limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019. Konkretisht është kërkuar që konsumi i kombinuar është kërkuar të jetë 4.5 l/100 km në një kohë që mjeti Fiat Doblo ka një konsum prej 5.5 l/100 km, mjeti nuk dëshmon për disponimin e opsionit Hill Assist, komanda në timon, sistem start – stop, fuqia motorike është nën nivelin e kërkuar, etj. Në mënyrë të ngjashme rezulton se edhe për mjetet e ofruara nga ana e dy OE të tjerë A....N M....R C....Y dhe A....O S....A, çmimet njësi të të cilëve kanë shërbyer si referencë për përllogaritjen e vlerës së fondit limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019.
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, <i>“Për prokurimin publik”</i>, i ndryshuar, Neni 1 <i>“Objekti dhe qëllimi”</i>, pika 2 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Qëllimi i këtij ligji është:</i> b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.</p> <p>- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 <i>‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’</i>, neni 59, pika 2 <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe</i></p>

	<p>çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe</p> <p>çmimet e tregut; ose/dhe</p> <p>çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore”</p> <p>- Rregulloren e Përgjithshme të punës;</p>
Ndikimi:	Mungesë e konfirmimit të përcaktimit të vlerës reale të fondit limit.
Shkaku:	Mungesa e ezaurimit në mënyrën e duhur të të gjitha hapave për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike.
Rëndësia:	E mesme.
3.1 Rekomandimi:	Nga ana e grupeve të ngritura për përlogaritjen e fondit limit të ezaurohen të gjitha hapat e duhur e të nevojshëm me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike përmes marrjes së ofertave për mallra/shërbime/punime sipas atyre të kërkuara nga AK me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve dhe transparencës në drejtim të planifikimit të vlerës së investimeve.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi grupi i punës i ngritur për përcaktimin e vlerës së fondit limit z. R. A., znj. V. K. dhe znj. O. H..

Në përfundim të vlerësimit të ofertave nga ana e Grupit të Punës të ngritur për përlogaritjen e vlerës së fondit limit, vlerat e ofertave kanë rezultuar si më poshtë:

A....N M....R C....Y – 119,664,000 lekë pa TVSH

M....N M....S – 117,720,000 lekë pa TVSH

A....O S....A – 119,124,000 lekë pa TVSH

Pavarësisht sa më sipër, Grupi i Punës ka vlerësuar si vlerë të fondit limit shumë prej 100,000,000 lekë pa TVSH, kjo me argumentin se vlera vjetore për 4 vjetarin e parashikuar ka qenë 25,000,000 lekë pa TVSH. Ky konkluzion i është paraqitur Titullarit të AK sipas aktit nr. 1110/7 prot., datë 26.04.2019 i cili ka miratuar këtë vlerë fondi.

4. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të vendosjes së kriteve.
Situata:	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt <i>“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”</i> viti 2019 rezulton se specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur sipas shkresës nr. 381 prot., datë 08.02.2019 me përbërje të grupit z. G. P., z. B. Sh. dhe znj. E. S. janë të paargumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Konkretisht rezultojnë të tilla kërkesat e komisionit për mjetet si:</p> <p>Autoveturë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsumi i kombinuar Max: 4.0 l/100 km; - Gjatësia Min-Max 4,350-4,400 mm - Lartësia Min-Max 1,400-1,450 mm - Gjerësia (pa pasqyra) Min-Max 1,850-1,880 mm - Distanca Aksiale Min-Max 2,640-2,660 mm - Sensorë parkimi prapa (përse jo edhe Sensorë përpara) - Etj. <p>Furgonçina</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konsumi i kombinuar: Max: 4.5 l/100 km; - Gjatësia: Min 4,150 mm - Lartësia: Min 1,770 mm - Gjerësia (pa pasyra): Min 1,760 mm - Distanca Aksiale: Min 2,480 mm

	<ul style="list-style-type: none"> - Lartësia nga toka: Min 175 mm - Etj. <p>Motoçikleta</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmasat: (gjatësia/gjerësi/lartësi): Max. 1,950/720/1,060 mm - Lartësia nga toka: Min. 130 mm - Pesha: Min-Max 90-110 kg - Sistemi i frenimit: Para sistem hidraulik me disk, prapa me tambure - Rrota e përparme: Tubolare deri në 16”,goma 90/80-16 deri në 100/100-16 - Rrota e pasme: Tubolare deri në 14”,goma 110/80-14 deri në 120/80-14 - Valixhe në pjesën mbrapa: Kapaciteti deri në 75 litra, me hapje nga sipër (kuti plastike) - Koshi në pjesën e përparme: Kapaciteti deri në 35 litra (kuti plastike) <p>Në lidhje me këto specifikime, përveç sa më sipër, nuk argumentohet domosdoshmëria e përdorimit të sistemit GPS i cili, sipas citimit të Grupit të Punës është parashikuar të përdoret vetëm për Motoçikletat dhe Furgonçinat dhe jo për Autoveturën. Konkretisht është cituar: ... <i>Menaxhimin e flotës me anë të inkorporimit të sistemit të GPS ...</i> duke sqaruar në vijim se ky menaxhim do të kryhet nga ana e kompanisë operacionale, pra shoqëria private fituese e procedurës së prokurimit.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2 <u>ku përcaktohet se</u>: “Qëllimi i këtij ligji është: <ul style="list-style-type: none"> a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga Autoritetet Kontraktore; b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” <u>ku përcaktohet se</u>: “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: <ul style="list-style-type: none"> a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.” Neni 20 “Mosdiskriminimi” <u>ku përcaktohet se</u>: “1 Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.” Neni 23 “Specifikimet teknik” <u>ku përcaktohet se</u>: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të

	<p>kufizuara.</p> <p>2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.</p> <p>3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:</p> <p>a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;</p> <p>b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;</p> <p>c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj 61 .</p> <p>4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe 61 Shtuar me ligjin 131/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.</p> <p>5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.”</p> <p>VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 28 “Kontratat e Shërbimeve”, <u>ku përcaktohet se</u>: “Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet”</p> <p>- Rregullore e Brendshme e Punës</p>
Ndikimi:	Vendosja e kriterëve jo në përputhje me nevojat e shërbimit ndikon në

	konkurrencën e lirë e të ndershme si dhe nuk siguron përdorim me efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet të fondeve të shoqërisë aksionare Posta Shqiptare.
Shkaku	Interpretim i gabuar i kuadrit ligjor e rregullator të procedurave të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomicitet.

5. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të planifikimit të investimit.
Situata:	<p>Nga ana e Grupit të Auditimit u analizua Relacioni i hartuar nga ana e Grupit të Punës i ngritur me Urdhër nr. 53, datë 12.03.2019, me nr. 740 prot., datë 12.03.2019 për analizën e kostos dhe efikasitetin procedural për procedurën e prokurimit si më sipër, kjo me qëllim identifikimin e avantazheve dhe disavantazheve të përdorimit të Leasing operacional dhe imazhin e institucionit.</p> <p><u>Nga kjo analizë rezulton si më poshtë shpjegohet:</u></p> <p>Sipas këtij relacioni, pika 2 është cituar ndër të tjera se vlera e automjetit pëson një rënie të konsiderueshme gjatë viteve të përdorimit, vlerë kjo e parikuperueshme në fund të jetës së automjetit. Në fakt, nga një analizë e dokumenteve të vëna në dispozicion rezulton se nga grupi përkatës nuk është marrë në konsideratë shuma e mbetur e investimit e cila në fund të 4 viteve rezulton të jetë në total në masën <u>24,332,448 lekë</u>, e përllogaritur kjo për mjete si më poshtë:</p> <p>Motoçikleta – 3,756,840 lekë; Autovetura – 3,686,400 lekë; Furgonçina – 16,889,208 lekë;</p> <p>Pra, në total rezulton se AK në përfundim të afatit të kontratës së qirasë do të kishte në dispozicion të tij asete me vlerë kontabël 24,332,448 lekë. Përveç kësaj, rezulton se pa u mbështetur në një historik konkret, Grupi i Punës ka përllogaritur për variantin e blerjes, shpenzime për kryerjen e shërbimeve periodike. Konkretisht rezulton se në përllogaritje janë përfshirë pajisje kamera dhe sistemi GIS, të dyja këto në shumën prej 67,000 lekë/makine për 4 vite, ose shuma prej 1,407,000 lekë pa TVSH. Njëkohësisht nga ana e këtij Grupi Pune është përllogaritur shuma prej 114,720 lekë pa TVSH/vit x mjet, ose në total për 21 furgonçina shuma prej 9,636,480 lekë pa TVSH, parashikim ky jo plotësisht i argumentuar, kjo pasi vetë blerja e sistemit së bashku me kamerat është parashikuar në shumën prej 67,000 lekë/mjet. Nga verifikimi i kilometrave të përshkruara nga mjetet e marra me qira nga fillimi i kontratës e deri aktualisht rezulton se autoveturat, furgonçinat dhe motoçikletat në pjesën më të madhe të tyre kanë përshkruar më pak kilometra nga sa janë parashikuar⁷.</p>
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2 <u>ku përcaktohet se</u>: “Qëllimi i këtij ligji është:</p> <p>a) të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të</p>

⁷ Aneksi 2.3.7

	<p>kryera nga Autoritetet Kontraktore;</p> <p>b) të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;</p> <p>c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;</p> <p>ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;</p> <p>d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;</p> <p>dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”</p>
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, efijencë dhe ekonomicitet i fondeve në shumën prej 96,009,900 lekë pa TVSH.
Shkaku	Interpretim i gabuar i kuadrit ligjor e rregullator si dhe planifikim i gabuar i investimit.
Rëndësia:	E lartë.
5.1 Rekomandimi:	Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për një vlerësim të saktë të leverdishmërisë së investimeve të kryera për punë/mallra shërbime me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, efijencë dhe ekonomicitet të fondeve siç është i rastit të kontratës me objekt “Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite” me vlerë 96,009,900 lekë pa TVSH.

NË LIDHJE ME ZBATIMIN E KONTRATAVE PËR PUNIME CIVILE

1. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti I: Rikonstruksion i Zyrave Postare të Filialeve Gjirokastër, Sarandë

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE H.O K.N (me nr. licence NZ.) & (me nr. licence NZ.), me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor sipas aktit me nr. 2402/20 prot., datë 07.01.2019 me vlerë **18,867,329 lekë me TVSh** dhe me afat të zbatimit të punimeve 60 ditë kalendarike nga data e fillimit të punimeve.

Projekti

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se projekti i zbatimit i hartuar nga ana e shoqërisë R.N. me përfaqësues ligjor znj. R. N., ka parashikuar rikonstruksionin e zyrës së Përpunimit të Postës Gjirokastër, zyrës postare Memaliaj, zyrës postare Jorgucat, zyrës së pensioneve nr. 2 Tepelenë dhe zyrës postare Qendër Sarandë.

Mbikëqyrja e kontratës

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me Autoritetin Kontraktor me nr. 14/1 prot., datë 29.10.2018 me vlerë **793,132 lekë me TVSh** me shoqërinë R.N. SHPK me përfaqësuese ligjore znj. R. N.

Kolaudimi i punimeve

Kolaudimi i punimeve është kryer në bazë të kontratës së kolaudimit me nr. 5/2 prot., datë 30.09.2019 nga shoqëria I.Y. me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. I. S. me nr. licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK.3331/1, datë 25.07.2019 me vlerë të kontratës 41,724 lekë me TVSH. Akti i kolaudimit të punimeve mban datën 17.12.2019.

Zbatimi i punimeve

Sipas korrespondencave rezulton se punimet kanë filluar me datë 15.03.2019 dhe kanë përfunduar me datë 08.11.2019 (disa pika postare i janë dorëzuar sipërmarrësit të punimeve në data të mëvonshme se data 15.03.2019).

6. Titulli i gjetjes:	Punime të likuiduara por të pakryera në fakt.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite”, viti 2018 rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE H.O K.N & .T tepër në vlerë si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej 458,663 lekë pa TVSH , vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.3.0.1.
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.</p> <p>neni 12, <u>ku përcaktohet se:</u> “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.”</p> <p>- VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.</p> <p>- Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I, germa A, paragrafi i fundit <u>ku përcaktohet se:</u> “Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat” Si dhe Kreu II, Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit</p> <p>- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës” Pika 8.3: “Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë”.</p> <p>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u> “3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p>

	<p>3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, vepohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.</p> <p>- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 14/1 prot., datë 29.10.2018.</p> <p>- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 5/2 prot., datë 30.09.2019.</p>
Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 458,663 lekë pa TVSH.
Shkaku	Veprimet dhe mos veprimet e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej 458,663 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE H...O K. N & .T me të cilët është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 2902/16 prot., datë 05.12.2018 me objekt “<u>Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite</u>”, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.</p>

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve znj. R. N. përfaqësuese e shoqërisë R.N. dhe kolaudatori i punimeve znj. I. S. përfaqësuese e shoqërisë I.Y.

2. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues BOE A. (me nr. licence NZ..) & B.S (me nr. licence NZ.....), me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor (Posta Shqiptare, Filiali Gjirokastër) e përfaqësuar nga z. I. Z. sipas shkresës me nr. 3163/47 prot., datë 30.03.2020 me vlerë 40,220,232 lekë me TVSh dhe me afat të zbatimit të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të punimeve. Sipas aktit me nr. 1822/6 prot., datë 16.10.2020 është lidhur kontrata shtesë në masën prej 20 %, ose me vlerë 8,039,720 lekë me TVSH.

Projekti

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se projekti i zbatimit i hartuar nga ana e shoqërisë R.N. me përfaqësues ligjor znj. R. N., ka parashikuar rikonstruksionin e disa filialeve/degëve/pikave postare në zonën e Vlorë, Sarandës dhe Gjirokastrës.

Mbikëqyrja e kontratës

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me Autoritetin Kontraktor (Posta Shqiptare, Filiali Gjirokastër) e përfaqësuar nga z. I. Z. sipas

shkresës me nr. 135 prot., datë 30.03.2020 me vlerë 417,688 lekë me TVSh me shoqërinë D.S SHPK me përfaqësues ligjor z. V. T..

Kolaudimi i punimeve

Kolaudimi i punimeve është kryer në bazë të kontratës së kolaudimit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020 nga shoqëria I.Y. me administrator znj. R. N. me nr. licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK., datë 08.10.2020 me vlerë të kontratës 220,559 lekë me TVSH. Akti i kolaudimit të punimeve mban datën 01.03.2021.

Zbatimi i punimeve

Sipas korrespondencave rezulton se punimet kanë filluar me datë 31.03.2020 dhe kanë përfunduar me datë 30.11.2020 (disa pika postare i janë dorëzuar sipërmarrësit të punimeve me datë 01.06.2020).

7. Titulli i gjetjes:	Punime të likuiduara por të pakryera në fakt.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt <i>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”</i> , viti 2020 rezultoi se në përgjithësi punimet janë kryer me një cilësi të dobët duke bërë që investimi të paraqesë shenja shumë të hershme amortizimi, kjo më shumë në rifiniturat për shkak kryesisht të mos marrjes së masave kundër shkaktarëve të lagështisë. Dyert nuk janë vendosur të cilësisë së parë dhe druri duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të punimeve të mos respektohen kërkesat e projektit për një shumë totale prej 740,432 lekë pa TVSH për 84.14 m ² dyer të realizuara. Gjithashtu, për sa i takon dritareve dhe dyerve rezulton se nuk janë realizuar me material plastik por me alumin të thjeshtë duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të punimeve të mos respektohen kërkesat e projektit dhe preventivit për një shumë totale prej 1,248,296 lekë pa TVSH për dritaret dhe dyert e realizuara. Për rrjedhojë rezulton se janë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet fondet në shumën prej 1,988,728 lekë pa TVSH. Gjithashtu nga inspektimi rezultuan ambiente me lagështi dhe punime rifiniturash të amortizuara në prej lagështisë dhe mungesës së izolimeve në disa raste. Nga krahasimi i volumeve të situacionuara e likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE A. & B.S në shumën totale prej 58,414 lekë pa TVSH , vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.3.0.2.
Kriteri:	- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”</i> , i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7/1: <i>“1. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.</i> <i>2. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, në çdo rast, kur gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së</i>

	<p><i>Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.”</i></p> <p><i>- Kreu II Kërkesa Themelore, neni 12, ku përcaktohet se:</i> <i>“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. objekti është realizuar në kushtet teknike;</i> <i>2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;</i> <i>3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës;</i> <i>4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.”</i> <p><i>-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, ku përcaktohet se:</i> Pika 8.1: <i>“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.</i></p> <p><i>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se:</i> <i>“3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</i></p> <p><i>3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;</i></p> <p><i>- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 135 prot., datë 30.03.2020.</i></p> <p><i>- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.</i></p>
Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 58,414 lekë pa TVSH dhe përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet i fondeve në shumën prej 1,988,728 lekë pa TVSH .
Shkaku	Veprimet dhe mos veprimet e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë.

7.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej 58,414 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE A.& B.S me të cilët është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/47 prot., datë 30.03.2020 me objekt <u>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, <u>Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë</u>”</u> , për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.
7.2 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të kontratave të punimeve për të siguruar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale e duke shmangur kështu përdorimin pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve siç është ai në rastin e kontratës me objekt <u>“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, <u>Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë</u>”</u> me BOE A... & B...S ku rezultoi se nuk janë respektuar specifikimet teknike për dy zëra punimesh në shumën prej 1,988,414 lekë pa TVSH .

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. V. T. përfaqësues i shoqërisë D.S dhe kolaudatori i punimeve znj. R. N. përfaqësuese e shoqërisë I.Y.

3. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE L.N K.N (me nr. licence NZ.....) me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga ish Titullari i AK z. L. D. sipas shkresës me nr. 3163/56 prot., datë 15.05.2020 me vlerë **24,879,726.19 lekë me TVSh** dhe me afat të zbatimit të punimeve 6 muaj nga data e fillimit të punimeve, afat ky i cili është amenduar sipas aktit me nr. 3163/101 prot., datë 09.12.2020.

Projekti

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se projekti i zbatimit i hartuar nga ana e shoqërisë R.N. me përfaqësues ligjor znj. R. N., ka parashikuar rikonstruksionin e disa filialeve/degëve/pikave postare në zonën e Elbasan dhe Korçës.

Mbikëqyrja e kontratës

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga z. A. D. (në atë kohë Drejtor i Filialit Elbasan) sipas shkresës me nr. 104 prot., datë 17.01.2020 me vlerë **354,756 lekë me TVSh** me shoqërinë A.....N SHPK me përfaqësues ligjor z. A. B. (me nr. licence MK.....).

Kolaudimi i punimeve

Kolaudimi i punimeve është kryer në bazë të kontratës së kolaudimit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020 nga shoqëria I.Y. me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. A. N. me nr. licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK....., datë 08.10.2020. Akti i kolaudimit të punimeve mban datën 23.03.2021.

Zbatimi i punimeve

Sipas korrespondencave rezulton se punimet kanë filluar me datë 15.07.2020 dhe kanë përfunduar me datë 22.01.2021.

8. Titulli i gjetjes:	Punime të likuiduara por të pakryera në fakt.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan”, viti 2020 nga krahasimi i zërave të situacionuar e të pasqyruara në librezën e masave si dhe verifikimit në terren të kryer në prezencë të përfaqësuesve të Postës Shqiptare SHA rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve OE L...N K...N si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej 202,501 lekë pa TVSH , e argumentuar kjo sipas Aneksit nr. 2.3.0.3.
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7/1: “1. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. 2. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, në çdo rast, kur gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.”</p> <p>- Kreu II Kërkesa Themelore, neni 12, <u>ku përcaktohet se:</u> “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.”</p> <p>- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.</p> <p>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u> “3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë</p>

	<p>për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;</p> <p>- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 104 prot., datë 30.03.2020.</p> <p>- Kontrata e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.</p>
Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 202,501 lekë pa TVSH
Shkaku	Veprimet dhe mos veprimet e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë.
8.1 Rekomandimi:	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej 202,501 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit të punimeve OE L.N K.N me të cilin është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/56 prot., datë 15.05.2020 me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, <u>Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan</u>”, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.</p>

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. A. B. përfaqësues i shoqërisë A.N dhe kolaudatori i punimeve znj. A. N. përfaqësuese e shoqërisë I.Y.

4. Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës

Historiku i zbatimit të punimeve

Në përfundim të procedurës së prokurimit, është shpallur fitues OE K..N K.N (me nr. licence NZ.....), me të cilin është lidhur kontrata me Autoritetin Kontraktor e përfaqësuar nga Titullari z. L. D. si dhe përfaqësuesi i sipërmarrësit z. L. Gj. sipas aktit me nr. 1995/30 prot., datë 14.01.2020 me vlerë **27,170,217 lekë me TVSh** dhe me afat të zbatimit të punimeve 5 muaj nga data e fillimit të punimeve. Kjo kontratë është amenduar në lidhje me aftin e përfundimit të punimeve sipas aktit me nr. 1995/60 prot., datë 01.07.2020.

Projekti

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se projekti i zbatimit i hartuar nga ana e shoqërisë T.T H.Y C.G me përfaqësues ligjor z. E. C., ka parashikuar rikonstruksionin e 14 zyrave postare në zonë veriore të Filialeve Shkodër, Mat, Lezhë dhe Kukës.

Mbikëqyrja e kontratës

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur kontrata përkatëse e shërbimit me BOE 2 R... M... me nr. licence MK ... & M.....O e cila është amenduar në lidhje me afatin e zbatimit

të punimeve sipas aktit me nr. 224/1 prot., datë 15.06.2020. Sipas shkresës me nr. 1036 prot., datë 01.06.2020 është bërë njoftim për tërheqje nga kontrata e njërit prej anëtarëve të këtij BOE, R.... M.... për arsye shëndetësore. Në vijim nga ana e Titullarit me shkresën nr. 1036/1 prot., datë 03.06.2020 është njoftuar sipërmarrësi për ndërprerjen e punimeve deri në zgjidhjen e situatës. Më tej kontraktori është njoftuar për rifillimin e punës përmes shkresës me nr. 1995/33 prot., datë 18.06.2020.

Kolaudimi i punimeve

Kolaudimi i punimeve është kryer në bazë të kontratës së kolaudimit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020 nga shoqëria L.....Y ... me administrator znj. R. N. me nr. licence për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh MK....., datë 08.10.2020.

Zbatimi i punimeve

Sipas korrespondencave rezulton se punimet kanë filluar në data të ndryshme duke nisur nga 17.02.2020 deri në datë 13.06.2020 me aktin e dorëzimit të shesheve të ndërtimit dhe kanë përfunduar me datë 05.09.2020.

9. Titulli i gjetjes:	Punime të likuiduara por të pakryera në fakt.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt <i>“Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”</i> , viti 2020 nga krahasimi i zërave të situacionuar e të pasqyruara në librezën e masave rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve OE K....N C.....N si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej 265,301 lekë pa TVSH , e argumentuar kjo sipas Aneksit nr. 2.3.0.4.
Kriteri:	<p>- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”</i>, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> neni 7/1: <i>“1. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.</i> <i>2. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve, në çdo rast, kur gjatë mbikëqyrjes së punimeve, sipas fazave përkatëse, konstaton mospërputhjen e punimeve të kryera me lejen e ndërtimit, me dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, urdhëron pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe njofton menjëherë Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të bashkisë ku kryhen punimet e ndërtimit dhe autoritetin përgjegjës të planifikimit ose, sipas rastit, edhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.”</i></p> <p>- Kreu II <i>Kërkesa Themelore</i>, neni 12, <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</i> 1. <i>objekti është realizuar në kushtet teknike;</i> 2. <i>objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj;</i> 3. <i>çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës;</i> 4. <i>në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit</i></p>

	<p>që do të kolaudojë.”</p> <p>- Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>Pika 8.1: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi të, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.</p> <p>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagraf 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”;</p> <p>- Kontrata e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 224/1 prot., datë 15.06.2020.</p> <p>- Kontrata e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.</p>
Ndikimi:	Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në shumën 265,301 lekë pa TVSH
Shkaku	Veprimet dhe mos veprimet e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve.
Rëndësia:	E lartë.
9.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej 265,301 lekë pa TVSH ndaj sipërmarrësit të punimeve OE K....N C.....N me të cilin është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/56 prot., datë 15.05.2020 me objekt “Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. T. S. përfaqësues i shoqërisë M. S. dhe kolaudatori i punimeve znj. R. N. përfaqësuese e shoqërisë I.Y.

10. Titulli i gjetjes:	Kryerje e shërbimeve të mbikëqyrje/kolaudimit në kushtet e konfliktit të interesit.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e zbatimit të kontratave me objekte si më poshtë rezulton se: 1. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastrë, Sarandë dhe

filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti I: Rikonstruksion i Zyrave Postare të Filialeve Gjirokastrë, Sarandë:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria R. N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I. Y. me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. I. S. Në fakt, referuar dokumentacionit të kontratës së dhurimit të kuotave me nr. 1828 rep. 754 kol., datë 25.09.2020 ndodhur në QKB, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R.N .

Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.

2. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastrë, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria R.N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I.Y. me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. I. S.. Në fakt, referuar dokumentacionit të kontratës së dhurimit të kuotave me nr. 1828 rep. 754 kol., datë 25.09.2020 ndodhur në QKB, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R.N.

Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.

3. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria A.N me përfaqësues ligjor znj. A. N.;

Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I.Y. me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. A. N.. Në fakt, sipas dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R.N.

Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.

	<p>4. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, <u>Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër:</u> Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.N. me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;</p> <p>Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria D.S me përfaqësues ligjor z. V. T.;</p> <p>Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I.Y. me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. R. N.. Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga e një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara të njëjtin person i cili njëkohësisht ka qenë edhe përfaqësues ligjor i shoqërisë hartuese të projektit R.N., konkretisht znj. R. N.. Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12 <u>ku përcaktohet se:</u> “Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.”
Ndikimi:	Kryerja e shërbimit të kolaudimit në kushtet e konfliktit të interesit nuk siguron besueshmëri në certifikimet e bëra për sa i takon anës teknik dhe asaj financiare.
Shkaku	Veprimet dhe mosveprimet e mbikëqyrësit dhe/apo kolaudatorit sipas rastit.
Rëndësia:	E lartë.
10.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masat e nevojshme për identifikimin dhe shmangien e rasteve të konfliktit të interesit me qëllim sigurimin e shërbimeve efektive nga ana e Kontraktorëve.

Lidhur me sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj. R. N., znj. I. S. dhe znj. A. N..

Zhvillimi i Procedurës “Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë”

Përshkrimi i procedurës

Pas analizimit të kërkesave të filialeve për mbulimin e shërbimit të sigurisë me sisteme sigurie të zyrave postare dhe ambienteve të tjera të rëndësishme, të pa pajisura me këto sisteme, Drejtoria e Sigurisë dhe Cilësisë ka kërkuar mbulimin me shërbimin e sigurisë me sisteme sigurie të zyrave postare të cilat nuk kanë qenë të pajisura më parë me këto sistemi si dhe rinovimin e disa zyrave postare të tjera të cilat kanë pasur sisteme të vjetra. Konkretisht:

- Sistem Alarmi - 80 Copë Mënyrat e Transmetimit
- Gprs Dhe Sms Ose Tcp/Ip (Program i Monitorimit)

- Sensore Alarmi Me Tela - 128 Copë Sensor Pyroelektrik Me Element Të Dyfishtë
- Dvr 4 Kanale - 52 copë
- Dvr 8 Kanale - 9 copë
- Dvr për Automjetet (2 Kamera Secila) 12 copë
- Kamera për Brenda - 140 copë
- Kamera për Jashte - 140 copë
- Kamera për Automjetet - 24 copë
- Ekran për Automjetet
- Karta Memorie për Sistemin e Automjeteve

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 20 datë 20.08.2020	2. Lloji i procedurës së Prokurimit “E hapur” me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: z. L. M. (përgjegjës) z. O. Dh. (specialist) z. Xh. H. (specialist)
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 31 datë 16.06.2020 z. B. B. z. O. Dh. z. Xh. H.	5. Komisioni për përllogaritjen e fondit limit znj. Zh. B. znj. E. Ç. znj. E. K.	7. Fondi limit (pa TVSH) 28,505,600 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 15.09.2020 shtyrje e afatit 26.10.2020	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 34/1 datë 14.08.2019 z. V. A. (Kryetar) z. E. K. (Anëtar) z. H. K. (Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës <ul style="list-style-type: none"> • “F.H sh.p.k. 28,293,511 lekë • “A.M” sh.p.k 28,373,196 lekë • “E.K” sh.p.k 28,473,012 lekë • “I.S” sh.p.k. 27,888,888 lekë 	8. Oferta fituese (pa TVSH) 27,888,888 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 616,712 lekë
11. Ankimime AK “A.... B....S.....” sh.p.k. me nr. 1648/3 prot., datë 27.08.2020 “A.... B....S.....” sh.p.k. me nr. 1648/9 prot., datë 14.09.2020 Ankimime KPP Datë 16.09.2020, nr. 1648/10 prot.	12. Përgjigje Ankesës Urdhër i brendshëm nr. 20/4 datë 28.08.2020 mbi shqyrtimin e ankesës. Përgjigje ankesës me nr. 1648/6 datë 31.08.2020 drejtuar OE. Përgjigje drejtuar KPP nr. 1648/11 datë 21.09.2020	13. Përgjigje Ankesës nga KPP Përgjigje nr. 1648/12 datë 13.10.2020
14. Lidhja e kontratës Nr. 1648/20 datë 26.01.2020		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 120 ditë Zbatuar ___ditë	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës	21. 20. Akt i marrjes në dorëzim B. B. A. G. Xh. H.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi Situacion me pagesë intervalore	16. Likuiduar deri dt

Gjatë kërkesës për fillim procedurash për realizimin e prokurimit me objekt “Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë” drejtuar Administratorit z. L. D., Drejtoria e Sigurisë dhe Cilësisë ka kërkuar mbulimin me shërbimin e sigurisë me sisteme sigurie të zyrave postare të cilat nuk kanë qenë të pajisura më parë me këto sistemi si dhe rinovimin e disa zyrave postare të tjera të cilat kanë pasur sisteme të vjetra. Në kriteret e veçanta të kualifikimit AK ka përcaktuar që duhet të ketë kompatibilitet me sistemet ekzistuese që janë kamerat Hikvision, sistemet e alarmit Messer GPRS dhe Radio, Sistemet GPS Meitrack. Meqenëse shumica nga sistemet e implementuara janë të reja, gjithashtu dhe rinovimi i këtyre sistemeve do të bëhen me produkte të reja, nuk duhet që të ketë kompatibilitet me sistemet ekzistuese, ndërsa për sa i përket kompatibilitetit me platformën e menaxhimit të sistemeve të alarmit e cila është KRONOS si dhe platformës së menaxhimit të sistemeve GPS MS03 është

e drejtë pasi duhet të integrohen midis tyre. Gjatë përlogaritjes së fondit limit i janë dërguar shkresat për oferta 3 subjekteve si:

S.....S, S..... S.... S..... dhe A....D. Gjatë hulumtimit vihet re se distributori i platformës KRONOS për Shqipërinë është subjekti E.....K nga ku minimumi i kërkesës për ofertë duhet të ishte subjekti në fjalë, si dhe nga të tre subjektet që kanë sjell ofertat e tyre asnjë nuk është paraqitur në garë për procedurën në fjalë.

Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimit, grupi i auditimit konstatoi:

- Në kërkesën për fillim procedurash për realizimin e prokurimit, drejtorja e sigurisë dhe cilësisë ka kërkuar mbulimin me shërbimin e sigurisë me sisteme sigurie të zyrave postare të cilat nuk kanë qenë të pajisura e ku gjithashtu përfshihen dhe vendosja e sistemeve GPS për automjetet;
- Gjatë shqyrtimit të konsumimit të karburantit, grupi i auditimit hasi vështirësi në verifikimin e km të kryera dhe konsumit të karburantit nga automjetet në përdorim të punonjësve të shoqërisë, pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk ishin të pajisura me sistemin GPS;
- Gjithashtu, grupi i auditimit konstatoi se dhe në automjetet që ishin të pajisura me sistemin GPS, nuk u arrit të merreshin të dhëna për vitet periudhë nën auditim 2019-2022, pasi në sistemin qendror nuk u gjenden rekorde për gjurmimin e automjeteve.

11. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në zbatimin e kushteve të kontratës
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë”, gjatë implementimit dhe zbatimit të kontratës nga grupi i auditimit u konstatua që një pjesë e konsiderueshme e automjeteve nuk ishin të pajisura me sistemin GPS si dhe automjetet që ishin të pajisura me sistemin GPS, nuk u arrit të merreshin të dhëna për vitet periudhë nën auditim 2019-2022, pasi në sistemin qendror nuk u gjenden rekorde për gjurmimin e automjeteve.
Kriteri:	VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”.
Ndikimi:	Ndikim në përmbushjen e objektivave të procedurës së prokurimit.
Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të kontratës.
Rëndësia:	E lartë.
11.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, komisioni i ndjekjes dhe i zbatimit të kontratës, të marrin në konsideratë të gjitha kushtet e kontratës dhe të garantojë zbatimin e tyre me përpikmëri nga të dyja palët.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi, Komisioni i zbatimit dhe mbikëqyrjes së kontratës z. B. B., z. A. G. dhe z. Xh. H..

Zhvillimi i Procedurës “Blerje palmar profesional, barkod reader me Wireless, lexues barkodesh”

Përshkrimi i procedurës

Blerja e pajisjeve do të shërbejë për kryerjen në mënyrë elektronike dhe automatike të disa shërbimeve të rëndësishme për institucionin si në terren ashtu edhe në sportele. Blerja e këtyre pajisjeve ul kostot operative dhe rrit performancën duke ofruar një pjesë të shërbimeve në mënyrë elektronike dhe të automatizuar.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje palmar profesional, barkod reader me wireless, lexues barkodesh”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 26 datë 16.09.2020	2. Lloji i procedurës së Prokurimit “ E hapur” me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: z. V. K. (përgj.) z. A. K. (specialist)

		z. B. Dh. (specialist)
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 29 datë 12.06.2020 z. A. K. z. M. Z. znj. B. Dh.	5. Komisioni për përlogaritjen e fondit limit znj. Zh. B. znj. M. S, znj. E. K.	7. Fondi limit (pa TVSH) 33,731,000 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 12.10.2020	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 34/1 datë 14.08.2019 z. V. A. (Kryetar) z. E. K. (Anëtar) z. H. K. (Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës • “S.....A” sh.p.k. 32,821,000 lekë • “A.....M” sh.p.k. 28,373,196 lekë • “S.....A” sh.p.k. 29,800,000 lekë • “I.....S” sh.p.k. 33,000,000 lekë b) s’kualifikuar: • “F.....H sh.p.k. • “A.....M” sh.p.k. • “E.....K” sh.p.k	8. Oferta fituese (pa TVSH) 32,821,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 910,000 lekë
11. Ankimime AK ska	12. Përgjigje Ankesës	13. Përgjigje Ankesës nga KPP
14. Lidhja e kontratës Nr. 1840/8 datë 21.11.2020		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 45 ditë Zbatuar ___ ditë	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës me 35 ditë	21. 20. Akt i marrjes në dorëzim E. P. K. H. A. K.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi Faturë nr. 85/2021 datë 27.01.2021	16. Likuiduar deri dt

Specifikimet Teknike

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Palmar professional	Copë	300
2	Barkod reader me Wireless	Copë	20
3	Lexues barkodesh	Copë	250

Softwëre duhet të jetë i përfshirë dhe të ofrojë mundësinë e menaxhimit të të dhënave dhe të lejoj transmetimin e tyre nga programi në palmar dhe anasjelltas. Palmaret duhet të ofrojnë mundësinë e ndryshimit/përshtatshmërisë të menisë, opsioneve duke krijuar kështu politika specifike të përdorimit të pajisjeve nga përdorues. Për këtë qëllim prodhuesi duhet të ofroj një Softwëre i cili i jep mundësinë administratorit, të bëjë ndryshimet e nevojshme të parametrave si më poshtë:

- Karakteristika të pajisjes (Device Settings)
- Update i sistemit të operimit (OS Update)
- Instalim programesh (APK, Licence, etj.)
- Të hapë programet (Run on APP)
- Të ofrojë mundësinë e modifikimit të dokumenteve. (Modify, Create, Rename, Copy, Delete File or Directory)
- Të menaxhojë karakteristika të rrjetit (Network management)

Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve u konstatua:

- Pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, kriteri i veçantë nr. 2.5 ku thuhet që produktet e ofruara duhet të jenë Brand i njohur Ndërkombëtar është kriter diskriminues pasi janë certifikatat e cilësisë, origjinalitetin e mallrave ato që i japin këto attribute dhe jo emri. Për rrjedhojë vendosja e një kriteri të tillë është në kundërshtim me Nenin 20 të Ligjit për Prokurimin Publik;
- Gjatë vlerësimit të ofertave, komisioni i vlerësimi të ofertave ka s’kualifikuar ofertën me vlerë më të ulët, sjellë nga OE S.....A me vlerë 29,800,000 lekë pa TVSH dhe ka kualifikuar OE

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Mirëmbajtja e Data Center” 2022		
1. Urdhër Prokurimi 13 datë 19.05.2021		
Lloji i procedurës së Prokurimit: Procedurë e Hapur	2. Njësia e Prokurimit z. E. A. znj. V. K. znj. E. H.	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: z. R. K. z. E. A. z. E. K.
4. Fondi limit (pa TVSH) Lekë 12,000,000 lekë	5. Burimi i Financimit Buxheti i institucionit	6. Data e hapjes së tenderit 27.10.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës D.... sh.p.k + B... 11,898,000 L..... S..... pa ofertë Jupiter Group 11,980,000 b) kualifikuar: D.... sh.p.k + B... 11,898,000	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. A. S. znj. A. K. z. K. H.	9. Oferta fituese (pa TVSH) 11,898,000 lekë
10. Data e lidhjes së kontratës 1069/8 datë 06.08.2021	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 102,000 lekë	12. Ankimime Nuk ka
13. Struktura për ndjekjen e kontratës z. E. A. znj. E. S. znj. M. S.	y14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 1 vit
16. Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi		

Zhvillimi i procedurës së mësipërme të prokurimit përfshin:

- Suporti dhe garancia me mbulimin dhe zëvendësimin të hardwëare të difektuar (kosto e përfshirë) si dhe përditësimet me versionet e fundit të firmwëare dhe drivers (kosto e përfshirë);
- Përditësimi falas i aplikacioneve ndihmëse (firmwëare dhe drivers) në rast të shfaqjes së dobësive (bugs) të shfaqura gjatë operimit;
- Suport për të gjitha pajisjet dhe licencat kërkohet të jetë me kohë përgjigje 4 orë gjatë periudhës 24x7 pas raportimit të problemit.

Nr.	Produktet/Garancitë dhe shërbimet	Produkti	PN
1	Garanci dhe Suport 1 vjeçar On-Site për produktet Fujitsu Blade System - dhe specifikisht BX900 S1 System Unit, 18 x BX920 S2 Dual Server Blade, 2 x FC Switch 8Gb 18/8 26 (Brocade) 2 x Eth Switch/IBP 1Gb 36/12 dhe komponentët e tjerë përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	PRIMERGY BX900 S1	ABN:K1245-V200-21
		PRIMERGY BX920 S2	A3C40125829
		PY CB Eth Switch/IBP 1Gb 36/12(Mode:Switch)	A3C40096531
		PY CB FC S2 8Gb 18/8 26 (Brocade)	A3C40108452
2	Garanci dhe Suport 1 vjeçar On-Site për produktin EMC Data Storage - dhe specifikisht EMC Clariion SAN Array CX4-120 dhe komponentët e tjerë përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	CX4-120 COMBO	900566004
3	Garanci dhe Suport 1 vjeçar On-Site për produktin Quantum Scalar i40 Tape Library - dhe specifikisht për Sci40 LIBRARY TEO LTO-4HH dhe komponentët e tjerë përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	SELECT Sci40 LIBRARY TEO LTO-4HH 25 SLOTS NFC	LSC14-CH4G-119H
4	Garanci dhe Suport 1 vjeçar për Juniper Core Firewall, Juniper Core Switchet - dhe specifikisht për Juniper SRX 3400 Cluster FireWalls dhe Juniper EX 4200 Switches. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	SWITCH ESMODEL EX 4200-48T	750-033063
		FIREWALL SRX 3400	710-015748
5	Suport 1 vjeçar për produktet CheckPoint Edge Firewall + P209 Software Gateway + Security Management	Software Check Point Edge Firewall	CPSG-P209
6	Garanci dhe Suport 1 vjeçar onsite 12x5 next-business-day për produktet Cisco ASA 5510 Adaptive Security Appliance dhe komponentët e tjerë përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	Cisco ASA 5510 Security Plus bundle	ASA5510K8
		Cisco RPS 675	PËR675ACRPSN1
7	Garanci dhe Suport 1 vjeçar onsite 24x7x4 për produktet IBM System Servers dhe komponentet e tjerë përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	Server IBM System x3550 M3	7944KAG
8	Garanci dhe Suport 1 vjeçar onsite 24x7x4 për produktet HP ProLiant Server DL380 G5 Server dhe komponentët e tjerë përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	HP ProLiant DL380 G5	470064627
9	Garanci dhe Suport 1 vjeçar onsite 24x7x4 për produktet HP ProLiant Server DL360 G6 Server dhe komponentët e tjerë përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	HP ProLiant Server DL360 G6	484184B21
10	Garanci dhe Suport 1 vjeçar On-Site për produktin IBM Storage - dhe specifikisht IBMStoreize V5030 dhe komponentët e tjerë përbërës. (shiko listën e detajuar tek tabela përkatëse)	IBM Storeize v5030	2078-312

Nga auditimi i procedurës së mësipërme u konstatua:

Gjatë analizimit të ofertës së sjellë nga O.E. fitues i procedurës së mësipërme, vihet re që në zërat sipas specifikimeve të mësipërme, vlera e mirëmbajtjes dhe garancisë së ofruar është më e lartë se vlera e produkteve, si më poshtë: (referuar çmimeve në Web të faqeve zyrtare të produkteve)

Emërtimi	Sasia	Vlera nga Web	Shuma Në \$	Vlera e ofruar nga O.E.
Intel Xeon X5460 Quad-Core 64-bit processor - 3.16GHz	2	1000	2000	
146GB hot-plug single-port SAS hard disk drive - 10,000 RPM, 3Gb/sec transfer rate, 2.5-inch small form factor (SFF)	5	15	75	

4GB, 667MHz, PC2-5300F-5, DDR2, dual-rank x4, 1.80V, registered, fully-buffered ãith ECC	8	27	216	
1000 Ë AC hot-plug Power supply	2	80	160	
System I/O board (motherboard)	1	700	700	
Hot-plug fan assembly - 60 mm x 60 mm x 38 mm	8	15	120	
TOTAL			3271 \$	458,000

Emërtimi	Sasia	Vlera nga Web	Shuma Në \$	Vlera e ofertuar nga O.E.
10 Gb iSCSI HOST PORT	4	450	1800	
4TB 7200RPM SAS DISK DRIVE	4	220	880	
600GB 15K 4GB SAS DISK DRIVE	4	125	500	
REDUNDANT POËER SUPPLY 800Ë	2	253	506	
10 GbE PORT DATA MANAGEMENT	2	800	1600	
TOTAL			5286	2,263,400

Emertimi	Sasia	Vlera nga Web	Shuma Në \$	Vlera e ofertuar nga O.E. në lek
Chassis assembly (ëithout front bezel)	2	25	50	
Power supply, 460 Ëatt, ac	4	51	204	
Hard disk drive, 2.5-inch hot-sëap, 146 GB, 15K	4	20	80	
Memory, 8 GB dual-rank DDR3-1333 RDIMM	4	23	92	
System board	2		0	
Mikroprocesor, Intel Xeon E5645 2.40 GHz, 12 MB, 80Ë (six core)	2	300	600	
SAS/SATA riser card	2	35	70	
TOTAL			1096	345,000

Emërtimi	Sasia	Vlera nga Web	Shuma Në \$	Vlera e ofertuar nga O.E. në lek
CX4-120 COMBO (8GBFC-1GBISCSI) Ë 1 SPS	1	3500	3500	
4G DAE FACTORY OR FIELD INSTALL	7	1	7	
600GB 15K 4GB FIBRE CHANNEL DISK DRIVE	75	60	4500	
....B 7200RPM SATA II DISK DRIVE	9	24	216	
VALUT CX4 SERIES 600GB15K 4G DRIVES QTY	1	7000	7000	
NAV/UNI CX4-120	1	300	300	
TOTAL			15523	2,750,600

Për sa më sipër, nga ana e përfaqësuesve të Posta Shqiptare SHA, gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit për mirëmbajtjen e Data Center nuk është marrë në konsideratë menaxhimi i duhur i burimeve të shoqërisë, ku grupi i auditimit gjykon që pjesët hardwãare dhe sistemet e mësipërme mund të menaxhohen dhe mirëmbahen nga vetë specialistët e institucionit si dhe gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në përlllogaritjen e fondit limit nuk janë marrë në konsideratë çmimet e pajisjeve që do të mbulohen me mirëmbajtje, duke kaluar çmimin e tyre të blerjes.

14. Titulli i gjetjes:	Parregullsi gjatë përlllogaritjes së fondit limit.
Situata:	Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “ <i>Mirëmbajtja e Data Center</i> ”, nuk është marrë në konsideratë menaxhimi i duhur i burimeve të shoqërisë, ku grupi i auditimit gjykon që pjesët hardwãare dhe sistemet e mësipërme mund të menaxhohen dhe mirëmbahen nga vetë specialistët e institucionit si dhe gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në përlllogaritjen e fondit limit nuk janë marrë në konsideratë çmimet e pajisjeve që do të mbulohen me mirëmbajtje, duke kaluar çmimin e tyre të blerjes. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomikitetit vlera prej 11,898,000 lekë .
Kriteri:	VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “ <i>Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik</i> ”, neni 13 “ <i>Neni 13 “Studimi paraparak i tregut</i> ”.
Ndikimi:	Pengesë në zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë.
Shkaku:	Vendosja e kriterëve jo në proporcion me vlerën e kontratës.
Rëndësia:	E lartë.

14.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, gjatë alokimit të burimeve të shoqërisë, të marrin në konsideratë përdorimin e 3E, duke përdorur burimet e shoqërisë për kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave të shoqërisë.
--------------------------	---

Auditimi i procedurave të prokurimit u përqendrua kryesisht në investimet dhe shpenzimet e bëra gjatë periudhës objekt auditimi për aplikacionin e quajtur Eterna, i cili është sistemi kryesor për administrimin e veprimeve operationale në Posta Shqiptare SHA. Ky sistem përfshin: shërbime financiare si arkëtime e pagesa, transfera bankare, etj. si dhe mbulon proceset e shërbimeve postare.

Historiku i zhvillimit të këtij aplikacioni paraqitet më poshtë:

Data e lidhjes se kontratave	Kontrata	OE Fitues	Investimi (lekë) Pa TVSH		Mirëmbajtja (lekë) Pa TVSH		
			Vlera e Kontratave te brejes	Fatura	Vlera e kontratave te mirëmbajtjes	Vitet	Vlera e paguar deri në 31.12.2020
21.08.2012/ 14.05.2014*	Blerje informatizimi i sporteleve, gjurmimi kombëtar i objekteve postare dhe euroxhiro kombëtare.	H.....S S.....S	51,791,320	48,650,000	26,850,000	3 vite	26,850,000
22.05.2017	Mirëmbajtja e Sistemit Eterna	H.....S S.....S	-	-	27,000,000	3 vite	27,000,000
03.06.2020	Mirëmbajtja e Sistemit Eterna	H.....S S.....S	-	-	27,000,000	3 vite	5,250,000
09.03.2018/ 18.07.2019*	Kalimi i sistemit eterna në Web dhe zhvillime të tjera, programi i informatizimit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe finance kontabilitet, si dhe sistem Software për ndjekjen dhe menaxhimin e çështjeve (help desk)	H.....S S.....S	29,500,000	29,500,000	9,450,000	4 vite	3,150,000
	Dorëzimi i funksioneve grupi i pare	H.....S S.....S	-	-	-	-	-
	Dorëzimi i funksioneve grupi i dyte	H.....S S.....S	-	-	-	-	-
	Integrimi i funksioneve (mod Financës)	H.....S S.....S	-	-	-	-	-
	Integrimi i funksioneve (te tjerat)	H.....S S.....S	-	-	-	-	-
04.08.2018	Shërbim ndërfaqe ndërmjet sistemit Eterna dhe kompanisë Digicom	H.....S S.....S	-	-	800,000	Një here	800,000
03.08.2018/ 18.07.2019*	Eterna Gateway Application	H.....S S.....S	25,000,000	25,000,000	0,000,000	4 vite	6,666,667
03.08.2018	Eterna E-Posta	H.....S S.....S	25,000,000	25,000,000	20,000,000	4 vite	1,666,667
	Faza I	H.....S S.....S	-	-	-	-	-
	Faza II	H.....S S.....S	-	-	-	-	-
25.06.2019	Posta Retail Outlet	H.....S S.....S	19,800,000	19,800,000	11,100,000	4 vite	1,387,500
	Faza I	H.....S S.....S	-	-	-	-	-
	Faza II	H.....S S.....S	-	-	-	-	-
16.09.2019	Blerje Eterna BI + Data Warehouse + Reporting Services, Log Management, Manaxhim të dokumentave, Statistike	H.....S S.....S	25,000,000	25,000,000	16,000,000	4 vite	1,000,000
	Faza I	H.....S S.....S	-	-	-	-	-
	Faza II	H.....S	-	-	-	-	-

	S.....S	-				
Totali	H.....S S.....S	176,091,320	172,950,000	158,200,000		73,770,833

Sipas tabelës së mësipërme që prej vitit 2012, janë investuar për blerjen e sistemeve Eterna Postare dhe Eterna Financiare në vlerën **176,091,320 lekë pa TVSH** dhe me **211,309,000 lekë me TVSH**. Për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve janë lidhur 10 kontrata që vazhdojnë më afat deri në mesin e vitit 2023 me vlerë të përgjithshme **158,200,000 lekë pa TVSH** dhe **189,840,000 lekë me TVSH**. Deri në 30 qershor 2021, për kontrata e mirëmbajtjes janë shpenzuar rreth **93,000,000 lekë pa TVSH** dhe rreth **110,000,000 lekë me TVSH**. Vlen të theksohet se, të gjitha procedura e prokurimeve si të blerjeve të sistemit ashtu edhe të mirëmbajtjes së tyre janë fituar nga i njëjti operator ekonomik H.....S S.....S. Fillimisht në korrik të vitit 2012 është realizuar procedura e prokurimit për *“Blerje informatizimi i sporteleve, gjurmimi kombëtar i objekteve postare dhe euroxhiro kombëtare”* GateWay.

- Zhvillimi i procedurës me objekt *“Mirëmbajtje GateWay Application për 4 Vite”* me fond limit 20,000,000 lekë pa TVSH, me datë 14.05.2019. Posta Shqiptare SHA ka kërkuar të mirëmbajë platformën Eterna GateWay Application, e cila u mundëson institucioneve financiare dhe bankare që të lidhin sistemin e tyre me sistemin Eterna të Postës Shqiptare, në mënyrë që të kryejnë nëpërmjet sporteleve të saj disa prej shërbime të tyre dhe në të njëjtën kohë për të rritur gamën e shërbimeve që sportelet e Postes Shqiptare ofrojnë për klientët. Mirëmbajtja përfshin funksionet e mëposhtme:

- Ndërlidhjen me sistemin core banking ose sistemin e pagesave të palëve të treta;
- Klientët e bankave/institucioneve financiare të depozitojnë lek te llogaritë e tyre;
- Walking Customer të bëjnë veprime në llogari të tjera bankare;

- Zhvillimi i procedurës me objekt *“Mirëmbajtja e Moduleve të Eternës (Finance-kontabilitet, Burimet njerëzore, Magazina, Help Desk) për 4 vite”*, datë 31.05.2019

Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen janë si më poshtë:

- Korigjimin e të gjithë gabimeve (bug-eve) të funksioneve të moduleve përkatëse, pas raportimit të marrë nga Personi i kontaktit të postës;
- Monitorimi periodik i performancës së sistemit. Në raste kur vërehen probleme në performancë, Operatori Ekonomik duhet të ndërhyjë për zgjidhjen e tyre duke optimizuar kodin burim;
- Kompania duhet të garantojë suport duke modifikuar modulet përkatëse në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm afekton sistemin;
- Koha e përgjigjes dhe e zgjidhjes së kërkesave të mësipërme duhet të bëhet në bazë të tabelës së pikës që jepet në paragrafin *“Përgjigja dhe shkallëzimi i shërbimit”*.

- Zhvillimi i procedurës me objekt *“Posta retail outlet (blerje on line për objekte postare si pulla, souvenire, etj. si dhe Mirëmbajtje për 4 vite pas implementimit)”*, më datë 13.05.2019. Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një dyqani Online ose tregtisë elektronike Online për Postën Shqiptare. Tregtia elektronike *e-commerce* është një mënyrë e re për të bërë biznes duke shfrytëzuar rrjetet më të mëdha elektronike siç është interneti. E ashtuquajtura *e-commerce*, tregtia elektronike në masë të madhe lehtëson transaksionet midis Posta Shqiptare dhe konsumatorëve (B2C), midis Posta Shqiptare dhe kompanive të tjera (B2B). Shumë kompani postare e kanë futur me sukses këtë shërbim duke rritur gamën e shërbimeve të tyre gjithashtu.

- Zhvillimi i procedurës me objekt *“Blerje Eterna BI + Data Warehouse + Reporting Services, log management, manaxhim te dokumenteve, statistikë si dhe Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit”*, më datë 22.07.2019.

Objektivi është ndërtimi i një magazine të dhënash (Data Warehouse), inteligjencë biznesi (Business Intelligence) dhe administrim logesh (Log Managament) që do të shërbejnë si një burim kryesor raportimi dhe analize për punonjësit e Postës Shqiptare SHA. Ndërtimi i një database Data Warehouse që të mundësojë organizimin e të dhënave nga data bazat operacionale, në mënyrë të konsoliduar dhe të standardizuar, duke e bërë të mundur

vendimmarrjen e postës ndërmjet mjeteve analitike dhe raportuese. Modeli i data bazës duhet të bazohet mbi skema dimensionale dhe faktike, duke marrë informacionin e vlefshëm nga data bazat operacionale për të gjitha shërbimet financiare dhe postare të sistemit ETERNA. Loget që gjenerohen në Sistemin Eterna dhe Financiare duhet të jenë të kategorizuar dhe për nga burimi i gjenerimit të log-ut. Duhet të kemi të paktën 2 burime për sistemin Eterna Postar dhe Eterna Financiare si dhe brenda tyre duhet të ketë një kategorizim të mëtejshëm si Security Log, Application Log dhe WebService Log. Security Log duhet të regjistrohet çdo gjë që ka të bëjë me sigurinë e sistemit, si tentativë të sukseshme apo jo për tu loguar në sistem, ndryshim password apo të dhënash të tjera tek përdoruesi i sistemit, dhënie apo heqje aksesit tek modulet apo profilet e sistemit. Application Log do të regjistrohet çdo gjë tjetër që ka të bëjë me sistemin Eterna Financiare dhe Postare por që nuk ka lidhje direkte me shërbimet e palëve të treta. WebService Log do të regjistrohet çdo gjë që ka të bëjë me komunikimet direkte me service-et e palëve të treta si shërbimet e OSHEE, Gjobave, Ujësjesit në rastin e financiarit apo Shërbimi i Import/Export të IPS në rastin e postarit.

- Zhvillimi i modulit të aplikacionit
- Konfigurimi i infrastrukturës IT që do të mbajë aplikacionin
- Trajnimi i punonjësve të Posta Shqiptare, Punonjësit e Shërbimeve Financiare dhe postare (trajnim i trajnuesve të postës)
- Trajnimi i administratorëve të TI
- Krijimi i manualit të administratorëve
- Krijimi i manualit të përdorimit
- Zhvillimi i procedurës me objekt *“Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite”*, më datë 05.05.2020.

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është mirëmbajtja e sistemeve Eterna-Financiare dhe Eterna Postare, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në të gjitha zyrat postare në të cilat është instaluar ky sistem. Eterna Financiare përbëhet nga serverët e mëposhtëm:

- ‘Application server’: i cili operon me sistemin e operimit Windows Server dhe shërben si ndërfaqe midis kërkesave nga përdoruesit dhe shërbimet drejt serverit të bazave të të dhënave.
- ‘Database Server’: i cili operon me sistemin e operimit Windows Server dhe shërben për të ruajtur të dhënat operacionale të cilat gjërohen gjatë proceseve të ndryshme të punës.
- ‘Data Warehouse Server’: i cili operon me sistemin e operimit Windows Server dhe shërben për të ruajtur të dhënat për gjenerimin e raporteve me periudhë më të gjata se 3-ditore, i ngritur me qëllim për të mos afektuar performancën e serverit të data bazës Production.

- Zhvillimi i procedurës me objekt *“Mirëmbajtja E-Posta për 4 vite”*, më datë 05.05.2020.

Në platformën Dixhitale e-Posta kryhen veprimet e mëposhtme nëpërmjet kompjuterit, smartphone-it ose tabletit pa qenë nevoja të paraqiteni në sportelet e Posta Shqiptare SHA:

- Regjistrimi online i profilit
- Krijimi në mënyrë të pavarur të identitetit dhe fjalëkalimit
- Lidhja me profilin e klientit të kontratave dhe shërbimeve të klientit që janë të publikuar në e-posta
- Kontrolli i veprimeve financiare dhe postare
- Konfirmim i transfertave
- Regjistrimi i llogarive Pre-beneficioary për transferimin e fondeve
- Pagesa e faturave të klientëve
- Pagesa e detyrimeve
- Aksesimi i sistemi e-posta nga Web dhe mobile Android dhe iOS
- Printim i veprimeve të klientëve online

e-Posta ju ofron mundësi individëve dhe institucionet për të kontrolluar/rishikuar në kohë reale dhe në mënyrë të sigurt të gjitha transaksionet/pagesat dhe veprimet postare të kryera në Posta Shqiptare. Klientët mund të kontrollojnë aktivitetin e tyre në çdo kohë nëse kanë një kompjuter, mobile dhe qasje në Internet. Aplikimi e-Posta lejon pagesën në internet të faturave për kompanitë e ndryshme utilitare si OSHEE, Albtelecom, kompanitë e furnizimit me ujë, gjobat e policisë etj. që ofrohen si shërbime nga Posta Shqiptare.

- Zhvillimi i procedurës me objekt *“Blerje Biznes Hub”*, më datë 14.05.2021

Nëpërmjet Business Hub do kryhet shtimi i komponentëve të mëposhtëm në funksionet ekzistuese të sistemit informatik të Postës Shqiptare për të ofruar një game të gjere shërbimesh për klientë nëpërmjet modifikimeve në modulën E-posta të cilat ofron mbajtjen e llogarive virtuale për klientë dhe gjithashtu ofron pagesa online nëpërmjet këtyre llogarive, integrimi me sistemet e tjera të cilat mbajnë të dhënat (siç është data baza e studentëve). Nëpërmjet aplikimit e-Posta klientët pasi të regjistrohen/aprovohen do të kenë mundësinë të përfitojnë të gjithë gamën e benefiteve të ofruara për ta.

- Data baza e klientëve preferencial në përputhje me kategorinë përkatëse;
- Moduli i ofrimit të shërbimit për tregtarët;
- Moduli i ofrimit të shërbimit për Klientët;
- Lista e tregtarëve të përfshirë në skemë;
- Lista e klientëve që përfitojnë nga skema e uljeve;
- Integrimi me sistemin e pagesave e-wallet;
- Moduli për hedhjen e ofertave për segmente të ndryshme klientësh;
- Integrimi i Moduli për hedhjen e ofertave për segmente të ndryshme klientësh me e-commerce;
- Integrimi me e-albania për të mundësuar pagesat e shërbimeve qeveritare nëpërmjet e-wallet;
- Ndryshimet e nevojshme në Eterna •b Log Management Module;
- Integrimi me modulën e njoftimeve në Eterna;
- Integrimi me modulën e dhënies së të drejtave në Eterna;
- Shtimi i funksioneve të duhura për të plotësuar nevojat e mësipërme tek Eterna Financiare;
- Aprovimi i pagesave nga moduli e-posta;
- Rest Api për tarifën postare;
- Rest api për integrimin e kontrollit të kuponave nga sistemet e tregtarëve;

● **Zhvillimi i procedurës me objekt “Gjenerimi i IBAN”, më datë 27.12.2022**

Përdorimi i IBAN, bëhet me qëllim:

- Identifikimin në mënyrë të vetme të llogarisë së klientit në sistemin qendror të Postës Shqiptare, duke përdorur një format të standardizuar të paraqitjes së saj;
- Përpunimin automatik të identifikimit të llogarive;
- Unifikimin dhe standardizimin e procesit të kontrollit të vlefshmërisë së llogarive.

Nga auditimi i procedurave së mësipërme u konstatua se:

- Duke qenë se shoqëria ka operuar me humbje, për zhvillimin e procedurave të mësipërme nuk është kryer një analizë e detajuar kosto përfitim;
- Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “*Blerje Eterna BI + Data Warehouse + Reporting Services, log management, manaxhim të dokumenteve, statistikë si dhe Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit*”, më datë 22.07.2019, objektivi është ndërtimi i një magazine të dhënash (Data Warehouse), inteligjencë biznesi (Business Intelligence) dhe administrim logesh (Log Management) që do të shërbejnë si një burim kryesor raportimi dhe analize për punonjësit e Postës Shqiptare SHA si dhe mirëmbajtja e tyre për 4 vite, ku njëkohësisht është zhvilluar dhe procedura me objekt “*Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite*”, më datë 05.05.2020 ku kanë objekt të ngjashëm dhe flitet për të njëjtat zëra mirëmbajtje si më poshtë: ‘Application server’, ‘Database Server’ dhe ‘Data Warehouse Server’.
- Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “*Posta retail outlet (blerje on line për objekte postare si pulla, suvenire, etj. si dhe Mirëmbajtje për 4 vite pas implementimit*”, më datë 13.05.2019, u konstatua që të ardhurat e fituara gjatë përdorimit të modulit të mësipërm nuk mbulojnë shpenzimet e implementimit dhe të mirëmbajtjes së modulit;
- Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “*Mirëmbajtja e Moduleve të Eternes (Finance-kontabilitet, Burimet njerëzore, Magazina, Help Desk) për 4 vite*”, datë 31.05.2019, grupi i auditimit gjykon se zhvillimi i mirëmbajtjes për modulet në fjalë nuk është i nevojshëm dhe mund të mbulohet nga specialistët e IT së institucionit, duke marrë në konsideratë dhe modulet ose aplikacionet e tjera që zhvillohen pranë institucioneve të tjera të cilët mirëmbahen nga vetë specialistët e institucioneve pas zhvillimit të trajnimeve;

- Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “Blerje Biznes Hub”, më datë 14.05.2021, në përbërje të objektit dhe specifikimeve të cilësuar në dokumentet standard të procedurës së prokurimit, cilësohen modifikime të moduleve ekzistuese të Eternës, për të cilët është zhvilluar procedurë për mirëmbajtjen dhe modifikimin e moduleve ekzistuese;
- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullave të prokurimit publik për realizimin e këtyre procedurave u konstatuan problematika të njëjta me problematika që u trajtuan më lartë, të cilat po i përmendim shkurtimisht dhe njëherë për të 6 procedurat:
 - të 6 procedurat janë zhvilluara të hapura, por në këto procedura ka pasur mungesë konkurrence pasi në to ka marrë pjese vetëm operatori H.....S S.....S, i cili është shpallur edhe fitues dhe ka lidhur kontratat e zbatimit;
 - Mungesa e theksuar e konkurrencës ka ardhur si pasojë e vendosjes në DT të kërkesës së veçantë që:
 - OE duhet të zotërojë të Drejtën e Autorit për programin Eterna Software të instaluar tek Posta Shqiptare ose të jetë i autorizuar nga mbajtësi i të drejtës së autorit për këtë program;
 - Operatori ekonomik, qoftë zotëruesi i të drejtës së autorit ose i autorizuar prej tij, duhet të disponojë kodin në burim, pasi Posta Shqiptare nuk e disponon këtë kod.

15. Titulli i gjetjes:	Nuk është kryer një analizë kosto-përfitim për zhvillimin e procedurës.
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “Blerje Eterna BI + Data Warehouse + Reporting Services, log management, manaxhim te dokumenteve, statistikë si dhe Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit”, më datë 22.07.2019, objektivi ka qenë ndërtimi i një magazine të dhënash (Data Warehouse), inteligjencë biznesi (Business Intelligence) dhe administrim logesh (Log Managment) që do të shërbejnë si një burim kryesor raportimi dhe analize për punonjësit e Postës Shqiptare SHA si dhe mirëmbajtja e tyre për 4 vite, ku njëkohësisht është zhvilluar dhe procedura me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite”, më datë 05.05.2020 ku kanë objekt të ngjashëm dhe flitet për të njëjtat zëra mirëmbajtje si më poshtë: ‘Application server’, ‘Database Server’ dhe ‘Data Warehouse Server.
Kriteri:	Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”.
Ndikimi:	Përdorimi pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve të prokuruar.
Shkaku:	Zhvillimi i procedurave të prokurimit për të njëjtin objekt.
Rëndësia:	E lartë.
15.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, të kryejnë një analizë të hollësishme të sistemeve të implementuar, duke kryer një kategorizim të serverëve dhe të mirëmbajtjes së tyre, pasi në procedurat e prokurimit të zhvilluara për mirëmbajtjet, objekti dhe specifikimet janë të njëjta.

16. Titulli i gjetjes:	Zhvillimi i procedurave të prokurimit që mund të mbulohen nga vetë punonjësit e institucionit.
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “Mirëmbajtja e Moduleve të Eternës (Finance-kontabilitet, Burimet njerëzore, Magazina, Help Desk) për 4 vite”, datë 31.05.2019, nga auditimi rezulton se zhvillimi i mirëmbajtjes për modulet në fjalë nuk është i nevojshëm dhe mund të mbulohet nga specialistët e IT së institucionit, duke marrë në konsideratë dhe modulet ose aplikacionet e tjera që zhvillohen pranë

	institucioneve të tjera të cilët mirëmbahen nga vetë specialistët e institucioneve pas zhvillimit të trajnimeve. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, efizienzës dhe ekonomicitetit vlera prej 9,450,000 lekë .
Kriteri:	Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “ <i>Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin</i> ”.
Ndikimi:	Përdorimi pa efektivitet, efizienzë dhe ekonomicitet i fondeve të prokuruar.
Shkaku:	Mos zhvillimi i një analizë kosto-përfitim.
Rëndësia:	E lartë.
16.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, gjatë alokimit të burimeve të shoqërisë, të marrin në konsideratë përdorimin me efektivitet, efizienzë dhe ekonomicitet të fondeve, duke përdorur burimet e shoqërisë për kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave të shoqërisë.

17. Titulli i gjetjes:	Nuk është kryer një analizë kosto-përfitim për zhvillimin e procedurës
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “ <i>Blerje Biznes Hub</i> ”, më datë 14.05.2021, në përbërje të objektit dhe specifikimeve të cilësuar në dokumentet standardë të procedurës së prokurimit, cilësohen modifikime të moduleve ekzistuese të Eternës, për të cilët është zhvilluar procedurë për mirëmbajtjen dhe modifikimin e moduleve ekzistuese. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, efizienzës dhe ekonomicitetit vlera prej 25,000,000 lekë .
Kriteri:	Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “ <i>Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin</i> ”.
Ndikimi:	Përdorimi pa efektivitet, efizienzë dhe ekonomicitet i fondeve të prokuruar.
Shkaku:	Mos zhvillimi i një analizë kosto-përfitim.
Rëndësia:	E lartë.
17.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese të shoqërisë, të kryejnë një analizë të hollësishme lidhur me shtimin dhe modifikimin e moduleve, të cilat janë objekt i procedurave të mëparshme të prokurimeve dhe detyrë e O.E. fitues i procedurave të mëparshme të Eternës, si dhe të kryejë një analizë kosto përfitim në lidhje me shtimin e moduleve të tilla, pasi mirëmbajtja e tyre rrit kostot e shoqërisë.

Zhvillimi i Procedurës “Blerje Hibrid Mail”

Përshkrimi i procedurës

Projekti “Hybrid Mail” synon të kthejë institucionin e Postës Shqiptare në një shërbim printimi me një ndalesë (One-stop-shop Printing) si:

- Fatura (Fatura shërbimesh utilitare si ujë, drita etj...);
- Materiale promocionale të personalizuar;
- Materiale transaksionale + informacioni promocionale (fatura shërbimesh telkomunikacioni);

Specifikimet Teknike

- Zgjidhja duhet të ketë një modul vizual (GUI) për lidhjen e të dhënave (data mapping) dhe hartimin e dokumenteve;

- Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të nxjerrë të dhëna nga burime të ndryshme dixhitale, të modifikojë të dhënat, të dizajnojë dokumentet dhe të krijojë produktin final. I tërë procesi duhet të jetë i automatizuar sa më shumë që të jetë e mundur;
- Të ofrojë mundësi për të pasur mjedise të veçantë për Backup / Testim / Zhvillim;
- Të ofrojë mundësi printimi në çdo printer, pavarësisht nga licenca (pa pasur nevojë për license për printer);
- Të ofrojë mundësi raportimi të automatizuar që mund të miratohet për nevojat e blerësit;
- Skalabiliteti - të lejojë organizatën të rrisi performancën e prodhimit për të përpunuar një kërkesë më të lartë kur është e nevojshme. (OPTION);
- Arkitektura e klasterit duhet të mbështetet plotësisht. Arkitekturimi e serverit duhet të jetë e mundur (p.sh. instalimi i një pjese të ndryshme të sistemit në servera të ndryshëm);

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt "Blerje Hibrid Mail"		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 34 datë 14.08.2019	2. Lloji i procedurës së Prokurimit "E hapur" me mjete elektronike	3. Njësia e Prokurimit: z. N. Ll. (përgjegjës) z. K. B. (specialist) z. A. S. (specialist)
4. Hartuesit e Specifikimeve Teknike Urdhër nr. 110 datë 24.07.2019 znj. B. Z. znj. F. Gj. z. K. B. z. E. P. z. A. S.	5. Komisioni për përllogaritjen e fondit limit znj. J. S. z. R. K. znj. A. K.	7. Fondi limit (pa TVSH) 175,122,553 lekë
9. Burimi i Financimit Buxheti i Postës Shqiptare	8. Data e hapjes së tenderit 13.09.2019	6. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 34/1 datë 14.08.2019 z. V. A. (Kryetar) z. E. S. (Anëtar) z. H. B. (Anëtar)
10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës <ul style="list-style-type: none"> • "S.....A" sh.p.k. 174,715,000 • "E.....K" sh.p.k. Pa ofertë ekonomike • "A..... P...." sh.p.k. Pa ofertë b) s'kualifikuar: <ul style="list-style-type: none"> • "E.....K" sh.p.k • "A.... P..." sh.p.k 	8. Oferta fituese (pa TVSH) 174,715,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 407,553 lekë
11. Ankimime AK "L... A..." sh.p.k. me nr. 2187 prot., datë 26.08.2019 Ankimime KPP Datë 16.09.2019, nr. 2187/7 prot. Ankimime Ministria e Financave Datë 07.10.2019 nr. 2594	12. Përgjigje Ankesës Urdhër i brendshëm nr. 34/4 datë 27.08.2019 mbi shqyrtimin e ankesës. Përgjigje ankesës me nr. 2187/6 datë 29.08.2019 drejtuar OE. Përgjigje drejtuar KPP nr. 2187/8 datë 18.09.2019 Përgjigje drejtuar MF nr. 2594/1 datë 10.10.2019	13. Përgjigje Ankesës nga APP Përgjigje nr. 1475/3 datë 04.10.2019 Përgjigje Ankesës nga KPP Përgjigje nr. 2187/10 datë 22.10.2019
14. Lidhja e kontratës Nr. 2187/25 datë 20.01.2020		
18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 120 ditë Zbatuar ___ditë	20. Shtyrja e zbatimit të kontratës Nr. 34/29 datë 20.05.2020 me 3 muaj Nr. 2187/31 datë 19.08.2020 me 2 muaj	21. 20. Akt i marrjes në dorëzim M. Z. R. Ll. R. N. A. G. A. B.
21. Fletë hyrja	Situacioni përfundimtar/Faturë malli/shërbimi Fatura nr. 130R datë 20.10.2021	16. Likuiduar deri dt 04.08.2021

Në zbatim të programit ekonomik të Shoqërisë Posta Shqiptare SHA më datë 22.07.2019 është dërguar shkresa me lëndë "Kërkesë për fillimin e procedurës të Postës Hibride (Hibrid Mail)" drejtuar Titullarit të Institucionit z. L. D. nga Drejtori i Dep. të Zhvillimit të Standardeve z. V. A.. Në shkresën në fjalë janë listuar të gjitha veçoritë dhe përfitimet e përdorimit të Hibrid Mail, por nuk është marrë parasysh një analizë Kosto-Përfitim dhe kjo

për shkak se implementimi i një teknologjie të tillë ka një kosto të lartë ashtu siç tregohet dhe në vlerën e prokuruar që arrin në shumën 174,715,000 lekë pa TVSH. Veçori tjetër është edhe kostoja e lartë e mirëmbajtjes e cila nuk është parashikuar si zë në hartimin e procedurës.

Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve u konstatua:

- Pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, shpenzimet për projekte investimesh ku përfshihen shpenzimet kapitale në infrastrukturë, ku në këtë rast janë blerje e pajisjeve të mëdha teknologjike, në fazën e planifikimit buxhetor të shpenzimeve nuk është kryer një analizë kosto-përfitim e projektit për një menaxhim sa më efektiv të shpenzimeve në mospërputhje me praktikat më të mira dhe me udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”;
- Sistemi Hybrid Mail është parashikuar që të vihet në përdorim në bazë të kontratave lidhur me shoqëritë e tjera, pasi si objekt kryesor ka prodhimin dhe zarfimin e dokumenteve në mënyrë që të vijojë shpërndarja e tyre. Nga momenti që është vënë në përdorim deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit, kontratat e lidhura nga AK me subjektet e tjera janë minimale në vlerë dhe nuk sjellin përfitime për përdorimin e një sistemi të tillë;
- Për zbatimin e kontratës, nga ana e OE ishte si detyrim afati prej 120 ditësh për implementimin e sistemit Hibrid Mail (deri më 20.05.2020). Nga ana e AK ka pasur dy amendime kontratash për arsye të Covid 19. Gjithashtu situacioni përfundimtar nr. 130 mban datën 20.10.2021 e cila nuk përkon as me amendimin e dytë të kontratës dhe nga ana e AK nuk është mbajtur penalitet për vonesën prej 12 muajve të përfundimit të kontratës;
- Gjatë vitit 2022 është realizuar dhe një procedurë prokurimi për mirëmbajtjen e sistemit në fjalë me bojëra teknologjike, për një vlerë prej 12,580,000 lekë pa TVSH, nga i njëjti operator ekonomik, vlerë e cila nuk e mbulon fitimin e përdorimit të sistemit gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu nga grupi i auditimit u konstatua se e njëjta procedurë prokurimi është zhvilluar dhe gjatë vitit 2023 për një vlerë prej 11,599,165 lekë pa TVSH.

18. Titulli i gjetjes:	Kryerja e procedurës së prokurimit në kundërshtim me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit.
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “ <i>Blerje bojëra teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail</i> ”, më datë 30.09.2022, për një vlerë prej 12,580,000 lekë pa TVSH, nga i njëjti operator ekonomik, vlerë e cila nuk e mbulon fitimin e përdorimit të sistemit gjatë kësaj periudhe, pasi sistemi “Hibrid Mail” pothuajse nuk ka funksionuar. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit vlera prej 12,580,000 lekë .
Kriteri:	Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “ <i>Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin</i> ”.
Ndikimi:	Përdorimi pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet i fondeve të prokuruar.
Shkaku:	Mos zhvillimi i një analizë kosto-përfitim.
Rëndësia:	E lartë.
18.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese të shoqërisë, gjatë menaxhimit të burimeve të shoqërisë si dhe zhvillimit të sistemeve të reja të kryejë një analizë kosto përfitim të detajuar duke shmangur përdorimin e fondeve pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet.

Zhvillimi i procedurës me objekt “Blerje kancelari dhe zarfa”

1.Urdhri i Prokurimit Nr. 21 prot., datë 30.11.2022	3.Hartuesit e DST U.P. Nr. 21 prot., datë 30.11.2022	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave
---	--	--

2.Lloji i Procedurës Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar	1. L. M. 2. E. A. 3. A. D.	Urdhër nr. 21/1 prot., datë 30.11.2022 1. B. A. (Kryetar) 2. R. G. 3. E. Q.
5.Fondi Limit 40,577,848.16 lekë pa TVSH	6.Oferta fituese 39,187,981 lekë pa TVSH I....T O.....E	7.Diferenca me fondin limit 1,389,867.1 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 19.01.2023, ora 10:00	9.Burimi Financimit Posta Shqiptare SHA	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender. 1. I.....GJ.....K..... 2. L..... D..... 3. O..... C..... 4. I....T O.....E 5. I.....C. 6. D.... G..... b) S'kualifikuar 1. I.....GJ.....K..... 2. O..... C..... 3. L..... D..... 4. D.... G..... c) Kualifikuar 1. I....T O.....E 2. I.....C.
11.Ankimime për AK. OE I.....C shpk Nr. 2671/4 datë 12.12.2022	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr. 2671/5 prot., datë 15.12.2022	13.Përgjigje Ankesës nga KKP
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës nr. 2671/16 prot., datë 22.02.2023	15.Vlera e kontratës) 47,025,577 lekë me TVSH	

Planifikimi i materialeve kancelari dhe zarfa

Kërkesa për blerjen e materiale kancelari dhe zarfa për nevojat e filialeve të Postës Shqiptare, hartuar nga Drejtoria Program Zhvillimit dhe Infrastrukturës për fillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kancelari dhe zarfa” është miratuar nga Administratori i Shoqërisë Posta Shqiptare znj. A. K. me shkresën nr. 229/8 datë 12.10.2022.

Hartimi i specifikime teknike

Titullari i Autoritetit Kontraktor, nëpërmjet Urdhrit të Brendshëm nr. 132., datë 13.10.2022., ka ngritur grupin e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike për prokurimin me objekt të përbërë nga znj. E. S., znj. A. D. dhe znj. E. A..

Grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike dhe i ka përcjell tek Drejtoria Juridike e Postës Shqiptare me shkresën nr. 2320/2 prot., datë 21.10.2022.

Llogaritja e Fondit Limit

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit i ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 140 datë 24.10.2022 të Administratorit të Shoqërisë znj. A. K. përbëhej nga z. R. P., znj. E. S. dhe znj. B. M.. Në referim të relacionit të hartuar nga grupi i punës mbi përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kancelari dhe zarfa” nr. 2407/7 prot., datë 15.11.2022, ftesa për ofertë është dërguar OE I....T O.....E, I.....GJ.....K....., M..... B..... dhe A.... G....., të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike si më poshtë, vijon:

- OE I.....GJ.....K..... 41,224,050 lekë.
- OE I....T O.....E 38,228,651 lekë
- OE M..... B..... 42,280,843 lekë.

19. Titulli i gjetjes:	Mos respektim i kuadrit ligjor në përllogaritjen e fondit limit
Situata:	Mbi bazën e ofertave të paraqitura nga subjektet e sipërcituar, grupi i punës ka përllogaritur fondin limit në shumën 40,577,848 lekë, pa

	<p>TVSH. Përlllogaritja e FL nga grupi i punës është pasqyruar në relacionin nr. 2407/7 prot., datë 15.11.2022., miratuar nga Titullari i AK z. A. D. me Vendimin nr. 24, datë 16.11.2022. Në zbatim të LPP dhe akteve nënligjore të tij, grupi i auditimit të KLSH përlllogariti fondin limit të kësaj procedure duke përfshirë dhe çmimet për njësi të 29 artikujve korrespondentë të kontratës së mëparshme. Fondi Limit i përlllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH është në shumën 20,173,165 lekë pa TVSH.</p> <p><i>Përlllogaritja e Fondin Limit duke përfshirë edhe 29 artikujt e kontratës nr. 939/33 prot., datë 17.11.2021 me objekt “Blerje kancelari dhe zarfa” paraqitet në tabelën nr. 1., aneksi 2.3.1.</i></p> <p><u>Nga auditimi rezultoi se:</u></p> <p>a. Autoriteti Kontraktor Posta Shqiptare ka zhvilluar tender për blerjen kancelari dhe zarfa me objekt dhe specifikime teknike të njëjta në vitin 2021 me procedurën e vitit 2022.</p> <p>b. Në kontratën e vitit 2021 me nr. 939/33 pot. datë 17.11.2021 “Blerje kancelari dhe zarfa”, 29 artikuj të saj, kanë specifikime teknike të njëjta me artikujt e procedurës së prokurimit të zhvilluar në vitin 2022.</p> <p>c. Grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit, nuk ka përfshirë çmimet për njësi të këtyre 29 artikujve të kontratës së vitit 2021 në prokurimin e vitit 2022.</p> <p>c. Fondit limit i përlllogaritur nga AK është miratuar në shumën 40,577,848 lekë pa TVSH, kundrejt atij të përlllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH në shumën 20,173,165 lekë pa TVSH, pra AK Posta Shqiptare ka rritur artificialisht FL me 201 %, ose vlerën prej 20,404,683 lekë pa TVSH.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - LPP nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”,
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve në shumën prej 20,404,683 lekë pa TVSH.
Shkaku:	Rritje artificiale e fondit limit.
Rëndësia:	E lartë.
19.1 Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përlllogaritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit.

Për sa më lart, grupi i punës për llogaritjen e FL i përbërë nga z. R. P., znj. E. S. dhe znj. B. M. dhe Titullari i AK në cilësinë e miratuesit të Fondit Limit kanë vepruar në mospërputhje me LPP nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76 “Mënyra për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të prokurimit”.

Me veprimet apo mos veprimet anëtarët e grupit të përlllogaritjes së Fondit Limit z. R. P., znj. E. S. dhe znj. B. M. dhe Administratori i shoqërisë z. A. D. në cilësinë Titullarit të AK dhe

miratuesit të FL ngarkohen me përgjegjësi pasi kanë vepruar në mospërputhje me nenin 76 pika “c” të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, duke mos përfshirë në përlllogaritjen e FL çmimet për njësi të 29 artikujve të kontratës së mëparshme, me qëllim që vlera e FL të ishte një vlerë reale dhe jo e rritur artificialisht me 201 %, e cila ka ndikuar edhe në vlerësimet e KVO në rastin e OE të vlerësuar si oferta anomalisht të ulta.

Hartimi i dokumenteve të Tenderit

Në Proces Verbalin e datës 05.12.2022, njësia e prokurimit ka argumentuar vendosjen e specifikimeve dhe kriterëve të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt ” Blerje kancelari dhe zarfa”.

Në DST të hartuar nga njësia e prokurimit është përcaktuar afati i lëvrimit 90 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

AK për artikujt me numër rendor 6, 7, 10, 13, 17, 18, 28, 36, 37, 38, 42 ka kërkuar që ditën e hapjes së tenderit duhet të paraqesin fizikisht mostra për këta artikuj.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

OE I.....C SHPK nëpërmjet shkresës nr. 2671/4 prot., datë 12.12.2022 ka paraqitur pranë AK Posta Shqiptare kërkesën për sqarim në lidhje me kriterin e DST pika 2.3 dhe 2.3.4., si më poshtë:

OE duhet të ketë kapacitete të stafit të tij për të prodhuar gjithë sasinë e kërkuar në këtë prokurim si dhe listë pagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë më i vogël se 5(pesë) punonjës për muajin e fundit të maturuar, nisur nga data e hapjes së ofertave....

Në lidhje me këtë kriter OE I.....C ka kërkuar sqarim nëse ofertuesit e mundshëm duhet të jetë vetë prodhues apo tregtar për mallrat e prokuruar.

Gjithashtu OE I.....C shpk ka kërkuar sqarim nga AK edhe për kriterin 2.3.3., pasi ky i fundit ka përcaktuar që:

Për zarf kartoni për shërbimin EMS me përmasa 230x330 mm OE duhet të paraqes autorizim nga firma prodhuese ose akt marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhues për mallin objekt prokurimi ose nga distributori autorizuar nga prodhuesi.

Pas shqyrtimit të ankesës së OE I.....C shpk, AK Posta Shqiptare nëpërmjet shkresës nr. 2671/6 prot., datë 15.12.2022 ka vlerësuar të drejtë kërkesën për sqarim nga ky OE., dhe ka bërë modifikimin e DST tek kriteret e veçanta, shtojca 7 dhe me shkresën 2671/9 prot., datë 23.12.2022 tek specifikimet teknike, shtojca 5.

Dorëzimi i mostrave

Referuar Proces verbalit të mbajtur nga anëtarët e KVO, më datë 19.01.2023 ora 10:00., mbi dorëzimin e mostrave nga OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “ Blerje kancelari dhe zarfa” sipas këtij proces verbalit, OE pjesëmarrës në këtë procedurë respektivisht I.....GJ.....K....., L..... D....., O..... C....., I....T O.....E, I.....C.dhe D.... G....., kanë dorëzuar mostrat sipas kërkesave të kriterit 2.3.5 të DST.

KVO sipas proces verbalit të datës 02.02.2023 ka vlerësuar se:

- a) *OE I....GJ.....K....., I....T O.....E dhe I.....C kanë dorëzuar mostrat për artikujt me numër rendor 6, 7, 10, 13, 17, 18, 28, 36, 37, 38, 42, dhe janë kualifikuar për plotësimin e këtij kriteri*
- b) *OE O..... C..... nuk është kualifikuar pasi artikulli me nr. rendor 28 nuk ishte sipas përcaktimeve të kërkuara të kriterit 2.3.5 në shtojcën 5.*

Vlerësimi i KVO

KVO në Proces verbalin e datës 02.02.2023., ka pasqyruar vlerësimin e ofertave të OE pjesëmarrës.

Sipas këtij proces verbalit në SPE, më datë 19.01.2023 kanë paraqitur ofertë OE të mposhtëm:

- 1.OE I.....GJ.....K..... me ofertë ekonomike 27,197,592.50 lekë
- 2.OE O..... C..... me ofertë ekonomike 33,590,250 lekë
- 3.OE L..... D..... me ofertë 35,555,000 lekë
4. OE I...T O.....E me ofertë 39,187,981 lekë
5. OE I.....T me ofertë 39,984,650 lekë
6. OE D.... G..... nuk kishte paraqitur oferte ekonomike

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në SPE, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, kanë konstatuar se:

OE I.....GJ.....K....., rezulton ofertë anomalisht e ulët.

KVO më datë 30.01.2023 nëpërmjet SPE., ka kërkuar nga OE I.....GJ.....K..... që brenda 3 (tre) ditëve pune duhej të paraqiste shpjegime të çmimit ose kostove të ofertës.

Nga auditimi konstatohet se:

1.OE I.....GJ.....K..... mbi bazën e kërkesës së KVO, ka kthyer përgjigje në lidhje me ofertën ekonomike cila ka rezultuar anomalisht e ulët.

OE I.....GJ.....K..... në përgjigjen e vet e ka mbështetur ofertën ekonomike pasi për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ka realizuar kontrata të suksesshme me objekt të njëjtë prokurimi.

Në tabelën e mëposhtme, paraqitet në mënyrë të përmbledhur realizimi me sukses i kontratave të OE I.....GJ.....K..... me AK të ndryshme:

Viti	Vlera e kontratave të realizuara nga OE I.....GJ.....K.....			F.L. (lekë)
	2020	2021	2022	
Shuma (lekë)	18,583,244	10,266,511	3,798,000	40,577,848

OE I.....GJ.....K..... në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Tatim Taksave ka realizuar një xhiro vjetore të paraqitur në Tabelën si më poshtë

Viti	Xhiro vjetore			F.L.
	2019	2020	2021	
Shuma	163,831,955	207,723,635	221,887,264	40,577,848
Të ardhura kundrejt F.L. (%)	404%	512%	547%	

Nga auditimi rezulton se:

OE I.....GJ.....K..... ka dhënë shpjegime për mundësinë e realizimit të kontratës nëpërmjet shkresës të datës 01.02.2023 në përgjigje të kërkesës së KVO të datës 30.01.2023.

20. Titulli i gjetjes:	S'kualifikim i padrejtë nga KVO i OE me ofertë anomalisht të ulët.
Situata:	<p>Në referim të shkresës së datës 01.02.2023 të paraqitur në <i>Faksimilen nr. 1, aneksi 2.3.1.</i>, OE I.....GJ.....K..... sqaron se oferta e paraqitur prej tij është e përballeshme pasi ka një xhiro të lartë vjetore dhe se për të artikuj të njëjtë me ato të AK Posta Shqiptare ka realizuar kontrata të suksesshme me subjektet publike si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Autoriteti Portual Durrës 2. Bashkia Kavaje 3. Dega e doganës Shkodër 4. Drejtoria e përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës 5. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 6. Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar 7. Ujësjetës Kanalizime Durrës 8. Universiteti i Korçës 9. Spitali rajonal memorial fier 10. Drejtoria Rajonale e shërbimit kombëtar të punës 11. Universiteti i Tiranës 12. Agjencia kombëtare e zonave të mbrojtura

	<p>13. Drejtoria e përgjithshme Detare 14. Instituti i sigurimeve shoqërore 15. Ujësjellës kanalizime Kamëz</p> <p>Bashkëlidhur, shkresës në lidhje me zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, OE I.....GJ.....K..... ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015, si dhe vërtetim nga AK të sipërcituar mbi realizimin me sukses të kontratave me objekt të njëjtë me prokurimin e zhvilluar nga AK Posta Shqiptare.</p> <p>Kontrata këto të ngarkuara në SPE.</p> <p>Për sa më lart, OE I.....GJ.....K..... plotëson kërkesat e e pikës 2 germa a, b, c, ç, d, të nenit 93 në të 5 komponentët e kërkuar.</p> <p><u>Nga auditimi i procedurave të mëparshme të Postës Shqiptare, rezulton se:</u></p> <p>Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera, bojëra printeri” të vitit 2022, KVO ka konstatuar se: OE M.....G & D.....N dhe I...T O.....E kanë rezultuar oferta anomalisht të ulta.</p> <p>Pas kërkesës së KVO të asaj procedure, drejtuar dy OE mbi dhënien e sqarimeve për mbështetjen e ofertës anomalisht të ulët, rezulton se këta OE kanë paraqitur pothuajse të njëjtat argumente me ato të paraqitura nga OE OE I.....GJ.....K..... duke i pranuar dhe kualifikuar dhe në përfundim është shpallur fitues OE M.....G & D.....N, pavarësisht se rezultonte Ofertë anomalisht e ulët.</p> <p>Ndërkohë për rastin e OE I.....GJ.....K....., Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i kane konsideruar jo bindëse argumentet e këtij OE duke e s’kualifikuar në kundërshtim me nenin 82 pika 4 e VKM 285 datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”</p> <p>KVO e ka s’kualifikuar OE OE I.....GJ.....K..... në mënyrë të pa drejtë, dhe pas shpjegimeve të dhëna nga OE I.....GJ.....K....., duke vërtetuar me dokumentacion që kishte kapacitete financiare për ta realizuar kontratën me një marzh të vogël fitimi, dhe për më tepër që nga auditimi i kësaj procedure rezultoi që vlera e FL e përllogaritur nga AK posta Shqiptare ishte jo reale dhe e rritur artificialisht me 201%</p> <p>Për sa më lart, shuma 11,990,389 lekë e cila përfaqëson diferencën midis ofertës së shpallur fituese padrejtësisht në vendin e parë në shumën 39,187,981 lekë të OE I...T O.....E dhe ofertës së paraqitur nga OE I.....GJ.....K..... në shumën 27,197,592.50 lekë e s’kualifikuar si ofertë anomalisht e ulët, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Postës Shqiptare.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi:	Rritje të shpenzimeve dhe keq përdorim të buxhetit të Postës Shqiptare.
Shkaku:	Mos respektim i parashikimeve të LPP dhe akteve nënligjore për Prokurimet Publike
Rëndësia:	E lartë
20.1 Rekomandimi:	Administratori i Shoqërisë Posta Shqiptare të përdorë procedurat

	administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës 11,990,389 lekë të ndarë në mënyrë propocionale për secilin anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit “ <i>Blerje kancelari dhe zarfa</i> ”.
--	--

Me veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi z. B. A. (Kryetar), z. R. G., znj. E. Q. në cilësinë e anëtarëve të KVO dhe z. A. D. në cilësinë e Titullarit të AK dhe miratuesit të procedurës.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me skualifikimin e padrejtë të OE I.....GJ.....K....., anëtarët e KVO kanë përcjell në mënyrë të përmbledhur kundëshittë, si më poshtë, e citoj:

“...Autoriteti ynë kontraktor ka vlerësuar informacionin e dhenë, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi I.....GJ.....K....., nuk ka krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, e për rrjedhojë bazuar në pikën 3, të nenit 93 “Oferta anomalisht e ulët”, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” dhe pikës 4, të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM 285 datë 19.05.2021” rregullat e Prokurimit Publik”, indryshuar, ka vendosur të refuzojë si ofertë të parregullt.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH^{-së}:

AK Posta Shqiptare ka paraqitur një analizë hipotetike të ofertës ekonomike të OE I.....GJ.....K....., e cila nuk është bërë dhe pasqyruar në dokumentacionin e audituar nga grupi i auditimit të KLSH dhe nuk është e pasqyruar në raportin përmbledhës të KVO të miratuar nga Titullari i AK, dhe për më shumë observacioni nuk është pasuruar me dokumentacion shtesë të pa audituar nga grupi i auditimit të KLSH, prandaj ky observacion për këtë pikë nuk do të merret në konsideratë dhe do të pasqyrohet në materialin e auditimit.

Vlerësimi i KVO (në vijim)

2. OE O..... C..... është s’kualifikuar nga KVO për mungesë të depozitimit në SPE të formularit të sigurimit të ofertës dhe mos plotësim të disa kërkesave të përcaktuar për mostrat e dorëzuara.

3. OE L..... D..... është s’kualifikuar për mungesë të paraqitjes së mostrave.

4. OE D.... G..... është s’kualifikuar nga KVO., pasi nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

5. OE I...T O.....E është kualifikuar, pasi sipas KVO ky OE i plotësonte të gjitha kërkesat dhe kriteret e kërkuara nga AK Posta Shqiptare.

6. OE I.....T është kualifikuar, pasi sipas KVO ky OE i plotësonte të gjitha kërkesat dhe kriteret e kërkuara nga AK Posta Shqiptare.

Referuar Raportit Përmbledhës nr. 2671/13 prot., datë 20.02.2023, KVO ka shpallur fitues OE I...T O.....E si ofertën e suksesshme dhe me çmimin më të ulët në shumën 39,187,981 lekë pa TVSH

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE pjesëmarrës, KVO ka bërë renditjen e ofertave të kualifikuara:

Vendi i parë: OE I.....T me ofertë 39,187,981 lekë pa TVSH

Vendi i dytë: OE I.....T me ofertë 39,984,650 lekë

Njoftimi i fituesit

AK nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit (paraparak) me nr. 2671/14 prot., datë 20.02.2023 ka njoftuar OE I...T O.....E se oferta e paraqitur në shumën 39,187,981 lekë pa TVSH është shpallur fitues.

Lidhja e kontratës

Kontrata me objekt “*Blerje kancelari dhe zarfa*” është lidhur më datë 22.02.2023 me nr. 2671/16 prot., midis AK posta shqiptare dhe OE I...T O.....E.

Në nenin 10 pika 10.2 Afati lëvrimit të mallit është përcaktuar afati 90 ditë kalendarike nga momenti i nënshkrimit të kontratës ose brenda datës 21.05.2023.

Zbatimi i kontratës

Titullari i institucionit ka ngritur komisionin për ndjekjen e kontratës me objekt “Blerje kancelari dhe zarfa” i përbërë nga z. T. H., z. S. T. dhe znj. E. A. me urdhrin e brendshëm nr. 21/19., datë 22.02.2023. Furnizimi nga OE I...T O.....E është bërë brenda periudhës së zbatimit të kontratës duke furnizuar në mënyrë pjesore. Sipas proces verbaleve të komisionit të marrjes në dorëzim artikujt janë dorëzuar nga kontraktuesi dhe janë marrë në dorëzim nga AK konform me kërkesat dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratën nr. 2671/16 prot., datë 22.02.2023

Zhvillimi i procedurës me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”

1.Urdhri i Prokurimit Nr. 5. prot., datë 07.07.2022	3.Hartuesit e DST U.P. Nr. 5. prot., datë 07.07.2022	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 5/1 prot., datë 07.07.2022
2.Lloji i Procedurës Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar	1. N. Ll. 2. E. T. 3. L. P.	1. D. G. (Kryetar) 2. R. G. 3. A. K.
5.Fondi Limit 62,891,062 lekë pa TVSH	6.Oferta fituese 53,159,738.75 lekë pa TVSH I...T O.....E	7.Diferenca me fondin limit 9,731,323 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 21.10.2022 ora 10:00 Loti I. 07/11/2022, ora 10.00. Loti II	9.Burimi Financimit Posta Shqiptare SHA,	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender. Loti I 1. L..... D..... 2. I...T O.....E 3. I.....C 4. M..... & D..... b) S’kualifikua 1. L..... D..... c) Kualifikuar 1. I...T O.....E 2. I.....C 3. M..... & D..... a) Pjesëmarrës në tender. Loti II 1.A.....O 2.D.... G..... 3.I...T O.....E 4.I.....S 5.M.....G & D....N 6.K.....H b) S’kualifikua 1.K.....H 2.D.... G..... 3.I...T O.....E c) Kualifikuar 1.I.....S 2.M.....G & D....N 3.A.....O d. S’kualifikuar pas rivlerësimit 1.I.....S 2.M.....G & D....N e.Kualifikuar A.....O
11.Ankimime për AK. Po	12. Përgjigje Ankesës nga AK Po	13.Përgjigje Ankesës nga KKP Vendimi 759/2022, nr. 761/2022 datë 08.08.2022, nr. 903/2022 datë 19.09.2022, nr. 874/2022 datë

		09.09.2022, nr. 85/2023 datë 07.02.2023, nr. 120/2023 datë 16.02.2023, nr. 88/2023 datë 07.02.2023, nr. 143/2023 datë 24.02.2023
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Loti I. nr. 1637/82 prot., datë 22.02.2023 Loti II. nr. 1637/92 prot., datë 23.03.2023	15.Vlera e kontratës) Loti I 23,892,886.5 lekë me TVSH Loti II 39,898,800 lekë me TVSH	

Kërkesa e Drejtorisë së Program Zhvillimit dhe Infrastrukturës për fillimin e procedurës së prokurimit për blerjen e letrës A4, A3 dhe letrës traktor A5, A4 për filialet e Postës Shqiptare është miratuar nga Administratori i Shoqërisë Posta Shqiptare znj. A. K. me shkresën nr. 94/13 datë 12.05.2022.

Hartimi i specifikime teknike

Titullari i Autoritetit Kontraktor nëpërmjet Urdhrit të Brendshëm nr. 68, datë 12.05.2022 ka ngritur grupin e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike për prokurimin me objekt me përbërje znj. E. T., znj. L. P. dhe znj. E. A.. Specifikimet teknike për të hartuara nga grupi i punës i janë përcjellë Drejtorisë Juridike pranë Postës Shqiptare me shkresën nr. 1149/1 prot., datë 17.05.2022.

Llogaritja e Fondit Limit

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit i ngritur është ngritur me urdhrin e brendshëm të Administratorit të shoqërisë znj. A. K. nr. 71 datë 18.05.2022 me përbërje z. D. M., znj. O. M. dhe znj. B. B..

21. Titulli i gjetjes:	Mos respektim i kuadrit ligjor në përllogaritjen e fondit limit.
Situata:	<p>Në referim të relacionit të hartuar nga grupi i punës mbi përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje letër fotokopje A4, letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër. A4 Traktor (3 kopje)” nr. 1209/8 prot., datë 07.06.2022, ftesa për ofertë i është dërguar OE M.....G & D.....N, I....T O.....E, I.....C dhe A.....O të cilët kanë paraqitur ofertat për çmim për njësi i më poshtë, të paraqitur në tabelën nr. 1., aneksi 2.3.2. Mbi bazën e ofertave të subjekteve të sipërcituar, grupi i punës ka përllogaritur fondin limit në shumën 62,891,062 lekë, pa TVSH. Përllogaritja e FL nga grupi i punës është pasqyruar në relacionin nr. 1209/8 prot., datë 07.06.2022, i cili është miratuar nga Titullari i AK znj. A. K. me Vendimin nr. 6, datë 07.06.2022.</p> <p><u>Nga auditimi rezulton se:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Autoriteti Kontraktor Posta Shqiptare ka zhvilluar tender me të njëjtin objekt prokurimi edhe në vitin 2021, duke lidhur kontratën nr. 2575/40 prot., datë 17.06.2021 me objekt “Blerje letër fotokopje A4”, dhe kontratën nr. 2575/41 prot., “Blerje letër traktor (3 kopje) A5, A4” datë 17.06.202. - Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit nuk ka përfshirë çmimet për njësi të artikujve letër fotokopje A4 dhe atyre të letrës traktor (3 kopje) A5, A4 të kontratës së lidhur në vitin 2021, të cilat kanë patur specifikime teknike të njëjta me specifikimet e kërkuara nga AK në procedurën e prokurimit të vitit 2022. - Në zbatim të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi, grupi i auditimit të

	<p>KLSH bëri përlllogaritjen e fondit limit duke përfshirë dhe çmimet për njësi të artikujve letër fotokopje A4 dhe letër traktor (3 kopje) A5 dhe A4.</p> <p>Si rezultat FL i përlllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH është në shumën 42,064,659 lekë pa TVSH. Ndërkohë që AK Posta Shqiptare Fondin limit e ka përlllogaritur dhe miratuar në shumën 62,891,062 lekë, pa TVSH pra me një diferencë prej 20,826,403 lekë pa TVSH.</p> <p>Për sa më lart, AK ka rritur artificialisht me 150 % Fondin Limit për procedurën me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”. Grupi i auditimit të KLSH, në përlllogaritja e Fondin Limit të kësaj procedure ka përfshirë përveç çmimeve të studimit të tregut edhe çmimet e artikujve të kontratës nr. 2575/40 prot., kontratës nr. 2575/41 prot., datë 17.06.2021 me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)” të paraqitur në tabelën nr. 2., aneksi 2.3.2.</p>
Kriteri:	LPP nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve në shumën prej 20,826,403 lekë pa TVSH .
Shkaku:	Rritje artificiale e Fondit limit.
Rëndësia:	E lartë.
21.1 Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përlllogaritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit.

Për sa më lart, me veprimet apo mos veprimet anëtarët e grupit të përlllogaritjes së fondit limit z. D. M., znj. O. M. dhe znj. B. B. dhe Administratori i shoqërisë znj. A. K. në cilësinë titullarit të AK dhe miratuesit të FL ngarkohen me përgjegjësi pasi kanë vepruar në mospërputhje me nenin 76 pika “c” të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”

Hartimi i dokumenteve të Tenderit

Njësia e prokurimit ka hartuar DST ku në Proces Verbalin e datës 08.7.2022 ka argumentuar vendosjen e specifikimeve dhe kriterëve të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)” te ndare ne dy lote:

Loti I: Blerje letër fotokopje A4, Letër A3 me vlere 28,918,530 lekë pa TVSH;

Loti II: Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), Letër A4 “Traktor” 93 kopje) me vlerë 33,972,532 lekë pa TVSH.

Paraqitja e mostrave:

AK Posta Shqiptare SHA, për Lotin I, u ka kërkuar që ditën e hapjes së ofertave OE ofertues paraqitjen e mostrave për letrën e fotokopjes A4 duke paraqitur një koli me 5 rizma letër A4 80 gr/m² dhe një rizëm për letrën A3 80gr/m²;

Për Lotin II, OE u është kërkuar paraqitja e një fije letër A5 “Traktor” (tre kopje) dhe një fije letër A4 “ Traktor” (3 kopje).

Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Pas publikimit të formularit të njoftimit të kontratës me nr. 1637/2 prot., datë 08.07.2022, nga ana e OE ka pasur ankesa dhe kërkesa për sqarim, konkretisht:

-OE A.....O me shkresën 1637/4 prot., datë 14.07.2022 ka kërkuar nga AK sqarime në lidhje me kriterin 2.3.4.

-OE I.....S me nr. 1637/5 prot., datë 19.07.2022 ka paraqitur ankesë për kriterin 2.3.2 “Kapacitete teknike”. , etj.

Për shqyrtimin e ankesave të OE të sipërpërmendur, Titullari i Autoritetit Kontraktor Posta Shqiptare znj. A. K. nëpërmjet Urdhrit të Brendshëm nr. 5/6 datë 20.07.2022, ka ngritur Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave për lotin II, të përbërë nga znj. K. C., znj. A. L. dhe Znj. M. Z..

-OE I....T O.....E me shkresën hyrëse të protokollit Posta Shqiptare nr. 1637/7 prot., datë 21.07.2022 ka paraqitur pranë AK posta shqiptare Ankesën në lidhje me piken 2.10 dhe specifikimet teknike të artikullit letër A5 “Traktor” A5 dhe A4 (3 kopje).

-Në lidhje me ankesën e paraqitur nga OE I....T O.....E, Titullari i AK me Urdhrin e Brendshëm nr. 5 /9 datë 27.07.2022 ka pezulluar procedurën e prokurimit “*Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)*” për të dyja lotet.

-Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesave pranë AK Posta Shqiptare në relacionin nr. 1637/10 prot., datë 27.07.2022 ka pranuar ankesat e OE I.....S për disa sqarime për lotin II, duke reflektuar ndryshimet në DST.

-Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës se OE I....T O.....E në relacionin nr. 1637 prot., datë 02.08.2022 ka pranuar pjesërisht ankesat e paraqitura nga OE I....T O.....E.

-Me shkresën nr. 1637/17 dhe shkresën 1637/18 prot., datë 04.08.2022 është bërë njoftimi i APP për ndryshimin e DST bazuar në kërkesat për sqarim dhe ankesave të OE ofertues. Gjithashtu me shkresën nr. 1637/21,22 prot., datë 08.08.2022 AK Posta Shqiptare ka informuar KPP për hapat e ndërmarra pas shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga OE ofertues.

Vendimet e KPP

KPP me vendimin nr. 759/2022 datë 08.08.2022 ka pranuar ankesën e OE I....T O.....E për procedurën e mësipërme të prokurimit duke kërkuar nga AK Posta Shqiptare modifikimin e DST në përputhje me konstatimet e KPP.

-Pas ankesës së OE I....T O.....E për mos reflektim të vendimit nr. 759/2022 datë 08.08.2022 të KPP, ky autoritet ka dal me vendimin nr. 903/2022 datë 19.09.2022 duke kërkuar pezullimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe modifikimin e DST sipas pikës III.2.10 të vendimit nr. 759/2022 datë 08.08.2022 të KPP.

Dorëzimi i mostrave

Referuar Proces verbalit të mbajtur nga anëtarët e KVO më datë 21.10.2022, ora 10:00 është bërë mbyllja e dorëzimit të ofertave në SPE. Sipas kërkesave të DST kanë paraqitur mostra OE:

-I....T O.....E

-I.....T

-M.....G & D.....N

-L..... D.....

Vlerësimi i KVO Loti I

KVO në Proces Verbalin e datës 21.10.2022 ka pasqyruar vlerësimin e ofertave të OE pjesëmarrës për Lotin I “*Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3*”

Sipas këtij Proces Verbalit rezulton se në SPE më datë 21.10.2022, kanë paraqitur ofertë OE të mëposhtëm:

1.OE I....T O.....E me ofertë ekonomike 19,910,738 lekë

2.OE I.....T me ofertë 20,503,000 lekë

3.OE L..... D..... me ofertë 23,422,500 lekë

4. OE M.....G & D.....N me ofertë 28,627,500 lekë

Referuar Proces Verbalit të vlerësimit të KVO të datës 02.11.2022 për Lotin I “Blerje letër fotokopje A4, A3”, renditja përfundimtar e OE për Lotin I është:

1.OE I...T O.....E me ofertë ekonomike 19,910,738 lekë

2. OE I.....T me ofertë 20,503,000 lekë

3. OE M.....G & D.....N me ofertë 28,627,500 lekë

4.OE L..... D..... me ofertë 23,422,500 lekë

OE L..... D..... nuk plotësonte kriteret për kapacitetin teknik për kualifikim dhe është s’kualifikuar nga KVO.

Njoftimi i fituesit Loti I

AK nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit (paraprak) me nr. 1637/54 prot., datë 14.11.2022 ka njoftuar OE I...T O.....E se oferta e paraqitur në shumën 19,910,738.75 lekë pa TVSH është shpallur fitues për Lotin I. AK Posta Shqiptare ka njoftuar OE I...T O.....E se oferta e paraqitur në shumën 19,910,738.75 lekë është shpallur fituese në bazë të çmimit më të ulët nëpërmjet Formularit të njoftimit të fituesit (pas procesit të ankimimit) nr. 1637/80 prot., datë 20.02.2023.

Lidhja e kontratës për lotin e I

Kontrata me objekt “Blerje letër fotokopje A4, A3” është lidhur më datë 22.02.2023 me nr. 1637/82 prot., midis AK posta shqiptare dhe OE I...T O.....E. ... Në nenin 10 të kontratës është përcaktuar afati i lëvrimit të mallrave objekt të kontratës pra të letrës fotokopje A4 dhe A3, si më poshtë:

Neni 10. Dorëzimi

10.1. Dorëzimi i Mallrave dhe përfitimi i shërbimeve të lidhura me to do të jetë në përputhje me kërkesat specifikuar në Dokumentet e Tenderit.

10.2. Afati i lëvrimit të mallrave do të jetë:

Malli objekt kontrate do të lëvrohet me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, për gjatë periudhës 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Sasia prej 25% e mallit objekt kontrate, duhet të lëvrohet jo më vonë se 2 (dy) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës...

10.4.Me dorëzim të mallit objekt kontrate kuptohet dorëzimi i letrës fotokopje A4, letër fotokopje A3, në përputhje me ofertën tekniko – ekonomike të paparaqitur në tender, sipas afateve dhe përcaktimeve të DST-së....

Zbatimi i kontratës

Titullari i institucionit ka ngritur komisionin për ndjekjen e kontratës me objekt “Blerje letër fotokopje A4, A3” i përbërë nga z. T. H., znj. O. M. dhe znj. E. A. me urdhrin e brendshëm nr. 5/83., datë 22.02.2023.

Dorëzimi i mallit nga Kontraktuesi

1.Komisioni i Marrjes në Dorëzim sipas Proces Verbalit të mbajtur më datë 06.03.2023 ka marrë në dorëzim letrën për fotokopje A4 në sasinë prej 39,725 kg (ose 14,690 rizma/2938 koli);

2.Komisioni i Marrjes në Dorëzim sipas Proces Verbalit të mbajtur më datë 06.06.2023 ka marrë në dorëzim letrën për fotokopje A4 nga Kontraktuesi OE I...T O.....E sasinë prej 10075 kg (ose 4,030 rizma/806 koli);

3.Komisioni i Marrjes në Dorëzim sipas Proces Verbalit të mbajtur më datë 05.07.2023 ka marrë në dorëzim letrën për fotokopje A4 nga Kontraktuesi OE I...T O.....E sasinë prej 12,500 kg (ose 5000 rizma/1000 koli);

4. Komisioni i Marrjes në Dorëzim sipas Proces Verbalit të mbajtur më datë 01.08.2023 ka marrë në dorëzim letrën për fotokopje A4 nga Kontraktuesi OE I...T O.....E sasinë prej 20,000 kg (ose 8000 rizma/1600 koli);

5. Komisioni i Marrjes në Dorëzim sipas Proces Verbalit të mbajtur më datë 18.08.2023 ka marrë në dorëzim letrën për fotokopje A4 në sasinë prej 47,700 kg (ose 19080 rizma/3816 koli) dhe Letrën për fotokopje A3 80 gr/m² në sasinë 125 kg (ose 25 rizma/5 koli).

Dorëzimi i mallit sipas fletë hyrjeve në magazinë paraqitet në tabelën nr. 3., aneksi 2.3.2.

22. Titulli i gjetjes:	Mos respektim të afateve kohore nga kontraktuesi gjatë dorëzimit të letrës A3 80gr/m ² .
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kontraktuesi ka dorëzuar pranë magazinës së AK Posta Shqiptare mallin pjesë të Kontratës nr. 1637/82 datë 22.02.2023, letër Fotokopje A3 80 gr/m ² më datë 18.08.2023, pra me 118 ditë me vonesë të këtij artikulli duke mos respektuar nenin 10 pika 10.2 të Kontratës Loti I <i>“Blerje letrë fotokopje A4, letrë fotokopje A3”</i> . Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka mbajtur proces verbal në lidhje me dorëzimin me vonesë të këtij artikulli, duke mos informuar AK për mos përmbushjen e afateve nga kontraktuesi siç janë të përcaktuara në kontratën e sipërcituar për mallin <i>“Leter A3 80 gr/m²”</i> ku është përcaktuar se: <i>“Malli objekt kontrate do të lëvrohet me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, për gjatë periudhës 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Sasia prej 25 % e mallit objekt kontrate, duhet të lëvrohet jo më vonë se 2 (dy) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës...”</i> . Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se OE I...T O.....E nuk e ka respektuar këtë detyrim për mallin letrë A3 pjesë e objektit të kontratës nr. 1637/82 datë 22.02.2023. Vlera e penaltetit sipas nenit 21 duhet të llogaritej mbi 25 % të vlerës totale të këtij artikulli duke e penalizuar me 4/1000 për ditë.
Kriteri:	Flete hyrje nr. 32 datë 18.08.2023. Fatura tatimore nr. 11378/2023 datë 18.08.2023. Kontrata 1637/82 prot., datë 22.02.2023, pika 10.1, 10.2 dhe 10.4.
Ndikimi:	Ne aktivitetin e shoqërisë.
Shkaku:	Vonesë në furnizimin me mallin e kërkuar.
Rëndësia:	E lartë.
22.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

Me veprimet apo mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi z. T. H., znj. O. M. dhe znj. E. A. në cilësinë e anëtareve të marrjes në dorëzim.

Vlerësimi i KVO Loti II “blerje letrë A5, A4 “Traktor” (3 kopje)

Referuar Proces Verbalit të datës 07.11.2022 të KVO ne procedurën e prokurimit loti II kanë paraqitur interes OE e mëposhtëm:

- 1.OE A.....O me vlerë të ofertës 33,249,000 lekë pa TVSH
- 2.OE D.... G..... me vlerë të ofertës 31,589,400 lekë pa TVSH
- 3.I...T O.....E me vlerë të ofertës 31,765,257 lekë pa TVSH

- 4.OE I.....S me vlerë të ofertës 31,913,760 lekë pa TVSH
- 5.OE M.....G & D.....N me vlerë të ofertës 32,972,070 lekë pa TVSH
6. OE K.....H nuk kishte paraqitur oferte ekonomike

Referuar Proces Verbalit te KVO të datës 17.11.2022 për lotin II, pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO, OE D.... G..... është s’kualifikuar për mos plotësim të kriterit teknik, si dhe OE I....T O.....E.

Ne vijim te Proces verbalit KVO ka kualifikua si oferta të suksesshme dhe ka kualifikuar OE sipas renditjes se mëposhtme

- 1.OE I.....S me vlerë të ofertës 31,913,760 lekë pa TVSH
2. OE M.....G & D.....N me vlerë të ofertës 32,972,070 lekë pa TVSH
3. OE A.....O me vlerë të ofertës 33,294,000 lekë pa TVSH

OE A.....O ka paraqitur anekese pranë AK Posta Shqiptare me nr. 1637/58 prot., datë 02.12.2022 mbi kualifikimin e OE I.....S dhe OE M.....G & D.....N. Titullari i institucionit z. A. D. ka pezulluar vazhdimin e procedurës dhe shqyrtimin e ankesës se OE A.....O dhe OE I....T O.....E me urdhrin nr. 5/62 datë 09.12.2022. Grupi i ngritur për shqyrtimin e ankesave me relacionin nr. 1637/63 prot., datë 16.12.2022 nuk ka pranuar ankesën e OE A.....O.

Pas ankesës se OE A.....O pranë KPP, ky i fundit ka kërkuar nga AK Posta Shqiptare që krahas përcjelljes së informacionit të dorëzoj pranë KPP mostrat e paraqitura nga OE pjesëmarrës për lotin e II për ti testuar në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “E...-S.... P....”.

Vendimi nr. 143/2023 datë 24.02.2023 i KPP

Pas ankesave të OE A.....O dhe OE I....T O.....E, KPP ka dal me vendimin nr. 143/2023 datë 24.02.2023 duke pranuar pjesërisht ankesën e OE I....T O.....E dhe pranimin e ankesës se OE A.....O, duke i kërkuar AK Posta Shqiptare anulimin e vendimit të KVO për kualifikimin e OE M.....G & D.....N dhe I.....S duke i s’kualifikuar këta operator ekonomik. KPP a vendosur rishikimin e arsyeve të s’kualifikimit te OE I....T O.....E dhe korrigjimin e shkeljeve të konstatuara në vendimin e KPP.

Rivlerësimi i procedurës

Referuar Proces Verbalit te datës 01.03.2023 nga anëtarët e KVO për lotin II “ Blerje letër traktor me 3 (tre) kopje A5 dhe A4” pas renditjes së ofertave të paraqitura ne SPE si me poshtë:

1. OE D.... G..... me vlerë të ofertës 31,589,400 lekë pa TVSH
2. I....T O.....E me vlerë të ofertës 31,765,257 lekë pa TVSH
3. OE I.....S me vlerë të ofertës 31,913,760 lekë pa TVSH
4. OE M.....G & D.....N me vlerë të ofertës 32,972,070 lekë pa TVSH
- 5.OE A.....O me vlerë të ofertës 33,249,000 lekë pa TVSH
6. OE K.....H nuk kishte paraqitur oferte ekonomike

Në zbatim të vendimit të fundit të KPP, nga rivlerësimi i KVO OE D.... G....., I....T O.....E, I.....S, M.....G & D.....N dhe OE K.....H u s’kualifikua për mos plotësim të kriterëve të vendosura në DST.

Pas rivlerësimit nga KVO u vlerësuar ofertë e suksesshme vetëm OE A.....O me vlerë të ofertës 33,249,000 lekë pa TVSH, ofertë kjo e renditur në vlerën më të lartë midis këtyre OE pjesëmarrës në këtë procedure.

Njoftimi i fituesit Loti II

AK nëpërmjet formularit te njoftimit te fituesit nr. 1637/89 prot., datë 07.03.2023, njoftuar OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit loti i II “ Blerje letër traktor me 3 kopje, A5 dhe A4” duke njoftuar OE A.....O për dorëzimin e dokumentacionin fizik dhe vazhdimin e lidhjes se kontratës me vlerën e ofertuar 33,249,000 lekë pa TVSH.

KVO ka pasqyruar gjithë veprimtarinë e rivlerësimit të ofertave të OE pjesëmarrës në Raportin Përmbledhës të miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. A. D. nr. 1637/90 prot., datë 13.03.2023.

Lidhja e kontratës II

Kontrata me objekt “Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)” është lidhur më datë 23.03.2023 me nr. 1637/92 prot., midis AK posta shqiptare dhe OE A.....O.

Afatet për lëvrim

Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare”, në zbatim të pikës II.2., të vendimit nr. 943/2022 datë 28.09.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik, referuar shkresës nr. 1637/47 prot., datë 11.10.2022 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Posta Shqiptare znj. A. K., afati i lëvrimin është rishikuar në shtojcën 6, Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimin, të Dokumenteve Standarde të Tenderit, “Afatet e Lëvrimin”, si më poshtë:

“Malli objekt kontrate do të lëvrohet me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, përgjatë periudhës 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Sasia prej 25 % e secilit artikull të mallit objekt kontrate, duhet të lëvrohet jo më vonë se 2 (dy) muaj kalendarik nga data e nënshkrimit të kontratës.

Çdo Sasi tjetër e cila do të jetë në përpjesëtim me sasinë totale të kontratës (kërkesa e tjera në vazhdimësi), do të lëvrohen me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor (Blerësit) brenda 20 (njëzet) dite kalendarik nga kërkesa me shkrim drejtuar Furnizuesit”

Zbatimi i kontratës

Titullari i institucionit ka ngritur komisionin për ndjekjen e kontratës me objekt “Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)” me përbërje z. I. K., znj. E. A. dhe znj. G. K. me urdhrin e brendshëm nr. 5/93., datë 23.03.2023. Dorëzimi i mallit nga kontraktuesi paraqiten në tabelën nr. 4 aneksi 2.3.2.

Marrja në dorëzim e mallit

Marrja në dorëzim e letrës traktor A4 (3 kopje)

Komisioni i marrjes në dorëzim më datë 20.06.2023 ka mbajtur Akt Dorëzimin për sasinë 1,935,500 fije letër traktor A4 (3 kopje) të dorëzuar nga kontraktues A.....O, i cili ka paraqitur faturën tatimore nr. 119/2023 në shumën totale 7,664,580 lekë me TVSH. Nga auditimi konstatohet se kontraktuesi ka dorëzuar me 28 ditë vonesë mallin dhe nga ana e Drejtorisë Ekonomike është përlllogaritur vlera 853,433 lekë e cila është zbritur nga pagesa e faturës nr. 119/2023 datë 20.06.2023 të kontraktuesit.

Marrja në dorëzim e letrës traktor A5 (3 kopje)

Komisioni i marrjes në dorëzim më datë 15.08.2023 ka mbajtur Akt Dorëzim për sasinë 2,841,000 fije letër traktor A5 (3 kopje) të dorëzuar nga kontraktuesi. Sipas proces verbalit të mbajtur nga komisioni i marrjes në dorëzim, malli i dorëzuar është në përputhje me parashikimet dhe kërkesat e kontratës.

23. Titulli i gjetjes:	Mos respektim i afateve kohore nga kontraktuesi gjatë dorëzimit të letrës traktor A5 me 3 kopje.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kontraktuesi nuk ka zbatuar kushtet e kontratës për afatin e dorëzimit të letrës traktor A5 me 3 kopje në masën 25 % të sasisë, të cilën duhej ta dorëzonte pranë AK Posta Shqiptare brenda datës 23.05.2023, kjo pasi është dorëzuar gjithë sasia e mallit letër A5 traktor me 3 kopje më datë 15.08.2023, pra 84 ditë me vonesë nga afati i përcaktuar në kontratën nr. 1637/92 prot., datë 23.03.2023. Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka mbajtur proces verbal për dorëzimin me vonesë të letrës traktor A5 si pjesë e mallit të kontratës dhe nga ana e Drejtorisë

	<p>Ekonomike të Postës Shqiptare nuk është llogaritur penalitetet për këtë mall, duke e paguar tërësisht faturën tatimore nr. 156/2023 datë 15.08.2023 të kontraktuesit A.....O. Bazuar në kushtet e kontratës, Letra A5 “Traktor” (3 kopje) si pjesë e mallit objekt kontrate duhet që sasia prej 25 % të dorëzohet brenda datës 23.05.2023. Në referim të nenit 21 të kontratës “Penalitet”, parashikohet se: <i>“Penalitetet për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarife ditore 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i kontratës, por jo me pak se 25 % e vlerës së kontratës.</i></p> <p>Për sa më lart, Kontraktuesi A.....O ka dorëzuar mallin letër A5 traktor (3 kopje) me 84 dite vonesë nga përcaktimi në DTS dhe kontratën e lidhur midis palëve.</p> <p>Meqenëse ky zë i Kontratës për artikullin me emërtimin letër A5 traktor (3 kopje) është lëvruar në sasinë totale më datë 15.08.2023, për të llogaritur penalitetin është marrë vlera minimale e këtij zëri në shumën 25% të saj. Vlera e letrës A5 Traktor (3 kopje) është në shumën 7,841,160 lekë. Vlera e përlllogaritur e penalitetit është në shumën $(1,960,290 * 0.004) * 84 = 658,657$ lekë, vlerë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.</p>
Kriteri:	Fletë hyrje nr. 31 datë 15.08.2023, Fatura tatimore nr. 156/2023 datë 15.08.2023, Kontrata nr. 1637/92 prot., datë 23.03.2023.
Ndikimi:	Në aktivitetin e shoqërisë Posta Shqiptare.
Shkaku:	Vonesë në furnizimin me mallin e kërkuar.
Rëndësia:	E lartë.
23.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

Me veprimet apo mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi z. I. K., znj. E. A. dhe znj. G. K. në cilësinë e anëtarëve të marrjes në dorëzim.

Zhvillimi i procedurës me objekt “Blerje tonera, bojëra printer”

1.Urdhri i Prokurimit Nr. 17. Port. datë 26.10.2022	3.Hartuesit e DST U. Nr. 17. Port. datë 26.10.2022 1. Z. M. 2. O. D. 3. M. P.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 17/1 Port. datë 26.10.2022 4. A. B. (Kryetar) 5. A. K. 6. K. M.
2.Lloji i Procedurës Procedure e Hapur		
5.Fondi Limit 14,717,900 lekë pa TVSH	6.Oferta fituese 5,212,900 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 9,505,000 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 27.12.2022 ora 10:00 Modifikuar: 04.01.2023 ora 10:00	9.Burimi Financimit Posta Shqiptare Sha	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender. 1. I....T O.....E 2. E.....I 3. M.....G & D.....N 4. A.....T 5. I.....GJ.....K..... 6. E.....N L.....I b) S’kualifikuar 1. I.....T 2. E.....I c) Kualifikuar 1. M..... & D.....

		2. A.....T 3. I.....GJ.....K..... 4. E.....N L.....I
11.Ankimime për AK. OE E.....I C.....Y Nr. 2415/3 datë 03.11.2022 OE E.....N Nr. 2415/19 datë 14.02.2022	12. Përgjigje Ankesës nga AK -Shkresa nr. 2415/22 prot., datë 23.02.2023 -Shkresa nr. 2415/23 prot., datë 23.02.2023	13.Përgjigje Ankesës nga KKP Vendimi nr. 183/2023
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 2415/33 prot., datë 18.04.2023	15.Vlera e kontratës) 6,255,480 lekë me TVSH	

Kërkesa e Drejtorisë së Program Zhvillimit dhe Infrastrukturës për fillimin e procedurës së prokurimit për blerjen e bojërave dhe tonerave për filialet dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shoqërisë Posta Shqiptare është miratuar nga Administratori i Shoqërisë nëpërmjet shkresës nr. 195/8 datë 08.09.2022.

Hartimi i specifikime teknike

Titullari i Autoritetit Kontraktor nëpërmjet Urdhrit të Brendshëm nr. 118., datë 16.09.2022 ka ngritur grupin e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike për prokurimin me objekt “Blerje tonera, bojëra Printeri” i përbërë nga z. O. Dh., z. M. P. dhe z. T. H.. Grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike për tonerat duke kërkuar që tonerat të jenë origjinale (jo të rimbushura), të jenë të shoqëruar me pullën e sigurisë së prodhuesit dhe të identifikohen nga numri “Part Number”. Tonerat gjithashtu është kërkuar se duhet të plotësojnë specifikimet mbi numrin e kopjeve në bazë të preventivit, si dhe të kenë garanci jo më pak se 2 vjet, si dhe furnizimi nga kontraktuesi të bëhet me njëjta tipe dhe lloje të tonera dhe bojëra që OE ka paraqitur gjatë dorëzimit të mostrave.

Llogaritja e Fondit Limit

Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit është ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 126 datë 29.09.2022 me përbërje të grupit znj. E. A., z. A. K. dhe z. A. S.. Referuar relacionit të grupit të punës mbi përllogaritjen e fondit limit nr. 2183/7 prot., datë 14.10.2022, ftesa për ofertë është dërguar OE E.... D...., OE I...T O.....E, OE I.....GJ.....K..... dhe OE O..... S....., të cilët kanë paraqitur ofertat sa më poshtë:

- OE E.... D....	17,212,000 lekë
- I...T O.....E	14,524,750 lekë
- I.....GJ.....K.....	14,946,750 lekë
- O..... S.....	15,528,500 lekë

Grupi i punës ka përllogaritur Fondin Limit në shumën 14,717,900 lekë mbi bazën e mesatarizimit të çmimeve të ofertave të marra nga subjektet e sipërcituar. Përllogaritjen e Fondit limit, grupi i punës e ka pasqyruar në relacionin nr. 2183/7 prot., datë 14.10.2022., i cili është miratuar nga Titullari i AK znj. A. K. me vendimin nr. 18, datë 14.10.2022. Në tabelën nr. 1 aneksi 2.3.3 paraqitet përllogaritja e FL nga grupi i KLSH mbi bazën e ofertave të paraqitura nga subjektet e sipërcituar dhe vlerës së kontratës së mëparshme për artikujt me nr. 1,3,4,7,8,10,11,12,13,14.

24. Titulli i gjetjes:	Mos respektim i kuadrit ligjor në përllogaritjen e fondit limit.
Situata:	Nga auditimi rezulton se: AK ka lidhur kontratën nr. 635/46 prot., datë 15.02.2021 me objekt “Blerje tonera dhe bojëra printeri”, nga ku 10 artikuj nga 14 artikuj të kërkuar në procedurën e prokurimit mbi bazën e Urdhri i Prokurimit nr. 17. prot., datë 26.10.2022 kanë specifikime teknike dhe Part/Number të njëjtë. Grupi i KLSH mbi bazën e çmimeve të ofertave të OE dhe çmimeve koresponduese të artikujve të kontratës së

	mëparshme bëri përllogaritjen e fondit limit, shuma kjo e cila rezultoi 11,376,988 lekë. Për sa më lart, AK ka përllogaritur fondin limit në shumën 14,717,900 lekë duke e rritur artificialisht me 29 % më shumë se vlera e fondit limit, e përllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH. Pra 3,340,912 lekë pa TVSH më tepër.
Kriteri:	LPP nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi:	Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve në shumën prej 3,340,912 lekë pa TVSH .
Shkaku:	Rritje artificiale e Fondit limit.
Rëndësia:	E lartë.
24.1 Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përllogaritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit.

Për sa më lart, me veprimet apo mos veprimet anëtarët e grupit të përllogaritjes së Fondit limit E. A., A. K. dhe A. S. dhe Administratori i shoqërisë Znj. A. K. në cilësinë Titullarit të AK dhe miratuesit të FL, ngarkohen me përgjegjësi pasi kanë vepruar në mospërputhje me nenin 76 pika “c” të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Hartimi i dokumenteve të Tenderit

Njësia e prokurimit në Proces Verbalin e datës 28.10.2022 ka argumentuar vendosjen e specifikimeve dhe kriterëve të kualifikimit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje bojëra dhe tonera”. Në DST periudha e shërbimit është përcaktuar 6 (gjashtë) muaj. AK për disa tonera ka kërkuar që ditën e hapjes së tenderit duhet të paraqesin fizikisht mostra të mallrave.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

OE E.....I C.....Y nëpërmjet shkresës nr. 2415/3 prot., datë 03.11.2022 ka paraqitur pranë AK Posta Shqiptare ankesë në lidhje me kriterin 2.3 pika 2.3.2. Në Dokumentet Standard të Tenderit njësia e prokurimit ka kërkuar që: “OE ofertues duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001-2015, ISO 22301 ose ekuivalente me to.” OE E.....I C.....Y në lidhje me kërkesën për paraqitjen e certifikatës ISO 22301 është konsideruar i panevojshëm dhe që nuk është në përpjesëtim të drejtë me objektin e kontratës që do prokurohet. Gjithashtu ky OE ka patur ankesë dhe në lidhje me kriterin 2.3.4 për pikat b dhe c, pikën 2.3.5, pikën 2.3.6. pikën 2.3.7, pikën 2.3.8 dhe pikën 2.3.9. të cilën e ka paraqitur pranë AK dhe tek KPP.

Shqyrtimi i Ankesave nga AK Posta Shqiptare

Për shqyrtimin e ankesës së OE E.....N C.....Y Titullari i AK Posta Shqiptare ka nxjerrë urdhrin nr. 17/4 datë 04.11.2022 nga ku ka ngritur grupin e punës të përbërë nga znj. K. C., z. E. S. dhe z. E. A.. Grupi i punës pas shqyrtimit të ankesës së OE E.....I C.....Y ka përgatitur relacionin nr. 2418/5 prot., datë 08.11.2022 të miratuar nga Titullari i Institucionit duke mos e pranuar ankesën dhe duke i kthyer përgjigje OE E.....I C.....Y me shkresën nr. 2415/6 datë 08.11.2022, duke argumentuar arsyet e mos pranimit të ankesës në lidhje me kriteret sipas pikave respektive, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.8 dhe 2.3.9 të DST.

Shqyrtimi nga KPP

KPP me vendimin nr. 1170/2022 datë 24.11.2022 ka pranuar pjesërisht ankesën e OE E.....I C.....Y, duke pranuar ankesën për kriterin 2.3.2 në lidhje me certifikatën ISO 22301 si një kriter i panevojshëm për këtë procedurë. Për kriterin 2.3.4 KPP ka kërkuar që pika c të modifikohet si me poshtë: *“Tonerat do të jenë bojëra origjinale, me vulë origjinaliteti, të pahapur dhe jo të rimbushura ose ekuivalente të shoqëruara me pullë sigurie në rastet kur aplikohet nga prodhuesi.*

Në pikën 2.3.5 KPP ka kërkuar që në kriterin e vendosur nga AK të shtohet “në rast kur aplikohet nga prodhuesi”, etj.”

Në zbatim të vendimit të KPP nr. 1170/2022 datë 24.11.2022, AK Posta Shqiptare nëpërmjet shtojcës 7 ka bërë ndryshimet në DST., për pikën 2.3.2; 2.3.4; 2.3.5, 2.3.7; 2.3.8. AK me shkresën nr. 2415/10 prot., datë 05.12.2022 ka njoftuar APP për ndryshimet e bëra në DST dhe me shkresën 2415/11 prot., datë 05.12.2022 ka informuar KPP për zbatimin e vendimit nr. 1170/2022 datë 24.11.2022.

Dorëzimi i mostrave

Më datë 04.01.2023 KVO ka mbajtur Proces Verbalin mbi dorëzimin e mostrave nga OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera, boja printimi”. OE M.....G & D.....N, OE I....T O.....E, OE I....GJ.....K....., OE E.....I C.....Y, OE E.....N L.....I dhe OE A.....T kanë dorëzuar mostrat sipas kriterit 2.3.9 të DST. Sipas proces verbalit të datës 04.01.2023 KVO nga evidentimi fizik i mostrave të dorëzuara për artikujt me numër rendor 3, 4, 5, 7 dhe 13 ka kualifikuar të gjithë OE pjesëmarrës pasi sipas tyre mostrat e kërkuara dhe të dorëzuara përputheshin me specififikimet teknike të kërkuara nga AK Posta Shqiptare.

Vlerësimi i KVO

KVO me Proces verbalin e datës 01.02.2023 ka pasqyruar vlerësimin e ofertave të OE pjesëmarrës. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SEP, KVO ka bërë vlerësim si më poshtë:

- 1.OE I....T O.....E me ofertë ekonomike 3,711,960 lekë
- 2.OE E.....I C.....Y me ofertë ekonomike 3,755,000 lekë
- 3.OE M.....G & D.....N me ofertë 5,212,900 lekë
4. OE A.....T me ofertë 5,448,900 lekë
4. I....GJ.....K..... me ofertë 7,667,150 lekë
5. OE E.....N L.....I me ofertë 8,780,000 lekë

KVO pas shqyrtimit të ofertës ekonomik për OE I....T O.....E dhe E.....I C.....Y, të cilat kanë rezultuar anomalisht të ulëta, ka kërkuar nga këta OE argumentimin e ofertës anomalisht të ulët dhe shpjegimeve të tyre për mbështetjen e ofertave. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të ngarkuar në SPE, KVO pas marrjes së përgjigjeve dhe argumentimit nga OE I....T O.....E dhe E.....I C.....Y nëpërmjet postës elektronike e-mail me datë 23.01.2023, ka pranuar argumentimin e tyre dhe i ka kualifikuar. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE pjesëmarrës, KVO ka bërë renditjen e ofertave të kualifikuara, si më poshtë:

Vendi i parë:	OE I.....T me ofertë 3,711,960 lekë
Vendi i dytë:	OE E.....I C.....Y me ofertë 3,755,000 lekë
Vendi i tretë:	OE M.....G & D.....N me ofertë 5,212,900 lekë
Vendi i katërt:	OE A.....T me ofertë 5,448,900 lekë
Vendi i pestë:	OE I....GJ.....K..... me ofertë 7,667,150 lekë
Vendi i gjashtë:	OE E.....N L.....I me ofertë 8,780,000 lekë

Njoftimi i fituesit

KVO me anë të Proces Verbalit të datës 06.02.2023 në zbatim të udhëzimit të APP “Për shqyrtimin e ofertave në prokurime me mjete elektronike” ka shqyrtuar dokumentacionin e shkruar të OE I...T O.....E, i cili përputhej dhe ishte i njëjtë me atë të ngarkuar në SEP. Mbi këtë bazë AK nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit (paraparak) me nr. 2415/18 prot., datë 07.02.2023 ka informuar OE I...T O.....E se oferta e paraqitur në shumën 3,711,960 lekë është shpallur fituese.

Paraqitja e ankesave të OE

OE E.....I ka përcjellë formularin e ankesës pranë AK Posta Shqiptare me shkresën nr. 2415/19 prot., datë 14.02.2022 me objekt kundërshtim të vendimit të KVO lidhur me kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE I...T O.....E. OE E.....I ka konstatuar se mostrat e dorëzuara nga OE I.....T nuk përputheshin me kërkesat dhe kriterin 2.3.5 dhe 2.3.9. të DST, si më poshtë: 1. Për artikullin me numër rendor 3, me emërtimin HP Laser Jet MFP M125a me p/n CF283A83A OE ka dorëzuar një toner kompatibël të prodhuar nga i-Aicon, pa emërtim, pa tregues të kapacitetit të numrit të fletëve dhe pa part number; 2. Për artikullin me nr. Rendor 4 me emërtimin Epson LX 350 me P/n S015637 nuk ka dorëzuar mostrën origjinale por ka dorëzuar një produkt kompatibël me emërtimin Epson LQ 350 pa tregues të kapacitetit të numrit të fletëve dhe pa P/N; 3. Për artikullin me emërtimin Brother HL-L6250DN me P/N TN-3430 nuk ka dorëzuar mostrën origjinale por ka dorëzuar kompatibël nga shoqëria Print-RITE, pa emërtim, pa tregues kapacitet të numrit të fletëve dhe P/N Pr-TN3430; 4. Për artikullin me nr. 7 me emërtimin Samsung ML 2022 me P/n MLT-D111L nuk ka dorëzuar mostrën origjinale të kompanisë Samsung por kompatibël të i-Aicon pa emërtim, pa tregues të kapacitetit të nr. të fletëve dhe me p/n D111L NC; 5. Për artikullin me nr. 13 me emërtimin Brother 2300 me p/n TN-3220 OE I...T O.....E ka dorëzuar toner kompatibel të prodhuar nga print Rite, pa emërtim, pa tregues të kapacitetit të nr. të fletëve.

Shqyrtimi i ankesave

Titullari i institucionit nëpërmjet Urdhrit të Brendshëm nr. 17/20 datë 16.02.2023 ka ngritur grupin për shqyrtimin e ankesës së OE E.....N dhe OE M.....G & D.....N me përbërje të grupit znj. K. C., z. E. S. dhe z. E. A. nga ana e të cilit me shkresën nr. 2415/21 prot., datë 23.02.2023 është përpiluar relacionin mbi shqyrtimin e ankesës së OE E.....I dhe M.....G & D.....N lidhur me dokumentet e tenderit. Në përfundim grupi i ngritur për shqyrtimin e ankesave i ka vlerësuar si jo të drejta ankesat e këtyre OE. Brenda afatit kohor OE E.....N dhe M.....G & D.....N me të njëjtin objekt ankimi kanë paraqitur pranë KPP, nga ku KPP ka dalë me Vendimin nr. 183/2023 duke pranuar ankesën e OE M.....G & D.....N dhe OE E.....N duke kërkuar nga AK rivlerësimin e procedurës brenda 5 ditëve duke e informuar KPP për zbatimin e këtij vendimi. AK nuk ka respektuar afatin kohor të zbatimit të vendimit 183/2023 të KPP, në këto kushte KPP me shkresën 300/7 datë 20.03.2023 i ka kërkuar AK posta Shqiptare që në zbatim të nenit 35, pika 2 të vendimit të KPP nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e KPP” AK brenda 5 ditëve nga marrja dijani duhet të zbatoj vendimin e komisionit.

Rivlerësimi i ofertave

AK Posta Shqiptare më datë 21.03.2023 nëpërmjet faqes së APP ka kërkuar argumentimin e ofertës ekonomike anomalisht të ulët të OE M.....G & D.....N, kjo në zbatim të nenit 93 të LPP 162/2020 “Për prokurimet Publike”. Me shkresën nr. 2415/27 prot., datë 23.03.2023 AK Posta shqiptare ka informuar KPP mbi zbatimin e vendimit nr. 183/2023 datë 09.03.2023 lidhur me rivlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Tонера, Bojra Printeri”. KVO në zbatim të vendimit të KPP KVO ka bërë rivlerësimin e ofertave për këtë

procedurë duke s'kualifikuar OE I....T O.....E dhe OE E.....I C.....Y. Pas rivlerësimit nga KVO, në vendin e parë është shpallur OE M.....G & D.....N me vlerë të ofertës 5,212,900 lekë pa TVSH. Rivlerësimi i ofertave në SPE është bërë në datë 23.03.2023.

Njoftimi i fituesit

AK Posta Shqiptare ka njoftuar nëpërmjet formularit të njoftimit të fituesit nr. 2415/30 prot., datë 31.03.2023 duke informuar OE M.....G & D.....N se oferta e paraqitur në shumën 5,212,900 lekeë pa TVSH është shpallur fituese në bazë të çmimit më të ulët. Raporti përmbledhës i KVO nr. 2415/31 prot., datë 04.04.2023 i KVO është miratuar nga Titullari i institucionit.

Lidhja e kontratës

Kontrata me objekt Blerje Tонера, bojëra printeri është lidhur më datë 18.04.2023 me nr. 2415/33 prot., është lidhur midis AK posta shqiptare dhe OE M.....G & D.....N. Në nenin 8 përgjegjësit e furnizuesit pika 8.2 furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e artikujve në sasinë e paraqitur në faksimilen nr. 2., aneksi 2.3.3.

Zbatimi i kontratës

Titullari i institucionit ka ngritur komisionin për ndjekjen e kontratës me përbërje të komisioni z. E. L., znj. B. H. dhe z. O. Dh. me urdhrin e brendshëm nr. 17/35., datë 20.04.2023. Tek shtojca 6 në DST është parashikuar se: *“Malli objekt kontrate do të lëvrohet me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, për gjatë periudhës 6 (gjashtë) muaj kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Sasia prej 25 % e secilit artikull, të mallit objekt kontrate, duhet të lëvrohet jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës. Çdo sasi tjetër e cila do të jetë në përpjesëtim me sasinë totale të kontratës (kërkesat e tjera në vazhdimësi), do të lëvrohet me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor (Blerësit) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga kërkesa me shkrim drejtuar Furnizuesit.*”

25. Titulli i gjetjes:	Mos respektim të afateve kohore nga kontraktuesi gjatë dorëzimit të bojërave dhe tonerave për printer.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në zbatim të kushteve të kontratës kontraktuesi duhej të dorëzonte pranë magazinës së Postës Shqiptare brenda datës 02.06.2023 të paktën 25 % të çdo artikuj sipas përcaktimeve të DST. Më datë 07.07.2023, nga ana e audituesve të KLSH u krye një verifikim fizik pranë magazinës së Postës Shqiptare dhe kanë mbajtur Akt verifikimi nr. 1 me punonjësen përgjegjëse të materialeve, nga ku u konstatua se nga ana e Kontraktuesit nuk ka filluar lëvrimiti i mallit për sasinë 25 % për çdo artikull brenda 45 ditëve. Akt verifikimi nr. 1 është protokolluar në Posta Shqiptare me nr. 909/2 prot., datë 12.07.2023. Nga Komisioni i marrjes në dorëzim nuk është mbajtur proces verbal në lidhje me mosrespektimin e kushteve të kontratës dhe nuk është informuar Administratori për mos respektimin e kushteve të kontratës nga ana e Kontraktuesit në lidhje me afatet e lëvrimit të mallit. Për mos zbatim të kushteve të kontratës deri në datën e mbajtjes së akt verifikimit, nga KLSH rezulton se kontraktuesi nuk e ka dorëzuar mallin për 36 ditë kalendarike. Penaliteti për vonesë të lëvrimit nga kontraktuesi është $(0.25 * 5,212,900) * 0.004 * 36 = 187,664$ lekë, vlerë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.
Kriteri:	Kontrata nr. 2415/33 prot., datë 18.04.2023.
Ndikimi:	Në aktivitetin e shoqërisë.
Shkaku:	Vonesë në furnizimin me mallin e kërkuar.

Rëndësia:	E lartë.
25.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

Për mos respektim të kushteve të kontratës ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim z. E. L., znj. B. H. dhe z. O. Dh..

Zhvillimi i procedurës me objekt “Blerje pjese këmbimi për automjetet e tipit Nissan NV300”

1.Urdhri i Prokurimit Nr. 14. prot., datë 30.09.2022	3.Hartuesit e DST U. Nr. 14. prot., datë 30.09.2022 1. E. P. 2. A. B. 3. H. M.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 14/1 prot., datë 30.09.2022 7. T. H. (Kryetar) 8. S. T. 9. P. K.
2.Lloji i Procedurës Procedurë e Hapur		
5.Fondi Limit 10,960,546 lekë pa TVSH	6.Oferta fituese 9,316,664 lekë pa TVSH	7.Diferenca me fondin limit 1,643,882 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit 19.10.2022 ora 10:00	9.Burimi Financimit Posta Shqiptare SHA	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender. 1. S.....2 2. P.....R I.....S b) S’kualifikua asnjë c) Kualifikuar 1.S.....2 2. P.....R I.....S
11.Ankimime për AK. Ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga KKP
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 2207/7 prot., datë 24.11.2022	15.Vlera e kontratës) 11,179,997 lekë me TVSH	Nr. Referencës: REF-44114-09-30-2022

Llogaritja e Fondit Limit

Titullari i Institucionit znj. A. K. nëpërmjet Urdhrit të Brendshëm nr. 87 datë 13.06.2022, ka ngritur grupin e punës të përbërë nga znj. A. H., znj. M. Q. dhe znj. M. Z. për llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pjese këmbimi për mjetet tip Nissan NV 300” nga ana e të cilit, sipas proces verbalit nr. 1 datë 15.06.2022 janë përzgjedhur subjektet e mëposhtme për të paraqitur ofertën e tyre për të përlllogaritur fondin limit:

1. A. V. person fizik NIPT
2. L..... R..... L..... NIPT
3. A....O S....A NIPT
4. P.....A NIPT
5. A.... J.... NIPT

Për sa më lart, AK Posta Shqiptare me shkresën nr. 1457/2 prot., datë 16.06.2022 ka përcjellë kërkesën për ofertë subjekteve të sipërcituar, duke kërkuar që brenda datës 20.06.2022 të paraqesin ofertën e detajuar pranë Postës Shqiptare. Referuar proces verbalit nr. 1/1., nr. 1457/3 datë 06.07.2022 të grupit të punës, në mungesë të kthimit të përgjigjeve nga subjektet e sipërcituar ka bërë ripërzgjidhje të dytë me subjektet e mëposhtme nëpërmjet kërkesës për ofertë me nr. 1457/4 prot., datë 07.07.2022.

1. A.K..... NIPT ...
2. R... .. NIPT ...
3. M....N M....S NIPT ...
4. D... A... NIPT ...

Në mungesë të përgjigjeve nga këto subjekte, grupi i punës në proces verbalin nr. 1/2 me nr. 1457/6 të datës 29.08.2022, ka përcjellë kërkesë për ofertë me shkresën nr. 1457/7 datë 30.08.2022 subjekteve, S.... A.... me NIPT, P.....R I.....S me NIPT dhe subjektit B.... S.... me NIPT, të cilat nëpërmjet shkresave respektivisht nr. 1457/8, 9, 10 datë 06.09.2022 kanë përcjellë ofertën e tyre sipas zërave dhe sasive të kërkuara pranë AK., Posta Shqiptare. Nëpërmjet proces verbalit nr. 2 me nr. 1457/11 prot., datë 06.09.2022 mbi bazën e 3 (tre) ofertave të subjekteve të sipërcituara duke përdorur metodën e mesatarizimit të ofertave ka përllogaritur shumën 10,960,546 lekë pa TVSH si vlerë për Fondin Limit për procedurën e prokurimit. Titullari i institucionit me vendimin nr. 13 datë 12.09.2022 ka miratuar fondin limit 10,960,546 lekë pa TVSH për procedurën e prokurimit bazuar nga relacioni i grupit të punës përllogaritjen e Fondit Limit me nr. 1457/12 prot., datë 09.09.2022.

Hartimi i specifikime teknike

Titullari i institucionit me urdhrin nr. 84 datë 09.06.2022 ka ngritur grupin e punës për përcaktimin e specifikimeve teknike të përbërë nga z. A. B., z. H. M. dhe znj. B. L.. Grupi i punës ka përcaktuar specifikimet teknike të pasqyruar në shkresën nr. 1419/1 prot., datë 13.06.2022. Grupi për hartimin e dokumenteve të tenderit me datë 30.09.2022 ka hartuar DT.

26. Titulli i gjetjes:	Mangësi në përcaktimin e specifikimeve teknike.
Situata:	Nga auditimi rezulton se grupi i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike nuk ka përcaktuar asnjë tregues teknik për mallrat e kërkuara, por thjesht ka pasqyruar listën e materialeve të kërkuar nga Drejtori i filialit qendra Tranzite z. A. Gj. bashkëlidhur relacionit me nr. 190 prot., datë 17.03.2022. Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike nuk ka parashikuar që: 1.Operatori Ekonomik të paraqiste katalogun origjinal të prodhuesit ose kopje të noterizuar të përkthyer në gjuhën shqipe me të dhënat teknike ku të jenë specifikuar të gjitha specifikimet e pjesëve të këmbimit; 2.Në ditën e hapjes së ofertave Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesë para komisionit mostra për të gjithë artikujt Pjesë Këmbimi; 3. Kërkesat e paraqitura tek shtojca nr. 5 nuk janë materializuar në kritere të veçanta si kërkesa të detyrueshme për OE pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi. Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike për të garantuar cilësinë e mallrave të kërkuara duhej të përfshinte kërkesën që gjatë dorëzimit të mallit, ato të shoqëroheshin me certifikata të sigurimit të cilësisë.
Kriteri:	DST.
Ndikimi:	Në cilësinë e mallrave të dorëzuara.
Shkaku:	Mos respektim të akteve ligjore ne fuqi ne fushën e prokurimeve.
Rëndësia:	E lartë.
26.1 Rekomandimi:	Administratori i shoqërisë të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të hartimit të specifikimeve teknike, pasi në disa raste hartimi i tyre konstatohet jo korrekt.

Për sa më lart, ngarkohet me përgjegjësi z. A. B., z. H. M. dhe znj. B. L., në cilësinë e anëtarëve të hartimit të specifikimeve teknike.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit

KVO nëpërmjet Proces verbalit të datës 01.11.2022 pasqyron procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të ngarkuara në SPE nga OE pjesëmarrës. Sipas këtij Proces verbali më datë 19.10.2022 në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy OE konkretisht:

1. OE S.....2 me ofertë ekonomike 9,316,664 lekë
2. OE P.....R I.....S me ofertë ekonomike 9,768,820 lekë.

Në referim të Proces Verbalit të datës 01.11.2022 në lidhje me verifikimin e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik të dorëzuar nga OE S.....2, KVO e ka konsideruar devijim të vogël mungesën e kësaj certifikate në gjuhë në shqipe. Të njëjtin argument ka përdorur edhe për mungesën e certifikatës ISO 45001:2018 nga OE P.....R I.....S, i cili ka paraqitur certifikatën ISO 45001:2015. Në përfundim ky Komision në bazë të nenit 92/4 të LPP nr. 162/2020 i ka kualifikuar të dyja ofertat e paraqitura nga dy OE pjesëmarrës. Mbi bazën e çmimit më të ulët të KVO ka shpallur fitues OE S.....2 me ofertën ekonomike 9,316,664 lekë.

Njoftimi i fituesit nga Titullari i institucionit është bërë me formularin e njoftimit të fituesit (paraprak) me nr. 2207/3 prot., datë 11.11.2022. Pas marrjes së njoftimit, OE S.....2 i shpallur fitues në bazë të kuadrit ligjor të prokurimeve publike ka paraqitur dokumentacionin e shkruar pranë AK Posta Shqiptare. KVO pas verifikimit të dokumentacionit të shkruar me anë të Proces Verbalit të datës 14.11.2022 ka konstatuar se dokumentacioni është i njëjtë me atë të ngarkuar në SPE.

Raporti Përmbledhës i KVO është miratuar nga titullari i institucioni me shkresën nr. 2207/5 datë 24.11.2022. Pas miratimit të relacionit mbi miratimin e kontratës me objekt “Blerje pjesë këmbimi për mjetet tip Nissan NV300” me shkresën nr. 2207/6 prot., datë 24.11.2022 Titullari i institucionit ka nënshkruar kontratën me nr. 2207/7 prot., datë 24.11.2022.

Zbatimi i kontratës

Titullari i institucionit z. A. D. ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të objektit të kontratës “Blerje pjesë këmbimi për mjetet tip Nissan NV 300” me vendimin nr. 14/8 datë 24.11.2022 me përbërje të këtij komisioni z. A. B., znj. A. P. dhe znj. A. Xh. Kontraktuesi ka realizuar kontratën brenda 6 mujorit nga data e nënshkrimit të kontratës. Mbi bazën e kërkesave të AK kontraktuesi ka dorëzuar mallrat duke i shoqëruar me faturën tatimore të fiskalizuara, të cilat janë marrë në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim:

Fat. 2/2023 datë 09.01.2023 në shumën 1,024,720.8 lekë, Fat.3/2023 datë 23.01.2023 në shumën 1,932,324 lekë, Fat. 10/2023 datë 27.02.2023 në shumën 678,950.4 lekë, Fat.17/2023 datë 08.04.2023 në shumën 1,262,368.8 lekë, Fat.22/2023 datë 03.05.2023 në shumën 2,019,105.6 lekë, Fat. nr. 26/2023 datë 10.05.2023 në shumën 1,812,675.6 lekë, fat.nr. 31/2023 datë 22.05.2023 në shumën 1,713,836.4 lekë, Fat.32/2023 datë 24.05.2023 në shumën 736015.2 lekë.

Zhvillimi i procedurës me objekt “Blerje e vendosje sisteme të integruara të sigurisë (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi CH4, CH8, CH16), sisteme inteligjente (SMART) të sigurisë CH4, CH8, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit”

Me shkresën nr. 85/3, datë 18.03.2021, Drejtorja e Sigurisë dhe Cilësisë bazuar në planin e investimeve të shoqërisë Posta Shqiptare SHA për vitin 2021, në analizë të kërkesave të filialeve për mbulimin e shërbimit të sigurisë me sisteme sigurie të zyrave postare dhe ambiente të tjera të rëndësishme të pa pajisura me këto sisteme, për rinovimin me sisteme të reja të atyre të vjetra të cilat nuk plotësojnë standardet në rritje të perfeksionit teknik të tyre, për regjistrime e vëzhgime të qarta dhe cilësore të pamjeve filmike, për të patur kontroll elektronik mbi shëndetin e pajisjeve të sigurisë dhe monitorimin e sistemeve të alarmit, ku do të blihet e instalohet sistemi SMART i cili do të shërbejë Sallës së Monitorimit të Postës në Drejtorinë e Përgjithshme dhe Sallës së Monitorimit të Operatorit fitues

përkatës, për informim dhe eliminim të defekteve në kohë mjaft optimale, në interes të rritjes së shkallës së sigurisë në të gjitha shërbimet dhe proceset operacionale që realizon shoqëria Posta Shqiptare SHA, propozon kërkesën si më poshtë:

- Blerje e vendosje sisteme sigurie
- Sisteme vëzhgimi DVR/NVR (CH4) = 51 copë, adaptor+kabëll+kanalin+instalim i tyre
- Sisteme vëzhgimi DVR/NVR (CH8) = 6 copë, adaptor+kabëll+kanalin+instalim i tyre
- Sisteme vëzhgimi DVR/NVR (CH16) = 3 copë, adaptor+kabëll+kanalin+instalim i tyre
- Sisteme alarmi = 52 copë, adaptor+kabëll+kanalin+instalim i tyre
- Blerje e vendosje monitor = 2 copë
- Blerje e vendosje Programi SMART
- Sisteme inteligjente siguire CH4 = 30 copë
- Sisteme inteligjente sigurie CH8 = 20 copë
- Programi i shëndetit të paisjeve të sigurisë = 329 copë
- Programi i monitorimit të sistemit të alarmit = 301 copë

Urdhër Prokurimi Nr. 08, datë 29.04.2021		
1.Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur	2. Njësia e prokurimit znj. E. P. z. O. Dh. z. Xh. H.	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave z. E. T. z. V. A. znj. N. S.
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike Z. A. G. Z. Xh. H. Z. O. Dh.		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 50,194,820 lekë	6. Oferta Fituese (pa TVSH) 48,888,888 i.s.s (integradet security solutions)	7. Diferenca me Fondin Limit (pa TVSH) 1,305,932 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 17.05.2021	9. Burimi i Financimit Posta Shqiptare SHA	10. Operatorët Ekonomikë G..... S.....- 50,072,000 a..... t..... s..... - 49,861,300 <u>i..... S..... - 48,888,888</u> I..... S.....s - pa ofertë
11. Ankimime -	12. Përgjigje e ankesës nga AK -	13. Grupi i ndjekjes së Kontratës z. O. Dh. z. Xh. H. z. T. H.
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës 1. Kontratë nr. 937/7 prot., datë 17.06.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 58,666,665.6 lekë	16. Afati i kontratës në muaj Afati i realizimit 2 muaj

Fondi është akorduar nga Buxheti i Postës Shqiptare me vlerë 50,194,820 lekë pa TVSH. Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Postës Shqiptare SHA.

Nga auditimi i procedurës së mësipërme të prokurimeve u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, salla e monitorimit të O.E. për eliminimin e defekteve mbulohet nga O.E. për 2 vite që është dhe garancia e produkteve. Pas dy vitesh meqenëse tërësia e produkteve funksionon si një sistem nuk është parashikuar mirëmbajtje dhe nuk është përcaktuar se kujt do ti kalojnë të drejtat e sallës së monitorimit. Meqenëse është zhvilluar një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit atëherë në procedurën e prokurimit duhet të ishte parashikuar dhe mirëmbajtja me qëllim ofrimin e shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose të shkatërrimit të të dhënave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit z. Xh. H., z. O. Dh. dhe z. E. P..

- **Zbatimi i Kontratës**

Në dhomën e serverave dhe të sigurisë së Postës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare, u bë verifikimi i sistemeve të integruara të sigurisë si dhe sistemet inteligjente (Smart). Nga auditimi me zgjedhje iu kërkua personit përgjegjës të sigurisë hapja e kamerave në kohë reale për të verifikuar funksionimin e tyre. U konstatua se në disa prej pikave ku janë instaluar këto sisteme nuk kishte akses pasi janë bërë ndryshime me serverët e internetit dhe ishin në proces në momentin e verifikimit të kryer nga grupi i auditimit në ambientet e Posta Shqiptare SHA. Sistemet e alarmit janë të gjitha funksionale në Filialet e Postës Shqiptare. Kjo gjë u provua dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare ku brenda 5 minutave nga alarmi në ambientet e Drejtorisë u paraqit grupi i gatshëm.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së mësipërme u konstatua se pas verifikimit fizik të ambienteve të dhomës së serverëve dhe të sigurisë së Postës Shqiptare SHA., në Drejtorinë e Përgjithshme ekzistonin kamera të cilat ishin jashtë funksionit dhe nuk u arrit të merrej sinjal, gjë e cila u konfirmua nga personat përgjegjës, përjashtuar rasteve të cilat ishin bërë ndryshimet në serverët e internetit dhe ishin në proces konfigurimi të kamerave.

Gjithashtu në verifikimin mbi hapësirën e ruajtjes së të dhënave mbi pamjet filmike, një pjesë e konsiderueshme e kamerave nuk arrinin të mbajnë të dhëna sipas specifikave të kërkuara nga ana e AK sipas kontratës nr. 937/7 prot., datë 17.06.2021. (koha e regjistrimit)

27. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të zbatimit të kontratës.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe nga verifikimi në terren i mallit objekt kontrate u konstatuan disa problematika. Konkretisht rezultoi se disa prej kamerave të instaluar në filialet e postës nuk ishin funksionale.
Kriteri:	<i>Vendim nr. 7 10, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, Pika 2.b) të cilat kanë sisteme ekzistuese, duhet të parashikojnë këtë marrëveshje, për mirëmbajtjen e sistemeve. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet.</i>
Ndikimi:	Rritja e kostove operacionale të Posta Shqiptare SHA.
Shkaku:	Moszbatimi i Vendimit nr. 710, datë 21.08.2013.
Rëndësia:	E lartë.
27.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat të hartojë dhe të parashikojë mirëmbajtjen e mallrave objekt kontrate sipas Vendimit në fuqi.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. O. Dh., z. Xh. H. dhe z. T. H., në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës.

Zhvillimi i procedurës me objekt “Blerje Kuti Postare restante, Kuti Postare me çelës për paketa, Kuti Postare për klientë”

Me shkresën nr. 274/13, datë 26.20.2020, Drejtoria e Programim Zhvillimit dhe Infrastrukturës, duke u mbështetur në kërkesat e filialeve dhe Drejtorisë së shërbimit Postar për Kuti postare Restante, Kuti postare me çelës dhe kuti postare për klientë në adresë, për vitin 2020 të pasqyruar në Programin e Zhvillimit Ekonomik të vitit 2020 të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.1 nr. 46, datë 27.12.2019, paraqet kërkesën për fillimin e procedurës së prokurimit për blerje Kuti postare Restante, Kuti postare me çelës për paketa (outdoor parcel lockers) dhe Kuti postare për klientë në adresë, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësi matje	Sasi
1	Kuti Postare Restante	Copë	400

2	Kuti Postare me çelës për paketa (parcel lockers)	Copë	13
3	Kuti postare për klientë në adresë	Copë	1000

Fondi limit në vlerën: 56,670,000 lekë pa TVSH

Loti I – 48,880,000 lekë pa TVSH *Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë*

Loti II – 7,790,000 Lekë pa TVSH *Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë*

Procedura e Prokurimit "Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë"		
Urdhër Prokurimi Nr. 01, datë 29.02.2021		
1.Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur	2. Njësia e prokurimit znj. V. K. z. E. K. znj. B. B.	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave znj. E. C. z. K. C. z. E. T.
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike z. E. K. znj. F. Gj. znj. B. B.		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 48,880,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa TVSH) 47,500,000 lekë pa TVSH	7. Diferenca me Fondin Limit (pa TVSH) 1,380,000 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 03.03.2021	9. Burimi i Financimit Posta Shqiptare SHA	10. Operatorët Ekonomikë U.....S R.....A– 43,993,000 I. B. & K.... – 47,500,000 Format –pa ofertë
11. Ankimime -	12. Përgjigje e ankesës nga AK -	13. Grupi i ndjekjes së Kontratës z. S. Z. z. A. S. znj. V. K.
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Kontratë Nr. 225/13 prot., datë 10.05.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 56,940,000 lekë	16. Afati i kontratës në muaj Afati i realizimit 70 ditë

Fondi është akorduar nga Buxheti i Postës Shqiptare, për të dy lotet është me vlerë 56,670,000 lekë pa TVSH: Për lotin I – 48,880,000 (dyzetë e tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH dhe për lotin II -7,790,000 (shtatë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Postës Shqiptare SHA.

28. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të vendosjes së specifikimeve teknike dhe mosvënie në përdorim e investimit.
Situata:	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt " <i>Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë</i> " rezulton se specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke mos përshkruar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së për të vlerësuar mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara e për rrjedhojë janë hartuar të tilla që nuk kanë krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve si rrjedhojë e arsyeve të sipërpërmendura. Referuar LPP është saktësuar fakti se specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik dhe ato duhet ti referohen standardeve kombëtare, ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera

	<p>teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato duhet t'u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare. Kërkesat e bëra nuk janë bërë plotësisht në terma funksionale pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Grupi i auditimit ka kryer një analizë të kriterëve të vendosura në raport me ato të përmbushura në ana e OE fitues të cilat, në gjykim të grupit krijohet një dyshim i arsyeshëm e i mbështetur në argumente konkrete mbi paracaktimin e OE fitues përmes vendosjes së specifikimeve teknike fikse të paargumentuara dhe që nuk lidhen me ndonjë domosdoshmëri konkrete me nevojat e AK. Konkretisht këto analizohen si më poshtë rast pas rasti për një pjesë prej tyre me qëllim identifikimin e fenomenit:</p> <p>3. Kriteri</p> <p>Kamera të integruar me rezolucion jo më pak se 350 k Pixel dhe me kënd vrotimi jo më pak se 92 gradë, për të monitoruar përdorimin dhe operacionet me zgjidhjen e MAK. Kamera duhet të jetë version miniature i përshtatshëm për tu montuar në MAK. Kërkohet që kamerat të kenë përmasa jo më të mëdha se 30 mm x 30 mm për arsyen e mësipërme. Kamera duhet të jetë e pajisur me një sensor për dedektim të imazhit, me shpejtësi kapje jo më të vogël se 30 fps at 640x480. Kamera duhet të vijë me një portë USB nga e cila gjithashtu të marri ushqim (energji elektrike). Nga sa më sipër, duke krahasuar kërkesat dhe të dhënat e produkteve sipas katalogut konstatohet se edhe për sa i takon të kërkesave edhe për sa i takon vlerave korresponduese, këto specifikime rezulton se janë marrë në mënyrë identike nga prodhuesi (<i>Foto nr. 1 Aneksi nr. 2.3.4</i>).</p> <p>4. Kriteri</p> <p>PC i brendshëm i integruar në format panelor i inkorporuar në ekranin 12'-13' (inch). Me të paktën 5 porta për lidhje USB, nga të cilat të paktën 1 portë duhet të jetë USB 3.0 për të garantuar shpejtësi më të madhe transmetimi. Të paktën 1 portë RJ45 dhe 1 portë DB15 (për lidhje VGA).</p> <p>Nga sa më sipër, duke krahasuar kërkesat dhe të dhënat e produkteve sipas katalogut konstatohet se edhe për sa i takon kërkesave edhe për sa i takon vlerave korresponduese, këto specifikime, rezulton se janë marr në mënyrë identike nga prodhuesi (<i>Foto nr. 2 Aneksi nr. 2.3.4</i>).</p> <p>Në lidhje me zbatimin e kontratës pas një inspektimi ne terren te disa pajisjeve MAK në qendrat e caktuara ne procesverbal për qytetin e Tiranës, rezultoi se asnjë nga 4 pajisjet nuk janë funksionale me shpjegimin nga grupi i ndjekjes kontratës se i ka mbaruar afati sistemit Cloud. Sistem ky i domosdoshëm për funksionim e pajisjeve MAK.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, <i>“Për prokurimin publik”</i>, i ndryshuar, Neni 1, <i>“Objekti dhe qëllimi” ku përcaktohet se:</i></p> <p><i>“Qëllimi i këtij ligji është:</i></p> <p><i>b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;</i></p> <p><i>c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;</i></p>

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”:
“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:
a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;
b) transparencë në procedurat e prokurimit;
c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve.”

Neni 20, “Mosdiskriminimi”:
“Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.”

Neni 23, “Specifikimet teknike”:
Pika 1: Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.
Pika 2: Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.
Pika 3: Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:
a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;
b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj 61

Pika 4: Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të

	<p>përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.</p> <p><i>Pika 5: Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”.</i></p> <p>VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar:</p> <p>Neni 27, “Kontratat e mallrave” <u>ku përcaktohet se:</u></p> <p>“1) Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.</p> <p>3) Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”</p>
28.1 Ndikimi:	Vendosja e parametrave teknike specifike, pa u mbështetur në argumente konkrete nuk siguron një procedurë efektive, eficiente dhe transparente prokurimi.
28.2 Ndikimi:	Mos vënia në përdorim nga dita e marrjes në dorëzim e deri aktualisht e kutive MAK ka bërë që vlera e shpenzuar prej 47,500,000 lekë pa TVSH të përbëjë përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve.
Shkaku:	Veprimet edhe mosveprimet e personave të angazhuar me hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike.
Rëndësia:	E lartë.
28.1 Rekomandimi:	Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të specifikimeve teknike në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.
28.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren

	masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësi për mosvënien në përdorim të këtij investimi me vlerë 47,500,000 lekë pa TVSH si dhe për shfrytëzimin e këtij aseti për qëllimin për të cilin është blerë.
--	--

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Hartimit të Specifikimeve Teknike z. E. K., znj. F. Gj. dhe znj. B. B..

Procedura e Prokurimit "Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë"		
Urdhër Prokurimi Nr. 01, datë 29.02.2021		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e hapur	2. Njësia e prokurimit znj. V. K. z. E. K. znj. B. B.	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave znj. E. C. z. K. C. z. E. T.
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike z. E. K. znj. F. Gj. znj. B. B.		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 7,790,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa TVSH) 7,572,000 lekë pa TVSH	7. Diferenca me Fondin Limit (pa TVSH) 218,000 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 03.03.2021	9. Burimi i Financimit Posta Shqiptare SHA	10. Operatorët Ekonomikë U.....S R.....A – 7,572,000 I.....C –pa ofertë F....T –pa ofertë
11. Ankimime -	12. Përgjigje e ankesës nga AK -	13. Grupi i ndjekjes së Kontratës z. S. Z. z. A. S. znj. V. K.
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Kontratë Nr. 225/19 prot., datë 21.05.2021 Amendim Kontrate Nr. 225/28 prot., datë 13.07.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 9,086,400 lekë	16. Afati i kontratës në muaj Afati i realizimit 60 ditë + 40 ditë me amendim kontrate

• **Zbatimi i Kontratës**

29. Titulli i gjetjes:	Mosfunksionim i kutive postare me çelës për klientë.
Situata:	Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit në terren të mallit objekt kontrate, pas një inspektimi në terren duke zgjedhur disa nga pikat ku janë montuar kutit postare sipas proces-verbalit bashkangjitur dosjes së prokurimit, rezultoi se shumë kuti postare në hyrjet e pallateve nuk ishin funksionale pasi nuk përmbanin as emrin dhe as nr. e apartamentit të banorëve. Pas një komunikimi dhe me administratorët e pallateve ata e mohuan që të kishin një kopje të çelësave për aksesimin e kutive postare. Kjo gjë është e ilustruar dhe nga fotot me nr. 3, 4, 5 dhe 6 në Aneksin nr. 2.3.4. Kutitë restante nuk janë montuar por janë në gjendje në magazinën qendrore të postës.
Kriteri:	Kontrata nr. 225/19 prot., datë 21.05.2021.
Ndikimi:	Efekt negativ financiar për buxhetin e Posta Shqiptare SHA.
Shkaku:	Mosveprim (neglizhencë) e AK për realizimin e qëllimit të kontratës.
Rëndësia:	E lartë.
29.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masat të analizojë situatën, të nxjerrë shkaqet dhe përgjegjësitë me qëllim vënien në funksion të Kontratës

nr. 225/19 pot., datë 21.05.2021.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Ndjekjes dhe e Zbatimit të Kontratës z. S. Z., z. A. S. dhe znj. V. K..

2.4 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Në zbatim të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme për vitet 2019-2020-2021-2022;
- Emërimet e lirimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
- Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës te Postës Shqiptare sha. dhe vendimet e Administratorit të shoqërisë për periudhën objekt auditimi.

Posta Shqiptare SHA është i vetmi operator publik postar, në tregun shqiptar e cila drejton administron dhe zhvillon rrjetin postar kombëtar si dhe ka detyrimin për përmbushjen e shërbimeve bazë postare. Kompania siguron një gamë të gjerë shërbimesh postare dhe financiare. Deri në 2009, këto shërbime kanë arritur në 77 lloje, si shërbimet tradicionale postare (postën e letrave, kolipostën dhe shërbime të urdhërpagesave), shërbimin e shpejtë EMS, shërbime biznesi si dhe shërbime financiare (transferta të shpejta të parave, pagesat e tatim taksave, shpërndarje të pensioneve të pleqërisë, arkëtimi i faturave telefonike, të energjisë elektrike, e pagesa të tjera).

Posta Shqiptare sha funksionon bazuar në kuadrin ligjor të përcaktuar sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë.

-Organet e shoqërisë janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshill Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë.

-Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Posta Shqiptare SHA përbëhet nga 6 anëtarë.


Nga auditimi konstatohet se:

- Për vitin 2019 Këshilli Mbikëqyrës është mbledhur 9 herë dhe janë marrë 46 vendime.
- Për vitin 2020 Këshilli Mbikëqyrës është mbledhur 16 herë dhe janë marr 32 vendime.
- Për vitin 2021 Këshilli Mbikëqyrës është mbledhur 5 herë dhe janë marr 16 vendime.
- Për vitin 2022 Këshilli Mbikëqyrës është mbledhur 7 herë dhe janë marrë 15 vendime.

Në lidhje me 2 gjetjet e konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren për këtë pikë të Programit, janë marrë në konsideratë observacionet e dërguara të cilat gjejnë trajtim si më poshtë.

2.5 Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga grupi i auditimit u verifikuan Struktura organizative, Dosjet e personelit, Rregullorja për përcaktimin e kriterëve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës, Kontrata kolektive dhe ato individuale të punës, Procedurat e rekrutimit dhe përfundimit të marrëdhënive të punës si dhe Procedurat e dhënies të masave disiplinore. Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Organet drejtuese të Posta Shqiptare SHA janë Administratori (z. A. D.), Këshilli Mbikëqyrës me përbërje z. B. K. (kryetar), znj. R. N., znj. V. C., znj. K. S., dhe z. E. M. (anëtarë). Me anë të Vendimit nr. 10 datë 01.04.2019 janë miratuar disa ndryshime në strukturën e Administratës Qendrore të Posta Shqiptare SHA, të filialit të Postës dhe degëve të filialeve si dhe janë miratuar kriteret tekniko-profesionale të punonjësve të Administratës Qendrore nga Këshilli Mbikëqyrës me përbërje znj. M. L. (kryetare), z. H. B., znj. I. M., znj. D. D., znj. A. C. dhe z. E. Q.(anëtarë). Me anë të Vendimit nr. 6 datë 16.06.2021 janë miratuar disa ndryshime në strukturën e Administratës Qendrore të Posta Shqiptare SHA, të filialit Hibrid Mail, Filialit Tiranë, Filialit Durrës dhe Elbasan nga Këshilli Mbikëqyrës me përbërje z. B. K. (kryetar), znj. R. N., znj. V. C., znj. K. S., dhe z. E. M. (anëtarë). Me anë të Vendimit nr. 14 datë 09.12.2021 janë miratuar disa ndryshime në strukturën e Administratës Qendrore të Posta Shqiptare SHA, Këshilli Mbikëqyrës me përbërje z. B. K. (kryetar), znj. E. M., znj. R. N., znj. V. C., znj. K. S., dhe z. E. M. (anëtarë). Struktura organizative të aparatit qendror të shoqërisë Posta Shqiptare si më poshtë (ilustruar me foto):



Përveç aparatit qendror të shoqërisë, Posta Shqiptare. përbëhet nga Qendra Tranzite dhe filialet në Qytete si më poshtë :

- Filiali Durrës
- Filiali Elbasan
- Filiali Shkodër
- Filiali Burrel
- Filiali Fier
- Filiali Korçë
- Filiali Mat
- Filiali Kukës
- Filiali Lezhë

- Filiali Lushnje
- Filiali Vlorë
- Filiali Gjirokastrë
- Filiali Sarandë

Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat mbi numrin e punonjësve për periudhën objekt auditimi

Nr.	Filialet	2019	2020	2021	2022
1	Tirane	606	621	638	644
2	Qendra tranzite	165	167	164	162
3	Durrës	167	167	179	179
4	Elbasan	197	199	211	211
5	Shkodër	140	144	144	143
6	Lezhe	94	94	94	93
7	Fier	128	127	128	128
8	Vlore	107	107	107	107
9	Lushnje	76	76	76	76
10	Berat	141	141	141	141
11	Korçe	149	152	152	149
12	Gjirokastrë	100	98	102	102
13	Sarandë	53	53	53	53
14	Mat	112	114	117	117
15	Kukës	76	76	76	76
16	Administrata	154	158	166	167
17	Hibrid Mail		5	17	16

Burimi: Posta Shqiptare SHA, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga auditimi për periudhën objekt auditimi konstatohet se Posta Shqiptare SHA:

- Nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive;
- Nuk ekziston një procedurë rekrutimi e punonjësve pasi për përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura. Pra nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj;
- Përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj.;
- Për disa pozicione pune nuk është përcaktuar kriteri i arsimit si domosdoshmëri për përmbushjen e funksionit të detyrave të pozicionit të punës.

1. Titulli i gjetjes:	Mos përditësimi i rregullores së brendshme administrative, për funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se Rregullorja e Brendshme, “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare nuk është përshtatur (amenduar) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Posta Shqiptare. Konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> - në rregulloren e brendshme të Posta Shqiptare SHA detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara përgjithësisht në nivel makro; - në disa raste konstatohet se mungojnë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësive për disa funksione që janë në strukturën organizative por nuk gjenden të reflektuara në rregulloren e brendshme të funksionit të administratës qendrore.
Kriteri:	Nenet 7, 11, 14, të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe neni 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe

	<i>kontrollin</i> ”, i ndryshuar si dhe “ <i>Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm</i> ” përcaktuar në rregulloren e brendshme.
Ndikimi:	Mos adresim i përgjegjësive si pasojë e keq adresimit të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive.
Shkaku:	Mos menaxhimi i ndryshimit në bazën ligjore, nënligjore dhe aktet rregullatore.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, të hartojnë, amendojnë dhe miratojnë, rregulloren e brendshme, “ <i>Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA</i> ” duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite në shoqëri. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontroleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale.

2. Titulli i gjetjes:	Nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive.
Situata:	Gjatë auditimit të procedurave në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj, në asnjë rast nuk u evidentua ndonjë gjurmë që sektorëve/departamenteve përkatëse ju ka lindur nevoja për rekrutimin e punonjësve të rinj.
Kriteri:	Rregullorja e Brendshme, “ <i>Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA</i> ” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare.
Ndikimi:	Mos arritja e efijencës në plotësimin e burimeve njerëzore.
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe Vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare SHA.
Rëndësia:	E lartë.
2.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, gjatë hartimit të strukturës organizative të aparatit qendror Posta Shqiptare SHA dhe njësisve të vartësisë, dhe në momentin e plotësimit të strukturës me punonjës të rinj, të marrë në konsideratë nevojat e sektorëve/departamenteve dhe njësisve të vartësisë që të arrijnë efijencën e plotë me qasjen me burimet njerëzore të duhura sipas nevojave.

3. Titulli i gjetjes:	Posta shqiptare SHA nuk ka pasur një procedurë rekrutimi të punonjësve
Situata:	Gjatë auditimit të mënyrës së rekrutimi të punonjësve të rinj, nuk u dokumentua një procedurë e mirëfilltë e rekrutimit të tyre. Deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura; nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.
Kriteri:	Rregullorja e Brendshme, “ <i>Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA</i> ” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare.

Ndikimi:	Konkurrenca e ulët në zhvillimin e garës, për përzgjedhjen e konkurrentit të duhur.
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe Vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare SHA.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj, të kryejë procedurat sipas metodave më të mira dhe me të drejta, për zhvillimin e tyre me transparencë të plotë dhe konkurrencë të plotë, duke përzgjedhur kandidatin e duhur sipas nevojave të institucionit.

4. Titulli i gjetjes:	Përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet.
Situata:	Gjatë auditimit të dosjeve të personelit dhe të dokumentit mbi <i>“Detyrat funksionale dhe Kriteret e punësimit për pozicionet e punës”</i> , përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj.;
Kriteri:	Vendimet <i>“Për miratimin e strukturës organizative të aparatit qendror të Posta Shqiptare SHA”</i> .
Ndikimi:	Mos realizimi i detyrave të përcaktuara në përshkrimin e punës.
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore dhe Vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare SHA.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj, të marrin në konsideratë të gjitha kriteret e vendosura dhe të miratuara nga Këshillimi Mbikëqyrës si dhe ato në Manualin e Burimeve Njerëzore.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. B. A., Drejtori i Burimeve Njerëzore.

2.6 Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta, sponsorizime, etj).

Veprimet me bankë dhe arkë në përgjithësi janë të rregullta, të shoqëruara me dokumentacionin justifikues, të pasqyruara në librin e arkës dhe ditarët përkatës në mënyrë elektronike, me programin Eterna Financiare, të pasqyruara periodikisht në llogaritë vjetore.

Struktura e shpenzimeve në veprimtarinë e shoqërisë Posta Shqiptare SHA është e përbërë nga shpenzime për materiale të para dhe mallra, shpenzime për amortizimin, shpenzime për personelin, si edhe shpenzime të tjera.

Në strukturën e shpenzimeve të tjera bëjnë pjesë shpenzimet për shërbime ndihmëse dhe shpenzimet për qëllime administrative.

Shpenzimet administrative për udhëtime dhe dieta janë vlerësuar përkatësisht, në masën prej 21,988,871 lekë në vitin 2021 dhe 20,339,336 lekë në vitin 2022. Këto shpenzime kryesisht janë shoqëruar me urdhrat dhe programet përkatëse, si edhe me dokumentacionin vërtetuese me natyrë shpenzuese.

Gjithashtu, në zbatim të kontratës 4 vjeçare nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 ndërmjet “M...N M...S” SHPK dhe Posta Shqiptare SHA janë parashikuar shpenzimet për qiranë financiare (Leasing) në vlerën gjithsej prej 24,002,475 lekë në vit, e ndarë në 12 fatura mujore në shumën prej 2,400,248.50 lekë/muaj.

Shpenzimi për qiranë financiare është kryer për 3 autovetura Volvo V40, të cilat janë vënë në përdorim të drejtorisë së përgjithshme, si edhe 21 kamionçina Ford Courier dhe 30 motoçikleta Piaggio Liberty në përdorim të filialeve.

Shpenzimet për karburantin për vitin 2022 janë vlerësuar në masën prej 57,366,591.55 lekë ose 10 % më shumë krahasuar me vitin financiar 2021.

Shoqëria Posta Shqiptare SHA mbulon një park prej 103 automjete dhe 126 motoçikleta, nga ku numrin më të madh e zë Filiali Tranzit Vorë, Filiali Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme etj.

Administrimi i konsumit të karburantit kryhet me ndihmën e platformës elektronike “I.....S” të furnitorit K.....I SHPK dhe furnizimi i automjeteve kryhet nëpërmjet kartave elektronike.

Shpenzimet për penalitete dhe dëmshpërblime, të cilat nuk përbëjnë shpenzime operative janë vlerësuar përkatësisht, në masën prej 19,696,614.50 lekë në vitin financiar 2021, dhe në masën prej 23,005,189.64 lekë në vitin financiar 2022 ose 14 % më shumë krahasuar me një vit më parë.

Drejtoria e Përgjithshme mbulon pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve krahasuar me filialet të marra së bashku, përkatësisht në vlerën prej 10,453,583.60 lekë në vitin 2021 ose 53 %, dhe në vlerën prej 14,607,896.70 lekë ose 63 % në vitin 2022, të cilat janë kryesisht dëmshpërblime për shkak të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

1. Titulli i gjetjes:	Shpenzime për dëmshpërblime nga largimet nga puna.
Situata:	Nga analiza e llogarisë 638 “Penalitete dhe dëmshpërblime”, për vitin 2021, shpenzimet për dëmshpërblime, kryesisht për largimet nga puna, që shoqëria ka kryer për shkak të vendimeve të formës së prerë të gjykatave, janë vlerësuar në vlerën gjithsej prej 10,302,400 lekë si më poshtë: - Me Vendimin nr. 36, datë 11.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. A. K., si dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi i paditësit është kryer me numër dokumenti 442, datë 11.03.2021 në vlerën prej 1,568,134 lekë. - Me Urdhrin e Sekuestros nr. 14483, datë 25.06.2021 është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. A. K. dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi është kryer me numër

	<p>dokumenti 1122, datë 29.06.2021 në vlerën prej 854,700 lekë.</p> <p>- Me Vendimin nr. 163, datë 08.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. R. M., si edhe dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi është kryer me numër dokumenti 4278, datë 05.10.2021 në vlerën prej 1,663,801.60 lekë.</p> <p>- Me Vendimin nr. 23, datë 01.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin Sindikatën e Pavarur të Industrisë, Energjetikës të Shqipërisë, si edhe dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi i paditësit është kryer me numër dokumenti 769, datë 17.06.2021 në vlerën prej 6,215,765 lekë.</p> <p>Nga vendimet e gjykatave, sa më sipër, ndërprerjet e marrëdhënieve të punës të ish-punonjësve kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi Punës i Republikës të Shqipërisë, i ndryshuar, për shkak të ndryshimeve të njëanshme të kushteve të përgjithshme të kontratës individuale të punës, nga ana shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Për sa më sipër, në kundërshtim me pikën 4, neni 5 të Vendimit nr. 11, datë 15.01.2018 të Asamblesë të Aksionarit “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e shoqërisë Posta Shqiptare SHA”, Administratori i Shoqërisë nuk ka propozuar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës mbi largimin e drejtuesve me nivel kombëtar përgjegjësie, siç është rasti i largimit të Drejtorit të Shërbimeve Bankare dhe Financiare në Drejtorinë e Përgjithshme, me Urdhrin nr. 28, datë 31.01.2018. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës në Vendimin nr. 13, datë 29.05.2020 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH” ka analizuar rastet e largimeve nga puna dhe ka ngarkuar administratorin dhe drejtoritë përkatëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. Sa më sipër, shoqëria nuk ka hartuar një plan veprimi për reagimin dhe raportimin sipas vendimit të sipërcituar, si edhe nuk ka nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për shpenzimet e kryera, të cilat rezultojnë si shpenzime me efekt financiar negativ. Sa më sipër, bie në kundërshtim me pikën 14.6, neni 14 i statutit të shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Parregullsitë sa më sipër, kanë shkaktuar shpenzime me efekt negativ financiar gjithsej në vlerën prej 10,302,400 lekë, në formën shpenzimeve të përsëritura për të njëjtin vend pune, në dëm të shoqërisë Posta Shqiptare SHA.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Pika 14.6, neni 14 i statutit të Postës Shqiptare SHA, <u>ku përcaktohet se:</u> “Administratori është përgjegjës, për ushtrimin e funksioneve të caktuara dhe për zbatimin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës. Ai i paraqet Këshillit Mbikëqyrës raporte për administrimin e shoqërisë në interval të rregullta, të paktën një herë në tre muaj. Për më tepër, i raporton Këshillit Mbikëqyrës për çdo rast tjetër të veçantë.”</p> <p>Në kundërshtim me pikën 4 neni 5, të Vendimit nr. 11, datë 15.01.2018 të Asamblesë të Aksionarit “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e shoqërisë Posta Shqiptare SHA”, <u>ku përcaktohet se:</u> “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës: Të miratojë propozimet e administratorit për emërimin/largimin e drejtuesve të departamenteve, në nivel kombëtar përgjegjësie, kontratat e të cilëve lidhen/zgjidhen nga Administratori i shoqërisë.”</p>

Ndikimi:	Shpenzime me efekt financiar negativ në vlerën 10,302,400 lekë në formën e shpenzimeve të përsëritura.
Shkaku:	Mungesa e zbatimit të kuadrit përkatës ligjor dhe rregullator.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorisë Posta Shqiptare SHA të analizohen shpenzimet e dëmshpërblimeve për shkak të ndërprerjeve të njëanshme të marrëdhënieve të punës dhe të përcaktohen personat shkaktarë përgjegjës. Administratori i shoqërisë të marrë masat e nevojshme për mundësinë e kompensimit të këtyre fondeve në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara ligjore.

Sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. L. D., larguar, me cilësinë e ish-Administratorit i Posta Shqiptare SHA dhe z. A. D., në cilësinë e administratorit aktual të Posta Shqiptare SHA.

2. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të konsumit të karburantit.
Situata:	<p>Parku i filialit Tiranë është i përbërë nga 14 automjete naftë (gazoil) në gjendje pune, nga ku 7 prej tyre, të tipit Ford Courier janë pjesë të kontratës me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 “Qiraja financiare (Leasing)”, ndërmjet M...N M...S SHPK dhe Posta Shqiptare SHA. Me anë të kontratës të shërbimit të sigurisë nr. 1322/24 prot., datë 19.10.2020 është përfshirë shërbimi i sistemeve të gjurmimit GPS/GPRS, ku është parashikuar të kryhet monitorimi i mjeteve me targa AA288NY, AA289NY dhe AA798BX të këtij parku (qendra e monitorimit ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA, me shërbim 24 h/7). Për sa më sipër, rezulton se për periudhën 2021-2022 ky shërbim nuk ka funksionuar. Shërbimi gjurmimit GPS/GPRS nuk përfshin mjetet nga kontrata e qerasë financiare (leasing), monitorimi i të cilave kontraktohet nga shoqëria qiradhënëse M...N M...S SHPK. Procesi i administrimit të konsumit të karburantit (gazoil) është raportuar sipas formatit “Treguesit teknik të mjeteve”, i cili nuk përmban çmimin për njësi, orën, datën dhe vendin e furnizimit, megjithëse programi “I.....S” i furnitorit K.....I SHPK është në gjendje të gjenerojë një situacion të saktë shpenzimi, për çdo automjet, me datën, vendin, dhe orën e furnizimit, çmimin/njësi, sasinë përkatëse të lëndës djegëse, si edhe numrin e kuponit të tërhequr. Nga ana tjetër, në procesin e administrimit të karburantit mungojnë fletudhëtimet e lëvizjes së automjeteve apo autorizimet përkatëse dhe nga muaji Mars 2022 nuk janë dhënë kilometrat e përshkruara në formatin “Treguesit teknik të mjeteve”. Nga auditimi rezulton se në formatin e sipërcituar është vendosur norma e konsumit të karburantit (gazoil) 10 litra (mesatarisht)/100 km, pa studim dhe procedurë të miratuar, për 7 mjetet nga kontrata leasing me targa AA 051YV, AA487YY, AA057YY, AA491YY, AA058YV, AA798YU, AA794YU. Por, në procesverbalin e datës 01.10.2019 për marrjen në dorëzim “Mbi pranimin e 21 furgonçinave Ford Courier sipas kontratës “leasing” nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019”, është konfirmuar se mjetet e reja të sipërcituara kanë një konsum të kombinuar 4.5 litra/100 km. Vendosja e normës së harxhimit të karburantit (gazoil)10 litra/100 km, duke u nisur nga kilometrat të plotësuar në formatin “Treguesit teknik të mjeteve”, tregon se administrimi i karburantit nuk është në pajtueshmëri me</p>

	<p>kuadrin ligjor dhe rregullator, për aq kohë sa kilometrat nuk janë të konfirmuara, kur lëvizjet e automjeteve nuk janë autorizuar, dhe kur nuk ka një studim të miratuar, që argumenton ndryshimin dhe rritjen e normës së dhënë të kombinuar për harxhimin e karburantit. Sa më sipër bie në kundërshtim me pikën 1.11.4 “Rregullat mbi përdorimin e automjeteve”, si edhe me pikat 3 dhe 7, neni 28 në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, miratuar me ndryshimet e saj me Urdhrin nr. 556, datë 13.12.2018 të Administratorit të shoqërisë. Veprimet dhe mosveprimet e njësisë shpenzuese Filiali Tiranë, kanë sjellë rritjen e paargumentuar të normës së konsumit të karburantit (gazoil), dhe kanë shkaktuar si pasojë konsumin prej 7,793 litra naftë më tepër {[konsumi në litra/muaj – konsumi i llogaritur (km të përshkruara * 4.5 litra/100 km)] /1 muaj}. Nga të dhënat e siguruara, rezulton se është kryer pagesa në vlerën prej 1,160,531 lekë më shumë, nga përdorimi i automjeteve “leasing” për periudhën Maj 2021 - Shkurt 2022 {Vlera në lekë e paguar/muaj – vlera e llogaritur [(km *4.5 litra/100 km) /1muaj * çmimi mujor]}. Parregullsitë, sa më sipër, kanë sjellë si pasojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA një përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në vlerën prej 1,160,531 lekë.</p>
Kriteri:	<p>Pika 1.11.4 e “Rregulla të përgjithshme mbi përdorimin e automjeteve” në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Automjetet në rast shërbimesh vihen në dispozicion vetëm për nevojat e punës, në bazë të procedurës së ndjekur dhe autorizimit të lëshuar.”</i> -Pikat 3 dhe 7, neni 28 në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, miratuar me ndryshimet e saj me Urdhrin nr. 556, datë 13.12.2018 të Administratorit të shoqërisë, <u>ku përcaktohet se:</u> <i>Përgjegjësi i sektorit të sigurimit të standardeve dhe cilësisë, ndjek zbatimin e grafikëve të lëvizjes së mjeteve, si dhe përcakton dhe kontrollon normativat e harxhimit të karburantit, duke llogaritur ngarkesën dhe distancën, si edhe në mbështetje të urdhrave nga administrata qendrore.</i></p>
Ndikimi:	<p>Përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i shkaktuar shoqërisë Posta Shqiptare SHA në vlerën prej 1,160,531 lekë.</p>
Shkaku:	<p>Keqadministrimi i konsumit të karburantit.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë.</p>
2.1 Rekomandimi:	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për nxjerrjen e përgjegjësive dhe më pas arkëtimin e shumë përkatëse ndaj personave përgjegjës, e cila aktualisht është në vlerën totale prej 1,160,531 lekë pa TVSH dhe aktualisht⁸ është konsideruar si përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve për shërbime të ofruara jo në përputhje me termat e kontratës, të lidhur sipas aktit me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 “<i>Qiraja financiare (Leasing)</i>”.</p>
2.2 Rekomandimi:	<p>Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren të gjitha masat e nevojshme për llogaritjen e vlerës së plotë të shumës së shkaktuar për shkak të dorëzimit të mjeteve jo në përputhje me</p>

⁸ Deri në nxjerrjen e përgjegjësive.

	<p>kushtet e kontratës. Kjo përlllogaritje të kryhet në bazë të kostos shtesë që i është shkaktuar buxhetit të AK Posta Shqiptare për sasinë e konsumuar të karburantit me norma mbi ato të paraqitura në katalogët përkatës të mjeteve të ofruara. Në përfundim të kësaj, vlera e përlllogaritur të kërkohet në rrugë ligjore për tu arkëtuar ndaj personave të gjetur me përgjegjësi përmes ndjekjes së të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe të gjitha shkallëve të gjyqimit.</p>
--	--

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. Sh. K. Drejtori i Filialit Tiranë, z. F. H., përgjegjës i Sektorit të Sigurisë dhe Cilësisë dhe ish-drejtor i Drejtorisë të Shërbimeve Mbështetëse në Filialin Tiranë, z. A. Ç. në cilësinë e specialistit në Sektorin e Sigurisë dhe Cilësisë dhe cilësinë e punonjësit të autorizuar.

Në lidhje me blerjet e vogla

Shoqëria Posta Shqiptare SHA është organizuar nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe 16 filialeve të saj, të cilat funksionojnë si njësi shpenzuese të pavarura.

3. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të hartimit i regjistrave të parashikimit të prokurimeve.
Situata:	<p>Drejtorja e Përgjithshme Posta Shqiptare SHA në momentin e hartimit të regjistrave të parashikimit, nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratës, të cilat kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Në 10 raste, gjatë hartimit të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve në vlerë të vogël, është evidentuar shmangie nga procedurat përkatëse të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo të kontratave si më poshtë:</p> <p><u>Drejtorja e Përgjithshme</u></p> <ul style="list-style-type: none"> -Procedura e prokurimit me objekt “<i>Blerje materiale anti-covid 2019</i>” me numrin e referencës REF-87799-02-22-2021 dhe fond limit në vlerën prej 788,000 lekë pa TVSH, nga ku fitues është shpallur M... V..... me vlerën prej 778,900 lekë pa TVSH. -Procedura e prokurimit me objekt “<i>Blerje produkte higjieno-sanitare</i>” me numrin e referencës REF-87793-02-22-2021 dhe fond limit në vlerën prej 792,666 lekë pa TVSH, nga ku fitues është shpallur M... V..... me vlerën prej 779,900 lekë pa TVSH. <p>Procedurat e prokurimit të sipërcituara rezultojnë në të njëjtin llogari shpenzimesh dhe me të njëjtin funksion kryesor parandalimin e përhapjes të infeksioneve nga bakteret dhe viruset.</p> <p>Sa më sipër, vlera totale e tyre është 1,558,800 lekë, nga ku kanë tejkaluar pragun procedurës së prokurimit në vlerën prej 758,800 lekë.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Procedura e prokurimit me objekt “<i>Sigurimi i fondit të përdoruesve për shërbimin e pagesave</i>”, me fondin limit 543,000 pa TVSH, e realizuar në datën 13.10.2022 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 520,000 lekë pa TVSH. -Blerje nën vlerën 100,000 lekë “<i>Siguracioni TPL për mjetet motorike</i>”, me fondin limit 100,000 pa TVSH, e realizuar me vlerën prej 19,700 lekë pa TVSH me shoqërinë I.....A. -Procedura e prokurimit me objekt “<i>Sigurim kontrate për magazinë doganore</i>”, fondi limit 1,000,000 pa TVSH, e realizuar në datën 23.02.2022 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 970,000 lekë pa

	<p>TVSH. Sa më sipër, përbëjnë grupe mallrash të ngjashëm në të njëjtën llogari shpenzimesh dhe si produkte sigurimi me të njëjtin funksion dhe qëllim kryesor blerjen e përgjegjësive tek shoqëritë e sigurimeve. Procedurat e sipërcituara së bashku, rezultojnë në vlerën totale prej 1,539,700 lekë, nga ku tejkalohej pragu në vlerën 539,700 lekë lekë.</p> <p><u>Filiali Tiranë</u></p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Siguracioni i aktiveve të qëndrueshme (ndërtesës)</i>”, fondi limit 800,000 pa TVSH, e realizuar në datën 09.04.2021 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 796,400 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Siguracioni TPL për mjetet motorike</i>”, fondi limit 300,000 pa TVSH, e realizuar në datën 26.04.2021 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 298,500 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura nën vlerën 100,000 lekë me objekt “<i>Siguracioni TPL për mjetet motorike</i>”, fondi limit 100,000 pa TVSH, e realizuar në datën 09.07.2021 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 99,996 lekë pa TVSH.</p> <p>Sa më sipër, të tre procedurat përbëjnë grupe mallrash të ngjashëm në të njëjtën llogari shpenzimesh si dhe produkte sigurimi me të njëjtin funksion dhe qëllim kryesor, pra blerjen e përgjegjësive tek shoqëritë e sigurimeve. Vlera totale e tyre është 1,194,896 lekë, pra tejkalojnë pragu e procedurës së prokurimit në vlerën me 394,896 lekë lekë.</p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Siguracioni i aktiveve të qëndrueshme (ndërtesës)</i>” me numrin e referencës REF-21657--03-10-2022 me fond limit në vlerën 800,000 lekë pa TVSH, dhe fitues A.....A me vlerën prej 796,950 lekë pa TVSH.</p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “<i>Siguracioni TPL për mjetet motorike</i>” me numrin e referencës REF-26141-04-22-2022 me fond limit në vlerën prej 400,000 lekë pa TVSH dhe fitues A.....A me vlerën prej 398,000 lekë pa TVSH.</p> <p>Dy procedurat e mësipërme së bashku rezultojnë në vlerën totale prej 1,194,950 lekë, nga ku tejkalojnë pragu e procedurës së prokurimit në vlerën prej 194,950 lekë.</p> <p>Sa më sipër trajtuam, bie në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit nr. 03, datë 08.01.2018 të APP, me pikën 3 të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021 të APP, gjithashtu në kundërshtim me nenin 56, pika 2 dhe 11, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “<i>Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik</i>”.</p> <p>Parregullsitë, sa më sipër, kanë sjellë për pasojë shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo kontratave.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “<i>Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik</i>”, neni 56 pika 2, <u>ku përcaktohet se:</u> “<i>Autoriteti Kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Në asnjë rast, Autoriteti Kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit.</i>”</p>

	<p>-Pika nr. 3 dhe nr. 4 e Udhëzimit nr. 03, datë 08.01.2018 të APP si dhe pika nr. 3 e Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021 të APP <u>ku përcaktohet se</u>: “3. Kjo procedurë do të përdoret për blerjen e një grup mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve.</p> <p>4. Autoriteti Kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërave të punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë dhe i përfshin ato në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik. Autoriteti Kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë njëherësh të gjithë sasinë e mallrave, shërbimeve, apo punëve ..Autoriteti Kontraktor mund të realizojë disa procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik, në varësi të nevojave dhe mundësive të tij, por vlera e përlogaritur në total e këtyre procedurave, për të njëjtin mall, punë, shërbim apo grup mallrash, shërbimesh/punësh, nuk duhet të jetë më e madhe se pragu.”</p>
Ndikimi:	Copëzimi fondeve apo ndarja e kontratave dhe kufizimi i procedurave konkurruese të prokurimit.
Shkaku:	Mungesa e zbatimit të kuadrit përkatës ligjor dhe rregullator.
Rëndësia:	E lartë.
3.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masat e nevojshme, që në hartimin e regjistrin të parashikimeve të prokurimeve në vlerë të vogël, të krijohen linja të qarta bashkëpunimi, raportimi dhe përgjegjësi dhe vendimmarrje të përcaktuara për parandalimin e copëzimit të fondeve publike, kjo njëkohësisht me qëllim edhe shmangien e kufizimit të procedurave konkurruese të prokurimit.

4. Titulli i gjetjes:	Mangësi në drejtim të procesit të vlerësimit të ofertave gjatë prokurimeve me vlerë të vogël.
Situata:	<p>Operatori ekonomik fitues rezulton me ofertë me vlerë më të ulët nga oferta e paraqitur gjatë verifikimit në treg për vlerësimin e fondit limit. Ofertat e mësipërme janë dhënë për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, si më poshtë:</p> <p>-Procedura e prokurimit me objekt “Blerje produkte higjieno-sanitare” me numrin e referencës REF-87793-02-22-2021, është kryer me Urdhrin e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme me nr. 03 datë 19.02.2021. Fondi limit i kësaj procedure është përcaktuar nga tregu në vlerën prej 792,666 lekë pa TVSH. Në procesverbalin datë 18.02.2021 të komisionit të prokurimeve të vogla për llogaritjen e fondit limit është administruar oferta e OE M.... V..... në vlerën prej 785,000 lekë, si një nga ofertat e marra gjatë studimit të tregut. Në të njëjtën kohë, oferta e operatorit ekonomik M.... V..... në sistemin elektronik të prokurimit është konstatuar e ndryshuar dhe në një vlerë më të ulët prej 779,900 lekë, e cila është shpallur operator fitues.</p> <p>Në rastin e konsultimit verbal, grupi i ngritur për këtë qëllim, duhet të hartojë një procesverbal me të dhëna, që mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës (praktikisht ofertat nga fituesi janë dhënë në të njëjtën kohë). Pranimi nga ana e komisionit të</p>

	prokurimeve në vlerë të vogël, të ofertës të operatorit fitues M.... V..... në SPE, ka sjellë deformimin e procesit të krahasimit të kësaj oferte me fondin limit për arsye se ka ndryshuar baza krahasuese (ekzistenca e dy ofertave të ndryshme në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin objekt prokurimi). Sa më sipër, operatori ekonomik fitues është paraqitur me 2 oferta të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi. Pranimi i 2 ofertave të sipërcituara për OE fitues, për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, ka shkaktuar deformimin e vlerësimit dhe të konkurrencës në procesin e prokurimit.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 63 pika 3, i ndryshuar, nga <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, vetëm në përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.”</i> VKM nr. 285, datë 19.05.2021 <i>“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”</i> , neni 13 pika 4, nga <u>ku përcaktohet se:</u> <i>“Për studimin e tregut, Autoriteti Kontraktor mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorë ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit verbal, grupi i ngritur për këtë qëllim, harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto të dhëna mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mos diskriminimit dhe transparencës.”</i>
Ndikimi:	Deformim i procesit të vlerësimit.
Shkaku:	Pranimi i dy ofertave prej OE fitues, për të njëjtën objekt prokurimi dhe në të njëjtën kohë.
Rëndësia:	E lartë.
4.1 Rekomandimi:	Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA, të merren masat e nevojshme për shmangien e deformimit gjatë procedurës së vlerësimit, duke siguruar që procesi i prokurimit në vlerë të vogël të përfshihet në një manual përdorimi, me qëllim identifikimin e përgjegjësive individuale, dokumentacionin përkatës të miratuar për hapat e procesit dhe vendimmarrjen individuale, që duhet të ushtrohen gjatë zbatimit të kësaj procedure të thjeshtuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në vlerë të vogël:

Për Filialin Tiranë: z. F. H., znj. E. Ç., znj. R. B., znj. D. L., z. G. J. dhe për Drejtorinë e Përgjithshme: znj. I. Sh., z. D. G. dhe z. R. G.

5. Titulli i gjetjes:	Shpenzime për udhëtime e dieta për jashtë shtetit të kryera pa dokumentacion të plotë justifikues.
Situata:	Referuar urdhrin nr. 194 datë 17.07.2019 për udhëtimet e disa punonjësve të Posta Shqiptare SHA jashtë shtetit, nga zyra e financës klasifikimi i shpenzimeve të paradhënies është kryer njëloj për çdo pozicion pune. Ky urdhër nuk është argumentuar sipas VKM nr. 870, datë 14.12.2011 <i>“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”</i> referuar dokumentacionit të sjellë me observacionin nr. 909/59 prot., datë 06.10.2023, sepse klasifikimi i kryer për çdo person udhëtues është i njëjti për çdo pozicion pune, duke nisur nga pozicioni i administratorit, drejtori drejtorisë, kryetar dege

	dhe këshilltar. Si rrjedhojë në VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, nuk përcaktohet që paradhënia për klasifikimet e pozicioneve të mësipërme të jetë e njëjtë. Për këtë arsye nuk justifikohen shpenzimet e udhëtimit referuar urdhrave të paradhënies.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe Udhëzimi nr. 22 datë 10.07.2013 i Ministrisë së Financave.
Ndikimi:	Shpenzime për udhëtim e dieta për jashtë shtetit të kryera pa dokumentacion të plotë justifikues, që kanë sjellë efekt financiar negativ shoqërisë në vlerën 6,434 euro .
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore dhe nënligjore, në praktikat e udhëtimeve jashtë vendit.
Rëndësia:	E lartë.
5.1 Rekomandimi:	Nga administratori i Posta Shqiptare SHA dhe zyra e financës të analizohet vlera e efektit financiar negativ prej 6,434 euro dhe të merren masa për korrigjimin e praktikave të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë shtetit, pa dokumentacion justifikues.

6. Titulli i gjetjes:	Shpenzime udhëtim e dieta për jashtë shtetit të kryera pa dokumentacion të plotë justifikues.
Situata:	Referuar urdhrin nr. 199 datë 07.08.2019 për udhëtimet e disa punonjësve të Posta Shqiptare SHA jashtë shtetit, nga zyra e financës klasifikimi i shpenzimeve të paradhënies është kryer njëllë për çdo pozicion pune. Ky urdhër nuk është argumentuar sipas VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” referuar dokumentacionit të sjellë me observacionin nr. 909/59 prot., datë 06.10.2023, sepse klasifikimi i kryer për çdo person udhëtues është i njëjti për çdo pozicion pune, duke nisur nga pozicioni i administratorit, drejtori drejtorisë, kryetar dege dhe këshilltar. Si rrjedhojë në VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, nuk përcaktohet që paradhënia për klasifikimet e pozicioneve të mësipërme të jetë e njëjtë. Për këtë arsye nuk justifikohen shpenzimet e udhëtimit referuar urdhrave të paradhënies.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe Udhëzimi nr. 22 datë 10.07.2013 i Ministrisë së Financave.
Ndikimi:	Shpenzime për udhëtim e dieta për jashtë shtetit të kryera pa dokumentacion të plotë justifikues, që kanë sjellë efekt financiar negativ shoqërisë në vlerën 3,145 euro .
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore dhe nënligjore, në praktikat e udhëtimeve jashtë vendit.
Rëndësia:	E lartë.
6.1 Rekomandimi:	Nga administratori dhe zyra e financës të shoqërisë Posta Shqiptare SHA të analizohet vlera e efektit financiar negativ prej 3,145 euro dhe të merren masa për korrigjimin e praktikave të shpenzimeve të

	udhëtimeve jashtë shtetit, pa dokumentacion justifikues.
7. Titulli i gjetjes:	Mungesë dokumentacioni në procedurën e prokurimit për blerje të vogla.
Situata:	Me urdhrin nr. 81, 2112 prot., datës 15.10.2020 ish administratori z. L. D. ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “ <i>Blerje dhe riparim pajisjesh për mobilim dhe arredimin e zyrave</i> ”. Pavarësisht procedurës së kryer, janë konstatuar problematikat e mëposhtme: Për realizimin e kësaj procedure prokurimi mungon kërkesa nga ana e drejtorisë përkatëse, nga ku të lindte nevoja për kryerjen e kësaj procedure. Së dyti, në rastin e s’kualifikimit të OE N..... H..... i renditur i gjashti në klasifikimin përfundimtar nuk është mbajtur protokoll zyrtar që të shpjegojë arsyet e s’kualifikimit, por e vetmja gjurmë gjendet në sistemin elektronik të APP.
Kriteri:	VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “ <i>Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</i> ” neni 56, pika 6.
Ndikimi:	Kryerje e procedurave të prokurimit për blerje të vogla jo në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator të Prokurimit Publik.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore dhe nënligjore në procedurë e prokurimit me vlerë të vogël.
Rëndësia:	E lartë.
7.1 Rekomandimi:	Nga administratori dhe zyra e financës të shoqërisë Posta Shqiptare SHA, të merren masa për korrigjimin e praktikave të prokurimeve me vlerë të vogël dhe zbatimi i tyre në përpikmëri sipas ligjit.

2.7 Mbajtja e evidencës kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë dhe hartimi i pasqyrave financiare.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, konkretisht Pasqyrave të pozicionit financiar, Pasqyrave të performancës financiare, Pasqyrave të flukseve monetare (Cashflow), Pasqyrave të Ndryshimeve në Aktivitet Neto/Fondet Neto. Me anë të Vendimit nr. 12 datë 01.03.2021 Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019. Humbja e vitit ushtrimor paraqitet -188,035,448 lekë. Me anë të Vendimit nr. 17 datë 18.03.2021 Asambleja e Përgjithshme ka miratuar pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e rezultatit të Shoqërisë Posta Shqiptare. Me anë të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2019. Humbja e vitit ushtrimor paraqitet -72,407,311 lekë. Me anë të Vendimit nr. 26 datë 19.01.2022 Asambleja e Përgjithshme ka miratuar pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e rezultatit të Shoqërisë Posta Shqiptare. Me anë të Vendimit nr. 03 datë 09.02.2023 Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2022. Humbja e vitit ushtrimor paraqitet -46,753,303 lekë. Me anë të Vendimit nr. 22 datë 30.03.2023 Asambleja e Përgjithshme ka miratuar pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e rezultatit të Shoqërisë Posta Shqiptare. Shoqëria ka kontraktuar auditues ligjor të pavarur për auditimin e pasqyrave financiare ndër vite. Duke marrë në konsideratë punën audituese të audituesve ligjorë, grupi i auditimit është fokusuar kryesisht në gjenerimin e raporteve dhe analizimin e disa nga zërave që grupi i auditimit ngre dyshimet mbi anomalitë që mund të hasen. Më poshtë paraqiten të përmbledhura në një tabelë pasqyrat e pozicionit financiar, në mënyrë krahasuese:

AKTIVET	Shënime shpjeguese	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Aktive afatgjate					
Aktive të qendrueshme të truazuara	5	3,588,162,196	3,610,430,054	3,409,893,744	3,020,841,915
Aktive të qendrueshme të patruazuara	6	87,508,444	142,229,402	96,987,965	108,736,894
Aktive të qendrueshme financiare	7	450,000,000	450,000,000	450,000,000	450,000,000
Totali i aktiveve afatgjate		4,125,670,640	4,202,659,456	3,956,881,709	3,579,578,809
Aktive afatshkurtra					
Gjendje inventari dhe në proces	8	223,282,214	288,209,384	250,394,191	239,935,033
Kerkesa për arketim nga debitorët	9	1,409,295,658	1,241,107,407	1,132,327,879	1,045,487,141
Personeli dhe persona	10	295,754,900	143,490,272	105,577,945	-
Kerkesa të tjera të arketueshme	10	25,445,120	261,695,405	145,213,870	381,630,095
Avance	11	2,836,913,958	30,849,572	45,100,270	13,344,106
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12	27,006,638	3,082,853,322	2,775,513,363	2,658,808,944
Totali i aktiveve afatshkurtra		4,817,698,488	5,048,205,361	4,454,127,516	4,339,205,319
TOTALI I AKTIVEVE		8,943,369,128	9,250,864,817	8,411,009,225	7,918,784,128
DETYRIMET DHE KAPITALI					
Kapitali dhe Rezervat					
Kapitali i nenshkuar	13	3,161,828,000	3,161,828,000	3,161,828,000	3,006,363,000
Rezerva ligjore		120,809,791	120,809,791	120,809,791	120,809,791
Rezerva rivleresimi		1,678,148,121	1,608,822,031	1,658,256,020	1,715,249,484
Rezerva të tjera		127,436	127,436	126,507	126,507
Fitime/(humbje) të mbartura	14	62,582,925	49,983,419	48,444,613	343,501,377
Fitime dhe humbje të ushtrimit		(1,555,285)	(46,753,303)	(72,407,311)	(188,035,448)
Totali i kapitalit		4,901,003,761	4,894,817,373	4,917,057,619	4,998,014,711
Detyrime afatgjate					
Hua afatgjate		-	-		
Grante e të ardhura të shtyra	19	53,386,694	52,649,118	5,867,145	7,176,717
Te ardhura të periudhave të ardhshme	19	-	65,938,922		
Totali i detyrimeve afatgjate		53,386,694	118,588,039	5,867,145	7,176,717
Detyrime afatshkurtra					
Tatim I shtyre	17	216,289,929	224,031,601	248,544,657	239,995,576
Furnitore për shërbime	15	623,950,180	366,365,759	802,293,287	1,093,830,707
Te tjera të pagueshme	16	3,075,397,408	3,603,323,039	2,391,680,905	1,540,062,087
Personeli	18	19,570,962	3,355,718	4,049,418	2,718,248
Shteti tatim taksa	17	45,500,035	40,383,285	41,516,194	36,986,082
Totali i detyrimeve afatshkurtra		3,988,978,673	4,013,427,801	3,239,539,804	2,673,597,124
Detyrime totale		4,042,365,367	4,356,047,441	8,411,009,226	7,918,784,128
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		8,943,369,128	9,250,864,815	8,411,009,226	

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike, përveç aktiveve afatgjate materiale të cilat maten me vlerën e rivlerësuar. Në përgatitjen e pasqyrave financiare drejtimi ka ushtruar gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave

kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë prej këtyre vlerësimeve. Posta Shqiptare SHA ka bashkëpunuar me vlerësues të pavarur për të përcaktuar matje të vlerës së drejtë. Drejtimi vlerëson evidencën e marrë nga palët e treta për të mbështetur përfundimin se këto vlerësime përputhen me kërkesat e SNRF, duke përfshirë edhe nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë, në të cilin vlerësime të tilla duhen klasifikuar. Humbjet e pritshme të kreditit maten si një provizion i barabartë me humbjen e pritshme 12-mujore për instrumentet e fazës 1, ose humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetës për instrumente të fazës 2 ose 3. Një instrument financiar lëviz në fazën 2 kur risku i tij i kreditit është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Për të vlerësuar nëse risku i kreditit të një instrumenti është rritur ndjeshëm apo jo, Shoqëria merr parasysh informacion cilësor dhe sasior të arsyeshem dhe të parashikuar. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos të amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me kosto historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni. Nga analizimi i dokumentacioni të kërkuar më sipër si dhe nga analizimi i raporteve të auditimit nga auditues të pavarur, të kontraktuar nga shoqëria, grupi i auditimit konstatoi se në analizimin e llogarisë Aktive Afatshkurtra, në nën-llogarinë “Kërkesa për arkëtim nga debitorët” shohim një tendencë rritje krahasuar nga viti 2019 në vitin 2022. E njëjta gjë është dhe për zërin “Kërkesa të tjera të arkëtueshme”. Risku i likuiditetit përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Posta Shqiptare është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer furnitorët. Nga ana tjetër, shoqëria përballet me vonesa të konsiderueshme në arkëtimet e klientëve. Në llogarinë Detyrime afatshkurtra dhe nën-llogarinë “Furnitorë për shërbime” nga viti 2019 deri në vitin 2021 ka tendencë rënie dhe në vitin 2022 ka tendencë rritje. (duke marrë në konsideratë që Pasqyrat Financiare për vitin 2022 nuk janë të miratuara). Në llogarinë Detyrime afatshkurtra dhe nën-llogarinë “të tjera të pagueshme” nga viti 2019 – 2022 ka tendencë rritje duke u rritur detyrimet.

1. Titulli i gjetjes:	Tendencë rritje e riskut mbi likuiditetin.
Situata:	Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re një rritje në riskun mbi likuiditetit që përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare si dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Posta Shqiptare është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer llogaritë e pagueshme.
Kriteri:	-
Ndikimi:	Risk mbi mbulimin e shpenzimeve të vetë subjektit dhe krijimin e borxhit të keq.
Shkaku:	Nuk janë marrë masat e duhura për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA të marrë të gjitha masat mbi arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, në rast të vonesave mbi arkëtimin e tyre të marrë masat

	<p>mbi vendosjen e kamatëvonesave duke iu përmbajtur kushteve të kontratave si dhe në mos realizimin e arkëtimit të tyre ti kalojë në borxh të keq. Gjithashtu Posta Shqiptare SHA të bëjë të mundur shlyerjen e llogarive të pagueshme duke shmangur penaltitetet e mundshme në të ardhmen.</p>
--	--

2.8 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

1. Titulli i gjetjes:	Posta Shqiptare sha nuk ka zbatuar rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH.
Situata:	<p>Me shkresën nr. 3003 Prot, datë 14.11.2019 është lëshuar nga Administratori i Posta Shqiptare SHA z. L. D., Urdhri nr. 332 i datës 14.11.2019 “Mbi raportin përfundimtar dhe rekomandimeve për auditimin e Posta Shqiptare SHA nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Me shkresën nr. 3003/1 prot., datë 14.11.2019 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është vënë në dijeni Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthim përgjigje ndaj KLSH, konstatohet se nga ana e Posta Shqiptare SHA është respektuar afati me dërgimin e shkresës nr. 1519/67 datë 26.09.2019 në zbatim të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, germa j. Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatojmë se Posta Shqiptare SHA nuk e ka përmbushur këtë detyrim. Me nisjen e shkresës nr. 520 prot., e datës 05.06.2020 KLSH njofton drejtuar Posta Shqiptare SHA për fillimin e auditimit tematik për zbatimin e rekomandimeve. Me shkresën nr. 520/1 prot., e datës 05.06.2020 KLSH nis programin e auditimit tematik për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Me shkresën nr. 520/9 prot., e datës 27.07.2020 KLSH nis projekt raportin e auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve në subjektin Posta Shqiptare SHA. Me shkresën nr. 520/42 prot., e datës 04.12.2020 KLSH nis drejt Posta Shqiptare SHA rekomandime dhe pjesë nga raporti përfundimtar. Me shkresën nr. 2689 prot., datë 28.12.2020 është lëshuar Urdhri i Brendshëm nr. 105 nga Administratori i Posta Shqiptare SHA për marrjen e masave mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Posta Shqiptare sha nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Janë rekomanduar <u>32</u> masa organizative, nga të cilat janë zbatuar <u>11</u> masa, janë në proces realizimi <u>12</u> masa dhe <u>9</u> masa nuk janë zbatuar. -Janë rekomanduar <u>7</u> masa për shpërblim dëmi, në vlerën 7,105,904 lekë, nga të cilat <u>0</u> masa janë zbatuar, janë në proces zbatimi <u>6</u> masa dhe <u>1</u> masë nuk është zbatuar, -Janë rekomanduar <u>6</u> masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit, nga të cilat <u>2</u> masa nuk janë pranuar, <u>1</u> masë është zbatuar, është në proces realizimi <u>1</u> masë dhe <u>2</u> masa nuk janë zbatuar.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, nenet 15 germa “j” 30, pika 2.
Ndikimi:	Në arritjen e objektivave dhe politikave të shoqërisë Posta Shqiptare SHA.
Shkaku:	Posta Shqiptare SHA nuk ka vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.
Rëndësia:	E lartë.
1.1 Rekomandimi:	Posta Shqiptare SHA, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Auditin e Brendshëm rezulton se për periudhën objekt auditimi, konkretisht në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 nuk janë realizuar plotësisht auditimet e parashikuara në planet vjetore të miratuara nga ana e Titullarëve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 6, pika a.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 30 – 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, të marrë masa për të përmbushur planet e auditimeve në subjektet e parashikuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin rezulton se Posta Shqiptare SHA nuk ka të miratuar planin për zhvillimin e strategjisë të cilën Titullari i njësisë publike miraton dhe monitoron. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 mbi “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit” dhe neni 21 “Menaxhimi i riskut”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 30 – 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Administratorit të Shoqërisë të merren masa për të ngritur një plan për zhvillimin e strategjisë, duke zbatuar kërkesat e parashikuara nga ligji si dhe duke kryer procedurat hap pas hapi konform kuadrit përkatës ligjor e rregullator.

Menjëherë

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin rezulton se Posta Shqiptare SHA nuk ka zhvilluar dhe rifreskuar në portalin e saj informacionin e rrjetit postar për vendndodhjen e zyrave postare. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Neni 3 “E drejta e informimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqet nr. 30– 33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoritë përkatëse të marrin masa për azhurnimin e faqes web në lidhje me vendndodhjet e pikave postare të vendosura në zona të ndryshme.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Programet ekonomiko-financiare rezulton se:

a. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar plane afat mesme apo afat gjatë të zhvillimit strategjik të saj;

b. Shoqëria Posta Shqiptare nuk ka hartuar dhe miratuar plan biznesin afatmesëm të shoqërisë.

Si rezultat i mungesës së dokumenteve dhe planeve strategjike shoqëria Posta Shqiptare nuk ka përcaktuar objektiva të qarta të zhvillimit, të cilat do të shërbenin si objektiva të matshme për vlerësimin e performancës së drejtimit të shoqërisë dhe në përmirësimin e performancës së shoqërisë. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 15 datë 02.05.2018 “Mbi Programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” të Ministrit të Financës dhe Ekonomisë si dhe Statutin e Postës Shqiptare, të ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 34 – 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të filloj hartimin dhe miratimin e planit të biznesit dhe dokumentet e tjerë strategjik të zhvillimit ekonomik afat mesëm dhe afat gjatë të shoqërisë.

Menjëherë

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi mbi Hartimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar si dhe miratimi tyre në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet e prore, rezulton se niveli i realizimit të investimeve të vitit 2019 është i ulët dhe zë 36% kundrejt programit, megjithëse investimet janë dyfishuar në vitin 2019 kundrejt vitit 2018, shkalla e realizimit të tyre ngelet e ulët pasi dhe në vitin 2018 shoqëria ka realizuar 45% të vlerës së investimit të programuara. Nga auditimi rezulton se, përtej parashikimeve optimiste të menaxhimit të lartë të shoqërisë, për të patur një fitim neto 6.6 milion lekë, si rezultat i rritjes së shpenzimeve, rënies të disa kategorive të të ardhurave dhe mungesa e një menaxhimi efektiv dhe planifikimi të mirë nga ana e drejtuesve të shoqërisë Posta Shqiptare, kanë sjellë që shoqëria në fund të vitit 2019 të rezultojë me humbje në vlerën 188,035,447.6 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 34 – 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësi për realizimin e ulët të të ardhurave ndër vite dhe të bëjë kujdes në vijimësi në lidhje me miratimin e shpenzimeve, për të mundësuar një mbulim të shpenzimeve nga të ardhurat, që shoqëria në fund të vitit ushtrimor të rezultojë me fitim.

Menjëherë

6. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave rezulton se:

- Për praktikën e qiramarrjes mes Posta Shqiptare Filiali Tiranë dhe znj. E. A., mungonte certifikata e pronësisë për kontratën e lidhur me UKT dhe as me OSHEE, në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 39/1 datë 23.09.2019.

- Për praktikën e qiramarrjes mes Posta Shqiptare Filiali Sarandë dhe znj. S. M. dhe z. M. M., mungon kontrata e lidhur me UK Sarandë dhe OSHEE, në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 185 prot datë 14.02.2019.

- Për praktikën e qiramarrjes mes Posta Shqiptare Filiali Durrës dhe z. V. M., mungon certifikata e pronësisë për ambientin e marrë me qira nga Posta Shqiptare SHA, në kundërshtim me kriteret e vendosura sipas Urdhrit të brendshëm nr. 7 datë 17.05.2021. Gjithashtu është konstatuar se Drejtoresha për Postën Shqiptare Filiali Durrës znj. E. B. ka pranuar kërkesën e z. V. M. për rritjen e pagesës së qirasë nga 20,000 lekë në 29,500 lekë pa kryer përsëri procedurën ligjore për marrjen e ambientit me qira, veprime këto në kundërshtim me nenin 821 i Kodit Civil i cili përcakton saktë se *Përsëritja e kontratës së qirasë rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmeja* si dhe me vet Urdhrin e Titullari nr. 7 prot., datë 17.05.2021;

- Disa zyra postare të marra me qira në Tiranë kanë distanca të afërta me njëra tjetrën. duke sjellë tejkalim të nevojave të qytetarëve në këto zona për të përdorur shërbimet e postës. Këto zyra postare që janë marrë me qira nga Posta Shqiptare rezultojnë të kenë një bilanc negativ në kundërshtim me nenin 8, pika 1 dhe neni 12 pika 3, germa a e ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

- Në të gjitha kontratat e qirave rezulton se sipërfaqja e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të zyrave postare, nuk është përllëguar duke pasur në konsideratë numrin e punonjësve të zyrave, në kundërshtim me neni 8, pika 1 dhe neni 12 pika 3, germa a e ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* si dhe germa a, pika 2 për mjedisin, Shtojca e VKM nr. 521, datë 06.08.2014 *“Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës”*. Gjithashtu

rezulton se nuk janë kërkuar kriteret e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës në kundërshtim me VKM nr. 564, datë 3.7.2013 “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës” si dhe me nenin 37 të i ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

- Nga Posta Shqiptare nuk janë ngritur grupe pune për marrjen në dorëzim të ambienteve të mara me qira sipas kontratat në përputhje me kërkesat e Postës Shqiptare ndaj objekteve. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe me VKM nr. 564, datë 3.7.2013 “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”.

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me kontratat e qirave rezulton se Posta Shqiptare nuk ka përdorur ligjin e posaçëm për dhënien me qira të objekteve. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqet nr. 34 – 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për kualifikimin e ofertuesve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim gëzimin e qetë të periudhës së qirasë dhe përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

6.2 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për plotësimin e dosjes së ofertuesve E. A., znj. S. M. dhe z. M. M. dhe z. V. M. me dokumentacionin e nevojshëm sipas parashikimeve të kuadrit ligjor e rregullator. Në rast të mosplotësimin, nga ana e Posta Shqiptare SHA të bëhet ndërprerja e kontratës së qirasë.

Menjëherë

6.3 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masat për të përdorur ligjin e posaçëm për dhënien me qira të objekteve të pasurisë shtetërore.

Në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara, konkretisht referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton:

- Në 1 rast, në procedurat me objekt *Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër* BOE nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimit e stafit mesatar për periudhën janar – nëntor 2019 sipër përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit me nr. 92 rep., 23 kol., datë 17.01.2020. Përveç sa më sipër rezulton se nga ana e BOE nuk janë dorëzuar analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar.

- Në procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”* viti 2019 rezulton se nga mjetet e ofertuara nga ana e OE M...N M...S, ai i modelit Furgonçinë është i markës FIAT modeli Fiat Doblo dhe të dhënat e këtij mjeti, çmimi njësi i të cilit ka shërbyer si referencë për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019. Në mënyrë të ngjashme rezulton se edhe për mjetet e ofruara nga ana e dy OE të tjerë A...N M...R C...Y dhe A...O S...A, çmimet njësi të të cilëve kanë shërbyer si referencë për përlllogaritjen e vlerës së fondit

limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019.

Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, pika 3 dhe 5 germa c, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 59, pika 2, neni 66 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 2, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave ‘Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit’”, pika 10 dhe pika 11 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë aksionare Posta Shqiptare të merren masa për të kualifikuar operatorët të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura në DST.

Gjithashtu në përlllogaritjen e fondit limit të kihen parasysh ofertat e marra për mallra/shërbime/punime sipas atyre të kërkuara nga AK me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve dhe transparencës në drejtim të planifikimit të vlerës së investimeve.

Në vijimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e prokurimit të zhvilluara, konkretisht referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ana e OE fitues rezulton, në 1 rast, në procedurat me objekt *Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër* BOE nuk plotëson kriterin në lidhje me disponimit e stafit mesatar për periudhën janar – nëntor 2019 sipër përqindjes së marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit me nr. 92 rep., 23 kol., datë 17.01.2020. Konkretisht sipas kësaj marrëveshjeje punimet janë ndarë në raportin 69.38 % OE A... dhe 30.62 % OE B.... Nisur nga fakti që numri total i punonjësve të kërkuar është 90, atëherë nga ana e këtyre dy OE duhet të ishin sjellë respektivisht dëshmi për disponimin e respektivisht 63 dhe 27 të punësuar. Në fakt nga ana e OE A... janë paraqitur listë pagesat mujore janar 2019 – nëntor 2019 me një numër mesatar prej 61 të punësuarish. Gjithashtu, nga ana e OE B..., edhe pse janë marrë përsipër 30.62 %, nuk janë sjellë dëshmi për disponimin e një inxhinieri elektrik si dhe një arkitekti si pjesë e licencës së shoqërisë. Përveç sa më sipër rezulton se nga ana e BOE nuk janë dorëzuar analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, neni 53, “Shqyrtimi i Ofertave”, pika 3 dhe 5 germa c, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, neni 66 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 2, VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave ‘Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit’”, pika 10 dhe pika 11 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga ana e shoqërisë aksionare Posta Shqiptare të merren masa për kualifikimin e operatorëve të cilët përmbushin plotësisht dhe saktësisht kriteret e vendosura me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve.

Në vijimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”* viti 2019 rezulton se nga mjetet e ofertuara nga ana e OE M....N M....S, ai i modelit Furgonçinë është i markës FIAT modeli Fiat Doblo dhe të dhënat e këtij mjeti, çmimi njësi i të cilit ka shërbyer si referencë për përlogaritjen e vlerës së fondit limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019. Konkretisht është kërkuar që konsumi i kombinuar është kërkuar të jetë 4.5 l/100 km në një kohë që mjeti Fiat Doblo ka një konsum prej 5.5 l/100 km, mjeti nuk dëshmon për disponimin e opsionit Hill Assist, komanda në timon, sistem start – stop, fuqia motorike është nën nivelin e kërkuar, etj. Në mënyrë të ngjashme rezulton se edhe për mjetet e ofruara nga ana e dy OE të tjerë A....N M....R C....Y dhe A....O S....A, çmimet njësi të të cilëve kanë shërbyer si referencë për përlogaritjen e vlerës së fondit limit nuk janë sipas kërkesave të bëra nga Grupi i Punës sipas aktit nr. 381/1 prot., datë 20.02.2019. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, neni 1 *“Objekti dhe qëllimi”*, pika 2, germa *b* dhe *dh*, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’*, neni 59, pika 2 si dhe me Rregulloren e Përgjithshme të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga ana e grupeve të ngritura për përlogaritjen e fondit limit të ezaurohen të gjitha hapat e duhur e të nevojshëm me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve publike përmes marrjes së ofertave për mallra/shërbime/punime sipas atyre të kërkuara nga AK me qëllim sigurimin e mirë përdorimit të fondeve dhe transparencës në drejtim të planifikimit të vlerës së investimeve.

Në vijimësi

10. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”* viti 2019 rezulton se specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës i ngritur sipas shkresës nr. 381 prot., datë 08.02.2019 me përbërje të grupit z. G. P., z. B. Sh. dhe znj. E. S. janë të paargumentuara teknikisht dhe ligjërish. Në lidhje me këto specifikime, përveç sa më sipër, nuk argumentohet domosdoshmëria e përdorimit të sistemit GPS i cili, sipas citimit të Grupit të Punës është parashikuar të përdoret vetëm për Motoçikletat dhe Furgoncinat dhe jo për Autoveturën. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, neni 1 *“Objekti dhe qëllimi”*, pika 2, neni 2 *“Parimet e përzgjedhjes”*, neni 20 *“Mosdiskriminimi”*, neni 23 *“Specifikimet teknike”*, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’*, neni 28 *“Kontratat e Shërbimeve”*, si dhe me Rregulloren e Brendshme të Punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kritereve të argumentuara teknikisht dhe ligjërish si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

11. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurat e zbatimit të kontratave me objekte si më poshtë rezulton se:

1. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti I: Rikonstruksion i Zyrave Postare të Filialeve Gjirokastër, Sarandë:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.....N ... me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria R....N ... me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I.....Y ... me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. I. S.. Në fakt, referuar dokumentacionit të kontratës së dhurimit të kuotave me nr. 1828 rep. 754 kol., datë 25.09.2020 ndodhur në QKB, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R....N

Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.

2. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.....N ... me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria R....N ... me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I.....Y ... me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. I. S.. Në fakt, referuar dokumentacionit të kontratës së dhurimit të kuotave me nr. 1828 rep. 754 kol., datë 25.09.2020 ndodhur në QKB, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R....N Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.

3. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.....N ... me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria A.....N me përfaqësues ligjor znj. A. N.;

Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I.....Y ... me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. A. N.. Në fakt, sipas dokumentacionit të sipërcituar, rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara person me lidhje me hartuesin e projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, konkretisht shoqërinë R....N Pra, në këtë rast shërbimi i kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit.

4. Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër:

Projekti i zbatimit është hartuar nga ana e shoqërisë R.....N ... me përfaqësuese ligjore znj. R. N.;

Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga shoqëria D.....S me përfaqësues ligjor z. V. T.;

Kolaudimi i punimeve është kryer nga shoqëria I.....Y ... me administrator në momentin e kolaudimit të punimeve znj. R. N..

Sipas dokumentacionit të sipërcituar rezulton se kolaudimi i punimeve është kryer nga e një kompani e cila ka patur si administrator dhe ortak të vetëm në momentin e kolaudimit të punimeve të përfunduara të njëjtin person i cili njëkohësisht ka qenë edhe përfaqësues ligjor i shoqërisë hartuese të projektit R....N ..., konkretisht znj. R. N.. Pra, në këtë rast shërbimi i

kolaudimit është kryer në kushtet e konfliktit të interesit. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 12 sipas të cilit kolaudatori nuk duhet të jetë i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin dhe mbikëqyrjen dhe e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masat e nevojshme për identifikimin dhe shmangien e rasteve të konfliktit të interesit me qëllim sigurimin e shërbimeve efektive nga ana e Kontraktorëve.

Në vijimësi

12. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë”, viti 2020 gjatë implementimin dhe zbatimit të kontratës nga grupi i auditimit u konstatua që një pjesë e konsiderueshme e automjeteve nuk ishin të pajisura me sistemin GPS si dhe automjetet që ishin të pajisura me sistemin GPS, nuk u arrit të merreshin të dhëna për vitet periudhë nën auditim 2019-2022, pasi në sistemin qendror nuk u gjenden rekorde për gjurmimin e automjeteve. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të kriterëve të argumentuara teknikisht dhe ligjërish si dhe në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficientësi dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje palmar profesional, barkod reader me Wireless, lexues barkodesh”, rezulton se në hartimin e kriterëve të veçanta është përfshirë në pikën nr. 2.5 kërkesa sipas të cilës produktet e ofruara duhet të jenë Brand i njohur Ndërkombëtar, veprim ky diskriminues pasi kriteri i plotësisimit të kërkesave të cilësisë dhe origjinalitetit të mallrave nuk qëndron, kjo sepse janë certifikatat ato që i japin këtotribute dhe jo emri. Gjatë analizimit të kësaj procedure, rezulton se komisioni i vlerësimi të ofertave ka s’kualifikuar ofertën me vlerë më të ulët mbështetur në këtë kriter, atë të OE S.....A me vlerë 29,800,000 lekë pa TVSH dhe duke kualifikuar OE S.....A me ofertë ekonomike 32,821,000 lekë pa TVSH, me diferencë **3,021,000 lekë**. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 23 “Specifikimet Teknike” si dhe neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Organet Drejtuese të Posta Shqiptare SHA, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të mirëmbajtjes së pajisjeve hardware, të krijojnë kushte me gjithëpërfshirëse, pasi vendosja e kriterëve të cilët kërkojnë certifikime të prodhuesve pengojnë zhvillimin e një gare dhe konkurrence të drejtë.

Në vijimësi

13.2 Rekomandimi: Organet Drejtuese të Posta Shqiptare SHA, të tregojë kujdes gjatë vlerësimi të ofertave dhe të marrë në konsideratë të gjithë kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nëse janë ose jo në përputhje me dokumentacionin e sjellë nga O.E. pjesëmarrës.

Në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “*Blerje Eterna BI + Data Warehouse + Reporting Services, log management, manaxhim te dokumenteve, statistikë si dhe Mirëmbajtje Eterna BI për 4 vite pas implementimit*”, më datë 22.07.2019, objektivi ka qenë ndërtimi i një magazine të dhënash (Data Warehouse), inteligjencë biznesi (Business Intelligence) dhe administrim logesh (Log Management) që do të shërbejnë si një burim kryesor raportimi dhe analize për punonjësit e Postës Shqiptare SHA si dhe mirëmbajtja e tyre për 4 vite, ku njëkohësisht është zhvilluar dhe procedura me objekt “*Mirëmbajtja e Sistemit Eterna për tre vite*”, më datë 05.05.2020 ku kanë objekt të ngjashëm dhe flitet për të njëjtat zëra mirëmbajtje si më poshtë: ‘Application server’, ‘Database Server’ dhe ‘Data Warehouse Server. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, të kryejnë një analizë të hollësishme të sistemeve të implementuar, duke kryer një kategorizim të serverëve dhe të mirëmbajtjes së tyre, pasi në procedurat e prokurimit të zhvilluara për mirëmbajtjet, objekti dhe specifikimet janë të njëjta.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje pjesë këmbimi për automjetet e tipit Nissan NV300*” rezulton se:

Grupi i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike nuk ka përcaktuar asnjë tregues teknik për mallrat e kërkuar, por thjesht ka pasqyruar listën e materialeve të kërkuar nga Drejtori i filialit qendra Tranzite z. A. Gj. bashkëlidhur relacionit me nr. 190 prot., datë 17.03.2022.

Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike nuk ka parashikuar që:

a. Operatori Ekonomik të paraqiste katalogun origjinal të prodhuesit ose kopje te noterizuar të përkthyer në gjuhën shqipe me të dhënat teknike ku të jenë specifikuar të gjitha specifikimet e pjesëve të këmbimit.

b. Në ditën e hapjes së ofertave Operatori Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesë para komisionit mostra për te gjithë artikujt Pjesë Këmbimi.

c. Kërkesat e paraqitura tek shtojca nr. 5 nuk janë materializuar në kriteret e veçanta si kërkesa të detyrueshme për OE pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi.

d. Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike për të garantuar cilësinë e mallrave të kërkuara duhej të përfshinte kërkesën që gjatë dorëzimit të mallit, ato të shoqëroheshin me certifikata të sigurimit të cilësisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Administratori i shoqërisë të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të hartimit të specifikimeve teknike, pasi në disa raste hartimi i tyre konstatohet jo korrekt.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)*” është konstatuar se, kontraktuesi nuk ka respektuar afatet kohore gjatë dorëzimit të letërës A3 80gr/m², pasi Kontraktuesi ka dorëzuar pranë magazinës së AK Posta Shqiptare mallin pjesë të Kontratës nr. 1637/82 date 22.02.2023, letër Fotokopje A3 80 gr/m² më datë 18.08.2023, pra me 118 dite me vonesë të këtij artikulli duke mos respektuar nenin 10 pika 10.2 të Kontratës Loti I “*Blerje letër fotokopje A4, letër fotokopje A3*”. Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka

mbajtur proces verbal në lidhje me dorëzimin me vonese të këtij artikulli, duke mos informuar AK për mos përmbushjen e afateve nga kontraktuesi siç janë të përcaktuara në kontratën e sipërcituar për mallin “Leter A3 80 gr/m²” ku është përcaktuar se: *Malli objekt kontrate do të lëvrohet me dërgesa të pjesshme sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, për gjatë periudhës 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Sasia prej 25% e mallit objekt kontrate, duhet të lëvrohet jo më vonë se 2 (dy) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës.* Nga auditimi i dokumentacionit të administruar nga Grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se OE I.....T nuk e ka respektuar këtë detyrim për mallin letër A3 pjesë e objektit të kontratës nr. 1637/82 datë 22.02.2023. Vlera e penaltetit sipas nenit 21 duhet të llogaritet mbi 25 % të vlerës totale të këtij artikulli duke e penalizuar me 4/1000 për ditë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe nga verifikimi në terren i mallit i kontratës me objekt “*Blerje e vendosje sisteme të integruara të sigurisë (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi CH4, CH8, CH16), sisteme inteligjente (SMART) të sigurisë CH4, CH8, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit*” u konstatuan problematika. Konkretisht rezultoi se disa prej kamerave të instaluar në filialet e postës nuk ishin funksionale. Sa më sipër është në kundërshtim me Vendimin nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar, pika 2.b).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masat të hartojë dhe të parashikojë mirëmbajtjen e mallrave objekt kontrate sipas Vendimit në fuqi.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “*Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë*” rezulton se specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke mos përshkruar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar,

Kërkesat e bëra nuk janë bërë plotësisht në terma funksionalë pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 20, “*Mosdiskriminimi*”, neni 23, “*Specifikimet teknike*”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 27, “*Kontratat e mallrave*” pika 1 dhe pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të specifikimeve teknike në raport me nevojat e investimit me qëllim përdorimin e fondeve me efektivitet, eficiencës dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit në terren të mallit objekt kontrate për praktikën me objekt “*Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë*”, pas një inspektimi në terren duke

zgjedhur disa nga pikat ku janë montuar kutit postare sipas proces-verbalit bashkangjitur dosjes së prokurimit, rezultoi se shumë kuti postare në hyrjet e pallateve nuk ishin funksionale pasi nuk përmbanin as emrin dhe as nr. e apartamentit të banorëve. Pas një komunikimi dhe me administratorët e pallateve ata e mohuan që të kishin një kopje të çelësave për aksesimin e kutive postare. Kjo gjë është e ilustruar dhe nga fotot me nr. 3, 4, 5 dhe 6 në Aneksin nr. 2.3.4. Kutitë restante nuk janë montuar por janë në gjendje në magazinën qendrore të postës. Sa më sipër është në kundërshtim me kontratën nr. 225/19 prot., datë 21.05.2021.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për vendosjen në procedurat e prokurimit të Posta Shqiptare SHA, të marrë masat të analizojë situatën, të nxjerrë shkaqet dhe përgjegjësitë me qëllim vënien në funksion të kontratës nr. 225/19 prot., datë 21.05.2021.

Në vijimësi

20. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi u konstatua se Rregullorja e Brendshme, “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare nuk është përshtatur (amenduar) duke mos reflektuar ndryshimet institucionale të ndodhura ndër vite në Posta Shqiptare. Konkretisht:

- në rregulloren e brendshme të Posta Shqiptare SHA detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara përgjithësisht në nivel makro;
- në disa raste konstatohet se mungojnë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësiive për disa funksione që janë në strukturën organizative por nuk gjenden të reflektuara në rregulloren e brendshme të funksionit të administratës qendrore. Sa më sipër është në kundërshtim me nenet 7, 11, 14, të Statutit të Shoqërisë Posta Shqiptare, dhe nenin 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si dhe “Detyrat dhe kompetencat e Administratorit të Përgjithshëm” përcaktuar në rregulloren e brendshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 120 – 123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, të hartojnë, amendojnë dhe miratojnë, rregulloren e brendshme, “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA” duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura ndër vite në shoqëri. Hartimi i kësaj Rregulloreje të marrë në konsideratë vendosjen e kontroleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale.

Menjëherë

21. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të procedurave në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj rezultoi se:

- Në asnjë rast nuk u evidentua ndonjë gjurmë që sektorëve/departamenteve përkatëse ju ka lindur nevoja për rekrutimin e punonjësve të rinj.

- Nuk janë dokumentuar procedura të mirëfillta rekrutimi të tyre dhe deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura,

- Përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj.

Sa më sipër është në kundërshtim me Rregullorja e Brendshme, “Për organizmin, funksionimin e administratës qendrore të shoqërisë Posta Shqiptare SHA” miratuar me vendimin nr. 6, datë 20.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare dhe Vendimet “Për miratimin e strukturës organizative të aparatit qendror të Posta Shqiptare SHA”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqet nr. 120 – 123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandimi: Organet drejtuese në Posta Shqiptare SHA, gjatë hartimit të strukturës organizative të aparatit qendror Posta Shqiptare SHA dhe njësive të vartësisë, të marrë në konsideratë nevojat e sektorëve/departamenteve dhe njësive të vartësisë duke rekrutuar punonjës të rinj me procedurat sipas metodave më të mira dhe me të drejta.

Në vijimësi

22. Gjetje nga Auditimi: Drejtoria e Përgjithshme Posta Shqiptare SHA në momentin e hartimit të regjistrave të parashikimit, nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, sipas natyrës, sasisë dhe llojit të kontratës, të cilat kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Në 10 raste, gjatë hartimit të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve në vlerë të vogël, është evidentuar shmangie nga procedurat përkatëse të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo të kontratave si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme

-Procedura e prokurimit me objekt *“Blerje materiale anti-covid 2019”* me numrin e referencës REF-87799-02-22-2021 dhe fond limit në vlerën prej 788,000 lekë pa TVSH, nga ku fitues është shpallur M.... V..... me vlerën prej 778,900 lekë pa TVSH.

-Procedura e prokurimit me objekt *“Blerje produkte higjeno-sanitare”* me numrin e referencës REF-87793-02-22-2021 dhe fond limit në vlerën prej 792,666 lekë pa TVSH, nga ku fitues është shpallur M.... V..... me vlerën prej 779,900 lekë pa TVSH.

Procedurat e prokurimit të sipërcituara rezultojnë në të njëjtën llogari shpenzimesh dhe me të njëjtin funksion kryesor parandalimin e përhapjes të infeksioneve nga bakteret dhe viruset.

Sa më sipër, vlera totale e tyre është 1,558,800 lekë, nga ku kanë tejkaluar pragun procedurës së prokurimit në vlerën prej 758,800 lekë.

-Procedura e prokurimit me objekt *“Sigurimi i fondit të përdoruesve për shërbimin e pagesave”*, me fondin limit 543,000 pa TVSH, e realizuar në datën 13.10.2022 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 520,000 lekë pa TVSH.

-Blerje nën vlerën 100,000 lekë *“Sigurimi TPL për mjetet motorike”*, me fondin limit 100,000 pa TVSH, e realizuar me vlerën prej 19,700 lekë pa TVSH me shoqërinë L.....A.

-Procedura e prokurimit me objekt *“Sigurim kontrate për magazinë doganore”*, fondi limit 1,000,000 pa TVSH, e realizuar në datën 23.02.2022 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 970,000 lekë pa TVSH. Sa më sipër, përbëjnë grupe mallrash të ngjashëm në të njëjtën llogari shpenzimesh dhe si produkte sigurimi me të njëjtin funksion dhe qëllim kryesor blerjen e përgjegjësive tek shoqëritë e sigurimeve. Procedurat e sipërcituara së bashku, rezultojnë në vlerën totale prej 1,539,700 lekë, nga ku tejkalohet pragu në vlerën 539,700 lekë.

Filiali Tiranë

-Procedura e prokurimit me objekt *“Sigurimi i aktiveve të qëndrueshme (ndërtesës)”*, fondi limit 800,000 pa TVSH, e realizuar në datën 09.04.2021 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 796,400 lekë pa TVSH.

-Procedura e prokurimit me objekt *“Sigurimi TPL për mjetet motorike”*, fondi limit 300,000 pa TVSH, e realizuar në datën 26.04.2021 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 298,500 lekë pa TVSH.

-Procedura nën vlerën 100,000 lekë me objekt *“Sigurimi TPL për mjetet motorike”*, fondi limit 100,000 pa TVSH, e realizuar në datën 09.07.2021 dhe operatori fitues A.....A me vlerën prej 99,996 lekë pa TVSH.

Sa më sipër, të tre procedurat përbëjnë grupe mallrash të ngjashëm në të njëjtën llogari shpenzimesh si dhe produkte sigurimi me të njëjtin funksion dhe qëllim kryesor, pra blerjen e përgjegjësive tek shoqëritë e sigurimeve. Vlera totale e tyre është 1,194,896 lekë, pra tejkalojnë pragun e procedurës së prokurimit në vlerën me 394,896 lekë.

-Procedura e prokurimit me objekt “*Siguracioni i aktiveve të qëndrueshme (ndërtesës)*” me numrin e referencës REF-21657--03-10-2022 me fond limit në vlerën 800,000 lekë pa TVSH, dhe fitues A.....A me vlerën prej 796,950 lekë pa TVSH.

-Procedura e prokurimit me objekt “*Siguracioni TPL për mjetet motorike*” me numrin e referencës REF-26141-04-22-2022 me fond limit në vlerën prej 400,000 lekë pa TVSH dhe fitues A.....A me vlerën prej 398,000 lekë pa TVSH.

Dy procedurat e mësipërme së bashku rezultojnë në vlerën totale prej 1,194,950 lekë, nga ku tejkalojnë pragun e procedurës së prokurimit në vlerën prej **194,950 lekë**. Sa më sipër trajtuam, bie në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit nr. 03, datë 08.01.2018 të APP, me pikën 3 të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021 të APP, gjithashtu në kundërshtim me nenin 56, pika 2 dhe 11, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”. Parregullsitë, sa më sipër, kanë sjellë për pasojë shmangien nga procedurat konkurruese të prokurimit, duke shkaktuar copëzimin e fondeve apo kontratave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masat e nevojshme, që në hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve në vlerë të vogël, të krijohen linja të qarta bashkëpunimi, raportimi dhe përgjegjësi dhe vendimmarrje të përcaktuara për parandalimin e copëzimit të fondeve publike, kjo njëkohësisht me qëllim edhe shmangien e kufizimit të procedurave konkurruese të prokurimit.

Në vijimësi

23. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla konstatohet se operatori ekonomik fitues rezulton me ofertë me vlerë më të ulët nga oferta e paraqitur gjatë verifikimit në treg për vlerësimin e fondit limit, kjo kur ofertat janë dhënë për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, si më poshtë:

-Procedura e prokurimit me objekt “*Blerje produkte higjieno-sanitare*” me numrin e referencës REF-87793-02-22-2021, është kryer me Urdhrin e Prokurimit në Drejtorinë e Përgjithshme me nr. 03 datë 19.02.2021. Fondi limit i kësaj procedure është përcaktuar nga tregu në vlerën prej 792,666 lekë pa TVSH. Në procesverbalin datë 18.02.2021 të komisionit të prokurimeve të vogla për llogaritjen e fondit limit është administruar oferta e OE M.... V..... në vlerën prej 785,000 lekë, si një nga ofertat e marra gjatë studimit të tregut. Në të njëjtën kohë, oferta e operatorit ekonomik M.... V..... në sistemin elektronik të prokurimit është konstatuar e ndryshuar dhe në një vlerë më të ulët prej 779,900 lekë, e cila është shpallur operator fitues. Në rastin e konsultimit verbal, grupi i ngritur për këtë qëllim, duhet të hartojë një procesverbal me të dhëna, që mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës (praktikisht ofertat nga fituesi janë dhënë në të njëjtën kohë). Pranimi nga ana e komisionit të prokurimeve në vlerë të vogël, të ofertës të operatorit fitues M.... V..... në SPE, ka sjellë deformimin e procesit të krahasimit të kësaj oferte me fondin limit për arsye se ka ndryshuar baza krahasuese (ekzistenca e dy ofertave të ndryshme në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin objekt prokurimi). Sa më sipër, operatori ekonomik fitues është paraqitur me 2 oferta të ndryshme për të njëjtën objekt prokurimi. Pranimi i 2 ofertave të sipërcituara për OE fitues, për të njëjtën objekt prokurimi dhe praktikisht në të njëjtën kohë, ka shkaktuar deformimin e vlerësimit dhe të konkurrencës në procesin e prokurimit. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 63 pika 3, i ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, neni 13 pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA, të merren masat e nevojshme për shmangien e deformimit gjatë procedurës së vlerësimit, duke siguruar që procesi i prokurimit në vlerë të vogël të përfshihet në një manual përdorimi, me qëllim

identifikimin e përgjegjësive individuale, dokumentacionin përkatës të miratuar për hapat e procesit dhe vendimmarrjen individuale, që duhet të ushtrohen gjatë zbatimit të kësaj procedure të thjeshtuar.

Në vijimësi

24. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla konstatohet se me urdhrin nr. 81, 2112 prot., datës 15.10.2020 ish administratori z. L. D. ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “*Blerje dhe riparim pajisjesh për mobilim dhe arredimin e zyrave*”. Pavarësisht procedurës së kryer, janë konstatuar problematikat e mëposhtme. Për realizimin e kësaj procedure prokurimi mungon kërkesa nga ana e drejtorisë përkatëse, nga ku të lindte nevoja për kryerjen e kësaj procedure. Së dyti, në rastin e s’kualifikimit të OE N.... H.... i renditur i gjashti në klasifikimin përfundimtar nuk është mbajtur protokoll zyrtar që të shpjegojë arsyet e s’kualifikimit, por e vetmja gjurmë gjendet në sistemin elektronik të APP. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” neni 56, pika 6.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1 Rekomandimi: Nga administratori dhe zyra e financës të shoqërisë Posta Shqiptare SHA, të merren masa për korrigjimin e praktikave të prokurimeve me vlerë të vogël dhe zbatimi i tyre në përpikmëri sipas ligjit.

Në vijimësi

25. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të pasqyrave financiare vihet re një rritje në riskun mbi likuiditetit që përcaktohet si risku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare si dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Posta Shqiptare është ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndodhura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer llogaritë e pagueshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqet nr. 134 – 136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA të marrë të gjitha masat mbi arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, në rast të vonesave mbi arkëtimin e tyre të marrë masat mbi vendosjen e kamatëvonesave duke iu përmbajtur kushteve të kontratave si dhe në mos realizimin e arkëtimit të tyre ti kalojë në borxh të keq. Gjithashtu Posta Shqiptare SHA të bëjë të mundur shlyerjen e llogarive të pagueshme duke shmangur penalitetet e mundshme në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetje nga Auditimi: Gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm rezulton se me shkresën nr. 3003 prot., datë 14.11.2019 është lëshuar nga Administratori i Posta Shqiptare SHA z. L. D., Urdhri nr. 332 i datës 14.11.2019 “*Mbi raportin përfundimtar dhe rekomandimeve për auditimin e Posta Shqiptare SHA nga Kontrolli i Lartë i Shtetit*”. Me shkresën nr. 3003/1 prot., datë 14.11.2019 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është vënë në dijeni Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Nga auditimi i zbatimit të afatit 20 ditor për kthim përgjigje ndaj KLSH, konstatohet se nga ana e Posta Shqiptare SHA është respektuar afati me dërgimin e shkresës nr. 1519/67 datë 26.09.2019 në zbatim të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, germa j. Nga auditimi i zbatimit të afatit 6 mujor për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, konstatojmë se Posta Shqiptare SHA nuk e ka përmbushur këtë detyrim. Me nisjen e shkresës nr. 520 prot., e datës 05.06.2020 KLSH njofton drejtuar Posta Shqiptare SHA për fillimin e auditimit tematik për

zbatimin e rekomandimeve. Me shkresën nr. 520/1 prot., e datës 05.06.2020 KLSH nis programin e auditimit tematik për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Me shkresën nr. 520/9 prot., e datës 27.07.2020 KLSH nis projekt raportin e auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve në subjektin Posta Shqiptare SHA. Me shkresën nr. 520/42 prot., e datës 04.12.2020 KLSH nis drejt Posta Shqiptare SHA rekomandime dhe pjesë nga raporti përfundimtar. Me shkresën nr. 2689 prot., e datës 28.12.2020 është lëshuar Urdhri i Brendshëm nr. 105 nga Administratori i Posta Shqiptare SHA për marrjen e masave mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Posta Shqiptare sha nuk i ka trajtuar me korrektësi rekomandimet e lëna nga auditimi i KLSH dhe në lidhje me to ka zbatuar si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 32 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 11 masa, janë në proces realizimi 12 masa dhe 9 masa nuk janë zbatuar.

-Janë rekomanduar 7 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 7,105,904 lekë, nga të cilat 0 masa janë zbatuar, janë në proces zbatimi 6 masa dhe 1 masë nuk është zbatuar,

-Janë rekomanduar 6 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit, nga të cilat 2 masa nuk janë pranuar, 1 masë është zbatuar, është në proces realizimi 1 masë dhe 2 masa nuk janë zbatuar. Sa më sipër është në kundërshtim me ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, nenet 15 germa “j” 30, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqet nr. 137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1 Rekomandimi: Posta Shqiptare SHA, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite”, viti 2018 rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE H...O K....N &T tepër në vlerë si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shumën totale prej **458,663 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.3.0.1. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, neni 12, VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, Udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I, germa A, paragrafi i fundit si dhe Kreu II, Struktura e Kostos së Punimeve të Ndërtimit, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 14/1 prot., datë 29.10.2018 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 5/2 prot., datë 30.09.2019.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **458,663 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE H...O K....N &T me të cilët është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 2902/16 prot., datë 05.12.2018 me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Gjirokastër, Sarandë dhe filialit qendrës tranzite, e ndarë në lote, Loti II: Rikonstruksion i Filialit Qendra Tranzite”, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë”*, viti 2020, nga krahasimi i volumeve të situacionuara e likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezulton se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve BOE A... & B...S në shumën totale prej **58,414 lekë pa TVSH**, vlerë kjo e cila jepet e detajuar sipas Aneksit nr. 2.3.0.2. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 7/1, neni 12, VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 *“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”*, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 135 prot., datë 30.03.2020 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **58,414 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve BOE A... & B...S me të cilët është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/47 prot., datë 30.03.2020 me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastrë”*, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.

3. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë e ndarë në lote, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan”*, viti 2020 nga krahasimi i zërave të situacionuar e të pasqyruara në librezën e masave si dhe verifikimit në terren të kryer në prezencë të përfaqësuesve të Postës Shqiptare SHA rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve OE L...N K...N si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej **202,501 lekë pa TVSH**, e argumentuar kjo sipas Aneksit nr. 2.3.0.3. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 7/1, neni 12, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 104 prot., datë 30.03.2020 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **202,501 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve OE L...N K...N me të cilin është lidhur kontrata përkatëse sipas

aktit me nr. 3163/56 prot., datë 15.05.2020 me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, Loti I Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan”, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

4. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt “Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”, viti 2020 nga krahasimi i zërave të situacionuar e të pasqyruara në librezën e masave rezultoi se janë përfituar tepër nga ana e sipërmarrësit të punimeve OE K....N C....N si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt në shuma prej **265,301 lekë pa TVSH**, e argumentuar kjo sipas Aneksit nr. 2.3.0.4. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7/1, neni 12, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 224/1 prot., datë 15.06.2020 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës totale prej **265,301 lekë pa TVSH** ndaj sipërmarrësit të punimeve OE K....N C....N me të cilin është lidhur kontrata përkatëse sipas aktit me nr. 3163/56 prot., datë 15.05.2020 me objekt “Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”, për punime të likuiduara por të pakryera në fakt.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kancelari dhe zarfa” rezulton se KVO ka s’kualifikuar me të padrejtë OE I....GJ....K.... e cila rezulton si ofertë anomalisht e ulët. Në referim të shkresës së datës 01.02.2023 të paraqitur në Faksimilen nr. 1, aneksi 2.3.1., OE I....GJ....K.... sqaron se oferta e paraqitur prej tij është e përballeshme pasi ka një xhiro të lartë vjetore dhe se për të artikuj të njëjtë me ato të AK Posta Shqiptare ka realizuar kontrata të suksesshme me 15 subjektet publike të rëndësishme. Bashkëlidhur, shkresës në lidhje me zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, OE I....GJ....K.... ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015, si dhe vërtetim nga AK të sipërcituar mbi realizimin me sukses të kontratave me objekt të njëjtë me prokurimin e zhvilluar nga AK Posta Shqiptare. Kontrata këto të ngarkuara në SPE. Për sa më lart, OE I....GJ....K.... plotëson kërkesat e pikës 2 germa a, b, c, ç, d, të nenit 93 në të 5 komponentët e kërkuar. Nga auditimi i procedurave të mëparshme të Postës Shqiptare, rezulton se në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tonera, bojëra printeri” të vitit 2022, KVO ka konstatuar se OE M.....G & D....N dhe I...T O.....E kanë rezultuar oferta anomalisht të ulëta. Pas kërkesës së KVO të asaj procedure, drejtuar dy OE mbi dhënien e sqarimeve për mbështetjen e ofertës anomalisht të ulët, rezulton se këta OE kanë paraqitur pothuajse të njëjtat argumente me ato të paraqitura nga OE OE I....GJ....K.... duke i pranuar dhe kualifikuar dhe në përfundim është shpallur fitues OE M.....G & D....N, pavarësisht se rezultonte Ofertë anomalisht e ulët. Ndërkohë për rastin e OE I....GJ....K...., Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i kanë konsideruar jo bindëse argumentet e këtij OE duke e s’kualifikuar në kundërshtim me *nenin 82 pika 4 e VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*. KVO e ka s’kualifikuar OE OE I....GJ....K....

në mënyrë të pa drejtë, dhe pas shpjegimeve të dhëna nga OE I.....GJ.....K....., duke vërtetuar me dokumentacion qe kishte kapacitete financiare për ta realizuar kontratën me një marzh të vogël fitimi, dhe për më tepër që nga auditimi i kësaj procedure rezultoi që vlera e FL e përlllogaritur nga AK posta Shqiptare ishte jo reale dhe e rritur artificialisht me 201 %. Shuma 11,990,389 lekë e cila përfaqëson diferencën midis Ofertës së shpallur fituese padrejtësisht në vendin e parë në shumën 39,187,981 lekë të OE I....T O.....E dhe ofertës së paraqitur nga OE I.....GJ.....K..... në shumën 27,197,592.50 lekë e s’kualifikuar si ofertë anomalisht e ulët, do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Postës Shqiptare.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të ndiqen procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës **11,990,389 lekë** të ndarë në mënyrë proporcionale për secilin anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit “*Blerje kancelari dhe zarfa*”.

Brenda datës 31.12.2023

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “*Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite*”, u analizua Relacioni i hartuar nga ana e Grupit të Punës i ngritur me Urdhër nr. 53, datë 12.03.2019, me nr. 740 prot., datë 12.03.2019 për analizën e kostos dhe efikasitetin procedural për procedurën e prokurimit si më sipër, kjo me qëllim identifikimin e avantazheve dhe disavantazheve të përdorimit të Leasing operacional dhe imazhin e institucionit. Nga kjo analizë rezulton si më poshtë shpjegohet:

Sipas këtij relacioni, pika 2 është cituar ndër të tjera se vlera e automjetit pëson një rënie të konsiderueshme gjatë viteve të përdorimit, vlerë kjo e parikuperueshme në fund të jetës së automjetit. Në fakt, nga një analizë e dokumenteve të vëna në dispozicion rezulton se nga grupi përkatës nuk është marrë në konsideratë shuma e mbetur e investimit e cila në fund të 4 viteve rezulton të jetë në total në masën 24,332,448 lekë, e përlllogaritur kjo për mjete si më poshtë:

Motoçikleta – 3,756,840 lekë; Autovetura – 3,686,400 lekë; Furgonçina – 16,889,208 lekë;

Pra, në total rezulton se AK në përfundim të afatit të kontratës së qirasë do të kishte në dispozicion të tij asete me vlerë kontabël 24,332,448 lekë. Përveç kësaj, rezulton se pa u mbështetur në një historik konkret, Grupi i Punës ka përlllogaritur për variantin e blerjes, shpenzime për kryerjen e shërbimeve periodike. Konkretisht rezulton se në përlllogaritje janë përfshirë pajisje kamera dhe sistemi GIS, të dyja këto në shumën prej 67,000 lekë/makine për 4 vite, ose shuma prej 1,407,000 lekë pa TVSH. Njëkohësisht nga ana e këtij Grupi Pune është përlllogaritur shuma prej 114,720 lekë pa TVSH/vit x mjet, ose në total për 21 furgonçina shuma prej 9,636,480 lekë pa TVSH, parashikim ky jo plotësisht i argumentuar, kjo pasi vetë blerja e sistemit së bashku me kamerat është parashikuar në shumën prej 67,000 lekë/mjet. Nga verifikimi i kilometrave të përshkruara nga mjetet e marra me qira nga fillimi i kontratës e deri aktualisht rezulton se autoveturat, furgonçinat dhe motoçikletat në pjesën më të madhe të tyre kanë përshkruar më pak kilometra nga sa janë parashikuar⁹. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 1 “*Objekti dhe qëllimi*”, pika 2.

⁹ Aneksi 2.3.7

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Posta Shqiptare SHA të merren masa për një vlerësim të saktë të leverdshmërisë së investimeve të kryera për punë/mallra shërbime me qëllim shmangien e përdorimit pa efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve siç është i rastit të kontratës me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”* me vlerë **96,009,900 lekë pa TVSH.**

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me zbatimin e kontratës së punimeve me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”*, viti 2020 rezultoi se në përgjithësi punimet janë kryer me një cilësi të dobët duke bërë që investimi të paraqesë shenja shumë të hershme amortizimi, kjo më shumë në rifiniturat për shkak kryesisht të mos marrjes së masave kundër shkaktarëve të lagështisë. Dyert nuk janë vendosur të cilësisë së parë dhe druri duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të punimeve të mos respektohen kërkesat e projektit për një shumë totale prej 740,432 lekë pa TVSH për 84.14 m² dyer të realizuara. Gjithashtu, për sa i takon dritareve dhe dyerve rezultoi se nuk janë realizuar me material plastik por me alumin të thjeshtë duke bërë që nga ana e sipërmarrësit të punimeve të mos respektohen kërkesat e projektit dhe preventivit për një shumë totale prej 1,248,296 lekë pa TVSH për dritaret dhe dyert e realizuara. Për rrjedhojë rezultoi se janë përdorur pa efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet fondet në shumën prej 1,988,728 lekë pa TVSH. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, neni 7/1, neni 12, VKM me nr. 629 datë 15.05.2015 *“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”*, Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu II, Pika 8.1 dhe Pika 8.3, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3, kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 135 prot., datë 30.03.2020 si dhe me kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve të lidhur sipas aktit me nr. 20/2 prot., datë 26.11.2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të kontratave të punimeve për të siguruar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale e duke shmangur kështu përdorimin pa efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve siç është ai në rastin e kontratës me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Korçë, Elbasan dhe Vlorë, Sarandë, Gjirokastër e ndarë në lote, Loti II Rikonstruksioni i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”* me BOE A... & B....S ku rezultoi se nuk janë respektuar specifikimet teknike për dy zëra punimesh në shumën prej **1,988,414 lekë pa TVSH.**

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt *“Mirëmbajtja e Data Center”*, nuk është marrë në konsideratë menaxhimi i duhur i burimeve të shoqërisë, ku grupi i auditimit gjykon që pjesët hardware dhe sistemet e mësipërme mund të menaxhohen dhe mirëmbahen nga vetë specialistët e institucionit si dhe gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në përllogaritjen e fondit limit nuk janë marrë në konsideratë çmimet e pajisjeve që do të mbulohen me mirëmbajtje, duke kaluar çmimin e tyre të blerjes. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e

efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit vlera prej **11,898,000 lekë**. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”, neni 13 “Neni 13 “Studimi paraprak i tregut”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, gjatë alokimit të burimeve të shoqërisë, të marrin në konsideratë përdorimin e 3E, duke përdorur burimet e shoqërisë për kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave të shoqërisë.

Në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “Mirëmbajtja e Moduleve të Eternës (Finance-kontabilitet, Burimet njerëzore, Magazina, Help Desk) për 4 vite”, datë 31.05.2019, nga auditimi rezulton se zhvillimi i mirëmbajtjes për modulet në fjalë nuk është i nevojshëm dhe mund të mbulohet nga specialistët e IT së institucionit, duke marrë në konsideratë dhe modulet ose aplikacionet e tjera që zhvillohen pranë institucioneve të tjera të cilët mirëmbahen nga vetë specialistët e institucioneve pas zhvillimit të trajnimeve. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit vlera prej **9,450,000 lekë**. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë Posta Shqiptare, gjatë alokimit të burimeve të shoqërisë, të marrin në konsideratë përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve, duke përdorur burimet e shoqërisë për kryerjen e detyrave dhe arritjen e objektivave të shoqërisë.

Në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “Blerje Biznes Hub”, më datë 14.05.2021, në përbërje të objektit dhe specifikimeve të cilësuar në dokumentet standardë të procedurës së prokurimit, cilësohen modifikime të moduleve ekzistuese të Eternës, për të cilët është zhvilluar procedurë për mirëmbajtjen dhe modifikimin e moduleve ekzistuese. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit vlera prej **25,000,000 lekë**. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, të kryejnë një analizë të hollësishme lidhur me shtimin dhe modifikimin e moduleve, të cilat janë objekt i procedurave të mëparshme të prokurimeve dhe detyrë e O.E. fitues i procedurave të mëparshme të Eternës, si dhe të kryejë një analizë kosto përfitim në lidhje me shtimin e moduleve të tilla, pasi mirëmbajtja e tyre rrit kostot e shoqërisë.

Në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurës me objekt “Blerje bojëra teknologjike dhe lëndë pastrimi teknologjike për Hibrid Mail”, më datë 30.09.2022, për një vlerë prej 12,580,000 lekë pa TVSH, nga i njëjti operator ekonomik, vlerë e cila nuk e mbulon fitimin e përdorimit të sistemit gjatë kësaj periudhe, pasi sistemi “Hibrid Mail” pothuajse nuk ka funksionuar. Për sa më sipër nga ana e shoqërisë konstatohet se janë përdorur në kundërshtim me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit vlera prej **12,580,000 lekë**. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë, gjatë menaxhimit të burimeve të shoqërisë si dhe zhvillimit të sistemeve të reja të kryejë një analizë kosto përfitim të detajuar duke shmangur përdorimin e fondeve pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

Në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kancelari dhe zarfa”, rezulton se fondi limit nuk është përlloritur sipas kërkesave të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi. Nga auditimi rezulton se:

- Autoriteti Kontraktor Posta Shqiptare ka zhvilluar tender për blerjen kancelari dhe zarfa me objekt dhe specifikime teknike të njëjta në vitin 2021 me procedurën e vitit 2022.

- Në kontratën e vitit 2021 me nr. 939/33 prot., datë 17.11.2021 “Blerje kancelari dhe zarfa”, 29 artikuj të saj, kanë specifikime teknike të njëjta me artikujt e procedurës së prokurimit të zhvilluar në vitin 2022.

- Grupi i punës për përlloriturjen e fondit limit, nuk ka përfshirë çmimet për njësi të këtyre 29 artikujve të kontratës së vitit 2021 në prokurimin e vitit 2022.

- Fondit limit i përlloritur nga AK është miratuar në shumën 40,577,848 lekë pa TVSH, kundrejt atij të përlloritur nga grupi i auditimit të KLSH në shumën 20,173,165 lekë pa TVSH, pra AK Posta Shqiptare ka rritur artificialisht FL me 201 %, ose vlerën prej **20,404,683 lekë pa TVSH.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”, rezulton se fondi limit nuk është përlloritur sipas kërkesave të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi.

Nga Auditimi rezulton se:

- Autoriteti Kontraktor Posta Shqiptare ka zhvilluar tender me të njëjtin objekt prokurimi edhe në vitin 2021, duke lidhur kontratën nr. 2575/40 prot., datë 17.06.2021 me objekt “Blerje letër fotokopje A4”, dhe kontratën nr. 2575/41 prot., “Blerje letër traktor (3 kopje) A5, A4” datë 17.06.2021.

- Grupi i punës për përlloriturjen e fondit limit nuk ka përfshirë çmimet për njësi të artikujve letër fotokopje A4 dhe atyre të letrës traktor (3 kopje) A5, A4 të kontratës të lidhur në vitin 2021, të cilat kanë patur specifikime teknike të njëjta me specifikimet e kërkuara nga AK në procedurën e prokurimit të vitit 2022.

- Në zbatim të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi, grupi i auditimit të KLSH bëri përlloriturjen e fondit limit duke përfshirë dhe çmimet për njësi të artikujve letër fotokopje A4 dhe letër traktor (3 kopje) A5 dhe A4.

Si rezultat FL i përlloritur nga grupi i auditimit të KLSH është në shumën 42,064,659 lekë pa TVSH. Ndërkohë që AK Posta Shqiptare Fondin limit e ka përlloritur dhe miratuar në shumën 62,891,062 lekë, pa TVSH pra me një diferencë prej **20,826,403 lekë pa TVSH.**

Për sa më lart, AK ka rritur artificialisht me 150% Fondin Limit për procedurën me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”

Grupi i auditimit të KLSH, në përlloriturja e Fondin Limit të kësaj procedure ka përfshirë përveç çmimeve të studimit të tregut edhe çmimet e artikujve të Kontratës nr. 2575/40 prot., Kontratës Nr. 2575/41 prot., datë 17.06.2021 me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)” të paraqitur në tabelën nr. 2., aneksi 2.3.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9 .Gjetje nga auditimi: Nga auditimi procedurës së prokurimit me objekt “Blerje tonera, bojëra printer”, rezulton se fondi limit nuk është përlloritur sipas kërkesave të LPP dhe akteve nënligjore në fuqi. Nga Auditimi rezulton se AK ka lidhur kontratën nr. 635/46 prot.,

datë 15.02.2021 me objekt “Blerje tonera dhe bojëra printeri”, nga ku 10 artikuj nga 14 artikuj të kërkuar në procedurën e prokurimit mbi bazën e Urdhri i Prokurimit nr. 17 prot., datë 26.10.2022 kanë specifikime teknike dhe Part/Number të njëjtë. Grupi i KLSH mbi bazën e çmimeve të ofertave të OE dhe çmimeve koresponduese të artikujve të kontratës së mëparshme bëri përlllogaritjen e Fondit limit. Fondi Limit i përlllogaritur nga grupi i KLSH rezultoi në shumën 11,376,988 lekë. Për sa më lart, AK ka përlllogaritur Fondin Limit në shumën 14,717,900 lekë duke e rritur artificialisht me 29 % më shumë se vlera e Fondit Limit, e përlllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH. Pra **3,340,912 lekë pa TVSH** më tepër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1-9.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë Posta Shqiptare nëpërmjet strukturave përgjegjëse të planifikojë programe trajnimi në fushën e prokurimeve publike për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore që angazhohen në procedurat e prokurimit publik, dhe të marrë masa për anëtarët e njësisë së përlllogaritjes së fondit limit të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur artificialisht Fondin Limit

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se kontraktuesi nuk ka zbatuar kushtet e kontratës për afatin e dorëzimit të letrës traktor A5 me 3 kopje në masën 25 % të sasisë, të cilën duhej ta dorëzonte pranë AK Posta Shqiptare brenda datës 23.05.2023, kjo pasi është dorëzuar gjithë sasia e mallit letër A5 traktor me 3 kopje më datë 15.08.2023, pra 84 ditë me vonesë nga afati i përcaktuar në kontratën nr. 1637/92 prot., datë 23.03.2023. Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka mbajtur proces verbal për dorëzimin me vonesë të letrës traktor A5 si pjesë e mallit të kontratës dhe nga ana e Drejtorisë Ekonomike të Postës Shqiptare nuk është llogaritur penalitet për këtë mall, duke e paguar tërësisht faturën tatimore nr. 156/2023 datë 15.08.2023 të kontraktuesit A.....O. Bazuar në kushtet e kontratës, Letra A5 “Traktor” (3 kopje) si pjesë e mallit objekt kontrate duhet që sasia prej 25 % të dorëzohej brenda datës 23.05.2023. Në referim të nenit 21 të kontratës “Penalitet”, parashikohet se: *“Penalitetet për dorëzimin e vonuar do të llogariten me tarife ditore 4/1000 e vlerës përkatëse të mbetur, nga çmimi i përgjithshëm i kontratës, por jo më pak se 25 % e vlerës së kontratës.* Për sa më lart, Kontraktuesi A.....O ka dorëzuar mallin letër A5 traktor (3 kopje) me 84 dite vonesë nga përcaktimi në DTS dhe kontratën e lidhur midis palëve. Meqenëse ky zë i Kontratës për artikullin me emërtimin letër A5 traktor (3 kopje) është lëvruar në sasinë totale më datë 15.08.2023., për të llogaritur penalitetin është marrë vlera minimale e këtij zëri në shumën 25% të saj. Vlera e letrës A5 Traktor (3 kopje) është në shumën 7,841,160 lekë. Vlera e përlllogaritur e penalitetit është në shumën $(1,960,290 * 0.004) * 84 = 658,657$ lekë, vlerë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet eficientë dhe ekonomikitet të fondeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren për masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

Në vijimësi

11. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje tonera, bojëra printer” rezulton se kontraktuesi nuk ka respektuar afatet kohore gjatë dorëzimit të bojërave dhe tonerave për printer. Konkretisht, në zbatim të kushteve të kontratës kontraktuesi duhej të dorëzonte pranë magazinës së Postës Shqiptare brenda datës 02.06.2023 të paktën 25 % të çdo artikuj sipas përcaktimeve të DST. Më datë 07.07.2023, nga ana e audituesve të KLSH u krye një verifikim fizik pranë magazinës së Postës Shqiptare dhe kanë mbajtur Akt

verifikimi nr. 1 me punonjësen përgjegjëse të materialeve, nga ku u konstatua se nga ana e Kontraktuesit nuk ka filluar lëvrimiti i mallit për sasinë 25 % për çdo artikull brenda 45 ditëve. Akt verifikimi nr. 1 është protokolluar në Posta Shqiptare me nr. 909/2 prot., datë 12.07.2023. Nga Komisioni i marrjes në dorëzim nuk është mbajtur proces verbal në lidhje me mosrespektimin e kushteve të kontratës dhe nuk është informuar Administratori për mos respektimin e kushteve të kontratës nga ana e Kontraktuesit në lidhje me afatet e lëvrimit të mallit. Për mos zbatim të kushteve të kontratës deri në datën e mbajtjes së akt verifikimit, nga KLSH rezulton se kontraktuesi nuk e ka dorëzuar mallin për 36 ditë kalendarike. Penaliteti për vonesë të lëvrimit nga kontraktuesi është $(0.25 * 5,212,900) * 0.004 * 36 = 187,664$ lekë, vlerë kjo e cila përbën përdorim pa efektivitet eficient dhe ekonomikitet të fondeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masa për ngritjen e grupeve efektive për monitorimin e kontratave me qëllim identifikimin e rasteve në të cilat kontraktorët nuk respektojnë afatet e parashikuara.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me procedurën me objekt “*Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë*” rezulton se specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke mos përshtuar minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që të garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP-së për të vlerësuar mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara e për rrjedhojë janë hartuar të tilla që nuk kanë krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve si rrjedhojë e arsyeve të sipërpërmendura. Referuar LPP është saktësuar fakti se specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik dhe ato duhet ti referohen standardeve kombëtare, ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato duhet t’u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare. Kërkesat e bëra nuk janë bërë plotësisht në terma funksionalë pasi nuk janë ta argumentuara teknikisht dhe ligjërisht. Grupi i auditimit ka kryer një analizë të kriterëve të vendosura në raport me ato të përmbushura në ana e OE fitues të cilat, në gjykim të grupit krijohet një dyshim i arsyeshëm e i mbështetur në argumente konkrete mbi paracaktimin e OE fitues përmes vendosjes së specifikimeve teknike fikse të paargumentuara dhe që nuk lidhen me ndonjë domosdoshmëri konkrete me nevojat e AK. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 20, “*Mosdiskriminimi*”, neni 23, “*Specifikimet teknike*”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 27, “*Kontratat e mallrave*” pika 1 dhe pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqet nr. 51 – 118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e përgjegjësive për mosvënien në përdorim të këtij investimi me vlerë **47,500,000 lekë pa TVSH** si dhe për shfrytëzimin e këtij aseti për qëllimin për të cilin është blerë.

Në vijimësi

13. Gjetje nga Auditimi: Nga analiza e llogarisë 638 “*Penalitete dhe dëmshpërblime*”, për vitin 2021, shpenzimet për dëmshpërblime, kryesisht për largimet nga puna, që shoqëria ka kryer për shkak të vendimeve të formës së prerë të gjykatave, janë vlerësuar në vlerën gjithsej prej 10,302,400 lekë si më poshtë:

- Me Vendimin nr. 36, datë 11.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. A. K., si dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi i paditësit është kryer me numër dokumenti 442, datë 11.03.2021 në vlerën prej 1,568,134 lekë.

- Me Urdhrin e Sekuestros nr. 14483, datë 25.06.2021 është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. A. K. dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi është kryer me numër dokumenti 1122, datë 29.06.2021 në vlerën prej 854,700 lekë.

- Me Vendimin nr. 163, datë 08.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin z. R. M., si edhe dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi është kryer me numër dokumenti 4278, datë 05.10.2021 në vlerën prej 1,663,801.60 lekë.

- Me Vendimin nr. 23, datë 01.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është detyruar shoqëria Posta Shqiptare SHA të dëmshpërblejë paditësin Sindikatën e Pavarur të Industrisë, Energjetikës të Shqipërisë, si edhe dhe shpenzimet e tjera ligjore gjyqësore. Likuidimi i paditësit është kryer me numër dokumenti 769, datë 17.06.2021 në vlerën prej 6,215,765 lekë. Nga vendimet e gjykatave, sa më sipër, ndërprerjet e marrëdhënieve të punës të ish-punonjësve kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi Punës i Republikës të Shqipërisë, i ndryshuar, për shkak të ndryshimeve të njëanshme të kushteve të përgjithshme të kontratës individuale të punës, nga ana shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Për sa më sipër, në kundërshtim me pikën 4, neni 5 të Vendimit nr. 11, datë 15.01.2018 të Asamblesë të Aksionarit “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e shoqërisë Posta Shqiptare SHA”, Administratori i Shoqërisë nuk ka propozuar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës mbi largimin e drejtuesve me nivel kombëtar përgjegjësie, siç është rasti i largimit të Drejtorit të Shërbimeve Bankare dhe Financiare në Drejtorinë e Përgjithshme, me Urdhrin nr. 28, datë 31.01.2018. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës në Vendimin nr. 13, datë 29.05.2020 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH” ka analizuar rastet e largimeve nga puna dhe ka ngarkuar administratorin dhe drejtoritë përkatëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. Sa më sipër, shoqëria nuk ka hartuar një plan veprimi për reagimin dhe raportimin sipas vendimit të sipërcituar, si edhe nuk ka nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për shpenzimet e kryera, të cilat rezultojnë si shpenzime me efekt financiar negativ. Sa më sipër, bie në kundërshtim me pikën 14.6, neni 14 i statutit të shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Parregullsitë sa më sipër, kanë shkaktuar shpenzime me **efekt negativ financiar** gjithsej në vlerën prej **10,302,400 lekë**, në formën shpenzimeve të përsëritura për të njëjtin vend pune, në dëm të shoqërisë Posta Shqiptare SHA. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 14.6, neni 14 të statutit të Postës Shqiptare SHA si dhe me pikën 4 neni 5, të Vendimit nr. 11, datë 15.01.2018 të Asamblesë të Aksionarit “Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e shoqërisë Posta Shqiptare SHA”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë Posta Shqiptare SHA të analizohen shpenzimet e dëmshpërblimeve për shkak të ndërprerjeve të njëanshme të marrëdhënieve të punës dhe të përcaktohen personat shkaktarë përgjegjës. Administratori i shoqërisë të marrë masat e nevojshme për mundësinë e kompensimit të këtyre fondeve në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara ligjore.

Menjëherë

14. Gjetje nga Auditimi: Parku i filialit Tiranë është i përbërë nga 14 automjete nafte (gazoil) në gjendje pune, nga ku 7 prej tyre, të tipit Ford Courier janë pjesë të kontratës me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 “Qiraja financiare (Leasing)”, ndërmjet M...N M...S SHPK dhe Posta Shqiptare SHA. Me anë të kontratës të shërbimit të sigurisë nr. 1322/24 prot., datë 19.10.2020 është përfshirë shërbimi i sistemeve të gjurmimit GPS/GPRS, ku është

parashikuar të kryhet monitorimi i mjeteve me targa AA288NY, AA289NY dhe AA798BX të këtij parku (qendra e monitorimit ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA, me shërbim 24 h/7). Për sa më sipër, rezulton se për periudhën 2021-2022 ky shërbim nuk ka funksionuar. Shërbimi gjurmimit GPS/GPRS nuk përfshin mjetet nga kontrata e qerasë financiare (leasing), monitorimi i të cilave kontraktohet nga shoqëria qiradhënëse M...N M...S SHPK. Procesi i administrimit të konsumit të karburantit (gazoil) është raportuar sipas formatit “*Treguesit teknik të mjeteve*”, i cili nuk përmban çmimin për njësi, orën, datën dhe vendin e furnizimit, megjithëse programi “L.....S” i furnitorit K.....I SHPK është në gjendje të gjenerojë një situacion të saktë shpenzimi, për çdo automjet, me datën, vendin, dhe orën e furnizimit, çmimin/njësi, sasinë përkatëse të lëndës djegëse, si edhe numrin e kuponit të tërhequr. Nga ana tjetër, në procesin e administrimit të karburantit mungojnë fletudhëtimet e lëvizjes së automjeteve apo autorizimet përkatëse dhe nga muaji Mars 2022 nuk janë dhënë kilometrat e përshkruara në formatin “*Treguesit teknik të mjeteve*”. Nga auditimi rezulton se në formatin e sipërcituar është vendosur norma e konsumit të karburantit (gazoil) 10 litra (mesatarisht)/100 km, pa studim dhe procedurë të miratuar, për 7 mjetet nga kontrata leasing me targa AA 051YV, AA487YY, AA057YY, AA491YY, AA058YV, AA798YU, AA794YU. Por, në procesverbalin e datës 01.10.2019 për marrjen në dorëzim “*Mbi pranimin e 21 furgonçinave Ford Courier sipas kontratës “leasing” nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019*”, është konfirmuar se mjetet e reja të sipërcituara kanë një konsum të kombinuar 4.5 litra/100 km. Vendosja e normës së harxhimit të karburantit (gazoil) 10 litra/100 km, duke u nisur nga kilometrat të plotësuar në formatin “*Treguesit teknik të mjeteve*”, tregon se administrimi i karburantit nuk është në pajtueshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator, për aq kohë sa kilometrat nuk janë të konfirmuara, kur lëvizjet e automjeteve nuk janë autorizuar, dhe kur nuk ka një studim të miratuar, që argumenton ndryshimin dhe rritjen e normës së dhënë të kombinuar për harxhimin e karburantit. Sa më sipër bie në kundërshtim me pikën 1.11.4 “*Rregullat mbi përdorimin e automjeteve*”, si edhe me pikat 3 dhe 7, neni 28 në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, miratuar me ndryshimet e saj me Urdhrin nr. 556, datë 13.12.2018 të Administratorit të shoqërisë. Veprimet dhe mosveprimet e njësisë shpenzuese Filiali Tiranë, kanë sjellë rritjen e paargumentuar të normës së konsumit të karburantit (gazoil), dhe kanë shkaktuar si pasojë konsumin prej 7,793 litra naftë më tepër { [konsumi në litra/muaj – konsumi i llogaritur (km të përshkruara * 4.5 litra/100 km)] /1 muaj}. Nga të dhënat e siguruara, rezulton se është kryer pagesa në vlerën prej 1,160,531 lekë më shumë, nga përdorimi i automjeteve “*leasing*” për periudhën Maj 2021 - Shkurt 2022 {Vlera në lekë e paguar/muaj – vlera e llogaritur [(km *4.5 litra/100 km) /1muaj * çmimi mujor]}. Parregullsitë, sa më sipër, kanë sjellë si pasojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare SHA një përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në vlerën prej **1,160,531 lekë**. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 1.11.4 e “*Rregulla të përgjithshme mbi përdorimin e automjeteve*” në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, Pikat 3 dhe 7, neni 28 në Rregulloren e Brendshme të Filialit Tiranë, miratuar me ndryshimet e saj si dhe me Urdhrin nr. 556, datë 13.12.2018 të Administratorit të shoqërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative për nxjerrjen e përgjegjësive dhe më pas arkëtimin e shumë përkatëse ndaj personave përgjegjës, e cila aktualisht është në vlerën totale prej **1,160,531 lekë pa TVSH** dhe aktualisht¹⁰ është konsideruar si përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet i fondeve për shërbime të ofruara jo në përputhje me termat e kontratës, të lidhur sipas aktit me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 “*Qiraja financiare (Leasing)*”.

¹⁰ Deri në nxjerrjen e përgjegjësive.

14.2 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA të merren të gjitha masat e nevojshme për llogaritjen e vlerës së plotë të shumës së shkaktuar për shkak të dorëzimit të mjeteve jo në përpudhje me kushtet e kontratës. Kjo përllogaritje të kryhet në bazë të kostos shtesë që i është shkaktuar buxhetit të AK Posta Shqiptare për sasinë e konsumuar të karburantit me norma mbi ato të paraqitura në katalogët përkatës të mjeteve të ofruara. Në përfundim të kësaj, vlera e përllogaritur të kërkohet në rrugë ligjore për tu arkëtuar ndaj personave të gjetur me përgjegjësi përmes ndjekjes së të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe të gjitha shkallëve të gjyqimit.

15. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla konstatohet se referuar urdhrin nr. 194 datë 17.07.2019 për udhëtimet e disa punonjësve të Posta Shqiptare SHA jashtë shtetit, nga zyra e financës klasifikimi i shpenzimeve të paradhënies është kryer njëllor për çdo pozicion pune. Ky urdhër nuk është argumentuar sipas VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” referuar dokumentacionit të sjellë me observacionin nr. 909/59 prot., datë 06.10.2023, sepse klasifikimi i kryer për çdo person udhëtues është i njëjti për çdo pozicion pune, duke nisur nga pozicioni i administratorit, drejtori drejtorisë, kryetar dege dhe këshilltar. Si rrjedhojë në VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, nuk përcaktohet që paradhënia për klasifikimet e pozicioneve të mësipërme të jetë e njëjtë. Për këtë arsye nuk justifikohen shpenzimet e udhëtimit referuar urdhrave të paradhënies. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe Udhëzimi nr. 22 datë 10.07.2013 i Ministrisë së Financave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Nga administratori i Posta Shqiptare SHA dhe zyra e financës të analizohet vlera e efektit financiar negativ prej **6,434 euro** dhe të merren masa për korrigjimin e praktikave të shpenzimeve të udhëtimit jashtë shtetit, pa dokumentacion justifikues.

16. Gjetje nga Auditimi: Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me blerjet e vogla konstatohet se referuar urdhrin nr. 199 datë 07.08.2019 për udhëtimet e disa punonjësve të Posta Shqiptare SHA jashtë shtetit, nga zyra e financës klasifikimi i shpenzimeve të paradhënies është kryer njëllor për çdo pozicion pune. Ky urdhër nuk është argumentuar sipas VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” referuar dokumentacionit të sjellë me observacionin nr. 909/59 prot., datë 06.10.2023, sepse klasifikimi i kryer për çdo person udhëtues është i njëjti për çdo pozicion pune, duke nisur nga pozicioni i administratorit, drejtori drejtorisë, kryetar dege dhe këshilltar. Si rrjedhojë në VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, nuk përcaktohet që paradhënia për klasifikimet e pozicioneve të mësipërme të jetë e njëjtë. Për këtë arsye nuk justifikohen shpenzimet e udhëtimit referuar urdhrave të paradhënies. Sa më sipër është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe Udhëzimi nr. 22 datë 10.07.2013 i Ministrisë së Financave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqet nr. 124 – 133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Nga administratori dhe zyra e financës të shoqërisë Posta Shqiptare SHA të analizohet vlera e efektit financiar negativ prej **3,145 euro** dhe të merren masa për korrigjimin e praktikave të shpenzimeve të udhëtimeve jashtë shtetit, pa dokumentacion justifikues.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

E.1 Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat b, c dhe ç, neni 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, nenin 37 të “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, kontrata individuale e punës, i rekomandojmë **Këshillit Mbikëqyrës** pranë institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit marrjen e masës disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”** për z. **A. D.** në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Posta Shqiptare SHA:

- Për mangësitë e konstatuara në praktikën me objekt *“Blerje e vendosje sisteme të integruara të sigurisë (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi CH4, CH8, CH16), sisteme inteligjente (SMART) të sigurisë CH4, CH8, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit”*;

- Për mos marrjen e masave të nevojshme për vënien në përdorim të investimit të kryer sipas kontratës me objekt *“Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë”*, për të cilën AK ka lidhur kontratën përkatëse me vlerë **47,500,000 lekë pa TVSH**. Konkretisht për pajisjet objekt kontrate rezultoi se asnjë nga pajisjet nuk është funksionale me argumentimin e dhënë nga grupi i ndjekjes kontratës se i ka mbaruar afati sistemit Cloud, sistem ky i domosdoshëm për funksionim e pajisjeve MAK;

- Për mos marrjen e masave të nevojshme për vënien e plotë në përdorim të investimit të kryer sipas kontratës me objekt *“Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë”*, për të cilën AK ka lidhur kontratën përkatëse me vlerë **7,572,000 lekë pa TVSH**. Konkretisht për pajisjet objekt kontrate, pas një inspektimi në terren rezultoi se disa nga pikat ku janë montuar kutitë postare sipas proces-verbalit bashkangjitur dosjes së prokurimit, shumë prej tyre në hyrjet e pallateve nuk ishin funksionale pasi nuk përmbanin as emrin dhe as nr. e apartamentit të banorëve dhe njëkohësisht Administratorët e pallateve nuk dispononin kopje të çelësve për aksesimin e kutive postare;

- Për miratimin e fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje kancelari dhe zarfa”* në kundërshtim me kuadrin ligjor e rregullator të prokurimit publik e me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **20,404,683 lekë pa TVSH**;

- Për mangësitë e konstatuara në drejtim të programeve ekonomiko – financiare për periudhën takuese të drejtimit të institucioni;

- Për mangësitë e konstatuara nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Mirëmbajtja e Data Center”*, viti 2022 nga ku rezultoi se nga ana e AK Posta Shqiptare SHA gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit për mirëmbajtjen e Data Center nuk është marrë në konsideratë menaxhimi i duhur i burimeve të shoqërisë, pasi pjesët hardware dhe sistemet e objekt kontrate mund të ishin menaxhuar dhe mirëmbajtur nga vetë specialistët e institucionit. Gjithashtu, po në këtë praktikë rezultoi se gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, në përlllogaritjen e fondit limit nuk janë marrë në konsideratë çmimet e pajisjeve

që do të mbulohen me mirëmbajtje, duke bërë që kostoja e mirëmbajtje të kalojë edhe çmimin përkatës të blerjes;

- Mos kryerjen e një analize të detajuar kosto – përfitim gjatë ushtrimit të funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm për Posta Shqiptare SHA, përpara zhvillimit të procedurave të prokurimit për periudhën 2019 – 2022, të fituara nga një OE i vetëm HELIUS SYSTEM, me vlerë totale të kontratave të lidhura në shumën prej 178,150,000 lekë pa TVSH;

- Për mangësitë e konstatuara nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje Hibrid Mail*”, për të cilën rezultoi se jo vetëm që nuk është kryer një analizë kosto përfitim për një menaxhim sa më efektiv të shpenzimeve në mospërputhje me praktikën më të mira, por përkundrazi rezultoi se nga momenti që është vënë në përdorim deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit, kontratat e lidhura nga AK Posta Shqiptare SHA me subjektet e tjera, janë minimale në vlerë dhe nuk sjellin përfitime për përdorimin e një sistemi të tillë. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2022 është realizuar dhe një procedurë prokurimi për mirëmbajtjen e sistemit në fjalë me bojëra teknologjike, për një vlerë prej **12,580,000 lekë pa TVSH**, nga i njëjti operator ekonomik S. A., vlerë e cila nuk e mbulon fitimin e përdorimit të sistemit gjatë kësaj periudhe. Njëkohësisht, nga auditimi rezultoi se e njëjta procedurë prokurimi është zhvilluar dhe gjatë vitit 2023 për një vlerë prej **11,599,165 lekë pa TVSH**;

- Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore që rregullon strukturën organizative dhe dhënien e pagave dhe shpërblimeve të institucionit. Konkretisht në këtë drejtim rezultoi se:

- a. *Nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive*

- b. *Në shoqërinë Posta Shqiptare SHA nuk ekziston një procedurë rekrutimi të punonjësve;*

- c. *Deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura;*

- d. *nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar hapat që ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.*

- e. *Përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj.;*

- f. *Për disa pozicione pune nuk është përcaktuar kriteri i arsimit si domosdoshmëri për përmbushjen e funksionit të detyrave të pozicionit të punës.*

- Për mangësitë e konstatuara në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit;

- Për mangësitë e konstatuara në drejtim të detyrimeve të institucionit për sa i takon pagesave të kryera si rrjedhojë e largimeve të padrejta nga puna;

- Mangësitë e konstatuara në drejtim të konsumit të karburantit;

- Mos marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm;

- Etj.

E.2 Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 - Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, neni nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Statutit të Shoqërisë si dhe Kontratës kolektive për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare SHA, kërkojmë nga Këshilli Mbikëqyrës si dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i institucionit të Posta Shqiptare SHA fillimin e procedurave për dhënie masash disiplinore për punonjësit të cilët janë konstatuar me shkelje nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit si më poshtë:

“*Vërejtje*” deri në “*Largim nga puna*” sipas nivelit të përgjegjësisë dhe shkeljeve për punonjësit e poshtë shënuar:

1. **A. S.**

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje tonera dhe bojëra printeri”* me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **3,340,912 lekë pa TVSH**;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit të kontratës me objekt *“Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë”*;

2. A. V.

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

3. A. K.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje tonera dhe bojëra printeri”* me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **3,340,912 lekë pa TVSH**.

4. A. V.

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Tiranë, Durrës, Qendra Tranzite, Ndryshime ndarjesh për shkak të ndryshimit të strukturës dhe Ndryshimi i ndriçimit nga floureshent në led (322 copë) në Godinën e Drejtorisë së Përgjithshme”* si dhe në procedurën me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”*;

5. A. C.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë, konkretisht për mosrespektim të Urdhrit të brendshëm nr. 39/1 datë 23.09.2019 me nr. 1264/3 prot., datë 23.09.2019;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të konsumit të karburantit nga OE M.N M.S SHPK me të cilin është lidhura kontrata me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 *“Qiraja financiare (Leasing)”*;

6. A. M.

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

7. A. B.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje pjese këmbimi për automjetet e tipit Nissan NV300”*;

8. B. B.

Për mangësitë e konstatuara në ushtrimin e funksionit të anëtarit të Njësisë së Hartimit të Specifikimeve Teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje Kutit Postare me çelës për paketa për klientë”*, viti 2021;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”* me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **20,826,403 lekë pa TVSH**;

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Tiranë, Durrës, Qendra Tranzite, Ndryshime ndarjesh për shkak të ndryshimit të strukturës dhe Ndryshimi i ndriçimit nga floureshent në led (322 copë) në Godinën e Drejtorisë së Përgjithshme”* dhe në atë me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”*.

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”*

9. B. A.

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje kancelari dhe zarfa”* me pasojë dëmin ekonomik në shumën prej **11,990,389 lekë**;

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrave si Drejtor i Burimeve Njerëzore;

10. B. H.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 17/35., datë 20.04.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt *“Blerje tonera, bojëra printer”* me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **187,664 lekë**;

11. B. L.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të grupit të hartimit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje pjese këmbimi për automjetet e tipit Nissan NV300”*’;

12. D. G.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të komisionit të prokurimit në vlerë të vogël;

13. D. M.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4 Traktor (3 kopje)”* me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **20,826,403 lekë pa TVSH**;

14. E. L.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 17/35, datë 20.04.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt *“Blerje tonera, bojëra printer”* me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **187,664 lekë**;

15. E. S.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës për përcaktimin e specifikimeve teknike sipas shkresës nr. 381 prot., datë 08.02.2019 në procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”*;

16. E. A.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/93, datë 23.03.2023 të Titullarit për ndjekjen e zbatimit të kontratës me objekt *“Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “Traktor” (3 kopje)”* me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **658,657 lekë**;

17. E. Q.

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje kancelari dhe zarfa”* me pasojë dëmin ekonomik në shumën prej **11,990,389 lekë**;

18. E. M.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ushtrimit të detyrës si anëtare e Grupit të Punës për analizën e kostos dhe efikasitetin procedural për procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”*;

19. E. C.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtare e komisionit të prokurimit në vlerë të vogël;

20. E. B.

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

21. F. Gj.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës për përcaktimin e specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje Kuti Postare me çelës për paketa për klientë”*;

22. F. H.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të konsumit të karburantit nga OE M. N M.S SHPK me të cilin është lidhura kontrata me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 *“Qiraja financiare (Leasing)”*;

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të komisionit të prokurimit në vlerë të vogël.

23. G. K.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/93, datë 23.03.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt “Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)”;

24. G. J.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës s anëtar i komisionit të prokurimit në vlerë të vogël;

25. H. K.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar i komisionit të ofertave në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje palmar profesional, barkod reader me Wireless, lexues barkodesh”;

26. H. M.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ushtrimit të detyrës si anëtar i Grupit të Punës për analizën e kostos dhe efikasitetin procedural për procedurën e prokurimit me objekt “Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”;

27. H. B.

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar i grupit të hartimit të specifikimeve teknike në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pjese këmbimi për automjetet e tipit Nissan NV300”;

28. I. K.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/93, datë 23.03.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt “Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)” me pasojë përdorimin pa efektivitet, eficiency dhe ekonomicitet të fondeve në shumën prej **658,657 lekë**;

29. J. K.

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

30. L. M.

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të pasqyrave financiare;

31. L. M.

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

32. M. Z.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtare e Komisionit të Vlerësimit Ofertave në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”;

33. M. H.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtare e komisionit të prokurimit në vlerë të vogël;

34. N. Ll.

Pas mangësive të konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës si anëtar i Njësisë së Prokurimit;

35. O. M.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/93, datë 23.03.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt “Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)”;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3, Letër A5-Traktor (3 kopje), Letër A4

Traktor (3 kopje)” me pasojë përdorim pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve në shumën prej **20,826,403 lekë pa TVSH**;

36. Q. H.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të hartimit të fondit limit në procedurën e prokurimit me objekt *“Leasing për automjete e motoçikleta për 4 vite”*;

37. R. Ll.

Për mangësitë e konstatuara gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të komisionit të ofertave në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i zyrave postare të filialeve Vlorë Sarandë, Gjirokastër”*;

38. S. Z.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit të kontratës me objekt *“Blerje kuti postare restante dhe kuti postare për klientë”*;

Për mangësitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, në procedurën e prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i Filialeve të Postës Shkodër, Lezhë, Mat dhe Kukës”*;

39. Sh. K.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë, në cilësinë e Drejtorit të Filialit Tiranë;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të konsumit të karburantit nga OE M.N M.S SHPK me të cilin është lidhura kontrata me nr. 1767/14 prot., datë 16.09.2019 *“Qiraja financiare (Leasing)”*;

40. Sh. I.

Pas mangësive të konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë;

41. T. H.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të zbatimit Urdhrit nr. 5/83, datë 22.02.2023 të Titullarit për ndjekjen e kontratës me objekt *“Blerje letër A5 “ Traktor” (3 kopje), letër A4 “ Traktor” (3 kopje)”*;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ndjekjes së kontratës me objekt *“Blerje e vendosje sisteme të integruara të sigurisë (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi CH4, CH8, CH16), sisteme inteligjente (SMART) të sigurisë CH4, CH8, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit”*;

42. V. D.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të kontratave të qirasë, konkretisht për mosrespektim të Urdhrit të brendshëm nr. 7 datë 17.05.2021.

43. Xh. H.

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ndjekjes së kontratës me objekt *“Blerje e vendosje sisteme të integruara të sigurisë (sisteme alarmi, sisteme vëzhgimi CH4, CH8, CH16), sisteme inteligjente (SMART) të sigurisë CH4, CH8, programi i shëndetit të pajisjeve të sigurisë dhe programi i monitorimit të sistemeve të alarmit”*;

Për mangësitë e konstatuara në drejtim të ndjekjes së kontratës me objekt *“Blerje e vendosje pajisje sigurie (kamera vëzhgimi (VVTV), kamera për automjete, sisteme alarmi, Video Wall për monitorimin e sistemeve të sigurisë”*.

Për ish punonjësit nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë më në marrëdhënie pune me këtë shoqëri dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte nga *“Vërejtje”* deri në *“Largim nga puna”*, sipas rastit.

SHËNIM:

Në përfundim të auditimit rezultoi se të paktën 8 procedura¹¹ me vlerë të prokuruar 219,517,888 lekë pa TVSH dhe vlerë të kontraktuar 201,458,948 lekë pa TVSH të mos jenë audituar nga ana e audituesve shtetërorë të KLSH. Me qëllim mbulimin me auditim të të gjithë periudhës, këto procedura, vlera e të cilave përbën 57 % të vlerës totale të kontratave të lidhura për këtë vit, do të jenë subjekt i një auditimi tematik nga ana e KLSH.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

¹¹ Lista e procedurave jepet sipas aneksit 2.3.a